

BH-31
8'25

Fatmir Gjata

Fëmijë primore

roman

8/11/21
8/25

FATMIR GJATA

FILLIM PRANVERE

Roman



63713

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KATIMER CATALOG

FILM DRAHARE

YUGOSLAVIA

Tirazhi 14000 kopje Format 78 x 109/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re — Tiranë, 1977

1. Vjeshta e atij viti filloj me një lajm të ri, që solli shqetësimë të tjera në fshat. Nuk ishte përmbytje nga ujërat e Devollit e të përrrenjve, as shtrëngatë me erë, që thyen plepat me krismë dhe ngre hatullat e kasolleve dhe që, në ato anë e quajnë «cangonjarka», ishte një urdhëressë e pushtetit të ri, po që i ngjante një stuhie. Njerëzit uleshin mbrëmjeve rrëth vatrës dhe këmbenin mendime gjer vonë natën, ca të tronditür, ca të shqetësuar e të heshtur, ca të zemëruar, ca të gëzuar. Fshatarët e varfër trokisnin lugët e drunjta mbi sofër dhe thonin me bindje, me zë të lartë:

K A P I T U L L I I

— Vendimi është i drejtë, se është pér ne, të varfrit!

Të mesmit më shumë heshtnin dhe s'dinin nga t'ia mbanin, kurse kulakët dukeshin si cironj, me sy e gojë të hapur, që i nxjerr dallga në stere e mezi marrin frymë...

Atë pasdite, Nuri Zyberi doli në kopsht dhe vështroi qiellin e vrenjtur përmes mollëve që kishin mbetur të blerta, me pika ngjyrë kafe në lëkurë. Përtej jazit nga rruga e pazarit, dukeshin brigjet e Devollit me korije shelgjishtesh, shkurre e kumbulla të egra. Kjo korije diku mbulohet nga mjegulla e bardhë, diku shkëlqente si e spërkatur me vesë. Më tej akoma shtrihej këneta e murrme. Atje kishte filluar fazë e dytë e punimeve pér t'i kthyer ujërat e fjetura në toka pjellore. Po kishin rënë shumë shira dhe syri i pamësuar e kishte vështirë të dallonte kufirin midis lomit e kënetës.

Nuriu ndjeu lagështirën që buronte nga këneta dhe fërkoi gjunjët, që i dhembnin. Me siguri, mendoi, edhe qyteti e ndien këtë lagështirë të padurueshme dhe, me systë e tij të fortë, dalloi atje tej, në jug, gjashtëmbëdhjetë kilometra larg, majat e maleve të qytetit. Atë çast një njeri po dilte nga këneta. Me ta parë, Nuriu e njohu udhëtarin dhe rënkoj fort, sikur të ishte i sëmurë, pa ua hequr vështrimin valëve të lehta që i frynte juga. Këto valë, të rraskapitura nga lëvizja e pérhershme, sillnin në kufijtë e fshatit ngjalat e majme, mëlyshët e bardhë, mrenjkën e vogël me mustaqe të verdha dhe krapin e madh, me gojën si të spërkatur me flori. Po s'ishte kohë për peshkim. Kur udhëtar u duk te qoshja e gardhit që rrëthonë kopshtin e madh, Nuriun e pushtoi një ndjenjë e hidhur.

— Merre gazeten!, — i tha udhëtar pa e përshtendetur duke ia zgjatur sipër gardhit. Nga supet e tij ngriheshin avuj të bardhë.

— Qenke bërë për ibret! Përmes kënetës erdhe?, — e pyeti Nuriu duke palosur gazeten.

— Ka dalë Devolli. Det dynjaja! Megjithatë i rashë për shkurt.

— Po pse kështu, more Malkë! Do të marrësh ndonjë reumatizmë, më keq se unë, — e zbuti zërin Nuriu duke parë me keqardhje të shtirur opingat e udhëtarit, që ngjiteshin pas baltës si rrëshirë.

— Jam mësuar!, — tha udhëtar. — Pastaj dita tani është shkurtuar. Duhet vënë përpara. Kështu na mëson pushteti ynë.

— C'lajme na sjell?

— I ke në gazetë, — u përgjigj Malka, që avullonte i téri, nga kasketa e vjetër gjer te pantallonat prej shajaku, me kopsa anës këmbëve.

Nuriu bëri sikur lexoi diçka në gazetë dhe tha me vete: «Pushteti ka trashëgimtarë, more qen!» Pastaj e ngriti zërin e tha, sikur arsyetonte me veten e vet:

— Kështu na mëson, kështu! Tani jemi njësoj të gjithë, njësoj, o Malkë, si këmbët e dhisë.

Udhëtari mbështolli qafën e dobët me jakën e setrës, shtrëngoi duart e lidhura në kraharor, ku mbante gazefat dhe, si e zgjati një herë qafën e hollë, tha me zë të kumbueshëm duke theksuar me tallje fjalën «xhaxha...»

— Po njerëzit, nuk janë si këmbët e dhisë, o «xhaxha», — dhe u largua duke qeshur, ndërsa Nuriu ngriu nga habia dhe nga ajo ndjenjë e hidhur që e pushtoi sa pa udhëtarin të dilte nga këneta.

Nga gazeta mori vesh se qeveria kishte nxjerrë një urdhëresë të përkohshme, sipas së cilës fshatarët duhej t'i dorëzonin pushtetit, kundrejt pagesës, tërë tepricën e bëreqetit. E lexoi lajmin me një frymë, diçka tha nëpër dhëmbë dhe me të hyrë në dhomë e hodhi gazeten në zjarrin e vatrës. E bija, një vajzë e shëndetshme dhe mjaft e llastuar, po torollake e llafazane, u mat ta pyeste, po, kur e pa të atin të vrenjtur nga zemërimi, e mbylli gojën për një çast.

— Kemi lajme të këqia nga qyteti!, — mërmëriti Nuriu dhe, siç e kishte zakon kur zemërohej, filloi të shajë.

— C'ka ndodhur, baba?, — e pyeti e trembur e bija.

Ai fliste me dëshpërim, ankohej se i qe mërziturjeta, i binte gjoksit me histerizëm dhe, nga ato që thoshte, e bija nuk kuptonte gjë prej gjëje.

— Po shpresat jote është e kotë!.. Ty, as zoti e as shej-tani nuk të njobin për pushtet!.. Pushteti ka trashëgimtarë, more qen!.. Këmbët e dhisë!.. këmbët e dhisë!..

Vajza ia dinte huqet, i bëri shpejt një kafe dhe e mori me të mirë:

— Baba! Përse thua që ta hëngrën shpirtin? Ti je kaq mirë me shëndet... .

Ai nuk iu përgjigj. Duke pirë kafenë, fliste me zë të lartë, me dikë tjetër, që nuk ishte atje:

— Bukur fort! Bukur fort! Ti thua të hamë njëri-tjetrin, të ngordhim! Mirë, besa!... Por, jo, more djalë! Jo! Eshtë shpejt akoma!... Me gjithë mend kujton se e hode vrahun?!

U ngrit rrëmbimthi dhe rrëzoi froni ku qe ulur. Sy-

të i qenë turbulluar dhe duart e ashpra i dridheshin lehtë. Së bijës i hyri frika në palcë dhe ishte gati të shpërthente në ngashërim. Ai as që e vuri re. Tundi grushtet në ajër, sikur kërcënonte njeri, dhe shfryu tërë duf:

— Derrat! S'u mjaftoi toka që më rrëmbyen! S'u mjaftuan qetë, kuajt dhe vreshtat! Tani dashkan edhe be-reqetin! I përplasi këmbët në truallin e ngjeshur të çardhakut dhe u nis për në fushë.

Qelli ishte zgjeruar. Toka e bymyer nxirrte avull të ngrohtë si buka nga çerepi. Po atë nuk e gjëzoiëmbëlsia e ajrit, as dielli që po perëndonte në horizontin e kuq. Ekte me hap të shpejtë, i pushtuar nga urrejtja dhe nga tmerri për atë që kishte vendosur të bënte. Po urrejtja ishte më e fortë se tmerri. Ajo e bënte të ecte gati me vrap, duke gulçuar, dhe të ndiente një farë ngushëllimi. Nganjëherë ajo i përzihej me flatrat e blerta të shpresës, si në një ëndërr të bukur, dhe i dukej sikur do të kthehej përsëri lumturia që kishte shijuar në të kaluarën jo shumë të largët.

Kishte humbur i téri në këto përfytyrime të mpeksura si gardh. Gjaku i vërvshonte i valë nëpër trup dhe i vinte mirë që ishte ende i fortë e i gjallë. Nganjëherë i buçisin veshët, dëgjonte zhurmëra të kumbueshme dhe i dukej sikur gjithshka në tokë e në quell po shëmbej. Po papritur, në trurin e lodhur, i fekste një dritë shprese, drita e verbët e urrejtjes çnjerëzore. Ajo ia kishte pushtuar tërë qenien dhe e kishte verbuar aq shumë sa u habit kur, ballë për ballë tij, i doli një njeri i ngarkuar me misërishte, sikur i mbiu nga dheu. Fshatari po kthehej nga fusha, çalë-çalë, me barrën e rëndë mbi kurriz dhe nuk e kishte mendjen fare se ç'bëhej rrëth tij.

Nuriu nuk e përhëndeti. Ndjeu një dhembje në zemër dhe e pyeti duke marrë frymë me zor, sikur të kishte vrapuar:

— S'i paske qetë, o Qamil?

Fshatari ngriti kokën përfund misërishteve. Ftyra e tij shprehte habi. Me emrin e vërtetë atë e thërrisin pak njerëz. Shumica e thërrisin «Çalo». Nuriu kurrë s'e kishte

thirrur me emër. Prandaj u habit fshatari. Picërroi sytë e vegjël dhe u përgjigj pa e parë:

— Po i kullozin fëmija...

— Ç'kemi nga fusha?

— Janë fryrë kallépët, sa po pëlcasin. Le ajo ara jote njéherë! Mos pyet! Një kallép, një flori!

— Ç'e do!

Nuriu donte të thoshte: s'do ta hamë vetë, po ndërroi mendje.

— Ç'e do!, — tha. — Ka dalë një urdhër i ri. A e more vesh?

— E, e!, — ia bëri Qamili sikur ta kishte kuptuar mendimin e fshehtë të Nuriut. — Kështu thonë. Po ka aty edhe pér ty, edhe pér të tjerët.

«Çaloja i halesë!», shau Nuriu me vete dhe përsëri i foli me të mirë:

— Si i ke qetë? A ua del gruaja t'u bëjë hyzmet?! Hajde, Qamil, hajde! Ia hipe kësaj radhe. U bëre, si i thonë, me dy këmbë.

Fshatari ia nguli vështrimin në sy, qetë-qetë. E kuptoi që Nuriu atë çast thoshte me vete: «Hap sytë mos thyesh edhe këmbën tjetër». Nuk dinte ç'përgjigje t'i jepte.

— Pse s'më përgjigjesh? Unë po të pyes si njeri. A të bëjnë ndonjë çikë pleh?

Nuriu mezi mbante të qeshurën. Fshatari e kuptoi që ai po nxirrte vrer, megjithëse e përbajti veten dhe u përpoq të tregohej i mirë e i dashur.

— Po fol, bre, një fjalë! Pér pleh të pyeta.

Fshatari tundi kokën dhe nga balli i pikuan përdhe rruaza djerse. U përgjigj qetë:

— Po urdhéro, zotrote, dhe e pesho!

— A, jo kështu! Jo kështu!, — tha Nuriu duke e përbajtur zemërimin. — Në fund të fundit, dihet se të kujt janë qetë, dihet.

— E të kujt janë?, — pyeti me vërvshëllima Qamili.

— Ja, ja, qerratai, sikur s'e di... Nejse!

— Të kujt pra?, — nguli këmbë Qamili, i mbuluar në djersë nga pesha e rendë dhe nga inati.

Nuriu rrahu gjoksin përpara fytyrës së skuqur e të parruar të fshatarit:

— Të mitë janë! Të mitë!

Qamili hodhi barrën e misërishteve përdhe dhe atëherë u duk trupi i tij, i vogël e i thatë. Meqë njérën këmbë e kishte sakate, dukej sikur krekozej. Po në të vërtetë ishte njeri i thjeshtë. Kur nxohej, dukej tepër qesharak. Po atëherë duhej të ikje prej tij, se ai s'nihi c'është frika e forca e tjetrit. Të përfshinte me duart si çengelë e të përplaste pér tokë pa mëshirë. Kur e shihte keq punën, vinte në veprim dhëmbët dhe kishte borxh të të pështynte nga goja veshin e shkulur.

E mati njëherë Nuriun me sy. Ky duket e ndjeu rrezikun dhe bëri një hap prapa. Atëherë Qamili i tregoi bërrylin dhe i tha:

— Hip këtu e shih Stambollë, që të marrësh vesh se të kujt janë qetë!

— Ore, Çalo!. — thirri Nuriu dhe një damar i kërceu në ballë. Po nuk guxoi t'i turrej. Qamili hodhi barrën në kurriz dhe u nis çalë-çalë drejt fshatit. Atëherë Nuriut iu mbushën sytë me lot. Në zemërim e sipër kafshoi cepin e djathtë të buzës dhe ajo sakaq iu skuq nga gjaku.

— Epo unë ende s'kam vdekur, — tha Nuriu në kulmin e dëshpërimit dhe eci me hap të shpejtë drejt fushës. — Po unë jam gjallë dhe gjersa jam gjallë, di se g'bëj me mallin tim! Di unë se ç'bëj! Di unë t'i them derrit dajë!

Kur hyri në arën me misër kishte filluar të errej. Tani edhe shpirti i tij ishte bërë si nata. Sa shumë ishin shkurtuar ditët! Mëngjesi ende i mbante sytë hapur pak si gjatë, kurse mbrëmja e lëshonte perden e rëndë menjëherë, bëhej shpejt errësirë dhe zhdukej çdo gjë. Kishin mbetur vetëm zhurmërat e natës, të qeta, të mybutura, që nganjëherë ktheheshin në klithma të frikshme. Nga larg dëgjohej fëshfërima e krahëve të rosave të egra, që binin ujërave të kënetës si popla e si gurë. Dëgjohej edhe gumëzhima e pandëprerë e lumi. Vetëm rrallë klithte ndonjë shpend nate. Nën këmbët e tij llapashitej balta, thyhej e ngjishej bari e krisja e thatë, megjithëse ai përpiquej të çante hendeget pa zhurmë, e të rrëshqiste si ngjala në ujë.

Hëna e zuri në mes të arës. Xhufkat e misërishteve iu

dukën si tē spērkatura me flori. Kallépët ishin tē mëdhenj e tē rëndë si granada. Kur hëna u fsheh përkohësish pas një reje, qelli u bë më i ndritshëm, ndërsa reja më e zezë, me ca si azhure tē shkëlqyera përreth. Atëherë ai u bind se bereqeti ishte i mbarë, shumë më i mirë se sa i tokave fqinje. Ai s'e kishte mbajtur kot arën më tē mirë gjatë Reformës Agrare. Zhveshi një kallép që i kishte fletët tē lagura dhe përtypi ca kokrra.

— Qenke bërë, o i uruar! Qenke bërë!, — Po duke kujtuar urdhëresën, i pështyu, sikur tē kishte helm në gojë. Menjëherë iu zhduk ai pakëz gjësim dhe i mbeti vetëm një shije e hidhur, e padurueshme.

— Ç'të bëj me ty, o i uruar? Të tē lë dhe tē tē hanë tē tjerët?

Nuriu, që ishte mësuar denbabaden tē rronte me djer-sën e botës, nuk mund tē duronte që puna e tij t'i shërbente ndokujt tjetër, përveç familjes së tij.

I ra edhe një herë arës tejembanë duke përkëdhelur mustaqet e shkrifta tē misrave. Gjethet fëshférinin lehtë, sikur merrnin frymë, po ai nuk e kishte mendjen atje. Natyra, misri, bota e tërë ishte shkrirë në një hidhërim tē madh dhe diçka nga ky hidhërim i qe shkrirë në gojë me pështymën dhe në shpirt, me gjakun e turbulluar.

«Jo. Nuk do t'ua le horrave tē mallëkuar!» mendoi.

Më në fund vendosi dhe tha me zë:

— Kjo do tē ndodhë. Në mos sot, nesër. Këtë e kam ditur. E kam pritur. Në mos ndodhë edhe ndonjë gjë më e keqe...

Këputi edhe një kallép, i cili u thye me një krismë tē thatë. I treti qe ende i njomë dhe mezi e shkuli duke e përdredhur dy-tri herë. Me tē tjerët e pati më lehtë. I këpuste dhe i hidhëtë në hendekun plot me ujë, nga fluturonin tē trembura çafka e rosa tē vetëmuara. Pastaj, si fshiu djer-sët e ftohta nga balli, filloj t'i shkulë misërishtet me gjithë rrënëjë, i thyente, i shtypte me këmbë, i ngjishte në baltë:

— Farmak tē marrin, farmak!

Dukej si një derr i egër e i uritur që zbret natën nga korita e Malit tē Thatë dhe gérmon azat në fushat me misër. Nuk i ndjeu djersët që po i kullonin, nuk i ndjeu duart

që i ishin prerë nga fletët e mprehta, nuk i dëgjoi arixhinjtë që ziheshin aty, përtej lëndinave. Vendosi ta prishë breqetin, që të mos i dorëzonte shtetit asnjë kokërr. Se shteti i ri ishte armiku i tij më i rrezikshëm. Shteti i ri i kishte marrë tetëdhjetë e pesë dynym tokë, dy pendë qe, dy buallica, dhe ua kishte dhënë fshatarëve të varfër.

...Atëhere, kur ishte hapur fjala se do të bëhej Reforma Agrare, Nuriu fshehurazi e me shumë kujdes, u kishte thënë fshatarëve që ende kishin një farë nderimi për të:

— E ku po na shpie mushka, o derëzinj! Toka është e zotit, kurse qeveritë hipin e bien. Pak ranë në kohë të Italisë?! Po, ja, për shembull, erdhi amerikani. Ku të futemi e si do t'i lajmë gjynahet?

Ca fshatarë edhe u shqetësuan nga këto mendime. Fjalët u përhapën, njerëzit u bënë më të myllur. Kur i dëgjoi, Malka shkoi menjëherë te Nuriu:

— «Xhaxha» Nuri, — i tha gjithnjë duke i rënduar me tallje fjalës xhaxha, — duhet t'i vesh fre gojës. Toka ka qenë jotja dhe ta kanë punuar hyzmeqarët! Tani do të të lëmë aq sa të takon e ta punosh vetë. Pjesën tjetër do ta marrin të varfrit. Sa për gjynahet, ne i lamë kësaj rade një herë e mirë!

Nuriu u tremb, po dhe u bind se ajo që kishte vendosur Partia do të bëhej pa një pa dy. Atëherë ia mori një këngë tjetër:

— Po jo, more bir, more Malkë, xhaxha Nuriu s'është nga ata burra që llap poshtë e përpjetë! Të kanë gënjer. Sigurisht keq më vjen, po edhe zemra më bëhet mal, ama! Merrini ç'ju takojnë! Të rrojmë të gjithë si njerëz!

Edhe këto fjalë u përhapën shumë shpejt dhe ndokush tha:

— E shikoni se si ndryshoi edhe xhaxha Nuriu? Po Nuriu nuk kishte ndryshuar asnjë qime. Përbrenda e gërryenin urrejtja dhe tërbimi, si ndryshku hekurin, kurse në fytyrë i mbiu një buzëqeshje e shtirur dhe e ftohtë...

Gërmoi arën një orë të tërë, duke kujtar se e kishte prishur të gjithën. Po në një interval të vogël pushimi pa

se kishte dëmtuar vetëm një pjesë fare të vogël. Edhe sikur tē punonte gjithë natën, nuk do të arrinte dot ta sheshonte. Mallëkoi veten që nuk mori një drapër nga shtëpia, megjithatë mërmëriti:

— Puna e filluar do mbaruar, — dhe papritur ndjeu një lodhje kau në tërë trupin.

Ndërkaq se kush thirri matanë lëndinavë, siç thërret stopani pér tē lëshuar bagëtinë. Nuriu u tremb dhe u hodh një hendekun me ujë.

— Dikush më kullauziti!, — mërmëriti dhe mishtë iu ngjeth nga tē ftohtit. Duke marrë frymë ngadalë, tërë sy e veshë, dëgjoi zëra njerëzish, angullitjen e një qeni dhe lebetitjen e një fëmije. Më në fund e kuptoi se po ziheshin arixhijtë, doli me një tē kërcyer nga hendeku dhe, pa menduar gjatë, me hap tē shpejtuar, shkoi te çadrat e tyre.

Arixhijtë e prenë sherrin. Gratë dhe ca burra hynë me tē shpejtë në çadrat e grisura. Si duket, s'ua kishte qejfi që një i panjohur tē merrte vesh arsyen e grindjes së zakonshme. Pranë zjarrit tē tulitur, në prushin e tē cilit po piqeshin misrat e njomë, qëndroi një arixhi i ri, me nofulla tē kërcyera.

— Tungjatjeta, o trim!, — e përshëndeti Nuriu duke i zgjatur dorën e qullur, tërë baltë e tërë tē prera tē holla.

— Ngjatjeta, aga!, — u përgjigj djali dhe u përpoq tē mbulojë misrat me hi.

— Léri tē piqen, léri!, — e këshilloi Nuriu me zë tē bütë, tē pikelluar. — Gjynah tē flenë fëmijët pa futur gjë në gojë! S'u bë kijameti pér dhjetë kallëpë misër. Si u ngrysët?

— Shyqyr zotit, aga!

Arixhiu filloi t'i qajë hallin dhe, duke e kujtar pér pojak, i kërkoi tē falur pér misrat që kishin këputur fëmijët në një arë aty pranë.

— S'ka gjë!, — e ndërpree Nuriu. — Është ara ime. Mund tē merrni sa tē doni! Njerëz jemi, dhe tē gjithë një perëndi kemi.

Arixhiu u qetësua dhe nagasi zjarrin. I tregoi se si një nga ata tē këshillit tē fshatit kishte dashur t'u mbante një

kalë që kishte hyrë azat në një arë me misër, se si kishin mbetur gjithë ditën pa futur gjë në gojë, se si ishin grindur me njëri-tjetrin për punë të shpérnguljes. Nuriu e dëgjoi me vëmendje. Më në fund e përkëdheli arixhinë në shpatulla dhe e pyeti:

- E si i dhatë karar, o trim? Kur do të ikni?
- Nesër, që pa gdhirë.
- Nga vendosët t'ia mbani?
- Rrjedhës së lumi, gjersa të dalim në vendet e ngrohta.

Arixhiu u ngrit, fshiu me pëllëmbë sytë që i dogjën nga tymi dhe shtrëngoi brezin e gjerë me vijëza. Nuriu i rrahu përsëri shpatullat:

— E di ç'të bësh ti, o kapedan! Mblidh kuajt dhe lëshoi në misrin tim! Thuaju edhe burrave, grave, edhe fëmijëve. Vilni e mbushni thasët!...

Arixhiu syzi, i frikësuar, tundi kokën me dyshim. Nuriu e kuptoï ç'donte të thoshte.

- Hajt, dhe mos kini frikë!
- Burgu, aga!, — belbëzoi djaloshi, po në zërin e tij dallohej fare qartë gëzimi i papërmabjatur.
- S'të pyet njeri e s'të trazon njeri. Është ara ime. Me mallin tim bëj ç'të dua! Pse? S'paskam të drejtë të bëj një të mirë? Pastaj, kush ka nge në këtë rrëmuje të merrët me ju? Dhe ku do t'ju gjejnë?

Arixhiut edhe i vinte mirë edhe nuk vendoste dot. Nuriu, me dorën që i dridhej lehtë, sa herë që kishte të bënte me pare, nxori nga quesja një grusht monedhash dhe ia ngjeshi arixhiut në pëllëmbën e ashpër. I ra lehtë me bërryl në ije:

— Merri dhe mos humb kohë, kapedan, se do të bëhesh pishman!

Koroziu futi paret në xhepin e kilotave të zeza, uli takjen e bardhë mbi sy dhe hyri në çadrën që ishte më pranë zjarrit. Nuriu dëgjoi gjuhën e pakuptueshme që u fol aty brenda. Pas pak pa pesë njerëz që dolën rrëmbimthi dhe u zhdukën si hije mes çadrave të tjera dhe lëndinave ku ishin penguar kuajt.

— Ryshfeti e qelepiri janë të ëmbël e të nxjerrin në selamet, — mendoi Nuriu duke ndezur cigaren me një shkarpë të hollë maja e të cilës lëshonte një flakë të vogël e të zbetë!

2.

Filloi të fryjë veriu, një erë e thatë dhe e ftohtë, që e bën baltën gur brenda një kohe shumë të shkurtër. Kjo erë, ashtu si edhe juga në korrik, e merr më qafë bereqetin. E zverdh para kohe, e mbush me kashtë e lëpushka dhe e bën bujkun të tundë kokën me maraz e të pyesë pa marrë asnje përgjigje: «Pse kështu?!»

— Pse kështu?, — pyeste veten edhe Nuriu, pa marrë asnje përgjigje. — Shkoi kot djersa e shtatë muajve!, — tha në një çast qartësie të plotë. Pastaj mendja iu trubullua përsëri, sytë ia veshi urrejtja e egër.

— Mirë!... Mirë!... Mirë!, — thoshte në çdo hap të rënduar që hidhte. — Mirë!... Mirë!.., Mirë!

I qe ngulur kjo fjalë në tru si me gozhdë. Të gjitha të tjerat i qenë zhdukur krejt. I qenë zhdukur kohët, hapësirat, vendi.

Në rrugën që ecte ai dhe në gjendjen që ishte, nuk kishte se si ta shihte njeriun që ishte fshehur prapa trungut të një kumbulle. Po kur kaloi fare pranë dhe kur njeriu doli në dritën e hënës, mundi ta dallonte e ta njihte menjëherë Jaçe Marrën, sekretarin e këshillit popullor të fshatit. Po tërë qenia e Nuriut, ishte kthyer vetëm në një fjalë, që e përsëriste si i humbur, shpesh pa vetëdije:

— Mirë!... Mirë!

Jaçe Marra, ia preu rrugën me atë trupin e tij të gjatë e të shëndoshë. Ia preu edhe atë fjalën e bezdissë, që nuk i shqitej nga mendja. Kur erdhi në vete, Nuriu pyeti i habitur si një njeri që porsa i ka dalë narkoza.

— Ç'bën këtu ti, Kuqo?!

Tjetri iu përgjigj me një gjuhë tallëse e therëse:

— Ta merr mendja që s'bëj atë që bëre ti!

Nuriu ndjeu në këtë përgjigje një kërcënim të madh

dhe përnjëherësh fjala e bezdishme iu shkul nga trutë si një dhëmb i prishur. Pyeti me rrëmbim dhe i shqetësuar:

— Pse?! Ç'bëra unë?!, — dhe shtoi po me atë zë: — Unë s'kam bërë asgjë të keqe!

Jaçja i futi krahun, ia shtrëngoi llërën fort dhe u rëndoi fjalëve:

— Ti prishe bereqetin dhe këtij i thonë sabotim, or tunjatjeta... Unë, si përfaqësues i pushtetit, të zura me presh në dorë...

Nuriu e gjeti përgjigjen menjëherë:

— Ashtu të është dukur, more Jaçe! Unë bëra vetëm një të mirë! Arixhijtë po vdisnin nga uria. U thashë: «Merrni nga ara ime, se të gjithë jemi fëmijët e perëndisë!»...

— Léri këto!, — e ndërpree tjetri.

Nuriu iu kanos:

— Po ti, përsë nuk ua more kalin që e kishin lëshuar në arën me misër?

— Është puna ime ajo...

— Edhe kjo është puna ime. Me mallin tim bëj ç'të duar... Megjithëse... Megjithëse... — Nuriu mezi e gjeti gënjeshtrën. — Unë i përzura ata djaj dhe kuajt e tyre nga ara. Po të isha në vendin tënd, do të kisha bërë më shumë. Po ti e di, tani jam pa fuqi e pushtet. Jemi bërë si këmbët e dhisë, o Jaçe! Po unë kam besim: ata vërtet ma bënë dërrmë arën, po do të përgjigjen... do ta pësojnë...

Jaçja ia shtrëngoi fort llërën dhe i fliste me ironi:

— Po të ishte kështu si thua zotrote, ti do të kishe ngritur fshatin më këmbë, Nuri aga! Po, nejse, unë e kup-toj përsë e bëre këtë!

Nuriu kapi vetëm fjalën «zotrote» dhe «aga»... Këto dy fjalë që kishin filluar të thuheshin me tallje nga shumë fshatarë, Nuriut nuk para ia vranë veshin. Kishin brenda zemërimit të shtirur një tingull të ëmbël, dashamirës, si dikur.

Nuriu u mundua të dallojë fytyrën e shëndetshme e të-ri krunde të mikut të tij, po hëna është hënë dhe dritën e ka të zbetë e të verdhë.

— Kuqo, — i tha me tē butë, — mos ma shtrëngó shumë llérën, se ma bëre plagë. Po një gjë tē dish: Nuri agai, éshtë aga që kur s'mbahet mend dhe jo rufjan.

Ai ia preu shkurt dhe ia lëshoi krahun:

— Léri ato! Fjalët s'pinë ujë më.

— Mirë, o xhan!, — i tha Nuriu qetë, — dora e djathitë lan tē majtën.

— S'të shkojnë ato!, — përsëriti Jaçja tē njëjtin menjdim, po me fjalë tē tjera.

Nuriu vazhdoi po me atë zë tē qetë e kërcënues:

— Ti do tē tregosh që unë lashë arixhijtë e mjerë e tē varfër tē hanë diçka nga malli im. Mirë, o xhan, trego! Po mos harro sé edhe unë gojën e kam hapur e ndonjë fjalë, kur tē duhet, do ta them për ty.

— Ti s'ke ç'thua për mua.

Jaçja u largua një hap nga krahu i tij.

— Kam, kam, — nguli këmbë Nuriu, kërcënueshëm.

— Asgjë s'ke!

— Mirë. E lémë me kaq! Shko e shpif! Ti do tē shpifesh për mua, kurse unë, nga e keqja, do tē tregoj tē vërtetën.

— Do tē shpifesh!, — tha Jaçja, po zërin e kishte tē tronditir.

— Unë nuk do tē shpif. Do tē them ato që kam dëgjuar...

— E ç'ke dëgjuar?... Dëngla? Thuaji! s'të beson njeri.

— Po bota ka shahitë, Jaçe! Dy shahitë varin një njeri. Për ty dalin më shumë se dy, dhe me dokumente. Po mirë, o xhan i Nuriut, mirë. Pështymë, se më ke në dorë. Po dhe mos harro! Lart mos pështy, se tē bie në fytyrë!

Jaçja donte t'i kundërshtonte, po ai s'e linte. E kishte vënë përpëra me ca fjalë që po e dérrmonin krejt, megjithëse s'po dëgjonte asnjë fakt.

S'ke ç'thua për mua. Unë jam i larë, — ia kthente Jaçja.

— Si oxhaku me blozë.

Nuriu qeshi me djallëzi dhe i pëshpëriti në vesh:

— Ke tē fala nga tregtar Niko Dardha.

— S'njoh unë asnjë tregtar.

— Kuqo! Kanë ardhur kohë të tilla që njeriut i duhet të ecë me kokën poshtë, duke menduar. Kështu më ka kë-shilluar një miku im në Tiranë, — dhe Nuri Zyberi kujtoi qartë ditën dhe vendin ku ishte takuar me atë «mikun» nga Tirana.

«...Ishte në një pijetore të vogël, të rrugës Bardhyl. Qe ulur në një tryezë dhe po lexonte gazeten, kur hyri një burrë i gjatë gati dy metra, i shëndetshëm, me një qeleshe të lartë e të bardhë dhe me një pallto shumë të gjërë. Tiranasi ecte ngadalë, me kokën poshtë, pa vështruar as majtas e as djathtas. U ul në tryezën e Nuriut, se të tjerat ishin të zëna dhe futi dorën në xhepin e madh si torbë. Në heshtje të plotë nxori një domate të madhe nga ato që u thonë zemër kau dhe filloj ta presë thela-thela me një biçak që e kishte lidhur në brezin e gjërë. Kamerieri i vuri përpara gotën e rakisë.

— Ke menim?, — e pyeti tiranasi Nuri Zyberin, i cili meqë s'i kuptoi fjalët, mblodhi supet, i habitur.

— Po edhe kam. S'ka njeri pa mendime...

— Ec tuj menuel!, — vazhdoi tiranasi duke prerë domaten. — Ke menim, s'ke menim, ec tuj menue, me kaptinë te poshtë, se, po ta çojsh tërmo, fffëëët! ta presin! — dhe bëri shenjë me thikën kur tha atë shprehjen «ffffët!»

Dolën të njobur. Ai qe një ish tregtar i madh i tatuari tri herë gjatë një viti e gjysmë. Herën e tretë veshi shallvare, vuri qeleshe dhe filloj të ecë me kokën poshtë. Kishte ndryshuar pamjen pothuaj krejt, prandaj Nuriu mezi e njuhu.

— Ke menim s'ke menim, ee tuj menue, se, vallahi biali, ffët kaptina!, — përsërishte tregtari duke prerë ajrin me biçak! ...»

— Fët kaptina, Jaçe, — përfundoi Nuriu pasi i tregoi me hollësi gjithë bisedën me atë «mikun» nga Tirana.

Jaçja vazhdonte në të tijën.

— Punën time e di Partia...

— Dëgjo xhaxha Nuriun ti. Unë nuk shpif. Vetë zoti Niko më tregoi një ditë se si të rregulloi në Tiranë, në polici dhe, pas kapitullimit të Italisë, të dërgoi te zogistët. Me

partizanët ti u lidhe nga e keqja, për të humbur gjurmët, dhe vetëm ditët e fundit kur luftohej për çlirimin e Tiranës. Po edhe që andej dezertove. Mirëpo në mbledhje na ke thënë se ke qenë partizan që me çetat e para. Bukur na e ke hedhur, qerrata! Ashtu duhej. Tani dëgjo këtu. Unë s'dua ta prish me ty. Dua që të mbetemi miq për kokë. Po s'deshe, mua s'më kushton gjë t'i tregoj Lytos. Vete e ia them nesër të gjitha. Në fund të fundit, dy duar për një kokë janë.

Jaçes i shkonin të ngjethura nëpër trup.

— A di njeri tjetër për mua?

— Askush, veç meje! Dhe nuk do të dijë, po t'i vësh gojës kyç!

Jaçja, i tronditur, tundi kokën në shenjë pohimi.

Hëna e kishte zbardhur natën, po drita e saj nuk u pëllente atyre të dyve. Kaluan përmes fshatit duke u fshehumë në hijen e lisave. Sado ulët që fliste Nuriu, në natën e qetë, dëgjohej zëri i tij i trashë.

— Krimbin, — i thoshte ai Jaçes, — mund ta ndash më dysh dhe të dy gjysmat do të jetojnë veç e veç. Jetën e njeriut nuk mund ta ndash. Sado që t'i shërbesh këtij pushtet, veprimet e tua të para do të të ndjekin nga pas, si bisht. Prandaj ec me kokën poshtë, duke menduar dhe mbahu mirë pas atyre që t'i pëlqejnë këto veprime dhe jo pas atyre që t'i dënojnë «Ke menim? Ec tuj menue!»... Më kupton, o Kuqo?

— Po, Nuri aga!

Jaçja sikur u kërrus. I kishte humbur plotësisht forcat dhe qielza i qe tharë. Te çesma me katër sylynjarë, u përkul përparrë dhe piu ujë me grushte. Uji zhurmonte e llapashitej në këmbët e tij, i ftohtë, i kristaltë. Papritur gjithshka iu errësua para syve dhe iu duk sikur po mbytej.

3.

Në zyrën e vogël e të thjeshtë të këshillit popullor të fshatit shkonte e vinte si furtunë sekretari i organizatës-bazë. E kishin zgjuar nga gjumi herët në mëngjes dhe i

kishin thënë se diku, në një arë me misër, ishte bërë dëm i madh. Pa humbur kohë, kishte shkuar në fushë. Ara ishte bërë shesh, sikur kishin vrapiuar kuaj e njerës bashkë. Gjatë natës kishte rënë shi dhe gjurmët ishin mbushur me ujë. Sekretari gjeti në hendek një palë opinga të grisura, u inatos dhe, me to në dorë, filloj të bërtasë e të shajë. Vinte i gjatë nga trupi, fytyrën e kishte të madhe, tërë eshtra e të mprehtë dhe zemërohej rrallë e tek. Atë nuk mund ta quaje fshatar të vërtetë. Dhjetë vjet punoi në qytet, në një punishte llastikash dhe gjatë asaj kohe sikur e harroi fshatin. Aty mësoi të dashurojë dhe të urrejë ashtu siç dashurojnë dhe urrejnë punëtorët. Shokët e tij komunistë e bënë një ushtar të Partisë dhe Partia e pranoi në gjirin e vet. Mbarimi i luftës e gjeti komandant të një kompanie dhe që ditët e para të Çlirimt, me të mbaruar një kurs të shkurtë partie, u dérgua në vendlindje. Ishte i varfër, pa tokë e katandi. I ati ruante dhitë. Një vëlla iu vra pas Çlirimt, në përpjekje me kriminelët e luftës. E motra, grua e urtë e shtëpiake e mirë, e la burrin që në kohën e luftës, se u bë ballist. Tani punonte me të atin e me të vëllanë në tokën që u dha pushteti popullor...

Në zyrën e Këshillit e priste Jaçe Marra tërë ankth dhe i zbetë nga nata që kishte kaluar pa gjumë.

— A është e vërtetë? — pyeti me gjysmë zëri.

— Po. Sabotim! — Sekretari hodhi në një qoshe opingat që gjeti në fushë.

Rezet e diellit, që hynin nga një dritare e vogël, ranë mbi portretet e Stalinit e të Enverit rrethuar me kallëza gruri dhe mbi një copë pëlhure të shkruar nga një dorë e pastërvitur «Të plotësojmë dorëzimin e bereqetit para afatit».

Sekretari erdhi rrötull tryezës, i xhindosur, duke përplasur këmbët e gjata. Ia nguli sytë e vegjël bojëqielli Jaçes dhe tha me një zë të ashpër e kumbues:

— Kjo është një punë e poshtër. Me të dalë urdhëresa, na sabotuan. Është krim! krim! Qyteti është në krizë! Punëtorët janë pa bukë! Kurse ne bëjmë gjumin e madh! Jo! Kjo s'na lejohet! Do t'i gjej maskarenjtë dhe do t'ia jap gjyqit të

popullit! T'i varin për gjuhe, të poshtrit!... Ç'u bë pojaku?...
Unë të pyes: ç'u bë pojaku?

— E lajmërova të vijë. Tashti vjen!, — u përgjigj Ja-
çja, i trembur nga zëri i ashpër i sekretarit, duke i dhënë
fytyrës një shprehje mërzie e meraku.

— Po Malka, ç'u bë? — pyeti sekretari pikë e vrer me
të njëjtin zë.

Jacja rrudhi ballin dhe u përgjigj si i shushatur:

— Ti më duket e ke humbur fare toruan. Po Malka, a
nuk do të vinte në kursin tremujor të Partisë? Është nisur
sot që pa gdhirë.

— Edhe kjo na duhej!, — shfryu sekretari nëpër dhë-
mbë duke trokitur gishtinjtë mbi tryezë sikur i binte daj-
resë. Inati ende s'i kishte rënë. Gishterinjtë i dridheshin
lehtë. Jacja, shtrirë mbi ca thasë bosh, pinte q duhan dhe
luante me tymin duke parë tavanin, sikur mundohej të
kujtonte diçka. Lytoja e pa shtrembër dhe i foli me ton
përbuzës:

— Po ti, ç'më rri shtrirë si démi i Zalos!? Ngreu, se
s'të shoh dot!

Jacja shohti cigaren te thembra e këpucës dhe u ngrit
ngadalë.

— Avash, — i tha. — Merre shtruar! Me ty s'u flitka
sot! — dhe u ul në cep të tryezës.

— A! E dashke shtruar, zotrote! E dashke urtë e butë.
Armiku le të na lërë pa bukë, ne urtë e butë! Po, a e di
që përgjegjësia bie në radhë të parë mbi mua e mbi ty? Në
qarkor do të thonë: «Me se merren ata? ! Sytë u plasën!»

Në dyqanin e kooperativës së shit-blerjes, që ndahej
nga zyra e këshillit popullor prej një çatmaje të hollë, u
dëgjua zhurmë. Flisnin me zë të lartë, sikur ziheshin, po
Lytoja s'i kuptoi dot fjalët, megjithëse vuri veshin. Pas një
minute hynë në zyrë katër-pesë fshatarë, me fytyra të pa-
rruara e të mekura. I fundit kapërceu prakun Nuri Zyberi
duke marrë frymë me zor dhe i verdhë dyllë. Tha i pikë-
lluar në kulm:

— O, ç'më gjeti mua të ziun, o Lyto! Më lanë me gisht
në gojë, o bir! Përse ma bënë këtë të keqe? Ç'u kam bërë?

Mjaft po duroj me turp atë nofkën e mallëkuar të kulakut, na tani, edhe një mynxyrë tjetër! Me se ta ngrys dimrin? Do të vdes urie! Ç'patën me mua? ç'patën? Kush ma dërgoi këtë mallëkim?...

Fshiu me shami sytë e hundët dhe rrahu gjoksin me grusht, po askush nuk u prek nga fjalët e tij. Një fshatar bëri me dorë një shenjë përbuzëse. Lytoja nuk iu përgjigj. Të tjerët vështronin me një farë kureshtje. Jaçja qëndron te në cep të tryezës duke tundur këmbët e gjata në ajér. Mustaqet, të verdha e të rralla, i vareshin si bisht miu. Vëtëm mustaqet i kishte të verdha, pa flokët, vetullat e qpallat i kishte të kuqe, si të lyera me këna. Fytyra i dukej si një sitë e mbushur me krunde, prandaj e thërrisin «kuqo». Kur Nuriu, me fuqi të prera, u mbështet pas murit dhe heshti pikë e vrer, Jaçe Marra përplasi grushtin mbi tryezë. Një shishe e vogël me bojë u përmbyss, pena ra përdhe.

— Po kjo pikë e zezë!, — tha ai pa iu drejtuar kujt. — Na u prish bereqeti më i mirë!

— Një kallëp, një flori, — rënkoj Nuri Zyberi me kryet varur në gjoks.

Lytoja i tregoi opingat e grisura:

— Të kujt janë këto?

Nuriu mblohdhi supat në shenjë mohimi:

— Ku ta di unë i ziu!

— Këto s'janë mall i fshatit tonë. S'mban njeri këtu të tilla. — tha Jaçja me bindje.

Fshatarët i panë opingat me kureshtje dhe, duke i kluar dorë më dorë, thanë se vërtet opinga të tilla s'mbante njeri në fshat.

— Atëherë, kush na e bëri këtë proçkë?, — pyeti Lytoja duke i parë të gjithë me radhë, jo për të zbuluar fajtorin midis tyre, po për t'u bindur në mendimin e vet. I mbeti vështrimi te një fshatar trupvogël, me qeleshe të zezë e shumë të vjetër, në ballë të së cilës kuqte një yll.

— Ti e di, o bir!, — i tha fshatari me zë të qetë sikur bënte muhabet rrëth vatrës.

— Nuk e di, prandaj pyes!, — tha Lytoja më i zbutur.

— Atë na e bënë, armiqtë! — dhe fshatari, si shau rëndë pa të keq, e uli qeleshen mënjanë sa mbuloi njërin sy.

Jaçe Marra tha me bindje duke vështruar tavanin e ciflosur:

— Këtë proçkë e bënë ose arixhinjtë, ose ndonjë burrë «i mirë» nga fshatrat rrëth e rrötull.

Pastaj iu drejtua sekretarit:

— Kemi armiq, Lyto! Duhet t'i mbajmë sytë hapur! E shikon ç'na punuan?! Na e lanë gjitonin me gisht në gojë. Janë tri barqe në shtëpi dhe gjë prej gjëje s'kanë. Me se do ta myllin dimrin?

Lytoja, si i dëgjoi të gjithë ata që ishin aty, hapi derën dhe fshatarët dolën njëri pas tjetrit, pa u ngutur.

— Na u zunë sytë!, — tha sekretari i Partisë i menduar, kur mbeti vetëm me Jaçen.

— Ç'hyj unë këtu? !... Ti e ke përgjegjësinë. Ti je sekretar.

Jaçe Marra i tha këto fjalë si nëpër dhëmbë, u ul nga tryeza dhe pështyu nëpër dritaren e vogël.

Lytoja tha, përsëri i menduar:

— Unë s'i trembem përgjegjësisë!

Vështronte kot nga dritarja. Ishte bërë i butë si qengj. Fliste si me vete:

— E hapim pastaj këtë muhabet! Tani, o Jaçe vëllai, duhet të gjejmë fajtorin... Ai s'është pojak... Ai është hajvan i téri... C'ruan ai? !... Po, fajtorin e kemi në fshat...

Për çudi edhe Jaçe Marra u bë si qengj. Tha me zë gati të shuar:

— S'kemi në fshat njerez të tillë...

— Ka!, — tha Lytoja prerë.

— S'ka. Ne s'kemi kulakë të rrezikshëm. Edhe në pacim ndonjë, ai s'është diversant. Jemi njësh! A mund ta quash atë, kulak të fshatit tonë? Ai tani është pucak, si ti e si unë.

— Kulaku që i ka humbur të gjitha është më i keqi. Njësoj si ai borgjezi i qytetit që i zbulojnë florinjtë e fshehur.

— Ti di më shumë. Ke bërë shkollen e Partisë!

— S'është punë shkolle kjo, o Jaçe vëllai!

Jaçes i pëlqente fjala «vëllai». Aq më shumë kur këtë e thoshte sekretari i organizatës-bazë.

— Kështu, o Jaçe vëllai! Kudo ka kulakë, domethënë, gjakpirës. Siç ka edhe të varfér, që janë gjaku ynë! Siç ka edhe të mesëm, që duhet t'i bëjmë me vete, se i kemi aleatë.

— Shkolla të hap sytë, — e ndërpreu Jaçja duke i vështruar majën e hundës së skuqur pak nga të ftohtit dhe, si u bind që ai fliste me vete, shtoi:

— Me të drejtë ti thua se kulaku është armik. Po njerëzit mos i ngatërro! E pe atë me yll të kuq në qeleshe?! Kasëm Sharrën?! Brekëçjerrë ishte dje. I dhamë tokën e bagëtitë e kulakut dhe tani ia ka hipur kalit! Si urdhëron zotrote ta quajmë atë? Sipas teje na dalka kulaku i shpronësuar, po prap kulak. Po ky Kasëmi që është pasuruar, i varfér qenka? ! Qef o qef! Bota s'ndryshon e s'ka qeder!... Kështu, apo jo?

Jaçja ia kapi majën e hundës dhe qeshi. Lytoja ia largoi gishtat nga hunda, po nuk u përgjigj menjëherë.

— Djall!, — i tha pas pak. — Kulakët, bejlerët e agallarët nuk bien nga qielli! Në këtë tokë mbijnë. Po grëmin viranot, duhet ta shkulim e ta djegim, se na le pa be-reqet.

— Shkolla... shkolla..., — qeshi Jaçja!

Papritur Lytoja mori zjarr:

— Ç' shkollë, more derdimen! Qyteti s'ka bukë, kurse këtu kulakët ushqejnë me bereqet lopët e qetë! Këtu... sabotojnë.

Në çast dera u hap dhe në zyrë hyri Milo Peçi, spezialisti i bujqësisë. Asnjeri, bile as vetë Lytoja, nuk e kishët të qartë se ç'donte në fshat ky leshzi e shpatullgjerë, veshur gjysmëushtar, gjysmëfshatar, që nuk ua dinte mirë ojnati fushave. Ai hiqej si i dituri i botës, zot mbi zot, dhe fuste hundët në çdo gjë. U ul në froni prej trungu arre, dhe, i rraskapitur u lëshua i téri, duke përsëritur frazën e dashur:

— Bashkimi bën fuqinë!

Jacja sikur mori zemër kur pa atë njeri mbështjellë me gëzof nga beli e lart.

— Kulak do zotrote?, — pyeti. — Urdhéro! Këtu e kishe! Po ne ia morëm tokat, qetë e vreshtat. I lamë morrat! Urdhéro e lufto kundër tij! Po ç'faj ka ai, ditéziu?!

Lytoja tha me mëdyshje:

— S'e kam me të! Hajvan të jetë njeriu, dhe atë punë s'e bën! Hajvan të jetë!

Mirëpo Lytoja gabonte. Ai nuk e dinte se armiku, kur e sheh punën pisk dhe kur i vëlon përbrenda. Uurrejtja çnjerëzore, mund të arrijë të therë me thikë edhe fëmijën e vet.

Specialisti, duke fshirë çizmet e gjata me një leckë, ndërhyri menjëherë:

— More shokë, bashkimi bën fuqinë. Ne na duhet bukë! Urtë e butë! Duam bukë! Kushdo që të na e japë, i themi faleminderit! Faleminderit i themi edhe ujkut, edhe tradhtarit, edhe çakallit, edhe shejtanit me brirë! Vetëm bukë të na japid...

— Stalini e Lenini nuk thonë kështu, — i tha i nxehur Lytoja.

— Të tjera kohë ishin aherë, — e ndërpreu specialisti.

— Edhe Partia jonë...

— Të tjera kushte kemi sot... Po, të lutem, mos na fut thellë në politikë, se as kohë s'kemi e as dalim dot, — tha Milo Peçi dhe menjëherë u ngrit e doli nga dhoma duke treguar për të fundit herë gishtin e tij kërcënues. Pas tij doli edhe Jacja. Si mbeti vetë, Lytoja u hutua fare nga ato që dëgjoi, shau veten që nuk ishte i zoti pér asgjë, dhe mbështeti ballin mbi tryezë, i vrarë shpirtërisht.

Ata të dy, duke ecur në rrugën e heshtur e plot baltë i pëshpërisnin njëri-tjetrit:

— Ky është sabotim dhe ty të takon ta gjesh!

— Unë s'di! Gurmazin ma shqyej, po unë s'di.

— Di, — i thoshte specialisti.

— S'di!, — ngulte këmbë Jacja.

— Di!

— Për perëndi!

Në kthesë u doli Nuri Zyberi, si një fantazmë. Hyri midis tyre, i shkurtër siç ishte. U tha vetëm dy-tri fjalë:

— Kapak kësaj pune!

Jaçja çakërriti sytë.

— Kapak!, — përsëriti Nuriu dhe për çudi Jaçja u zbut si qengj...

Ndërsa Lytoja, me kokën mbi tryezë, mërmëriste me vete:

— E ç'na duhet ky Milo? E ç'është ky Milo?! Kush na e solli? Kush e mbron? Po Jaçja...?!

Lytoja u ngrit nga tryeza dhe tha me zë:

— Kush e bëri sabotimin?

Erdhi rrrotull mureve të dhomës së ftohtë dhe tha me zë të ulët:

— Ndoshta ai!... Ndoshta ata të Pojanit, të Zvezdës, të Zëmbblakut... Të téré janë rufjanë... Po përse të vijnë ata këtu?... E kanë bërë tanët... mbaroi!... Mbase Nuriu. Veç në qentë i çmendur!... E përse? Që të mos e ngrysë dimrin?

Ai ecte pa pushim nëpër dhomë sikur maste me hapa gjatësinë dhe gjerësinë e saj. Ndeshi në ato këpucët që i kishte gjetur në hendek. U dha një shqelm dhe tha me vete:

— Kush mund të mendonte se kjo luftë për socializmin do të qe kaq e vështirë?! Bile më e vështirë se ajo me armë? Luftë e heshtur, me të hedhura e të përdredhura.... Jo dhe aq e heshtur, xhanëm, po fjala vjen, — nënqeshi dhe e ngriti pakëz zërin. — Ende nuk je mësuar të qëllosh si duhet, o Lyto vëllai. Je si një fëmijë që hedh hapat e para.

U ul në tryezë të shkruajë raportin për atë që ndodhi. Duhej lajmëruar prokuroria dhe shokët e qarkorit.

4.

Më drekëherë shiu pushoi. Pas ndonjë ore qelli u pastrua krejt nga retë. Nuk pikuan më as strehët e as plepat dhe, në të perënduar të diellit, malet u mbuluan me një

hije ngjyrë jargavani, fusha hapi gjiret gjer tej horizonteve dhe qelli ndriti. Qamili u kthye nga fusha me qetë përpara, mbrehur në zgjedhë. Në qoshen e oborrit shtruar me kalldrëm e shoqja milte lopën. Çurkat e qumështit tringëllinin si zilka në kusinë prej bakri.

— Si duket? — e pyeti të shoqen duke i hedhur një vështrim kusisë mbuluar me një cipë shkumbë.

— Shton përditë, — iu përgjigj e shoqja buzagas duke rrëshqitur duart e shkathëta në gjinjtë e fryrë të lopës.

— Domosdo do të shtojë, — tha ai, hoqi xhelugën nga zgjedha dhe qetë, të çliruara, hynë drejt e në haur. Rrëmbeu një krahë bar nga mullari dhe ua hodhi në grazhd. Bari lëshoi një aromë të mirë çai e marajthe. Qetë filluan të përtypeshin.

— Hani, se e keni hallall!, — u tha me zë sikur të ishin njerëz. — U mundova cazë sot, po mos harroni se edhe unë u lodha. Në fund të fundit, ju jeni me katër këmbë, o të uruar, kurse unë vetëm me një!, — dhe me kënaqësi u hoqi fijet e barit nga briret dhe u fërkoi kurrizin me pëllëmbën e ashpër.

Kau balash ktheu kokën, i mori erë dorës dhe e vësh-troi me sytë si kumbulla gjatoshe.

— Ha, balash, ha!, — i tha me zë dhe ia hoqi me pëllëmbë vitheve. Pastaj doli në oborr dhe u ul i lodhur, në postafin rrëzë murit. Shtriu këmbën sakate, ndezi çibukun prej bushi që e kishte bërë vetë dhe, si nëpër mjegull, filloj të mendojë se ç'punë e prisnin të nesërmen. Po, nga lodhja, e nesërmja i ngatërhojej me përfytyrimet e së kalluarës. Kishte pasur vetëm një kasolle thurur me gardh, lyer me baltë e bajga, mbuluar me presje dhe, përreth saj, një pollonicë tokë pér duhan, misër e zarzavate. Tërë jetën kishte jetuar si mund të jetonte një fshatar i varfër, pa tokë e bagëti. Punonte hyzmeqar e argat, shtronte kall-drëm në qytet, thyente gurë buzë xhadesë dhe kishte katër fëmijë, të shoqen, pesë dhe vetë, gjashtë. Vetëm më e madhja, Rasimeja, mund ta ndihmonte, pa të tjerët s'ishin veçse pér të ngrënë, si zogjtë pa pupla në fole, që mbajnë kryet lart e sqepin hapur. Sado që të punonte, ishte pak.

Ditë e net të zymta e të këqija kishte kaluar, sidomos që kur hynë italianët e gjersa theyn qafën gjermanët, se tamam në atë kohë i doli një xhungë në këllkun e majtë, ia ngriu gjurin dhe e la sakat. Dhe që nga ajo kohë ia harruan emrin. E thirrën «çalo».

Tani kishin ardhur kohëra të reja. Atij fshatari trupvogël e me flokë rudë, që rrinte në postafin e zbardhur nga gëlqerja, mbuluar nga shtëllunga tymi, me atë pamje të lodhur e të ciltër që ta jep vetëm puna e lirë dhe e ndershme, pushteti i ri i dha liri, tokë, qe e lopë.

Qamili nuk e harron kurrë gjëzimin që ndjenë fëmijët atë ditë, kur pinë për herë të parë qumësht nga lopa e tyre! Ai s'e harron kurrë atë ditë, kur, duke e ndier veten plotësisht të lirë, të ri e krenar, shkoi për herë të parë të lërojë tokën e tij me qetë e tij! S'e harron kurrë atë çast të lumtur kur e shoqja, një devollite e gjatë si selvi, e bukur dhe e shkathët, moli lopën, e shpuri në pillat për ujë dhe me koshin që e kishte thurur vetë nxori plehun nga ahuri! Ai kurrë nuk kishte menduar se ç'është lumturia! Edhe në kishte menduar, ajo i qe dukur si një ylber i bukur, i largët dhe i paarritshëm. Po tani e ndiente se ajo i kishte hyrë në çdo skutë të shtëpisë e në çdo qelizë të trupit. Ia kishte sjellë atë Partia, pushteti i ri, Enveri. Ai tani as që mund ta mendonte lumturinë pa Partinë, as që mund ta mendonte jetën e fëmijëve, të fshatit e të të gjithë Shqipërisë, pa atë që u fali këtë ylber të vërtetë.

E shoqja i solli kafenë prej elbi dhe ai u përmend. Kishte filluar të binte muzgu dhe tringëllimi i këmborëve po shuhej dalngadalë. Në kopshtin fqinjë, matanë lisave, se kush këndonte. Uji i vijës rridhët tatëpjetë me gurgullimë dhe s'e pengonte njeri, se askush s'kishte nevojë për të në atë vjeshtë me shira. E piu kafenë pa bërë zë duke parë të bijën që ecte në rrugë me stomnat e rënda në të dy duart.

— U rrit!, — pëshpëriti. — E drejtë si e ëma, e lehtë, si era. Po s'e ka mirë që mbush ujë në këtë orë! I pëlqen të llomotitë me shoqet!... Po me cilin po bisedon ashtu? — U ngrit me filxhanin në dorë dhe iu afroa gardhit për të

parë më mirë — Lytoja! — tha me zë të ngjirur nga të ftohit dhe shtoi po me zë: — Ç'do ai kësaj ane? Ai thotë vetë se nuk i pëlqejnë rrugët e gjata...

Thithi çibukun e shuar, ngriti për të fundit herë filxhanin dhe buzëqeshi duke tundur kokën:

— Xhevahir djalë! I ri dhe ka tërë atë fuqi në dorë!

Pastaj u vrenjt dhe tha me vete për të bijën:

— Po ajo, ç'e zgjat kaq shumë me të birin e botës??

Shkundi hirin e çibukut në pëllëmbë, la filxhanin dhe u ul përsëri në postafin e bardhë. Rasimeja u nda nga Lytoja dhe u drejtua për në shtëpi. Ekte ngadalë e me kujdes sikur kishte frikë mos pengohej. T'et iu duk sikur ajo tundej e përdridhej me naze.

— Mos u tund!, — e qortoi me inat po pastaj heshti, sepse e mori me mend se, edhe ai, po të ishte i ngarkuar me stomna të rënda, ashtu do të tundej nga pesha. Ajo kishte veshur një jelek të zi me anët si ar mbi një bluzë të bardhë, me mëngë të gjera, të qëndisura anës me oja. Era ia frynte pak bluzën dhe shaminë e kuqe të kokës. Gërshtet e dendura e të gjata i kishte lëshuar mbi kraharor dhe i lëkundeshin në çdo hap që bënte. I lëkundej edhe qoshja e shamisë që kishte vënë në xhepin e përparëses.

— Nga ishe?, — e pyeti Qamili kot, kur ajo hyri në oborr, duke e parë me një farë krenarie.

— Për ujë!, — u përgjigj ajo.

— Ç'qe gjithë ai muhabet me Lyton?

Ajo ndjeu qortimin e lehtë në zërin e tij dhe u skuq:

— Lytoja më tha se dikush ka démtuar misrin në arën e Nuri Zyberit.

Qamili u ngrit përnjëherësh.

— Vetëm Nuriut i kanë prishur bereqetin?

— Vetëm atij.

— Kllapka!, — tha Qamili i zemëruar dhe eci drejt derës duke hedhur me shqetësim, mbi kalldrëm, këmbën sakate.

Mbrëmja ishte e ftohtë dhe një erë e akullt ia fshiku fytyrën kur kapërceu hendekun para këshillit të fshatit. Gjer aty Lytoja e pati mendjen te Rasimeja.

«Ajo është vajzë e mirë, e dashur dhe e mençme. Vettullat i ka si krahë dallëndysheje. Dhe ndënë to, sytë si bajame, me ngjyrën e detit. Mbase ka ndonjë cen, po kur e shikon atë, sepse i harron të tjerat. Ke qejf ta dëgjosh kur flet. Kokën e mban poshtë, kurse me gjuhë të ther! Dhe ke qejf ta shohësh si heq vallen dhe si mban stomnat me ujë. Po me të është zor të bisedosh. Mund t'i rregullosh në mend të gjitha fjalët që do t'i thuash. Po asnëjëherë s'ia thua dot, se ajo e ndërron muhabetin menjëherë. Të flet për kulakët, pér diversantët, pér gratë që mundohen shumë, pér vajzat që i martojnë me zor, të vogla fare, me burra të rritur e të egër. Kur e shikon, të duket sikur qëndron matanë bregut të lartë ku ti s'arrin dot kurrë. Dhe sepse të mbushet mendja që më mirë të mos i thuash asnëjë fjalë... kurrë!»

Lytoja ecte i topitur dhe me zemër të thyer, si çdo i ri, që nuk merr asnëjë përgjigje nga vajza që dashuron.

Duke harruar pér një çast punët që e shqetësonin aq shumë tërë ditën, ndezi llambën me vajguri dhe filloj të rregullojë letrat mbi tryezë. Atë çast, në zyrë hyri pa trokitur Qamili, me atë këmbën sakate e të drejtë si stap, me atë trupin e vogël e të thatë, me atë fytyrë të parruar, në ballë të së cilës i qenë ngjitur flokët ruden.

— Hajde, dajë Qamil!, — i tha Lytoja, duke ngjeshur në brez një kobure me shtatë.

— Për ku kështu?, — e pyeti fshatari pa u ulur. Zëri i tij qe ngjirur fare dhe i dilte me vërvhellima.

— Në qarkor. Duhet të bisedoj me shokët. Kam rënë në hall. S'di si të bëj. Mendova t'u dërgoj një raport, po me gojë merresh vesh më mirë.

Qamili mbështeti pëllëmbën e ashpër mbi tryezë dhe e pyeti me interesim:

— Po, pse, o djale i daiut, ç'të ka ndodhur?!

Lytoja ngjeshi brezin dhe iu përgjigj duke e parë në sy.

— Se kush ma hedh këtu, dajë Qamil!

— Kush?

— Nuk e di!

— Dëgjo, more djalë i daiut, — tha Qamili dhe u ul në fron, me njëren këmbë të mbledhur e me tjetrën të shtrirë. — S'ka gënjeshtër që të mos dalë në shesh. Më tha diçka, ajo.... ime bijë. E ka drejt ajo. Arixhijtë s'e kanë bërë më kokë të tyre. Ata i ka futur njeri, i ka gënjer, i ka paguar dikush.

— Ndoshfa, — tha Lytoja i mërzitur.

— Dëgjo dainë ti. Paraja është e fëlliur... Njëherë e panë shejtanin duke fërkuar duart. «Ç'ke, shejtan? — e pyetën, — përsë je i gjëzuar?» «Doli paraja» tha shejtani. «Do të prishet bota». Dëgjo dainë ti. Kështu është kjo punë.

— Po kush i shtyri arixhijtë, këtë s'e marr vesh.

Qamili thithi çibukun dhe menjëherë e hoqi nga goja. Se ç'donte të thoshte, po si duket ndërrroi mendje. Lytoja e vuri re.

— Fol, dajo, ç'do të thoshe?

— S'kam gjë unë. Më vjen keq që i shkuant shtetit dëm ca killë të mira.

— Po, si mendon ti?, — e pyeti Lytoja duke e parë përsëri drejt në sy. — Kush mund ta ketë bërë?

— Kulakët, — u përgjigj menjëherë fshatari.

— Këtë e di edhe unë. Po kush?

— E do me emër ti, xhan i daiut?

— Po, me emër...

— E po, s'ka tjetër, kllapka!

— S'të kuptoj...

— Kllapka, — e ngriti zërin fshatari dhe përsëriti me urrejtje. — Kllapka!

Qamili e përdorte shpesh këtë fjalë, vend e pa vend. Ca qeshnin kur e dëgjonin, po askush nuk e merrte vesh këtë fjalë që për të kishte një rëndësi të madhe e një kuptim të thellë. Nuk e dinte as Lytoja.

— Dëgjon, o xhan? Mos qesh me fjalën time, se nuk ia di fillin. Kur u bë lufta kishim edhe ballistë. I znim, i lironim. Ata shkonin nëpër shtëpitë, bënин qejf, bëheshin përsëri ballistë, ne i znim dhe prapë i lëshonim. Mirë kemi bërë. Po kemi një gabim. Vetëm këtë gabim kemi bërë. E zure qerratanë, bëji një kllapë me gërvshërë në vesh! E zure për herë të dytë, bëja kllapkën në veshin tjetër. Se e shikon, o sekretar, ç'na ndodh? Jemi bërë si këmbët e dhissë. Tani, ai kllapka, ngrihet e brohoret aq shumë, sa të çan däullkën e veshit. Të mburret se ka bërë atë e këtë për partizanët për çetat, për luftën, për djemtë e plagosur. Ti s'e di. Ti i beson. Ty të vjen keq për të. «I ziu» thua dhe e ndihmon. Kurse ai ta kuq nga mbrapa. Ndërsa, po të mos e kishim bërë atë gabim në luftë, i theshim tani: «Po, mirë, o edepsëz, pa na i trego pak veshin që e ke mbuluar me lesh!» Fap ua bëje me pëlliembë flokëve të gjatë. Të dilte kllapka. S'kishe më nevojë për dëshmitarë. I theshe: «O kushëri, e pse gënjen, o kushëri? Mbaj vendin e bëj si të thonë, përndryshe kemi, veç gërvshërëve, edhe kosën që të pret kokën!» Dhe ta shikoje ti, xhan i daiut, si do të rrinte qeni sus, urtë e butë. Po ne këtë s'e bëmë, tani mirë të na e bëjnë.

Lytoja qeshi me lot dhe e kuptoi se në mendimin e fshatarit kishte diçka të vërtetë.

— Mirë, — tha — u bë ky gabim. Tani më thuaj kush na e bëri proçkën?

— I zoti i arës!, — u përgjigj Qamili dhe u mbulua me tym duhani.

— Nuriu??!

— Ai dhe s'ka tjetër...

— Nga e di ti?, — pyeti Lytoja pa u çuditur fare.

— Nga kllapka, — u përgjigj Qamili, dhe tryzea e vjetër kërciti nga pesha e rëndë e dorës së tij. — Unë s'e pashtë, po them, se s'ka kush ta bëjë veç kllapkës.

— Nuk e di, — tha Lytoja duke futur ca letra në çantën e vjetër partizane. — Ti ke të drejtë, ai është kllapkë, po më i përbajtj se të tjerët. Dhe ca ndihma na i dha, si në luftë edhe sot.

Qamili u ngrit i zemëruar, pa e treguar veten.

— Eh, more bir!, — tha duke psherëtirë. — Ti nuk e di si më shikon ai kur më takon në udhë me qetë e tij! Më shikon si qeni i tērbuar dhe është gati të më bëjë fértele, sikur i kam vrarë t'anë e t'ëmën! Po ti s'e di, o bir, s'di q'është ajo kllapka, gjersa qeshe me lot. Kur më vjen pranë, me një sy të trubulluar më shikon surratin e me syrin tjetër tërë gjak e lot shikon qetë. U përkëdhel vi-thet, i zë pér briri, u férkon zverkun, u jep t'ia lëpjinë dorën, sikur në ato kafshë të jetë shpirti i tij. Kurse mua ma ngjit atë sy si turjelë mu në lule të ballit dhe më hedh thumba e më këput të trasha, që i duroj veç pér hir të pushtetit. Po t'i këto s'i di, se edhe vetë kam faj. S't'i kam thënë, se kam menduar që këto punë komunistët i dinë dhe, në mos i ditshin, i ndiejnë, se janë rrënë e popullit të varfér...

Lytoja dëgjonte me vëmendje tregimin e atij fshatari sakat e të mençëm dhe thellë shpirtit, në fshehtësi të madhe, ndiente se do të ishte krenar sikur ai, Qamili, çaloja i fshatit, të bëhej vjehrri i tij.

Ata u bënë gati pér të dalë. Qamili e ndali te dera:

— Një herë, në atë mbledhjen që na fole pér kooperativën, më një anë ty të dëgjoja e më anën tjetër atë vështroja. Ishte ngjeshur andej nga fundi, në një qoshe, po kur ti fole pér kulakët, pér armiqëtë e sabotimet, Nuriu lojti nga vendi sikur rrinte mbi prush. Pastaj bëri sikur u kollit. Unë, tani, sa ma tha ime bijë, mendova menjëherë: Ky derr e ka bërë! Bereqetin e kishte të mirë. Tre çerekë i mbante pér vete, një çerek ia jepte shtetit. Po ai nuk ve-proi as si në luftë. Të kujtohet? Po ta marrim hollë-hollë, nga e keqja neve, aherë, na dha një çerek, kurse tre çerek Ballit e fashistëve. Tani, meqë shpëtoi nga kllapka, ka thënë: «Farmaq të hanë!» Dhe ngjau ajo që ngjau. Dhe, e di pse?... Ti, o xhan i daiut, mos ia qaj hallin kalorësit që i varen këmbët. Ky Nuri efendiu ka bukë sa pér pesë vjet. Ku e ka, do të thuash ti. Unë s'e di, po shpirti ma thotë se ka aq shumë ndën qilar, sa mund të ushqejë nga e keqja edhe lopën edhe buallicën. Këta janë kllapka, o Lytoja i dajos, që fshehin edhe armë. Janë të babëzitur gjysh stër-

gjyshi. Unë mbase s'e kam mirë, po kështu ma thotë kjo dërrasë – dhe i ra krahërorit koskë e kokalle me grusht.

Lytoja, si dolën në korridor, mbylli derën me një çelës të ndryshkur dhe tha:

— Mirë e ke menduar, o dajo! Edhe unë kështu them. Po më duket se të dy diçka lajthitim. Jaçja më tha se ka qenë së bashku me Nuriun atë natë. Dhe unë s'kam përsë të mos i besoj Jaçes.

— Ndoshta, — tha Qamili duke hedhur kömben si stap.

— Ndoshta, o bir! Po ndajnatëherë unë e takova Nuriun në udhën e plepave. Po shkonte në fushë. Po, po. Shkontakte në fushë! Ti, o bir, ke halle shumë. Po mos e harro edhe këtë.

Dolën së bashku të dy dhe kapërcyen hendekun me ujë përpara zyrës së Këshillit. Kishte rënë nata e errët e vjeshtës. S'kishte as yj, as hënë, dhe nata qe vërtet aq e errët, sa ata nuk dallohen kur ecnin. Dëgjohej vetëm biseda e përzemërt:

— Bëj si të jetë më mirë!, — e këshillonte Qamili.

— Mos ki gajle!, — përgjigjej djali i ri me ton të vendosur e të qartë. — Partia merr vesh cdo gjë.

— Dalç faqebardhë, o Lyto xhani! Ejeri këtej, kallmishteve, dhe te Udhë e Paazarit. Pastaj përmes Pëndavnjit... Jo... Ec pas meje, ec! Di unë një rrugë më të shkurtër që nuk është përblytur nga ujërat...

Fshatari e hodhi shpejt e shpejt këmbën sakate, i doli djalit përpara, ia kapi dorën fort dhe i tha thiesht:

— Eja pas meje. Vëre kämbën këtu ku e ve unë...

...Po sabotimi u zbulua vetëm si kaluan disa muaj, pas ngjarjeve të reja të stuhishme që shqetësuan përsëri fshatin në prag të pranverës së vitit 1949.

Po, ku ta dish që atje, në qytet, nuk kishte ndonjë në-punës që i vuri kapak kësaj pune?

Ku ta dish!

K A P I T U L L I . II.

Ndodhin ca gjëra në jetë që e habitin njeriun. Ato janë të thjeshta fare, me to mësoshesh si me ajrin e me bukën. Por, si kalon një kohë, rri e mendon. Pyet me ankth: «Si është e mundur?!» Dhe ai tjetri, bashkëbiseduesi, të shpregon me fakte bindëse se ashtu ka qenë. Ti përsëri pyet: «Po kur iku kjo kohë kaq shpejt?!»

Është e kotë të pyesësh. Koha ka ikur dhe s'kthehet më. Habit sa të duash, ditët, muajt e vitet ikin me një shpejtësi të çuditshme...

Kështu ikën gjithë ata muaj nga dita kur Nuri Zyberi prishi bereqetin në arë. Iu kujtua ajo që kishte bërë, kur hyri në qytet. Dita porsa kishte filluar të zbardhët dhe dritat e vogla dridhesin lart mbi shtylla, të zbeta e të mbuluara nga mjegulla e dendur.

— Çudi!, — tha me gjysmë zëri e i lodhur, — u bënë pesë muaj!

Pastaj, si la më krah hanin e Lazës, ku vite më parë takonte miqtë e tij, e harroi ngjarjen, u foli kuajve të ngarkuar me misër dhe mori tatëpjetë pazarit. Qëndroi përpara një dyqani me qepena, përkundrejt Zallit. Priti sa kaloi një udhëtar dhe trokiti në një mënyrë të veçantë.

Dera e vjetër u hap pas pak me gërrvima dhe te porta u duk ftyra e një njeriu. Drita e agimit ia theksonte më

shumë rrudhat kryq e tērthor ballit. Ky njeri e kishte fyttyrën tē fryrë e tē topitur, si alkoolikët ose si ata që vuajnë nga veshkat. Për një çast Nuriut iu duk sikur dyqanxhiu fshehu me zor një buzëqeshje, që pērbrenda tij ishte si një ngazëllim.

— S'të prisja sot, — tha dyqanxhiu dhe, si hodhi një vështrim tē shpejtë në rrugën e ngushtë me kalldrëm dhe pa njeri, ngriti me duart e fuqishme njërin nga qepenat dhe tha:

— Shpejt! Shpejt!

Nuriu i shkarkoi kuajt me një shpejtësi tē çuditshme, i futi thasët brenda, i zbriti kuajt në Zall, u vuri torbat me elb dhe, sa tē hapësh e tē mbyllësh sytë, u gjend në dyqanin e errët e tē ftohtë. Kaloi një çast gjersa në gjysmerësirë dalloj fyttyrën e dyqanxhiut, tē shtangur nga habia.

— Mirë se tē gjeta, zoti Ilo!, — tha dhe i shtriu dorën e djersitur.

— Jo kështu, jo kështu!, — përsëriti dyqanxhiu duke ulur qepenin gati gjer në fund.

— Mos u shqetëso kot, — i tha Nuriu duke ia shtrënguar dorën e ngrohtë e tē butë. — As më pa njeri, as ka pér tē marrë vesh njeri.

— Ç'na solle?, — e pyeti pas pak tregtari disi i qetësuar.

— Misér.

— Bukuri!, — dhe në gjysmerrësirë u dëgjuja fërkimi i shpejtë i pëllëmbëve. S'qenka i keq, por jo i dorës së parë. Nuriu donte t'i kundërshtonte, po tregtari meqë kishte frikë, u tregua sikur s'kishte nge.

— Sa ia ke shtënë?, — e pyeti duke iu dridhur pak zéri.

— Pesëqind lekë më shumë se javën e kaluar.

— E pérse? — Spekulanti shprehu habi në fyttyrën e tij tē majme e dhelparake.

— E di vetë zotrote, — iu përgjigj Nuriu duke kérkuar qesen e urorit në xhepat e jelekut. — Çmimet u ngriten përsëri këto ditë. Kuintali kushton shtatë mijë e pesëqind lek tē felliqura.

— Budallenjtë e blejnë kaq shtrenjtë misrin. Hajt, t'i

japim fund! Mjaft i ramë legenit, se këtu, me të feksur dita, vijnë edhe hallexhinj, edhe njerëzit të panjohur.

— Nejse, — tha Nuriu duke shkrepur masatin e duke u munduar të tregohet zemërgjerë. — Shtatë mijë e dyqind!

— Shtatë mijë dhe léri fjalët!

Nuriu për një çast heshti, duke përfituar nga rasti sa të ndizte cigaren me eshkë. Po, si u bind që tregtar s'jepte as edhe një lek më shumë, tha:

— Me ty s'i dilet dhe s'kemi përsë të prishemi. Hajt! Për hair qoftë! Shtatë mijë!

Tregtar, me një shpejtësi të rrufeshme, i hodhi thesët mbi peshore, i peshoi, pastaj hoqi një dërrasë nga dyshemeja dhe e derdhi misrin në hambarin e fshehtë. Tek lëvizte ngjante si një top që kërcente qosheve të errëta. Numëroi po me atë shpejtësi njëzet e tetë mijë lekë dhe ia ngjeshi Nuriut në dorë.

— Mund të mos i numërosh! Do të vish të shtunën tjetër?

— Po ta gjej tragën, se e di që më gjurmojnë. — Nuriu thithi duhanin, u kollit sipas zakonit dhe shtoi në të kollitur e sipër: — Ti e di, po të zunë, hajde t'u shpëtosh!

Kur u bë gati për të dalë, në kohën që ndukte dorën e ngrohtë e të butë të matrapazit, dikush trokiti në derë, po me atë mënyrën e Nuriut.

— Është njeriu ynë, — e qetësoi tregtar.

Duke u përkultur pak nën qepen hyri një fshatar trup-vogël me yll në mes të qeleshës.

— Urdhëro, Kasëm, urdhëro! Mos ki frikë! Nuri Zyberin kam këtu.

Fshatari shtangu. Nga era e ftohtë, në cepat e syve, i që mbledhur pakëz ujë dhe dukej sikur qante. Edhe zërin e kishte si më të vajtuar:

— Solla pak misër, — tha edhe fshiu me mëngën e setrës së ashpër vetullat e sytë. — Ua hoqa nga goja fëmijëve për kripë, sheqer e vajguri. Ç't'u bësh! Të hanë shpirtin!

— Për fëmijët e ke bërë. S'ka gjë, — i dha zemër tregtar.

Kasëmi futi në dyqan hejbet me misër dhe bënte çmos që të mos e vështronë Nuriun në sy. Në përgjithësi ai qe

njeri i urtë e i hështur. Shpesh dilte në fushë i grisur e i çjerrë dhe, për habi të të gjithëve, punonte edhe zbatur. Në mbledhjet e fshatit zinte një qoshe dhe pothuajse nuk fliste fare. Dhe kur i duhej të fliste, gjithnjë përkrahte pushtetin dhe mbante anën e Lytos e të Malkës. Me atë ngadalësinë e kaut të heshtur e të palodhur, dita-ditës grumbullonte misër, grurë, fasule, duhan dhe i shiste në treg të zi.

— S'të dija të tillë, — i tha Nuriu kur dolën nga dyqani dhe ecën nëpër pazarin mbushur plot me njerëz.

— Berekaversën pushtetit tonë!, — mezi u ndie Kasëmi duke vështruar me kujdes, sikur i numëronte gurët e kalldrëmit. — Duhej të na i hiqte triskat dhe na i hoqi. Mirë bëri. Nëse vajti kuintali shtatë mijë, s'kam faj unë! Unë, o vëlla, shpesh them me vete: Po të mos ishim ne, fshatarët, qyteti do të ngordhët për bukë si peshku pa ujë! Apo e kam gabim? —

— Drejt, drejt!, — i tha Nuriu i gjëzuar, duke ia hedhur dorën në bërryll, se iu duk sikur u pengua e do të binte. Dhe shtoi: — Ti flet si kulakët e këqij, o Kasëm!

Ai qëndroi një çast dhe tha pa hequr vështrimin nga kalldrëmi:

— Me kulakët mos më ngatërró! Në je zotrote i tillë, unë s'të kam ndonjë faj!

— Unë s'jam kulak i keq. Ti e di. Kjo është një nofkë, si kunj, që ta ngulin me shaka dhe që s'e heq dot, sado i zoti të jesh.

— E heq e s'e heq dot!, — tha Kasëmi dhe nxori kutinë për të dredhur një cigare. — Më dëgjo mua. Me pushtetin punët duhet t'i kesh në rregull, se është pushtet i popullit. Edhe unë kam dhënë shumë pér këtë pushtet, dhe, po të jetë nevoja jap përsëri, edhe jetën. Ti, po të sillesh mirë e pa djallëzi, edhe nofkën e heq!

«Dhelpër!» mendoi Nuriu dhe i ra shpatullave të arnuara me beze.

Ata e pleqëruan që të ktheheshin në fshat së bashku dhe, te mesi i pazarit, atje ku çirreshin më shumë hamenjtë e palodhur e të fortë, u ndanë përkohësisht. Kasëmi hyri te

një dyqan për të blerë një bateri radioje dhe goma e koper-tona biçikletash, megjithëse në shtëpi s'kishte as radio dhe as biçikletë. Kohët e fundit i qe bërë një ves i keq dhe blinte çdo gjë që i zinte syri. «Paraja shkrin, thoshte, malli mbetet». Dhe kishte vendosur, me atë mendjen e tij të çakërdisur, t'i kthente paratë në mall.

Nuriu eci nëpër rrugët e zhurmshme të pazarit dhe thoshte me vete, duke parë gurët e kalldrëmit dhe duke ü shtyrë herë-herë me supe nga udhëtarët: «Ky Kasëm Sharra qenka tamam burrë! Më parë as qurrat s'i hidhja! Tani më duket si vëlla! E sheh ç'bën pasuria!? Morraman e qurraman ishte! Tani më bën hije! Jepu, o pushtet, toka e pasuri sa të duash! Hallall u qofshin edhe të miat! Kasëm Sharra vjen vetë me këmbët e tija tek unë!»

Dikush e shtyu dhe ai e pa veten përpëra vitrinës së një dyqani të madh. Përtej xhamave pa Kasëmin që mundohet të fuste në hejbe ca rrathë të mëdhenj prej kauçuku. Atëherë iu kujtua se kishte në xhep njëzet e tetë mijë lekë dhe s'kishte vendosur ende ç'të blinte. E dinte mirë se paratë e thata s'mbaheshin shumë gjatë në atë kohë. Gjatë vjetëve të fundit ishin bërë dy reforma monetare. Kishte dëgjuar se mjaft kulakëve e pasanikëve u qenë djegur paratë letra fshehur në thasë e në këllëfet e dyshekëve. Por, po të bëhej reforma e tretë, edhe paratë e tij do t'i merrte djalli.

Ecte përmes pazarit, me kokën poshtë e ngadalë, se kohën e kishte përpëra. Për të blerë mund të blinte më vonë, po atë çast iu kujtua se e prisnin punë të tjera më të rendësishme. La pazarin, u kthyte në një rrugë të ngushfë e disi të heshtur dhe hyri në një shtëpi njëkatëshe, përmes kangjellave gati të rrenuara të oborrit të vogël e të shkretë.

Në një kolktuk, para tryezës së madhe me xham të cillosur, midis dosjeve të trasha si mure e të panumërtë, feks-te si miush një kokë e zezë, me mustaqe të holla të zeza e me gjyslykë të zinj mbi hundë.

— Tunjatjeta, zoti Niko!, — e pëshëndeti Nuriu që nga pragu.

Plaku ngriti syzet mbi ballë, hodhi kalemin dhe, si
enjohu mikun, fërkoi dy-tri herë pëllëmbët.

— Po të prisja, Nuri aga, po të prisja! Urdhéro, ulu!
Niko Dardha ishte shumë plak, poi tepër i shkathët.
Çdo fjalë e shoqéronte me lëvizje të gjymtyrëve. Kur fliste,
dukej sikur hidhej valle mbi kolktuk.

— Ja edhe florinjtë pér njëzet e tetë mijë lekët, Nuri
aga, I kam bëré gati që herët në mëngjes. Apo gabohem?!
Ndoshta janë më shumë se njëzet e tetë? Kështu?!

Nuriu tundi kokën e rënduar.

— Ti kurrë s'gabohesh, zoti Niko. Njëzet e tetë mijë.
Ja ku i ke!, — dhe ia lëshoi kartëmonedhat mbi tryezë.

Sytë e fajdexhiut lëvizën vetëtimthi, si ingjervi prapa
xhamave të syzeve. Lagu tre gishtrinj të hejtë e të verdhë
në një sfungjer të rrjepur dhe i numëroi kartëmonedhat
me shpejtësi të rrufeshme një herë mbarë dhe një herë
nga fundi.

— Tamam, tamam, Nuri aga! Kot i numërojmë! Jemi
një fis e s'mund ta gënjejmë njëri-tjetrin.

Nga një tok çelësash, lidhur me zinxhir, që nxori prej
jelekut të zi, zgjodhi më të voglin dhe me të hapi një ka-
safortë hekuri. I palosi mirë kartëmonedhat në një qoshe,
shënoi diçka në një formular dhe, duke myllur kasafor-
tën, iu kthye Nuriut:

— Këto nuk do t'i kthej në flori. Do t'i lëshoj me
fajde. Megjithëse tani është zor, po do të provoj njëherë?
Ka hallexhinj që kanë nevojë pér para. E njeh familjen
e një Qemal, Qemali. Janë dymbëdhjetë shpirt. Qemali u
vra në luftë, po njëmbëdhjetë kanë mbetur si cironjtë në
sterë. Banojnë në njérën nga shtëpitë e mia që kam fituar
me fajde. Atje janë pjellë të tetë fëmijët. Tani nuk më
paguajnë, po unë ja ku i kam dokumentet e tapitë. Edhe
në vdeksha, ia kam lënë djalit amanet që ta plotësojë këtë
porosi.

Nuriu mori një dorë florinj, që tringëllinë mbi xha-
min e thyer të tryezës, dhe i futi në kuletën me rruaza që
ia kishte dhuruar kunatollë, një kulak si ai, kur doli nga
burgu javën e kaluar. Plaku fajdexhi, hajdut e zemërak i

papërmabajt, dërdëlliste kundër familjes së Qemalit, kurse Nuriu u bë gati të dalë, krejtësisht i shkujdesur, si një njeri që, në çast, ka kapërcyer vdekjen e sigurt. Ai mund të kalonte tani midis pazarit, i qetë, i qeshur, i lumtur dhe asnjeri nuk kishte të drejtë ta prekte. Në xhepin e jelekut, në anën e majtë, kishte një qese me florinj. Zemra i rrihte me një ritëm të zakonshëm e të heshtur si rreh çdo zemër, po atij i dukej sikur i trokëllinin ato paret e vogla, të rrumbullta të lehta e me vlerë, që quheshin thjesht florinj e që, sipas tij, ngrinin ujin përpjetë dhe bënин luf-tën. Tani ai mund të delte pazarit e rrugëve si të gjithë njerëzit e kësaj toke, të pinte ndonjë birrë me kërnacka të shijshme, të blinte dyqaneve q'të dëshéronte, të pinte një kafe me ajkë te hani i Lazes. S'do të ishte keq sikur të luante kumar me fajdexhiun plak. E përse të mos luan-te? Kushedi sa herë, ata të dy dhe katër-pesë të tjerë, njerëz me ofiqe, kishin luajtur pikërisht rreth asaj tryze me xham të ciflosur, edhe poker, edhe dudum, edhe zare, edhe tridhjetenjësh!

— Me gjithë qejf, Nuri Aga! Po jo tani! Javën tjetër, — ia preu shkurt fajdexhiu dhe me ata sytë e zinj, të lë-vizshëm të veckël, si caraca, i tregoi derën. Por jo derën nga kishte hyrë. Një derë tjetër, përbri tij, që dukej si faqe dollapi. Plaku u ngrit nga kolltuku, vuri syzet mbi ballë, sic bënte gjithnjë kur i afrohej dikuj, dhe e zuri mikun për krahu:

— Nuri aga, — i tha, — ti ke kërkuar të takohesh me një mik të vjetër.

Nuriu ia preu shkurt;

— Jo, — tha. — S'kam kërkuar të takohem me njeri...

— Më fal, se jam plak dhe harroj. Ka kërkuar ai miku të takohet me ty. Ja tek e ke.

Plaku hapi derën si dollap, e shtyu mikun pak nga supet dhe Nuriu u gjend në një dhomë krejtësisht hermetike, pa dritare, që binte erë duhan e lagështirë dhe që ndriçohej nga një llambë jo më shumë se pesëmbëdhjetë qirinjsh. Në atë dhomë, kapardisur këmbë mbi këmbë, ishte Miloja, të cilin Nuriu, me gjithëse kishte ndryshuar

krejt veshjen, e njohu menjëherë, i dha dorën dhe e përqafoi.

Ishte veshur Milo Peçi si mos më keq, me kostum të vjetër të arnuar te gjunjët e te bërrylet. Edhe republikën e zezë e kishte të zgjyrosur. Fytyra e tij, dikur e shëndo-shë dhe e pashme, i qe hequr pak. Si u përqafuan, i hodhi një vështrim Nuriut, sikur donte të provonte diçka, dhe me zë shumë miqësor e ftoi të ulej:

— Ulu, zhaxha Nuri, ulu! Kështu janë këto punë. Por gëzohem që s'më paske harruar.

Fytyra e Nuriut e kishte zhdukur krejt atë gjëzimin e mëparëshëm, atë hijen e lumturisë së çastit dhe nuk shprehte asgjë. Kjo «asgjë» u theksua pas pak në të gjitha shqisat e gjymtyrët e tij. Qëndronte përpara Milo Peçit si përpara një njeriu fare të panjohur. Pati edhe ndjenjën e një ere të neveritshme, e një mishi krejtësisht të qelbur e të mbushur me krimba. Kjo gjendje e rëndë iu krijuar nga që dhoma ishte hermetike, e paajrisur prej ditësh.

— Ne njihemë prej kohësh, Nuri aga, prandaj do të flas me ty hapur e sinqerisht, si me vëllanë.

Karrigia e vjetër ku qe ulur kulaku krisi e vajtoi një çast gjersa zuri vend.

Miloja, pa luajtur fare nga vendi, duke shkundur hirin e cigares mbi takatuken me kokë luani, vazhdoi:

— Mua më hoqën si specialist edhe pér atë sabotimin tënd. Po unë përsëri në fshatin tuaj do të vij. Ja, sot më njoftuan se më emëruan nëpunës grumbullimi. Sigurisht, s'është si puna e specialistit. Po çka. Sa më të pakënaqur na bëjnë, aq më shumë na armiqësojnë... E, që ta dish, Nuri aga, miqtë e Shqipërisë po i varrozin me gjyqe e rezoluta. Po ne jemi të fortë, Nuri aga. Tërë perëndimi, me gjithë Amerikën e me tërë botën është me ne. Shqipëria është larg nga të mëdhenjtë dhe askush kurrë s'ka pér ta ndihmuar. Tani, më thuaj zotrote, meqë pér fat të keq populli e do Partinë dhe Enverin, punon e beson se këtu do të ndërtohet socializmi, a e pranon zotrote gjarprin të të mblidhet kutullaç rrëth qafës? Më thuaj, Nuri aga. E dua fjalën shqip e top. Pa dredhira! Pranon zotrote të të vëré

kularin hyzmeqari çalaman Qamil e tē tē drejtojë një rrje-pacak e maskara tjetër si Lytoja apo Malka?! Jo... tē lutem!... Mos u shpejto! Dua fjalë burrash!

Kërciti përsëri karrigia ku qe ulur kulaku. Nuriu, kur fliste Miloja, dëgjonte qëtë, kurse përbrenda bluante se ç'duhej t'i thoshte këtij Milos shpatullgjerë, leshzi e tē keq. Nuk ia kishte marrë kurrë mendja se njerëz si Miloja mund tē bëheshin organizatorë të grupeve diversi-niste e tē kishin lidhje me perëndimin.

- Zotrote, — i tha — dhe iu zu fjala në fyt.
- Fjalë burrash, — përsëriti Miloja.
- Mua s'ma pret mendja shumë, s'marr erë nga politika e madhe...

— Po nga e vogla?, — qeshi Miloja.

Nuriu, sikur tē mos i kishte ndërhyrë njeri, vazhdoi mendimin e vet, qetë-qetë.

— Unë jam hollë: lesoj tokën, bëj dru në mal, kullos bagëtinë lëndinave. Po, në qoftë se zotrote ke nevojë për ndonjë gjë, përse mos tē tē ndihmoj? Në qoftë se tē duhet ndonjë lek, megjithë qejf, urdhëro!

Nuriu futi dorën në xhepin e jekut për tē nxjerrë kuletën me rruaza.

— Mos u shit si budalla, Nuri aga, — ia preu me tē ash-për Miloja dhe vuri dorën në brez, ku i nxinte tyta e një revolveri. — Unë kam nevojë për ndihma tē tjera, jo për para... Që t'i rrëmbejë lumi komunistët, — vazhdoi Miloja — duhet t'i lësh pa popullin. Dhe që tē shkëputet populli, duhen terrore, vrasje, sabotime. Nuk duhet tē grumbullohen drithi, vezët, mishi e leshi. Nuk duhen kooperativa, rrugë e shkolla. Duhen ato që duhen, Nuri aga! Ja ç'duam nga ti... Këto duam nga ti.

Kulaku u step:

— Unë tē thashë, që s'marr erë nga këto, Milo Peçi! Unë jetoj me ditën e sotme, me veten time! Nesër, le tē bëhet ç'të bëhet! S'u përmbycka bota!? Një kokë kam në fund tē fundit, s'kam dy. Po ma prenë, mbarova!

Miloja e përfshiu Nuriun me tē dyja duart për sus-pesh, e shkundi disa herë dhe i tha duke e vështruar drejt në sy:

— Lëri fjalët e dhëpërëtë, Nuri aga! Kur e paske harruar kaq shpejt se si e prishe bereqetin? Kush të shpëtoi aherë?... Partia? Pushteti? Fronti?... Të shpëtova unë dhe miqtë e mi... Mos kujton se unë nuk e di ku e ke fshehur bereqetin dhe mitralozin gjerman?! I di të gjitha. Nejse, — uli zërin Miloja duke i rrahur shpatullat. — Ti je njeri i mirë, je me ne. Frika dhe guximi pranë janë, një presje ndan. Hiqe presjen dhe mos prit më. Ka ardhur koha të veprosh. A më more vesh, bre burrë?

Nuriu u lëshua i téri në karrigen që gjerrvinte dhe tha me gjysmë zëri:

— Po, zoti Milo!

— Fjalë burrash?

— Fjalë burrash...

Sipas shtrëngoi dorën, u ul edhe Miloja qetë në vendin e vet. Po tani ai ishte më energjik në të folur e në lëvizje.

— Udhëzime do të marrësh nga unë sa herë që të vij në fshat. Ka mundësi që të bëj vizita edhe në shtëpi. Jam i bindur që do të jem i siguruar!... Puna e parë: Buka! Këtu po ngordhin për bukë. Asnjë thërrime të mos jepni. S'ka grumbullim. Mos harro, Nuri aga, se ne, edhe kështu të përbysur, jemi të fortë. Do të bëhet luftë. Këta janë të rrethuar! Do të shfarosen e s'do t'u mbetet nam e nishan. Mos e harro këtë!

Miloja i foli gjatë dhe Nuriut frika pothuajse iu zhduk fare nga fjalët shpresëdhënëse. Me të dalë në rrugë, u takua me një grumbull njerëzish që ecnin me zhurmë duke qeshur.

— C'ka ngjarë?!, — pyeti i trembur.

— S'i ke sytë në ballë zotrote?, — iu përgjigj dikush duke mbajtur ijet me duar.

Përpara tij, midis njerëzve, ecnin tre veta të parruar, me fytyra të vrara e të verdha. Të tre ecnin me kokën poshtë, pa guxuar të vështronin njerëzit e shumtë, që qeshnin e talleshin, dhe fëmijët që i shoqeronin me vërvshëllima. Ata i kishin lidhur të tre njërin pas tjetrit me litar dhe në trup, bile edhe në ballë, u kishin ngjitur letra bi-

xhozi. Më në fund, Nuriu pa fandin — karo në gjoksin e njërit, dhjetën maço në krahun e tjetrit dhe asin spathi në ballë të të tretit.

— Tridhjetenjësh!, — mendoi dhe ndjeu një farë gëzimi në shpirt që nuk ishte edhe ai si një kumarkhi i regjur, midis tyre.

«Këta të bëjnë hatanë!» — tha me vete dhe u dha këmbëve për t'u larguar sa më shpejt, duke dëgjuar prapa krahëve thumbat e romuzet e njerëzve, që i dukeshin sikur i drejtosheshin atij:

— Kumarxhinjtë e fëlliqur!

— Mirë ua bëjnë!

— Atë kokë kanë, atë kapellë u vënë!. Kaloi edhe një herë përmes rrugës së pazarit, që gu-mëzhinte nga njerëzit, u ndal përsëri para vitrinave, bleu një sahat të madh muri dhe mori kuajt. Në lëndinat e fushës së sportit takoi Kasëmin dhe që të dy shaluan e morën rrugën e fshatit.

— Së shpejti do të kemi ngjarje të mëdha, — i tha Kasëmit kur dolën nga qyteti.

— Çfarë ngjarje?, — u interesua Kasëmi, që s'e hiqte kurrë nga koka atë qeleshen e zezë me yll.

— Po të mësosh shumë, do të plakesh shpejt, — bu-zëqeshi me dinakëri Nuriu. — Mbahu pas meje! S'ke për të rënë!

Ai e goditi kalin dhe e ngau me revan.

— Unë mbahem vetëm pas pushtetit, — tha Kasëmi prapa krahëve të tij,

2.

Fusha e rrethuar me kodra e male duket si një kupë gjigante mbushur me ngjyra me kallnj dhe me rrush. Kur del prej qytetit në rrugën që të shpie në Devoll, nga e djathta janë kodrat e malet, nga e majta shtrihen fusha sa të ha syri. Ja ku duket maja e malit Ivan përpara, në verilindje, dhe më tej Mali i thatë. Atje, në këmbët e atij Gurit të Bardhë si piramidë është fshati i tij. Sa gëzim

ndien njeriu, kur, pas një largimi të gjatë kthehet përsëri në vendin e lindjes. I njeh të gjitha fshatrat, më tej akoma çdo pemë, çdo gur. Po megjithëkëtë ai ka harruar shumë gjatë atyre gjashtë vjetëve. Pastaj edhe shumë gjëra kanë ndryshuar, siç ka ndryshuar edhe ai vetë. Për gjashtë vjet mund të rritej një pemë e re, mund të thahej lisi i mocëm. Guri mund të kthehej në pluhur. Vajza mund të bëhej nënë.

Dielli ishte në të perënduar dhe mbrëmja po binte ngadalë dhe e butë. Skënderi ecte me hap të shpejtë, shikonte me gëzim kodrat e malet e larta dhe shpesh mundohej të dallonte, në këmbët e tyre, fshatin e tij të bardhë. Çanta ushtarake i rëndonte supet dhe kishte djersit ur pak. Ai mund të çlodhej një copë herë në lëndinat, të çesmja me ujë të ftohtë e Plasës, siç bëjnë shumica e udhëtarëve, po nuk qëndroi, se donte të arrinte sa më parë në shtëpi.

Herë pas here në xhade kalonin kamionë të ngarkuar me gëlqere, me qereste, me gurë e cimento.

— Edhe nga kjo anë vëlon puna, — mendonte Skënderi me një ngazellim në zemër duke parë makinat që fluturonin përmes pluhurit në drejtim të Maliqit, ku vazhdonte faza e dytë për tharjen e kënetës dhe ku hidheshin themelët e një kombinati të madh sheqeri.

Matanë Plasës arriti një fshatar pakëz të kaluar nga mosha, që ecte i menduar prapa gomarit të ngarkuar me misër. Skënderi e përhëndeti me zë të lartë. Fshatari, i zënë në befasi, iu përgjigj shkurt e ftohtë dhe s'kishte qejf të hapte bisedë. Skënderi e vështroi duke qeshur:

— S'më njohe, xha Lame?

Plaku ktheu fytyrën tërë rrudha nga ai dhe tundi kokën me habi:

— Jo, o bir!

— Unë jam Skënderi i Zalos, s'të kujtohet? Fshatari qëndroi. Fytyra e pjekur nga erërat e nga dielli iu çel.

— Si more, Skënderi qenke ti? Po ke ndryshuar shumë, more bir, si të të njoh! Sa vjet u bënë?

Gjashtë vjet! Gjashtë, si një ditë!
Plaku e përqafoi, ia përkëdheli supet dhe për një copë
kohë vështroi me ëndje trupin e lidhur, të djaloshit, uniformën e tij ushtarake, shenjat e rreshterit dhe medaljet
në gjoks.

— Hidhe çantën mbi samar, se qenke djersitur. Me lejë
ke ardhur?

— Erdha përgjithnjë. Tani do të punoj në fshat.

— Sa mirë paske bërë! Do të gëzosh nënën. E di ajo?

— Jo, dhe kam frikë se mos sëmuret nga gëzimi.

— Nuk sëmuret njeriu nga gëzimi, or bir.

Ata vazhduan rrugën si dy miq të vjetër.

— Po ti, xhaxha, nga kështu?

Lamja pshérëtiu thellë:

— Për hall, në qytet... Shita kaun. Duhet t'i japim shtetit, mishin, prandaj. Unë do ta shlyej detyrimin më parë. Me lekët që më mbetën bleva misër.

— Po kaun, të tepërt e kishe?

— Një kisha unë... Po s'ka gjë, o bir. Kur të shtrëngohen punët në fushë, bëj si bëj. Mbase, aty nga vjeshta, mund të ble një pendë qe...

— Po përsë nuk i qave hallin këshillit? Ai i ndihmon
të varfërit.

— Të gjithë si ndihmon dot. Të kujtohet Jaçja? Ku-
qoja? Tani është sekretar në këshill, «Me gjithë qejf, o
xhaxha, më tha, po ku të gjejmë? Kurse plani është plan.
Shit ndonjë gjë dhe rregullohu» Ja kështu! Ndoshta Jaçja
ka të drejtë se është zor në fshat, o Keno. U dogjëm në
luftë, u përvëluam, ti e di... Duhet menduar diçka, pa kë-
shtu e kemi zor.

— Megjithatë, s'ke bërë mirë që shite kaun e punës...

— Isha në hall të madh. Duan të hanë ata të gjashtë
që kam në shtëpi? Tani shlyej detyrimin e mishit e të
dridhit dhe kemi të hamë gjer në korrije.

Eshatari përpiquej të tregohej i gëzuar, po në zërin e
tij kishte një tingull hidhërimi e pendimi të madh. Edhe
Skënderi ndjeu një farë boshllëku në shpirt. Ai qe larguar
nga fshati që në vitin 1943. Në ushtri çdo gjë ishte e qartë

dhe e përpiktë. Skënderi mendonte se edhe në fshat çdo gjë ishte e qartë, se ishte më mirë të punonte atje se sa të shërbente në ushtri. Gjatë viteve që shërbeu në ushtri, mësoi shkrim e këndim, lexoi gazeta e libra dhe mendonte se ishte në gjendje të zgjidhët çdo problem edhe në fshat. Po ja ku takoi fshatarin e parë e s'mund t'i thotë gjë, veç ndonjë ngushëllim a qortimi të lehtë.

Fshatari e vuri re pakënaqësinë e djaloshit dhe ia hodhi dorën në shpatull.

— Mos e vra mendjen, o bir! Unë i kam fajet që t'u ankova. Fshati fshatështë. Ka halle, vështirësi, gabime. Po ka dhe gjëra të mira, ama. Ti, pa mendo një herë. Ne tani kemi tokën që se kishim dje. Kemi tokën dhe lirinë, Keno! Tani duhet menduar diçka, duhet punuar, si të thuash, ndryshe, ja si ata devollinjtë që kanë filluar të ngrejnë kooperativë. Aherë çdo gjë do të shkojë më mirë, dëgjo plakun ti!...

Ata i qenë afruar Devollit. Midis brigjeve të veshura me shelgje e pemë të egra frutore, shndriste si argjend lumë. Në male kishte kohë që s'binte shi, prandaj Devolli rriddhë i qetë, duke pasqyruar retë e bardha dhe pemët e blerta. Ata e lanë xhadënë dhe morën bregun e lumi, përti rënë më shkurt e përtë kapërcyer pastaj matanë, mbi një urë të vjetër prej druri. Fshati tani ishte përkundrejt dhe, meqë koha ishte qelq, dukej fare pranë, nën Gurin e Bardhë, i mbledhur midis gjelbërimit dhe i ndarë më dysh. Njëra lagje fillonte gati buzë jazit e pëershkuar mes përmes nga xhadeja, kurse tjetra shtrihej mbi kodër, që nga Shkoza e gjer aty ku fillonin vreshtat.

— Pa shiko!, — i tha Lamja duke i bërë me dorë përpara.

Dy veta, hipur mbi kuaj, ecnin përmes shelgjishteve në tragën e rrahur nga qerret. Prapa i ndiqte një pelë cile.

— Kush janë ata?, — e pyeti Skënderi.

— Ai më i shkurtri është Kasëm Sharra, që s'e heq festen me yll nga koka. Tjetri është Nuriu.

— Cili Nuri?
Xhaxha Nuriu, bre! Një Nuri kemi ne, Nuri Zyberin.

— Kulaku?

— Kulak i thënçin! Ai vetë na i dha të gjitha dhe tanë ka mbetur dordolec. Sa kohë më parë se kush ia qëroi misrin në arë dhe gjer sot e kësaj dite s'po e mbledh veten... Me sa duket lan gjynahet e vjetra, — qeshi Lamja dhe u bëri zë udhëtarëve.

Kalorësit, që ecnin pak përpara, kthyen kryet dhe vazhduan rrugën. Lamja u thirri përsëri dhe ua bëri me dorë. Nuriu e njohu fshatarin që kishte shitur kaun, po tjetrin, ushtarakun, se kishte parë ndonjëherë. Një e rrëqethur i kaloi në trup papritur dhe nuk e kuptoi në i erdhi nga era e mbrëmjes, apo nga frika.

— C'është ai ushtarak?, — pyeti bashkudhëtarin dhe pér pak desh ra nga kali, — Mos është i Sigurimit?

Nuriu u zbe menjëherë dhe u drodh mbi kalë:

«Të më jenë qepur thua?...»

— A ke armë? — pyeti pastaj me zë.

— C'është kjo pyetje, Nuri aga?, — ia ktheu Kasëmi shumë i habitur.

— Kot. Kot. Në këto kohë është më mirë pér cilindo të mos mbajë armë.

— Unë e kam nagantin me lejë nga Dega, — tha fshatari duke prekur me dorë armën që mbante në bel.

Ndërkaq Lamja me Skënderin u ishin afruar shumë. Lamja vazhdonte t'u bënte me dorë që të qëndronin. Nuriu hoqi dorën, që e kishte vënë në ballë si strehë pér të parë më mirë, dhe tha i qetë:

— S'është gjë, jo.

Kasëmi u habit përsëri dhe pyeti:

— E çfarë kujton zotrote se do të jetë?

I paril u afrua ushtaraku. Nuriu i ra në sy uniforma e vjetëruar, dekoratat, shiritat e rreshterit. Ia nguli sytë. Iu duk si fytyrë e njohur, po nuk iu kujtua.

Skënderi i përshëndeti duke buzëqeshur lehtë. Nuriu ngriti vetullat me habi dhe balli iu rrudh. Lamja qeshi me zë:

— Nuk e njeh?, — tha. — Është djali i Zalos, që ka ikur partizan gjashtë vjet më parë.

Nuriu u hodh nga kali si ndonjë djalë i ri dhe iu derdh në qafë. E përqafoi edhe Kasëmi.

— Ku t'i njohësh këta azganët e sotëm! Mirë thonë: kur plakesh, t'i ha qeni sytë e mendtë. Si je, o djali i xhaxhait? Shyqyr që na u ktheve shëndoshë, se kaq djem i lanë kockat maleve e s'u kthyen! Të çmallësh atë derëzezë nënë dobarem, që ka mbetur fillkat vetëm e në mes të udhës...

Nuriu dukej shumë i prekur. Skënderi vuri re se atij edhe sytë iu njomën nga lotët.

— Faleminderit, xhaxha! Gëzohem që u gjeta shëndoshë e mirë.

Nuriu, si mori vesh që ushtaraku kishte ardhur përgjithmonë në fshat, u bë më i butë e më i dashur dhe fshiu sytë me kurrizin e dorës.

— Kemi nevojë pér ju, o djemtë e xhaxhait, se e di si venë punët këtu? Ja, kështu, lesh e li dhe s'e merr vesh qeni të zonë. Të tëra c'kishim i dhamë pér këtë pushtet, gjë prej gjëje s'mbajtëm pér vete. Dhe s'më vjen hiç keq, se vëllezërve ua dhashë. Ja, Qamilit, qetë më të mira ia zgjoda. Edhe këtij, Lames, i dhashë tokën më të mirë. Kështu, apo jo? Fol, Lame, në s'e kam drejt! Dhe ca çunakë, Lytoja e Malka, si shpërblim, më vunë atë nofkën e pësh-tirë e të ndyrë të kulakut. Po, nejse! Tani u mësova! Si i thonë asaj fjalës: Bëje të mirën e hidhe në det, në mos ta di peshku, ta di zoti vetë.

U hipën kuajve dhe u nisën drejt fshatit. Lamja mbeti më këmbë. Skënderi nuk fliste. Nuriu i peshonte fjalët dhe e vështronte të porsaardhurin me bisht të syrit. Kasëmi sepse e ndiente veten të vrarë dhe her-herë prekte tytën e ftohtë të revoles. Lamja qe bërë pishman që kishte shitur kaun, dhe gati qante përbrenda e përsëriste me vete fjalët e Skënderit, që i ishin ngulur në tru si turjelë: «Megjithatë, s'ke bërë mirë që shite kaun e punës!... Megjithatë... Megjithatë. — s'ke bërë mirë!»

Nuriu e kishte marrë veten dhe dalngadalë po vilt-te vrer:

— E ç'qullosem?! — pyeste ai dhe përgjigjet po vetë.

-- Në vend që të vihej puna në vijë, u djallos fare. Është bërë fshati si pazari më të perënduar të diellit.

Kur kapërcyen vijën e jazit, si i ngopën kuajt me ujë, Skënderi ia preu fjalën, i menduar:

— Partia do të vërë rregull atje ku s'ka. Më fal, xha-xha, po s'ma merr mendja që punët të jenë kaq keq.

Nuriu ia nguli kalit mâmuzët në bark dhe kafsha kërcëu e trembur e doli matanë jazit.

— Do ta shohësh me sytë e tu, o bir i xhaxhait, — tha i pikëlluar. — Sigurisht që jemi më mirë se ç'ishim dhe unë s'them dot asgjë kundër pushtetit. Partia dhe ne fshatarët jemi në rrugë të drejtë. Po njerëzit nuk e vënë drejt sérën e druve. Në s'beson, ja ku i ke, pyeti!

E kishte fjalën për Kasëmin e Lamen, po ata heshtën.

— Do të rrojmö e do të shohim, — tha Skënderi.

— Ashtu, xhan i xhaxhait, ashtu!, — ia bënte Nuriu herë pas here.

Biseda mori tjetër drejtim. Folën për grunyat e atij viti, që kishin shumë lagështirë, për vreshtat që nuk u ishin bërë shërbimet si duhet, se, si i thonë fjalës: s'bëhet vreshti me urata, po me shata e lopata, për pyjet që po i shkatërronin dhitë, për vajzat e para, që kishin shkuar vullnetare në tharjen e kënetës së Maliqit, për ato që pritej të ktheheshin nga hekurudha, për kooperativën, që mendohej të ngrihej edhe në fshatin e tyre. Po Nuriu, bëri si bëri, dhe e ktheu bisedën aty ku ishte ndërprerë. Pyeti Lamen, që ecte prapa gomarit të vet:

— Sa e bleve misrin, o Lame?

Lamja u përmend nga hallet, bëri një shenjë me dorë, që donte të thoshte «sa s'bëhet», dhe u përgjigj:

— Shtatë mijë e shtatëqind!

— Saa?!, — Nuriu desh ra nga kali.

— Siç! e dëgjon.

Kulaku u vrenjt dhe ia tërhoqi frerin kalit:

— Ku e bleve?, — pyeti.

— Në pazar, tek Iloja...

— Tek Iloja?!... Tek ai matrapazi?!

Nuriu shtrëngoi dhëmbët dhe shau me vete atë «qe-

rrata kaur», që ia kishte hedhur. Pastaj iu drejtua Skënderit.

— E sheh ç'bëhet, o bir i xhaxhait? Duhet të shesësh qetë, që të blesh bukë e të shlyesh detyrimin!

Aj e dinte se në fshat, vetëm Lamja kishte shitur kaun, po, për t'ia bërë të porsaardhurit qimen tra, tha duke u vënë theks të veçantë fjalëve:

— Dhe sa ka tē tillē, qē shesin qetē e punēs! Gjynah prej perēdie, o xhan i xhaxhait!

— Edhe unë desha të blija sot misër, — vazhdoi ai po me atë ton. — Po kur më thanë shtatë mijë e ca kuintalin, desh lojta nga mendtë. Ia hipë kalit dhe ja, siç më shikon, po kthehem me thasët bosh! Se, që ta dish ti, bir i xhaxhait, vjet, mua ma prishën misrin në arë ca armiq edepsëzë... ca...

Ai e preu bisedén papritur, sepse vuri re që Skënderi, duke parë me mall shtëpitë e para të fshatit, nuk po e dëgjonte më. Kurse Kasëmi thoshte me vete, i habitur:

«Tämä on tämä! Tämä on minun kaiken ajan ja minun elämän minä!»

the most. The boy does a good job as he defends the girl's right to determine her own life. Despite the negative comments from the other students, the boy's defense of the girl's right to choose is well-reasoned and articulate.

Geplante und gelegte Siedlungen sind nicht
gleiche Dörfer, es handelt sich bei diesen um
kleine ländliche Ansiedlungen, die sich auf
einen kleinen Landbesitz beziehen. Viele
diese Siedlungen sind von der Landwirtschaft
abgesondert und dienen als Nebenberuf.
Viele dieser Siedlungen sind von der Landwirtschaft
abgesondert und dienen als Nebenberuf.

K A P I T U L L I III

16 years is longer than the maximum of 15 allowed by the regulations. Despite being the largest single entity in the sector, Skypoint has not yet been granted a license.

1.

Ai ecte mbi tokën e tij si në vitet e lëmtura të fëmijërisë. Ekte dhe ndiente në çdo hap afshin e këndshëm të fshatit, që i hynte thellë në mushkëri. Mulliri i vjetër me myshk e shelgje, plepat e bardhë gjatë jazit, mullarët me kashtë të ngrënë gjer në belin e gjerë, çatitë e kuqe, çakëllet me gurë të vegjël, çdo gjë, me një dhembje të lehtë e të trishtuar i kujtonte ato vite. Nga shpejtësia e madhe nuk po i zinin këmbët dhë e shpesh i dukej sikur nuk po e njihte mirë vendin. Shtëpitë përtej hanit, që u dogjën gjatë Luftës, ishin rindërtuar. Edhe buzë xhadesë ishin ndërtuar shtëpi të reja, njëkatëshe, me ballkon e me tre-katër shkallë në hyrje. Një shkollë po ndërtohej majë bre-gut, te «varret e çobenje».

Ai ecte dhe kujtonte të vetmin njeri që i kishte mbetur gjallë nga Lufta: nënën! Vitet kishin ikur shumë shpejt, po kujtimet i kishin mbetur të pashlyera dhe çdo vit që i kte, ato, sikur t'i pikturente një mjeshtër i madh, dilnin më të gjalla, mbushur plot ngjyra dhe emocione të fortata...

Skënderi qëndroi para shtëpisë së tij. Kjo ishte një shtëpi e vogël në fund të rrugës, me plitharë lyer me gëlgjere, rrethuar me gardh, që mpleksej pas plepave. Rrëzë

gardhit kalonte një vijë uji, ku notonin disa rosa. Kopshti ishte i shkretë, me atë çacaçnikun e lartë në mes, në hijen e të cilit, midis shpendrave, ai bënte pallë në fëmijëri. Përmes mollëve, që ishin mbjellë vitet e fundit, vuri re ftyrën e një gruaje në dritaren e vogël. Zemra i rrahu fort nga malli. Pas pak, dera u hap dhe ai pa nënën që iu derdh në qafë:

— Bir i nënës!

Ai ishte më i gjatë. Fytyra e nënës i arrinte gjer në gjoks, ku i vareshin medaljet. Ajo e përqafonte, i përkëdhelte flokët, e puthte duke përsëritur veç ato fjalë që i delnin nga thellësia e shpirtit:

— Bir i nënës!

Duke parë atë ballë tërë rrudha, duke parë duart e saj të zeza si toka dhe fustanin të vjetër e me arna, Skënderi mendonte:

«Shumë qenke plakur, o nënoke!».

Kur hynë në odën e vogël dhe u ulën në postet pranë oxhakut, ai e pyeti gati me mbrytka në fyt:

— Si ke jetuar, moj e uruar? Ke vojtur ti, fill e vetme këshu...

— E éma e ndjeu tronditjen e të birit dhe ia preu menjëherë:

— Dynjaja është plot njerëz të mirë, more bir. Vetëm s'do t'ia kisha dalë dot mbanë, po më kanë ndihmuar Lytoja, Malka, Rasimeja, njerëzit. Më ke ndihmuar ti, me ato që më dërgoje.

— Eh! Unë! — C'të dërgoja unë?

Ajo filloi ta pyesë si kishte kaluar në ushtri, si kish-te punuar, a qe mërzitur, duke ia mbajtur duart në pëllimbët e vogla e të ngrohta. Skënderi i përgjigjej shkurt dhe ishte shkrirë i téri nga kjo dashuri e nënës që buronte si lumë. Fjalët i kishte të pakta. E pyeti si shkonin punët në fshat, c'bënin fqinjët, a ishin gjallë pleqtë e moçëm dhe pastaj ra në mendime.

E éma e vuri re këtë, po nuk i ra në sy menjëherë. U mbështet pas trupit të tij, i lëmoi kokën dhe ia puthi dekoratat,

— Sa më paske ndryshuar, o xhan i nënës! Edhe fjalët të qenkan rralluar! Ç'them edhe unë! Ti do të më jesh lodhur e do të më keshuri! Si nuk i dërgove nënës një kartë me dy fjalë: «vij sonte!» Të isha bërë hazër e të mos ma gjeje shtëpinë rrëmujë...

Ajo u bë me krahë kur i biri i tha se do të qëndronte përgjithnjë në fshat. E puthi në ballë, u ngrit si ndonjë nuse e re dhe rrëmbeu nga polica jastagaçin e okllainë:

— Tani ta shtron nëna! Ke kohë që s'ke ngrënë në shtëpi. Të bën nëna pulë me petë.

Lidhi peshtemallin dhe bëri të dalë në ashef, po Skënderi u kujtua përdicë dhe e ndali;

— Prit një çikë, nënë!

Nxori nga çanta ushtarake një kuti mbështjellë me gazetë dhe ia dha duke qeshur:

— Kjo është për ty.

Nëna me kujdes hoqi letrën dhe hapi kutinë. Në duart e saj ranë një shami e zezë dhe një fustan i errët me calule të vogla të verdha.

— Uh, more bir!, — tha ajo e habitur duke mos u zënë besë syve — Ç'gjëra të bukurë më paske sjellë. Aq të bukura, aq të bukura, sa s'më shkojnë hiç, mua plakës.

— Tamam për ty, sikur ta kishe porositur.

Nëna u gjëzua shumë dhe e puthi përsëri në ballë. Duke i vendosur dhuratat në sëndyq, sytë i dogjën nga lotët.

— Ky është peshqeshi i parë në jetën time, — tha e mallëngjyer. — Do të kem tani me se të dal në dasmën tën-de! Hair paç, o bir!

Fshiu lotët tinëz dhe nxitoi në ashef. Pas pak Skënderi dëgjoi pulat në kotec që kakarisën të trembura dhe buzëqeshi i lumtur.

— Ja këputi kokën nënokja! Po shkoj t'i ndihmoj!

Mirëpo ajo nuk e la të prekte asgjë me dorë. E shkathët, si gratë devollite, ndezi zjarrin me karthje të thata, zuri brumin, vuri saçin dhe i têrholli petët me një shpejtësi të çuditshme. Skënderi e vështronë me èndje dhe i habitur se ku e gjente ajo têrë atë energji e têrë atë mjeshtëri

për të kryer disa punë në të njéjtën kohë, pa humbur kot asnjë sekondë.

— Si je me béréqet?, — e pyeti ai papritur, duke kujtuar ankimet e fshatarëve me të cilët kishte udhëtaruar.

— Unë një gojë kam qenë, o bir! Një gojë ushqehet edhe me hithra e lëmpjeta. Por, siç e sheh, kam edhe miell të grunjtë pér ndonjë petë a pér ndonjë kulaçe. Misri na arrin gjer në korrjet. Do të bëjmë si do të bëjmë! Fshat jemi. Fshati, pa hiç s'mbetet kurrë...

Ai pshëretiu, se iu kujtuan përsëri bashkudhëtarët hallehinxj, po nëna nuk e vuri re shqetësimin dhe mërzinë, që ai nuk i shfaqte, pér të mos ia prishur gëzimin asaj.

2.

Nuriu, me të hyrë në oborr, u hoqi samarin kuajve dhe i thirri së bijës, që rrëmbeu hejbet:

— Kujdes, mos të tē thyhet. Është një sahat aty...!

— Përsëri sahat?, — u habit ajo.

— Mbyll gojën!, — i shfryu ai dhe e bija hyri në shtëpi pa bërë gëk. Si i futi kuajt në ahur e u hodhi bar në grazhd, doli përsëri në oborr dhe drodhi një cigare. E shoqja rrinte si mbi gjemba te pragu i çardhakut, duke pritur urdhrat e tij. Ai i hodhi një vështrim të shpejtë e të ashpër dhe u drejtua nga gardhi që rrëthonte kopshtin. Atë çast u dëgjua në rrugë një hingëllimë kali. Ai ngriti kokën dhe prapa kafshës së ngarkuar me bar pa Jaçe Marrën me kosën të hedhur në sup.

— Dëgjo këtu!, — i tha Nuriu pa e përhëndetur, si u bind që në rrugë s'kishte njerëz të tjerë. — Tani sa u kthyje Skënderi i Zalos! Shko e takoje menjëherë! Fol me të si mik i vjetër. Me sa m'u duk mua, ai s'merr vesh nga kjo dynja...

— Mirë! Mirë!, — mërmëriti Jaçja pa kthyer kokën nga gardhi duke hedhur kosën e rëndë në supin tjeter...

Kur filloi të errësohej Jaçja thirri te dera e shtëpisë së Skënderit me zë të ciltër e të lartë:

— A prisni mysafirë, more?!

Nëna nxori nga çerepi kulaçin e nxeh të dhe vrapoi te dera.

— Urdhëroni! Urdhëroni!

Pastaj u kthyte nga i biri dhe i tha e gjëzuar:

— Jaçja éshëtë ky. E njoh nga zëri, ti porsa pyete përtë. Mirë thonë, kujto qenin, bëj hazër stapin!

Me fytyrë të ndritur Jaçja Marra hyri në dhomë dhe iu derdh Skënderit në qafë, tërë mall:

— Mirë se na erdhe, o luftëtar! Ka kaq vjet që s'jemi parë. Na i bëre sytë ujë! Po si je? Po si vete? A të kujtohet kur na i zinte zekthi bagëtitë në kënetë, kur vinim në mal për shkarpa e binim pas luleshtrydheve? Po kumbulla e xha Hyskës, që ia këputnim pa u pjekur?

— Të gjitha më kujtohen, të gjitha. Eh! Si ikën koha, — e ndërpren Skënderi i prekur nga kujtimet e fëmijërisë.

— Ikën e s'kthehet më!, — shtoi Jaçja dhe u ulën të dy në këndet e vatrës. Vështronin njëri-tjetrin duke buzëqeshur, kujtuan kohën e shtypjes e të mjerimit, që u kishte lënë gjurmë të thella, folën për vitet e luftës, kur lindën shpresat për liri e për një jetë më të mirë, dhe kujtuan me mall të afërmit dhe ata pleqtë e urtë të fshatit që nuk ishin më gjallë, veç gjyshit Dule e hallës Mude.

Bisedën ua ndërpren nëna, e cila shtroi sofrën, vuri mbi të pulën me petë, kulaçin e ngrohtë e shishen e rakisë dhe i ftoi për të ngrënë.

— Qen kam me kësмет!, — tha Jaçja duke ndier erën e mirë të gjellëve. — Ka kohë që s'kam ngrënë gjë nga dora e Zalovicës, që éshëtë me nam në gjithë Devollin pér gjellë. — Mori shishen e rakisë dhe e vështroi në dritën e llambës me vajguri.

— Kjo e shkretë e ndez muhabetin!

Filluan të hanë të uritur, ulur të tre rreth sofrës. Jaçja mbillaçitej me të shpejtë dhe herë pas here hidhte me plot gotat e rakisë. Nga afshi i alkoolit fytyra iu skuq si lafshë gjeli dhe gjuha iu zgjidh. Nëna hante ngadalë, dëgjonte bisedën e tyre po gjuhën e kishte si të lidhur. Edhe Skënderi më shumë dëgjonte se sa fliste. Vetëm Jaçja llomotiste vazhdimisht. Foli për urdhëresat e fundit ekonomike,

për mbjelljet, për sistemet e reja të grumbullimit të bëregetit e të mishit, për të gjitha punët pa mbarim të fshatit. Jaçja, pakëz i dehur, s'la njeri e urdhëresë pa marrë në-për gojë. Sipas tij fshati ishte bërë rrëmujë, shumica s'kishte bukë, një pjesë e mirë s'kishte as elb e as krunde për të ngrënë, punët e këshillit kishin mbetur ploffë, me një fjalë bujqësia kishte marrë të tatëpjetën dhe po prishej.

— Sigurisht, për të gjitha këto ka faj Lytoja si sekretar i Partisë, — tha Jaçja gjysmë i dehur, pa përmbytj zemërimin. — Kurse Malka, Malkë! Një para s'i bën lëkura. Unë se marr vesh atë njeri. Një herë u përfolëm dhe më qiti koburen. Më qiti koburen, mua, partizanit! Po mirë thonë, peshku qelbet nga koka, prandaj janë qullosoj edhe punët tona.

Nëna vuri re se i biri nuk po hante me qjef. Iu duk i dëshpëruar, si një njeri që merr papritur lajme të hidhura e të këqija. U menda ta nxjerrë nga ajo gjendje duke u treguar e kujdeshme. Ngri ti një dolli për shëndetin e tij dhe ia afroi kofshën e pulës te gjunjët, po dukej qartë që ai ishte i pakënaqur dhe i dëshpëruar.

Më në fund Skënderi e ndërpren mikun duke u munduar ta mposhtë pakënaqësinë:

— Po mirë, more Jaçe, unë një gjë s'e kam të qartë. Kur ti e di që punët qenkan kështu, përsë nuk merr ndonjë masë? Ti je sekretar i këshillit, ti je kandidat partie dhe duhet të bësh si na mëson Partia...

Jaçja s'e la të flasë më gjatë:

— Po pse? Kollaj është të merresh vesh me ta? Pastaj ti je ushtar. Ja, më thuaj, o byrazer, a mund të jetë ushtari i vetëmuar një luftëtar i vërtetë? Veç kësaj, ka gjëra që s'honepsen fare... Gjithnjë na kërkojnë: bereqet, mish, vezë, lesh... po a nxirret dhjamë nga pleshti?... Kështu janë këto punë. Prandaj ai fshatari thotë me të drejtë: ç'më duhet të më bjerë bretku në arë, që të vijë tjetri e të marrëmbejë?!

Pas këtyre fjalëve, nëna e kuptoï përsë iu thyte zemra të birit. E pa me neveri Jaçen tek fshinte buzët e trasha me pëllëmbë dhe e qortoi, e përmbytj:

— Ti, Kuqo, mos i mbaj nëpër gojë djemtë e fshatit! Lytoja e Malka janë xhevahirë. Apo t'i mori mendtë kjo e flamosur? — dhe e hoqi shishen e rakisë.

— Rri, moj Zalovicë, se ti s'merr vesh nga këto punë! Shiko shtëpinë til!, — i tha pa të keq Jaçja.

Nëna kaloi në ashef me shishen e rakisë në dorë. Po Jaçja fliste me zë aq të lartë, sa ajo, me një farë ankthi në shpirt, zgjaste kokën te dera dhe vinte veshin për të dëgjuar më mirë. Që andej ia ngulte vështrimin të birit. I vinte keq që ai ishte aq i mërzitur e i menduar. Dukej sikur e pyeste dhe e këshillonte në të njëjtën kohë me ata sytë e zgjuar e tërë vëmendje:

«Përse më dëshpërohesh, o bir?! Ai derr i ka fajet, që ta prishi gjakun! Po Jaçja, Jaçe eshtë! Ç'e dëgjon?... Ti tani erdhe të gëzosh nënën! Unë isha si qyqe vetëm, kurse tani....» Asaj iu ngatërruan mendimet. Kishte hequr shumë në jetë, mezi e mbante veten dhe sytë i përloteshin shpesh.

Skënderi e dëgjoi mikun me durim e me zemër të vrarë gjer në fund. Pastaj, papritur, u ngrit i pari nga sofra, ngriti fitilin e llambës që ko kolitëte dhe tha i zemëruar:

— Mjaft tani, o Jaçe! Majft! I mora vesh edhe punët tuaja! Turp të kini të gjithë! Turp! Edhe ti! Unë vij nga rregulli, nga disiplina, dhe, o do të vë edhe këtu rregull e disiplinë, ose... mos më thënçin komunist!.... Në qoftë se do të duhet, vetë Komandantit do t'i shkruaj. Do t'i shkruaj e do t'ia numëroj të gjitha ato që bëjnë vaki këtu... të gjitha...

Kur u ndanë, qentë i kishin lëshuar dhe ata lehnin si të tërbuar pas hënës, që porsa kishte dalë nga maja e malit. Nëna e përcollti Jaçen gjer te dera e jashtme dhe e qortoi:

— Përse m'ia prishe qejfin djalit?! Ta kishe lënë një herë të çlodhej mirë e mirë. Ah! Jaçe! Jaçe!

Ai iu përgjigj çakërrqejf:

— Qenka si baruti yt bir, Zalovicë! Një thëngjill t'i vësh, marrka zjarr! Dëgjoi për hallet tonë dhe iu prish qejfi. Në ushtri e kishte mirë ai: tri vafte bukë e gjellë në

ditë, shtratin shtrat, ushtrimet ushtrime, rregull, shkollë, disiplinë... edhe rrrogë. Po këtu i thonë fshat!... Apo e kam gabim? Po nejse! Këtu do ta kemi tani. Përse bëhesh merak ti Zalovicë? Ia ndreqim qejfin!... Ia ndreqim!... E rregullojmë atë punë...

Ai vazhdoi të flasë, kurse nëna s'e dëgjoi më. I vuri llozin derës dhe me një lëmsh në shpirt, por edhe e gëzuar, u kthyte te i biri, që rrinte më këmbë, i menduar e i zymtë, pranë llambës me vajguri.

3.

Kur u zgjua, gjelat ende këndonin nëpër kotecë e mbi pemë. Pa zhurmë, për të mos zgjuar t'ëmën, që flinte pranë tij, u vesh e doli në kopsht. Gjëja e parë që bëri, hapi derën e kotecit. Një tufë pulash laramane dolën duke kakarisur. Një gjel u shpushpurish mirë e mirë, vrapi pas një jariçke buzë gardhit dhe ia thirri këngës, me një zë të zgjatur e të trashë. Ai buzëqeshi dhe nguli belin në tokën paksa të ngjeshur nga ngrica. E kishte marrë, malli për belin e pér tokën.

Që nga shtëpia e tij, prapa së cilës, mbi dheun e kuq të përroit, ngrihej si thikë Guri i Bardhë e i lartë, ai pa fushën tek shtrihej pa anë e fund gjer atje tej ku syri mezi kapte horizontin. Fusha ishte e mbuluar e tëra me ujërat e kënetës, me gjelbërimin e grurit, me ngjyrën kafe e të zezë të ugareve, që prisnin plugun, dhe me ato degët e zhveshura e të përcëlluara paksa nga ngricat e dimrit. Qielli ishte i sheshtë e i zymtë, si një kapak i madh bojë hiri. Në hapësirën e gjerë të fushës dalloheshin, si vijëzat në hartë, lumenjtë, përrenjtë, rrugët kryesore, udhishtet me tragat e qerreve dhe ato monopatet e këmbësorëve, të kuajve e të mushkave, që fillonin aty pranë shtëpisë e pastaj humbnin nga sytë midis bimësisë pafund.

Në fillim, atë qetësi paksa të trishtuar, që e prishte herë pas here kënga e gjelave, filloi ta trazojë beli, që mezi hynte në tokën e ngjeshur. Trishtimin e shtuan tufat

e korbave që mbushën qiellin dhe hapësirën me klithma e me krahët e tyre të zinj. Turreshin korbat nga vende të padukshme, klithnin mbi kënetë dhe zbrisnin diku, tufat-tufa, si mbi ndonjë kërmë. Pastaj hapësirën e mbushën cicërimat e gjuzuara të harabelëve e të cërreve, që fluturonin pothuaj rrafsh mbi tokë dhe që, papritur, binin si pupla, mbi degët e pemëve, mbi çatitë e mbi mullarët me bar. Tufat e currkave të shpejta e të rosve të egra, binin si popla thellë në ujërat e kënetës, midis presjeve e shavarëve. Dhe përsëri binte një qetësi e thellë, që trubullohej nga beli i mprehtë i cili, duke çarë tokën, ndeshte në guralecë.

Kur era filloj të lëkundë degët e çacaçnikut e t'u futë drithma barit e presjeve të thata të kënetës, ai ishte nxehur dhe në ballë i kishin dalë bulëza djerse. Kurse flokët e supet i kishte të mbuluar me brymë gati të shkrirë, si vesë. Atëherë eëma doli në kopsht duke mallkuar veten, që e kishte zënë gjumi, por edhe e habitur nga puna e të birit. Ai, pothuajse e kishte punuar gjysmën e kopshtit.

— Uf! More bir! Të lumshin krahët!, — tha në kulm të gjëzimit, e lehtë si era dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, erdhi para tij me një gotë qumësht të ngrohtë. Skënderi e piu i kënaqur.

— Më ka marrë malli për punën, néné!

— Puna na ka bërë njerëz, o bir!, — i tha ajo duke parë me èndje të madhe se si ai e rufsite qumështin e nxeh të.

— Kush ta ka punuar gjithë këtë bahçe?, — e pyeti.

— Vetë... dhe Rasimeja.

— Cila Rasime?

— E bija e Qamilit.

— Çupë e mirë qenka!

— E mirë sa s'ke ku gjen tjeter!

Kishte lindur dielli dhe, megjithëse përtej reve e kish te shpërndarë krejt mugëtirën. Kërcisinin mendeshat e ndryshkura të portave. Qentë ishin lidhur e nuk lehnin më. Rrallë dëgjohej kënga e ndonjë gjeli të vonuar. Fshatarët lëshuan për kullotë lopët, dhitë e dhentë dhe barinjtë i vunë përpara me britma të gjuzuara. Dikush, me gomar

përpara, mori përpjetë Shkozën, pér dru. Pesë vetë, hipur mbi kuaj, ranë poshtë në kënetë. Si duket shkonin pér pazar, në qytet. Një qerre gërviu tatëpjetë fushës, në tragë e pérhershme. Ca djem e vajza, krejt të rinj, u mblo-dhën një e nga një aty ku ndërtohej shkolla dhe pastaj, të gjithë së bashku, me kazma, lopata, sëpata e qysqi në supe, u nisën përpjetë malit, si një trumë zogjsh laramanë, pér të hapur toka të reja.

Skënderi i pa të gjitha këto dhe ndjeu çlodhje, me gjithëse djersët ende nuk i ishin tharë në ballë...

Gjithë ditën u mor me kopshtin, punoi si një ka i pa-përtuar, megjithëse eëma e këshillonte herë pas here që të mos vritej. Kur po vinte mbrëmja, si çdo mbrëmje fshati, plot zhurma të këndshme, ai la punën dhe u bë gati pér të dalë. Sipas tij dielli duhej t'u qe afruar brigjeve të Purgut, megjithëse qielli qe me re e rrezet e tij nuk dukeshin. Era nuk frynte më nga gryka e Shkozës dhe degët e përcëlluara gati në të celur të sytheve nuk lëkundeshin më. Bagëtia kishin zbritur nga mali dhe ishin kthyer nga kullotat e fushës. Dëgjoheshin blegërimat e shqerrave i që ndillnin qingjat e porsapjellë, hingëllimat e kujave, i që ishin freskuar me ujin e kristaltë të pillatit, tringëllimi i këmborëve e i zileve të dhive dhe zërat e gëzuara të grave e të fëmijëve, që u delnin përpara bagëtive, i ndillnin me të butë e i fusnin oborreve. Puna e ditës kishte marrë fund.

— Mos u vono!, — e këshilloi nëna më merak të madh kur ai kapërceu vijën e ujit para shtëpisë dhe pikërisht aty u takua përsëri me Jaçe Marrën. — Mos u vono, se mund të vijnë mysafirë pér të të parë!, — nguli këmbë ajo duke theksuar fjalën «mysafirë». S'e kishte hallin te miqtë. Kiske merak që u takua përsëri me Jaçen. Kishte merakun e mbrëmjes së kaluar, që iu venit si një kandil i shkretuar me vaj, pér faj të atij fytyrëkuqit llafazan e pijanec.

— Do të kthehem shpejt, — i tha ai me të mirë. — Shumë shpejt! Nëna priti te pragu i derës, gjersa ata i humbën nga sytë. Psherëtiu thellë, mori kusinë e filloii të mjelë dhitë, me mendjen vetëm tek i biri. I qe bërë zemra mal

që ai kishte punuar tërë ditën e ditës në kopsht dhe kishte genë i çelur, i dashur, i gjëzuar! Po kur i kujtohej mbrëmja e kaluar, dëshpërimi i tij i madh, pakënaqësia, zemra i mblidhej shuk... i rrud is avtura Këndyri

Ata ecën me hap të ngadalshëm në rrugën kryesore. Fliste vetëm Jaçja. Skënderi kishte kohë që s'e kishte shkelur atë rrugë dhe ndiente një kënaqësi të thellë, pa ua vënë veshin shumë fjalëve të Jaçes. Më të dyja anët ishin mbjellë pemë frutore. Ato, për tre-katër vjet ishin rritur dhe në degëzat e zhveshura e plot lëng ndihej pranvera, që po vinte me të shpejtë, ndiheshin sythet, që tek-tuk kishin plasur, mbasë asaj nate, atij mëngjesi ose asaj dite.

— Ja edhe dyqani ynë i kooperativës së shit-blerjes, — i tha Jaçja kur dolën mbanë një lëmi të vjetër. I futi krahun dhe e tërhoqi drejt tij.

Para dyqanit njëkatësh, ngjitur me të cilin ishin edhe zyrat e këshillit të fshatit, ndarë vetëm nga një çatma e hollë më kallama e baltë, ishte një grumbull fshatarësh. Ata kishin nëpër duar shporta e torba me vezë, me pula e me gjizë dhe ishin aq të zënë me to, sa nuk i panë fare të porsaardhurit. Shitësi, dhe blerësi njëkohësisht, i dyqanit, një lloz i gjatë, po u shpjegonte çmimet shtetërore të blerjes e të shitjes. U thosh se, sipas urdhëresave, një pjesë të vlerës do t'ua kthente në mall e tjetrën në para, përsëri sipas çmimeve të shtetit. Po këtë nuk e kuptonin të gjithë. Ata që e dinin dorëzuan ç'kishin, morën ç'u duhej, kripë, vajguri, penjë, sheqer dhe ikën. Ca të tjerë s'bindeshin, pyesnin me dhjetëra herë, u dukej se po u hahej haku e po gënjejeshin. Prandaj, sa vinte, zhurma bëhej më e madhe.

Një fshatar plak, bollkëgjerë e me një gjysmë gune hedhur krahëve, ishte ulur këmbëkryq mbi tokën e qullur dhe, tërë vëmendje e i përqëndruar, numëronte vezët duke i nxjerrë një e nga një prej shportës.

Jaçja iu afrua dhe e pyeti pa të keq: — Hé, more Demkë? A të del hesapi?... Kooperativës do t'ia shesësh?

Fshatarit i mbeti veza nē dorë. E pa Jaçen vrenjtur dhe nuk iu përgjigj, se kishte frikë mos harronte sa vezë kishte numëruar.

Ndërhyri Kasëm Sharra, ai burri i shkurtër, që s'e hiqte qeleshen e zezë me yll nga koka:

— Në qytet t'i marrin hallexhijntë edhe me njëzet lekë kokrrën, — tha pa të keq.

Fshatari Demkë, harroi fare sa vezë kishte numëruar.
— Si the? — pyeti me vezën nē grushtin që e mbante mbi krye.

— Njëzet lekë kokrra...

— Jo, more!, — ia priti Demka i habitur, me të dy sytë të çakarritur.

— Aq i shita unë. Domethënë aty afér. Një okë pa pak, një okë e pak. Më vdekshin fëmija!

Demka tundi supet dhe guna i ra nga krahët. Vuri vezën nē shportë me shumë kujdes dhe u ngrit menjëherë si ndonjë i ri. Shtyu me bërryle njerëzit majtas e djathtas dhe hyri nē dyqan. Gjer jashtë u dëgjua zëri i tij:

— S't'i jap! Vete e i shes gjetkë! Me njëzet!

Fshatarët ia plasën gazit kur ai doli me fytyrë të nxirë nga inati. I pa vëngër dhe i thirri shitësit:

— Ja ku i ke budallenjtë që i shesin për pesë kacidhe!

— S'janë kacidhe, po lekë të popullit, — ia preu dikush, po Skënderi nuk arriti ta kuptojë se kush ishte.

— Kacidhe... kacidhe! — thërriste plaku duke u larguar e duke mbajtur me shumë kujdes shportën me vezë. Ekte me hap të shpejtë. Guna e rrjepur i tundej. Me të dalë nē rrugë i ranë gjakrat. Nga pas e ndoqën ca fshatarë që ndërruan mendjen aty për aty, si ai. Të tjerët hynë nē dyqan.

Jacja, duke buzëqeshur, e pyeti:

— E sheh ç'bëhet?

Skënderi u përgjigj hidhur:

— E shoh!

— Ç'u thua këtyre urdhëresave që na vijnë njëra pas tjetrës si dallandyshet nē pranverë?, — e pyeti ai përsëri

dhe, si u drejtua nga fshatarët që u larguan, filloi t'u thotë sllogane të thata pas krahëve:

— Ç'bëni, more djaj?.. Ku vini?.. Jepini, more, sipas ligjeve!.. Pse i shkelni ligjet?.. Ah! More shokë! Po ligji është ligj, more! Përse nuk shtrohemë si pleqtë qëmoti e ta kuvendojmë, po merrni bishtin nën shalë si qentë e sall-haneve?..

U kthye nga Skënderi me një fytyrë të pezmatuar:

— Jo. Urdhéresat duhen rishikuar. Unë kështu them. Na kanë goditur rëndë trockistët e jashtëm e të brend-shëm. Edhe unë desh e hëngra prej tyre, edhe shumë të tjerë desh e hëngrën. Edhe Nuri ziu e hëngri më keq nga të gjithë. Kurse kulakët bënë pallë.

Ai s'kishte të pushuar. Po Skënderi nuk e kuptonte ende se ato fjalë të mëdha ishin si farashka që më shumë e halladitnin armikun e fshehur të klasës, kulakun, se sa e pickonin.

— Mirë, mirë..., — e ndërpree më në fund Skënderi i pakënaqur. — E mora vesh! S'jam tutkun, — dhe ndjeu një hidhërim në shpirt e në gojë. Gjithë ai ngazëllim, i dëlirët që iu ngjall nga puna e mëngjesit iu zhduk menjëherë.

Ata ecën më tej, të dy të zymtë, të zënë secili me mendimet e veta. Jaçja diçka i llomotiti përséri, po ai as që e dëgjoi. Kaluan edhe pérpara shtëpisë së Nuri Zyberit. Edhe aty Jaçja diçka i tha, po ai e kishte mendjen te tra-zirat e pakuptueshme të fshatit.

— C'janë këto që dëgjoj e që shoh?!, — mendonte Skënderi me vështrimin te maja e çizmeve të tij dhe me një boshllék të madh në zemër. — Vij nga ushtria me dëshirë të madhe për të punuar dhe më priten gjunjë e duar. Më priten fjalët. Më pritet oreksi..., — dhe mendja i shkonte te reparti ushtarak, te shokët e tij trima, të mirë e gu-ximtarë.

Jaçja i përralliste. Skënderi mendonte të tjera gjëra, të tjera vende, të tjerë njerëz dhe nuk shihte fare se ku i hidhët çizmet që ia kishte pastruar e éma me aq kujdes.

Ai nuk i vuri re dy djemtë që vinin përkundrejt, njëri

i gjatë, me fytirë të mprehtë e tërë eshtra, po i pashëm e me sy bojë qelli dhe tjetri me një qafë të hollë si lejlek, i shkurtër e i dobët sa s'ka ku të vejë më e me një kasketë të vjetër. Jaçja i ra në bërryl.

— Ja edhe shokët tanë, po kthehen nga fusha, — dhe hyri në dyqan.

Skënderi u përmend dhe shpejtoi hapin drejt tyre. Edhe kur u afruan, Lytoja s'e njoihu ushtarakun, kurse Malka tha i gjëzuar:

— Skënderi!

Kishte në atë takim edhe mall, edhe miqësi, edhe dashuri, edhe diçka më shumë se të gjitha këto së bashku. Tani ishin bërë katër komunistë dhe, siç tha Lytoja me të drejtë, katër komunistë morën një kala.

Ka ditë që na kanë lajmëruar nga qarkorë i Partisë se do të vije, — i tha Lytoja pa ia hequr duart nga supet.

— Dhe, më në fund erdhe. Sa mirë bëre! Sa mirë ke bëre, o Skënder! Kemi nevojë për kuadro, si për ujin e burimit në piskun e verës...

Ecën të tre në një radhë, me Skënderin në mes, duke zënë gjithë rrugën. Flisnin me zë të lartë, gëzoheshin, bënin shaka, qeshnin. Skënderi ndjeu një ngrohtësi të çuditshme nga ai takim. Iu duk sikur ishte midis atyre ushtarëve të Drejtorisë së Mbrojtjes së Popullit së bashku me të cilët flinte në një barrakë dhe ndiqte këmba-këmbës e asgjësonte diversantë, kriminelë e keqberës të tjerë. Ishin të tre në një rresht. Skënderi rrëmbente pak mbi të gjithë. Pas tij, nga lartësia vinte Lytoja, pakëzë ndërrimtar po dhe i sertë më të rrallë, dhe më i shkurtri, Malka, me ato këmbët futur në opinga llastiku e me ata kërcinj mbuluar me bollka prej shajaku, me kopsa të ndryshkura anash. Më i shkurtri, po më i ashpri e më i drejti qe ai, Malkë kryetari.

Ecnin të tre dhe kush i shikonte qëndronte një copë herë. Të varfrit ishin gati t'u hiqnin takijen. Të mesmit i përshëndesnin me dashuri. Ndonjë kulak u bënte temena që atje tej, me respekt të shtirur. Megjithëse ishte kohë e

mundimshme e me vështirësi të mëdha, njerëzit flisnin me admirim:

— Po kalojnë ata, djemtë tanë... Komunistët!

Ishte fillimi i 1949. Porsa ishte zbuluar e varrosur komploti i madh e i rrezikshëm armiqësor i trockistëve të jashtëm e të brendshëm që, për pak, desh e kthyen Shqipërinë edhe një herë në mesjetën e shurdhuar. Po mjaft armiq të deklasuar, cifligarë, tregtarë të mëdhenj, matrapazë, zyrtarë të lartë, zemërgur e gjakpirës ishin ende gjallë.

Të gjithë ata ishin në një ofensivë të tërbuar, sepse parashikonin ditë të zeza. Ata përpinqeshin të hynin kudo, si ca vjet më parë kulakët e agallarët, që depërtuan me marifet në komisionet e Reformës Agrare, në komitetet e fshatarëve të varfër, në ekipet e teknikëve e të specia-listëve. Të gjithë ata, megjithëse ishin përmbysur nga froni, fshihnin ende pasuri të tundshme, qypa me florinj, thasë me kartëmonedha, drithë. Të gjithë ata, pasi u varros komploti trostalist, dolën si të persekuuar, akuzuan djemtë e ndershëm të Partisë si plangprishës e antiatdhetarë dhe, në një front të bashkuar, me fije të dukshme e me fije krejt të fshehta, arritën të futin në rrjetën e tyre një pjesë të fshatarësissë së mesme, bile edhe disa fshatarë të varfër.

I tillë ishte ai fillim i vitit 1949...

Një kope delesh ua preu rrugën dhe për një çast u gjendën të rrethuar. Malka hoqi kapelën nga koka dhe i trembi dhentë. Vështrimi i Skënderit u mbërthye në flokët e pakrehur të Malkës. Ai e dinte që Malka kishte marrë një plumb në pjesën e sipërme të kafkës, në luftë e sipër. Ia dalloi tepen e kokës, si të përkuqur, pa flokë, dhe i erdhë mirë që shoku i tij i fëmijërisë, ishte ende i shkathët e pa cen. Si u larguan dhentë, u dëgjua një këngë e gëzuar e rinore, që këndohej anembanë vendit:

O shokë, ejani të shkojmë,
Në punë më parë se n'agim,
Dhe fushat me lule t'i shtrojmë,
Dhe jetës t'i japim gëzim.
O shoqe eja edhe ti...

— Janë tē rintjtë që hapin tokat e reja, — tha buzagaz Lytoja duke kthyer kokën nga Dheri i Kuq.

— Ata kalastelat janë, — tha Malka i gëzuar duke ngjeshur kasketën gjer te veshët.

Që nga mali po zbriste, me këngë në gojë, një kolonë e gjatë me djem e vajza. Të gjithë ishin të ngarkuar me veglat e punës e me kërrçepë. Karvani, në tē hyrë tē fshatit, u nda më dysh, më një anë vajzat e në tjetrën djemtë, si dy përrënjet që grahin me rrëmbim pranë e pranë, po që nuk i lënë brigjet e thepisur të bashkohen. Bërtisnin me sa fuqi kishin, pëershëndesnin njëri-tjetrin, këndonin, duke krijuar një si rrëmujë, midis së cilës spikaste tingëllimi i veglave që përplaseshin njëra me tjetrën. Pleqtë e plakat, nënët e baballarët kishin dalë te pragjet e shtëpive dhe prisnin me ankth mbusat, nipat e fëmijët t'u vinin nga tokat e reja. Hallo Mudja, ajo plaka e thyer më dysh, shurdhe e memece, që lante e kullandriste prej vitesh të vdekurat dhe bënte lloj-lloj magjirash, hidhte vështrime tē shuara rrëth e rrötull dhe mallékonte në heshtje kohën, qiellin e tokën...

— C'ke? Përse dukesh i dëshpëruar?, — e pyeti Lytoja ushtaraku, i cili s'i kishte hequr ende dekoratat nga gjoksi.

— Asgjë, — gënjeu Skënderi.

— Ti dukesh si i vrarë, — ia ktheu Malka me tē qeshur. — Të rrjedh një si vrer nga goja.

Skënderi padashur fshiu buzët me pëllëmbë e tha i habitur:

— Unë s'kam gjë!

— Ke! Ke! Ushtarak je, po më dukesh si i çarmatosur, — nguli këmbë kryetari i këshillit.

Skënderi më në fund ua tha hapur po me atë gjuhën e paravolisë fshatare:

— Dreqi t'u marrë! Po më copëtohet zemra! Erdha nga ushtria me mendimin se e keni zgjidhur nyjen, po ajo dreq qenka shtrënguar më keq...

— Na fal, o mik, po këtë gjuhë nuk ta kuptojmë, — e ndërpreu Malka duke qeshur.

— E po mirë! E doni shqip?, — pyeti me një farë ner-vozizmi Skënderi dhe vazhdoi po me atë zë, i rrëmbyer si përrua. — C'është kjo rrëmujë në fshatin tonë? Përse s'kemi bukë? Përse ndezim tregun e zi? Përse shesim qetë për të shlyer detyrimin e mishit? Përse e shesim kokrrën e vezës njëzet lekë? Përse e shesim kilen e preshit dyzet lekë? Përse...

Ai do të pyeste kushedi sa herë përse... po Malka ia preu shkurt, duke ia larguar dorën nga llëra:

— Sepse kemi armiq klase, — i tha, — kemi kulakë.

— E pastaj?, — pyeti Skënderi me një farë mendje-madhësie, duke nxjerrë gjoksin pakëz përparrë për t'i du-kur më mirë dekoratat.

Malka i hodhi një vështrim të rreptë. Sytë e tij si-kur vetëtinë. Atë vështrim u hidhte ai kulakëve, matrapa-zëve dhe armiqve të deklasuar. Po ndërhyri Lytoja e tha disi i menduar:

— E di si është puna, o Skënder i dashur,jeta jonë, në krahasim me të kaluarën, ka ndryshuar krejt. S'ka asnje barazim. Është si dita me natën...

Skënderi e ndërpreu:

— Mos ma thuaj mua këtë. Unë këtë e di, si një e një që bëjnë dy.

Lytoja vazhdoi me një zë të shtruar fare:

— Nuk them që s'e di. E di ti këtë. Po më duket se e di vetëm si një formulë.

Skënderi u prek në sedër e i tha:

— Lyto! Unë jam komunist! Dhe po të flas me zemër në dorë. Fshati është shkatërruar krejt. Fshati është bërë një rrëmujë që s'e merr vesh qeni të zonë. Unë pyes: Për-se? Ti ma dredh me politikë!

Jacja, që kishte dalë nga dyqani me një tufë lettrash cigareje, ndërhyri për t'i qetësuar dhe tha buzgas:

— Lërini këto tani. Kështu e ka kjo jallane. S'ke ç'i bën! Kemi kohë për të biseduar.

Ishte i bindur se fjala e tij do t'i qetësonte ata të tre,

po u gabua. Të tre morën zjarr si karthjet e thata. Skënderi e mbante kokën të lëshuar dhe vështronte i mendoruar qizmet. Malka turfullonte në vetvete. Jaçja dukej i qetë, po përbrenda kishte një inat të keq. Vetëm Lytoja dukej i qetë e i shtruar. Ekte pa ia hequr dorën nga krahu Skënderit e thoshte:

— Ne, o Skënder i dashur, fituam lirinë; një, morëm tokë: dy, marrim kredi: tre, marrim makineri bujqësore: katër, përdorim pleh kimik: pesë, hapim me ligj toka të reja: gjashtë, mbjellim fidane frutash e bimësh industriale: shtatë, marrim farë të zgjedhur me qëmim hiç me hiç: tetë... marrim... e çfarë s'marrit, kurse ti...!, — tha ai dhe heshti, sepse nuk donte ta rëndonte më tej shokun.

Mirëpo Skënderi kishte krijuar tanimë mendimin e vet.

— Fjalë!, — mërmëriti. Pastaj e ngriti zërin. — Ju keni vetëm fjalë! Si nuk shihni se këtu mungojnë të tëra?!

Malkës i mbeti fjala në gojë, se Lytoja, meqë ishin shumë pranë vendit ku ndërtohej shkolla, nuk e la të flasë.

— Përse të dëshpërohem kështu pa ardhur mirë? — pyeti me hidhërim Lytoja dhe drejtoi të dyja duart nga ndërtesa e re. — Pa shikoni rininë!..

Jaçja fërkonte duart e thoshte gjithnjë buzagas:

— Mirë e ka Lytoja! Mirë e ka Lytoja!

Në sheshin e madh të shkollës, që po ndërtohej me ndihmën e shtetit dhe me punën e fshatarëve, ishin grumbulluar shumë të rinj, të reja, fëmijë, gra, burra dhe ca pleq. Kapërcyen një gardh për të shkurtuar udhë dhe dolën te muret e shkollës, që ishin ngritur gati një bojë njëriu. Muratorët dhe punëtorët e gurit, që kishin emër të mirë në ato anë, porsa e kishin lënë punën dhe po pinin duhan kush ulur e kush më këmbë. Ca të tjerë ende transporthonin me tezga e carroca gurë, zhavor, gëlqere, qereste e tjegulla, që porsa i kishin nxjerrë nga furra primitive. Pleqtë vërenin me kujdes muret dhe, megjithëse

ishin të kënaqur, bënин vërejtje për qoshet, që, sipas tyre, nuk ishin shumë të lakuara.

Kur ata të katër u afroan, fshatarët u mblodhën dhe i prenë bisedat. Ra një heshtje e çuditshme. Dëgjohej vetëm zhurma e mushamasë së Qamilit. Kur ishte kohë me lagështirë, kur frynte Cangonjarka ose kur binte shi, Qamili vishte një mushama të vjetër, të zezë, që në çdo hap të tij bënte «fësh-fësh» sikur tundeshin me tërbim gjethet e pemëve. Ishte e çuditshme ajo veshja e zezë. Ia kishte marrë, në kohën e luftës, një oficeri rob italian dhe gjithnjë, edhe kur ai ishte ulur, bënte një zhurmë të bezdisshme. Po Qamili ishte mësuar me të dhe nuk i bënte asnjë përshtypje, kurse të tjerët talleshin duke thënë: «Zevzek, si i zoti!».

I pari foli Lamja, kur i pa të katër tek kapercenin gardhin.

— Ja ushtari ynë!

— Bre! Bre! Bre! Pse? I biri i Zalosështë ai?! Sa qenka rritur! Si rriten këta djem kaq shpejt?! — tha Qamili dhe çalë-çalë, duke bërë zhurmë me atë mushamanë e zezë, i doli përpëra dhe e përqafoi me mall. Skënderi pakëz i mallëngjyer, u përshëndosh me të gjithë burrat. Nuk donte ta dridhëte cigaren që i fali Qamili, po i erdhi rëndë. Po e vështronin gjithë ata sy dhe ai e dinte se, po të vepronte ndryshe, do ta tallnin me këngë: «La duhanë, la rakinë, u bë burrë për shtëpinë...» Ndezi cigaren, i pyeti si ishin dhe u tha:

— U mësova me atë jetë ku punët shkojnë si sahat. Këtu kam frikë se do të mërzitem.

— A, jo, djali i daiut — e ndërpren Qamili me zhurmën e tij të zakonshme. — Nuk të lëmë të mërzitesh... E përsë tê mërzitesh?!

— Po ja..., donte të thotë një mendim Skënderi, po nuk e la një fshatar i gjatë, si lloz, që kishte mustaqe të dendura e të zverdhura nga tymi i duhanit.

— Ushtria i ka punët një, dy dhe imbaroi, — tha fshatari. — Atje s'ka as gra, as pleq si ne, as fëmijë.. Këtë do të thuash?

— O Mehmet!, — iu drejtua Qamili duke i nxjerrë fjalët me një vërshëllimë të hollë, pér shkak tē dy dhëmbëve tē parë, tē thyer. — Atje janë vërtet tē gjithë tē rinj, po edhe ne s'i kemi punët aq keq. Kemi vëshirësi tē mëdha, por jo sa pér t'u mërzitur.

— Sikur thashë unë keq, po ka edhe më mirë, — tha Mehmeti me dorën te mustaqet.

Dhe kështu filloi ajo bisedë fshatare në atë perëndim dielli, te ato themelet e shkollës së re. Dalngadalë u grumbulluan tē gjithë tek arra e moçme. Vetëm gratë e vajzat rrinjin pakëz larg e nuk afroheshin, sikur aty ku kuvëndo-nin burrat tē ishte mbjellë urov e kishin frikë mos pengoheshin.

— Duhet bërë diçka, — tha Lamja i menduar e i pikelluar duke fërkuar duart e mbërdhira. — Ia thashë edhe Kenos. Unë s'di se çfarë, se aq ma pret tutku. Po them se s'duhet tē punojmë si kemi punuar gjer më sot.

Ai vështroi njerëzit përreth me sy tē ngrirë duke ndier mornica në trup. Ishte veshur shumë hollë, me rrobe krejt tē grisura e tē arnuara dhe njërin sy e kishte me sklepa, nga lotët që i rridhnin prej lagështisë së hidhur.

— Duhet punuar së bashku, — tha Qamili duke drej-tuar dorën një herë nga fusha dhe pastaj, nga gryka e Cangonjit. Në çdo lëvizje tē krahut u duk sikur fryu një rrymë e zhurmshme ere, si stuhi. — Të punojmë së bashku si rrëmbecarët e fushës e si ata devollinjtë e Vishocicës. I kam parë vetë, jetojnë shumë më mirë se ne, derrkat e derrit!

Fshatarët qeshën pa tē keq. Midis tē qeshurave ndërhyri Lytoja e tha:

— Çdo gjë varet nga ne. Po tē duam ne, do tē jetojmë si ata dhe më mirë se ata. Ka tē drejtë dajë Qamili. E vetmja rrugë e drejtë që tē nxjerr faqebardhë éshtë ko-operativa...

— Unë mendoja se do ta kishin ngritur, po ju qenki prapa, — tha Skënderi me një pakënaqësi krejt tē hapur.

— E kemi zakon ne, tē fundit, gjithnjë tē fundit!

Fjalët e tij ishin të rënda. Fshatarët ulën kryet të dëshpëruar. Dikush tha nëpër dhëmbë, po fjala e tij u dëgjua:

— S'është kollaj...

Qamili zhurmoi me mushamanë e tij «zevzeke».

— Klapka, — tha, — klapka na i ka fajet!

— Kulakët bëjnë punë, jo llafe. Dhe ne i hamë fjalët e tyre si llokume, — tha Malka me një farë nervozizmi, që më kot përpinqej ta përbante.

Vetëm Jaçja vuri buzën në gaz:

— Hajt, se do t'i vijë koha edhe asaj pune! Urtë e butë. S'ka përse të shpejtohem. Kështu janë udhëzimet. Se, që ta marrësh vesh ti, o ushtar i dashur, kur hip në kalë për herë të parë, duhet të dish të mbahesh fort, se të hedh në hendek.

Ai i mbështeti pëllëmbën në sup dhe Skënderit iu duk si një gjë e rëndë. Fshatarët mbetën përsëri si të topitur. Megjithëse nuk bënte asnjë lëvizje, mushamaja e Qamilit fëshférinte për dreq. Lytoja pa nga perëndimi dhe e mori me mend se dielli po fikej përmbi retë e zeza sterrë.

— Çdo fillim është i zorshëm. Vetëm duhet filluar. Dhe ne, nga vjeshta, këtë punë do ta mbarojmë. Apo jo?, — pyeti ai duke u hedhur një vështrim dashamirës. Qamili bëri «po» me dorë, sigurisht duke fëshféritur me mushamanë e tij. Mehmeti tha me zë «po». Ca heshtën. Një plak mërmëriti: «Do zoti!». Një nxori shaminë e madhe dhe fshiu hundët. Një tjetri iu drodh zëri dhe filloj të kollitej. Pastaj, kur ra fjala për punimin e tokës, për mbjelljet gë duhej të fillonin pa humbur kohë, për tokat e reja që hapte rinia, për ndërtimin e shkollës, të gjithë sikur u gjallëruan. Si njerëz që i kishte rritur balta e të mësuar me tokën, folën shpenguar se ku kishte kulluar toka, ku mund të hynin skuadrat e bashkuara për punë reciproke, ku mund të punohej me shatë, ku mund të lëronin qetë dhe ku mund të hynte traktori, që këshilli kishte premtuar se do ta sillte atë pranverë.

Papritur të rintjtë ia thirrën këngës. Burrat filluan të

mbajnë iso. Qamili bëri një shaka, po kësaj radhe fëshfërjen e bezdisshme të mushamasë së tij e varrosi kënga e shtruar e melodioze.

— Gjelat, — tha ai me seriozitet, — na zgjojnë në mëngjes për punë. Rinia na thotë «natën e mirë» me këngë.

Po kjo shaka u duk si e shpëlarë. Askush nuk qeshi. Megjithatë kënga i bëri njerëzit të harrojnë për një çast hallet e shumta, i afroi dhe i gëzoi. Skënderi hyri midis këngëtarëve dhe filloj të ziejë. Ishte një këngë e vjetër, që bënte fjalë për një rebel të burgosur e që i linte amanet nënës plakë gruan, vajzën e djalin. Gruaja, që kishte fëmijën në gji, mbërtheu bluzën dhe u afrua sëbashku me atë plakën që e ndiqte nga pas e gjithnjë i jepte porosi të panumërtë. U afruan edhe gra e vajza të tjera, të gjitha me një nur gëzimi në fytyrë, të çelura e të shkathëta. Vështronin burrat e djemtë e pashëm, pëershëritnin vesh më vesh, i bënin shenja të fshehta me duar e me sy njëra-tjetrës dhe kënaqeshin me atë këngë të dhimbshme burrash.

— Devolliçen, — thirri Qamili kur të rinjtë mbaruan këngën midis gëzimit të përgjithshëm. Eci çalë-çalë midis njerëzve, gjeti ata që i duheshin dhe i shtyri midis turmës.

— Merrjani! — urdhëroi me fërshëllima dhe, ashtu, i mbështetur vetëm mbi këmbën e shëndoshë, pa me admirim e tërë vëmendje dy djemtë e rinj, të pashëm, flokë kastë, të ngjashëm si binjakë. Njëri, ai që hiqte vallen, mbante në dorë një shami të kuqe me lule të bardha. Doren tjetër ia hodhi shokut në qafë. Hynë në valle edhe katër të tjerë, dy burra e dy pleq.

— Edhe ti, edhe ti!, — dhe Qamili shtyu me ato duart e holla e të forta si çengelë Skënderin, që nuk bindej nga turpi. — Mos i ke harruar zotrote vallet tonë?! Në i paç harruar, nuk na duhesht! Ashtu, xhan i daiut, ashtu!, — u zbut ai menjëherë dhe sytë i ndritën. — Ashtu, xhani daiut ashtu! Je nga kjo baltë ti! Hë më të lumtë! Dil në krye, dil, se ke radhën. Me radhë është kjo botë, në jetë dhe në valle! Me radhë! Po kur të të vijë radha, tunde! Ndryshe s'je gjë. Je avxhi dyfekplasur! Tunde, o bir! Po s'e

tunde ti, e Lytoja, e Malka, kush ta tundë? Kllapka?!... u shoftë!...

Qamili fliste si me vete dhe askush s'e dëgjonte. Fshatarët kishin qejf të shikonin Skënderin në valle. Ai ishte veshur ushtarak, ishte rritur dhe atyre u dukej tjetër njeri, kurse Skënderi, si nuk shpëtoi dot nga duart e Qamilit, u gjend në krye të valles. I vinte ende rëndë që të hynte në valle, aq më shumë, ta hiqte atë. Mirëpo djemtë, të cytur nga Qamili, e përfshinë si një hiçgjë dhe e lanë në krye. Ai mori shaminë e kuqe dhe, kur pa se s'kishte ç'të bënte tjetër, veç të zemërohej me të gjithë, mbështeti dorën në bel, nxori këmbën e djathtë pak përpara dhe qëndroi një çast si i ngrirë, me kryet pakëz lart e me vështrimin përmbi gardh tej nga perëndimi. Megjithëse ishte shumë i emocionuar, mundi të dallojë midis grave nënën e tij, me shaminë e re mbi krye. Ajo ndriçonte nga lumturia. Me atë dorën e vogël e të regjur i jepte zemër dhe atij i dukej sikur i thoshte:

— Merrja, o bir! Merrja, o tu bëftë nëna kurban!

Dikush e filloi këngën me një zë shumë të lartë. Një tjetër, me një zë baritoni të dridhshëm, ia preu. Njëherësh isoja e tendosur, sikur binin qindra vegla të ndryshme në një ton. Ai pa që eëma fshiu sytë, ngriti kokën edhe një herë më lart dhe filloi vallen. Shamia sikur iu shkëput nga dora, fluturoi mbi kokën e shokut që i mbante vallen dhe erdh e u mbërthye përsëri në gishtat e tij, si një flakë e kuqe dhe e dridhshme.

Sheshi, që dukej si një gërmadhë nga muret e pambaruara e nga materialet e ndërtimit të shpërndara gjithandej, sikur u lëkund. Gjithë zoqtë që kishin ardhur për të kaluar natën në degët e arrës u shpërndanë menjëherë në-për qiellin gri, sikur u shtiu dikush me çifte. Njerëzit u afroan më shumë pranë njëri-tjetrit. Filluan të ziejnë vajzat, gratë, fëmijët dhe Skënderi për një çast harroi se ku ishte. E kishte rrëmbyer kënga e vallja, si mund të rrëmbejë një djalë dashuria e zjarrtë e vajzës, si mund të rrëmbejë shkumba e bardhë e lumiit në verë një fëmijë të gëzuar. Ai përdridhej si ngjalë me atë trup të zhëdervjelltë, përkulej në gjunjë si pendë e lehtë dhe papritur,

mbështetur në sup të shokut, fluturonte si ata zogjtë e arrës, lart, shumë lart, mbi kryet e të gjithëve. Kur ulej në tokë rrötullohej e rrötullohej si një fugë druri, në një vend, pa iu marrë mendtë asnjë grimë dhe ngulej aty, te ajo copëz tokë, ku binin majat e qizmeve, si një gozhdë. Dhe papritur kërcente. Një këmbë e ngjishte mirë në tokë, kurse dora me shaminë fluturonte gjer në qiell, gjer lart ku, për çudi, kishte nxjerrë syrin ylli i parë. Ndërsa në gjoks, dekoratat i tringëllinin me një tingull të kthje llët e gazmor.

Fshatarët mbanin iso me ngulm. Kur u pëlgente kënga e vallja, ata vepronin gjithnjë kështu. Fshati i tyre njihej brez pas brezi për këngët e vallet. Ata i bënин buzët me gjak dhe hanin veten me dhëmbë kur ndonjë bir fshati s'dinte të këndonte a të hidhë valle, ose kur ua merrte atyre keq. Atëherë, duke sharë shumë rëndë me fis, me nënë e bir, në kulmin e zemërimit thërrisinin «Na turpëroi, derri i derrit» dhe nuk i flisnin, gjersa ai çunaku t'u vinte nderin në vend, të dilte në mes të sheshit të kërcente e të këndonte si të parët e tij.

Me Skënderin ndodhi e kundërtë. Ata, që në hapin e tij të parë, ndjenë se në dejt e djaloshit lëvrinte gjaku i tyre, prandaj kruan grykat mirë e mirë, i bënë llagar dhe zjenë me ata zërat e butë si mëndafsh e kadife, me ata zërat si jehonë mali e si gurgullimat e ujërave në pranverë. Vetëm një zë ia vrashtë Skënderit, në valle e sipër. Ai kujtoi se mos ishte ndonjë grifshë e fshehur midis degëve, prandaj vështroi lart, nga arra. Po kur thirrja u përsërit, si një instrument që gabon në një orkestër të madhe, ai hodhi vështrimin andej nga erdhi thirrja dhe, midis grave, pa një vajzë të re, të bukur, me faqet flakë, me gërshteta të gjata e me një shami të kuqe në kokë. Vajza zuri gjajën me të dyja duart dhe thirrja e saj u ndërpren menjëherë. Ndërsa Skënderi ia tundi shaminë e vet me të qeshur.

Kur mbaroi vallja, Skënderi, me kryet përdhe nga turpi, po dhe i gëzuar e i lumtur që çdo gjë i shkoi mbarë, fshiu djersët e ballit me shami, ndërsa burra, djem e pleq e uronin duke e përqafuar:

— Si goja, zemra, o bir, o Keno! Dasmën ishallah!

Kur filluan këngën e vallen tjetër, ai vështroi nga gratë, i ra me bërryl Malkës dhe e pyeti si pa gjë të keq:

— E kujt është ajo vajza me gërshteta?

Malka i ra me të menjëherë.

— S'e njeh? Është e bija e dajë Qamilit, Rasimeja. E kemi përgjegjëse të rinisë në fshat.

— Rasimeja?! Po ajo dreq ka qenë fare e vogël! Kur qenka rritur?

Malka i shtrëngoi krahun e iu përgjigj me shaka:

— E po bie shi shumë këndej nga anët tonë. Rriten bimët, rriten!

Ata s'e zgjatën më bisedën dhe u përqëndruan te vallëtarët që i tërhiqte Lytoja. Po Rasimeja, si duket, diçka kuptoi dhe vrenjtë vetullat. Për një çast u bë si memece. Gojën e kishte kryqur dhe kokën e mbante mënjanë, si një fajtore. Më në fund diçka i pëshpëriti shoqes që kishte në krah, e cila bëri një lëvizje me dorë e me fytyrë, sikur e këshilloi të mos bëhej merak e të mos përfillte asgjë. Atëherë Rasimeja u cel përsëri, hodhi shikimin te Lytoja, që hiqte vallen së bashku me të atin dhe nuk ia hodhi më sytë ushtaraku të ri...

Dielli perëndoi dhe ata po vonoheshin. Gratë, bënin ç'bënин, dhe vështronin tej nga Dheri i Kuq, se mos po zbrisnin dhitë e lopët nga kullota. Nga fusha vinte ndonjë fshatar i vonuar me qetë në zgjedhë e me damalug vënë pér së prapi. Kur hidhte sytë nga grumbulli i njerëzve, u fliste qeve, sikur të urdhëronte fëmijët që të shkonin drejt e në shtëpi, hidhte hostenin mbi sup e drejtohej nga shkolla. Aty po bëhej gati të hidhte vallen e fundit Qamili.

— As ma jepni mua atë shami! — thërriste duke u përpjekur t'ua rrëmbente.

Rasimesë i vinte rëndë që do të luante i ati. Se shoqes, asaj gruas së gjatë si selvi e të bukur, që në kohën e luftës u zbuloi kraharorin ballistëve e u tha: «Qëlloni, o derra!» dhe pastaj i nxori nga shtëpia me cfurk, i vinte turp që do të luante çalamani.

— Do të të tallin, o ditëzi!, — tha me vete duke qeshur me pahir.

Ai kishte dalë në mes të njerëzve, me atë këmbën sakte të shtrirë si stap përpara. E dinte që nuk kishte zë. Dikur, në rini, këndonte. Po, që kur iu thyen ata dy dhëmbët e mallëkuar, fryma i dilte me vëshëllima. Do të jepte dhjetë vjet jetë, po të këndonte edhe një herë si në rini. Kishte marrë edhe një të ftohur të keqe, netët e dimrit, te mulliri i Nuri Agait, që ia kishte prishur fytin fare, e kishte ngjitur dhe e kishte bërë për ibret. Megjithatë s'kishte në fshat njeri më të gjëzuar se ai. Ishte, mbas, njeriu më i lumtur në botë dhe donte që gjithë bota të ishte si ai, gjithë bota...

Fshatarët qeshën kur filloi të kërcejë. Qeshën nga e keqja e shoqja dhe e bija. Ai qe shumë i zhërvjelltë e i fortë. Kishte energji si ai përroi i Dherit të Kuq kur vërshten në vjeshtë. Po e pengonte ajo këmba e mallëkuar që s'i përthyhej te gjuri dhe që shpesh e shante me rrënje e degë, si dinë të shajnë punë e pa punë devollinjtë.

— Zjeni, more djema!, — u fërshëllente Qamili, i mbuluar në djersë, ndërsa mushamaja e tij kishte një avaz më vete.

— Jepi, jepi, dajë Qamil, — e nxisnin djemtë duke qeshur pa të keq.

«More dritëshkurtër, s'i sheh që tallen? Dil, more i zi, nga vallja! Ç'të duhet vallja ty!» — thoshte me vete e shoqja duke qeshur nga e keqja, po i vinte edhe mirë që ai tundte krahët, kokën e trupin si ndonjë djalë i ri.

Ashtu i tundte, si djalë i ri, po megjithatë, kur vinte puna për të hedhur këmbën, dukej, padashur, qesharak. Ai e ndiente thellë këtë dhe zemra i cërritte. Kishte një zemërim të madh, të hidhur, gati të egër, që ndahej për hiçgjë nga moshatarët, nga i ati, nga gjyshët e stërgjyshët. Prandaj mundohej ta hiqte vallen sa më mirë. Dhe, kur e shihte që s'ia dilte dot si duhet, mbyllte sytë me dhembje dhe brenda kapakëve të tyre të puthisura ndiente lot. Atëherë e ndiente veten më kq se kurdoherë, më keq se atëherë kur ballistët i vunë në rresht për ta pushkatuar dhe ai kishte në mend vetëm fjalën e tmerrshme: «Kllapka»!

Qamili shtrëngoi sytë fort, se kënga e vallja po merrte fund. Bëri një të përdredhur qesharake dhe qëndroi në vend. Nuk guxoi t'i hapë sytë, se kishte frikë mos i qenë përskuqur. Ashtu, me sy mbyllur, dëgjoi urimet e njerëzve. Ndjeu dhe krahë të ngrohtë mbi supe dhe të puthura në faqe, dhe një të puthur në buzë. Hapi sytë dhe pa majën e hundës së Litos. Një majë hunde e kuqe. E përqafoi si bir e tha, duke gëlltitur lotët, me grushtin lart:

Parti u bëftë gjithë bota!

Filluan të shpérndahen, se dhitë e lopët po zbrisnin nga Dheri i Kuq, dhe lopçari, një djale pakëz i pagdhendur e inatçi, po gazmor sa s'ka ku të vejë më, po u thërriste grave e fëmijëve të dilnin e të prisnin bagëtitë.

Skënderi u gjend papritur pranë vajzës së dajë Qamilit. U panë sy në sy. Ajo i dha dorën. Atij iu mbyll goja për një çast.

— Mirë se na erdhe!, — i tha ajo. — Je bërë burrë. S'ngjet hiç me atë fotografinë që i ke dërguar nënës.

Sytë e saj ishin të mëdhenj. Ai qe shumë pranë dhe iu dukën shumë më të mëdhenj. Dy sy të mençëm, të vë-mendshëm e të bukur. Mezi hapi gojën e i tha:

— Qenke e rinisë, ti...

Ajo u skuq në fytyrë.

— Kot, ma ka ngarkuar Lytoja këtë punë...

— Po ç'thotë rinia?, — e pyeti ai menjëherë.

— Rinia bën qejf! — iu përgjigj ajo kot, dhe, si ndërroi mendje nga kjo përgjigje pa vend, shtoi: — Rinia punon! Sapo u kthye nga hekurudha! Po hapim toka të reja dhe po ndërtojmë shkollën!

— Po babai, si është?, — pyeti ai i turbulluar.

— Babai hedh valle — u përgjigj ajo duke qeshur. — Nuk e pe? Lot më mirë se ti!

Ai e humbi toruan krejt. Po pikërisht në atë çast u dëgjuja prapa krahëve të tyre zëri i Qamilit. Ai e urdhëroi të bijën të shkonte në shtëpi dhe iu drejtua Skënderit.

— E, o bir, a po na vjen për darkë sonte?

— Faleminderit, dajo!

— Jo llafe, po të vish, — e urdhëroi ai. — Këtë të sont-men, ta dish, e bëmë për ty. S'e bëmë për kllapkën!

Skënderi pak më vonë, duke shtyrë derën e shtëpisë, qeshi kur iu kujtua «kllapka». Po në shpirt përsëri kishte një pikëllim: Punët në fshat nuk shkonin mirë!

4.

Sythet e pemëve ishin gati më të plasur dhe tërë atë javë fshatarët, të ndarë në skuadra e ndihmës reciproke, u derdhën në fushë me qe, plugje, lesa, me brana e me shata. Ngriheshin pa gdhirë dhe ktheheshin të lodhur kur binte nata. Shumë ngastra ishin kulluar, toka qe bërë bukëvale dhe punohej lehtë. Po ky gjësim i tokës së ardhur përzëhej me një shqetësim të përgjithshëm. Qyteti po hante rezervat e fundit dhe rrezikohej të mbetej pa bukë. Tërë atë javë mbinë në fshat ekipe të ndryshme. Punonjësve të grumbullimit s'u zinin këmbët dhe. I shikoje herë në zyrën e kryesisë, duke përplasur me zemërim grushtat mbi tavolinë, herë në fushë, duke kërcënuar ata që s'kishin shlyer ende detyrimin, dhe herë ndanë rrugës, ulur më bisht mbi ledh, tërë turinj e të mërzitur, duke u prerë rrugën fshatarëve. Dy herë u thirrën në Komitetin ekzekutiv e në qarkor atë javë Lytoja e Malka. Punëtorët e Partisë u shpjegonin me durim urdhëresat, u thoshin se ishte e treta herë që qeveria reduktonte fondin shtetëror të drithrave, se duheshin grumbulluar edhe shtatëdhjetë e dy mijë kuintalë, se qyteti ishte në pikë të hallit, ndërsa drithi fshihej nga kulakët e spekulantët dhe shitej aq shtrenjtë sa s'ta merrte mendja.

Komunistët dhe këshilli bënin mbledhje të gjata, gjer pas mesnatës. Lytoja ngjirej së thëni se kjo situatë e rëndë duhej përballuar pa një pa dy:

— Nuk do të vijnë njerëz nga Jashtë që të na e zgjidhin. Do ta përballojmë me forcat tona. Bereqet ka. Sa prodhuam vjet?.. Hé, pra! Edhe lopët e kuajt t'i kishim ushqyer, përsëri do të tepronte. Po kulakët na e punojnë me hile. E kanë fshehur. E kanë fshehur edhe ca të tjerë, se dëgjojnë gjuhën e nepërkës, dhe padashur bëjnë punën e kulakut... Po, more shokë, në fund të fundit, a jemi për

forcimin e aleancës me klasën punëtore? Po si mund të forcohet kur ne po i lëmë pa bukë ata që na japid kripën, vajgurin, hekurudhën, fabrikën e sheqerit, spitalin, minierat, dritën? Si? Pa më thoni?... Unë s'jam hiç dakord me Jachen. Jaçja është sylesh kur thotë se na kanë mbetur vetëm morrat... Mos më ndërpre! Fole pësë herë gjer tanë... Nai zu mëngjesi. T'i japid fund! Nesër që në mëngjes, të parët të japid shembullin ne, komunistët e anëtarët e këshillit.. Dhe asnjeri mos bëjë proqkën e Lames, hajvanit, që shiti kaun... Komunistët e kanë shlyer. Shumë mirë! Atëherë ju, shokë të këshillit, ju që rrini kokëvarrur andej nga fundi. Nesër në orën gjashtë, të ngarkoni qerren e të niseni, me Malkën në krye, drejt e në depot e grumbullimit...

Të nesërmen Skënderi, duke shkuar për në fushë, pa një qerre të ngarkuar me drithë, që e cte tragës buzë kënetës dhe buzëqeshi hidhur:

— Prapëserapë, megjithëse me kërcënëm, me urdhër, me forcë, vetëm një qerre...

Jaçja, që e cte krah tij, e dëgjoi dhe tha i zymtë:

— Kështu bëhen punët te ne. Dhe pastaj thonë se jam sylesh e budalla i budallenjve. Po nejse, dardha e ka bish-tin prapa.

Ishte butë dhe bryma e shkrirë pikonte nga pemët si shi i rrallë. Skënderi u bë pishman që s'mori lesën. Lesa ia kullonte tokës së punuar vlagën e tepërt, ashtu siç ia ruante kur ishte thatësirë. Duke menduar kështu pa buzë rrugës, mbi ledh, një grup fshatarësh. Midis tyre ishte Milo Peçi, veshur me një qyrk të shkurtër lëkure, me çizme të larta e me kokore me veshë të lëshuar. Tundëte grushtat në ajër dhe fliste me zemërim:

— Po përse, more derra, na sillni vërdallë? Përse?... Ty të pyes, more hu gardhi! E sata herë është që gënjen qeverinë? Kur do të vësh mend ti? Përse nuk e jep bereqetin?... Ah! S'paske... Mirë, dil këtej, pa ta tregoj unë ty, këlysh kulaku! Mu këtu, te kjo pemë, do të të var! Dhe do të të var për gjuhe, që ta marrin vesh edhe të tjerët se ç'do të thotë të tallesh me pushtetin popullor.

Miloja bëri disa hapa, e përfshiu fshatarin për jake dhe, duke e tërhequr gati zvarrë, e mënjanoi nga të tjerët.

— Në hu do t'ju shkoj, në hu! Të gjithëve!

— Kush është ky? — pyeti Skënderi Jaçen me zë të ulët.

— Punonjës i grumbullimit. Ka qenë te ne ndonjë vit si specialist bujqësor. Është burrë i mirë, i vendosur. Milo Peçi e thonë.

Skënderi shtrëngoi nofullat:

— Ama burrë i mirë qenka!

— E po, — e ndërpreu Jaçja duke mbledhur supet. — Nga halli sillet ashtu, se mos sillet nga e mira.

— Nuk thotë Partia të përdoret kërcënimi e forca me popullin.

— Me popullin po, po jo me këta. Ç'popull janë këta? Ca morramanë më keq se unë.

Miloja kishte mënjanuar edhe një fshatar tjetër, me atë dorën e tij si kërrabë, siç bën çobani që ndan shterpat për t'i therur. Fshatari e shau vendçe. Miloja u nxeh dhe i ngriti grushtin para fytyrës. Fshatari bëri gati hostenin:

— Mos m'u afro!, — i tha me sy të çakërritur dhe i nxirë në fytyrë nga inati. — Po bëre edhe një hap, ta dhashë në çakë të kokës, edepsëz!

Miloja u përbajt e tha:

— Mirë. Me mua mbaruat. Tani e ka fjalën Dega me ju, — dhe u bë gati të largohet.

Skënderit i hipit inati. I doli përpara, kur ai kërceu nga ledhi e ra në rrugë.

— More ti, zotni, — i thirri me zë të ashpër.

Miloja e pa vëngër.

— S'jam zotni, po shok...

— Mund të jesh. Po nga veprimet je zotni e kaluar zotnisë. Përse sillesh kështu me vëllezërit tanë? Kush të ka autorizuar ty, harbut, të bësh një punë të tillë?

Miloja vuri re Jaçen dhe mori zemër.

— Kush je ti?

— Fshatar jam, si këta, — u përgjigj Skënderi dhe ndjeu gjakun t'i hipë në kokë. Njerëzit iu afroan dhe iu bënë gardh prapa shpatullave.

— Unë ty s'të njoh! Si e ke emrin? E ke shlyer detyri-

min ti? — pyeti Miloja dhe, me duart që i dridhesin lehtë, hapi letrat ku kishte regjistruar emrat e fshatarëve.

Skënderi u bë papritur gjakftohtë, po u zverdh në ftyrë:

— Dëgjo këtu ti, Milo Peçi! O qëroju që këtë minutë nga fshati, o përndryshe, te ajo pemë, ku deshe të varësh fshatarët, do të mbarosh vetë, kokëtatëpjetë!, — dhe e shau devollje me rrënëjë e me degë.

Për pak desh u kacafytën. Jaçja e ndjeu këtë rrezik dhe ndërhyri me të butë:

— Po daleni, bre shokë! S'bëhen kështu këto punë! Djem të një nëne jemi. Të merremi vesh! Ka a s'ka pushtet në këtë fshat?! Jam a s'jam sekretar i tij?!

Ai hyri midis të dyve dhe i ndau. Miloja mori rrugën e qytetit pa kthyer kokën asnjëherë. Po nga mënyra si i tundte shpatullat e gjera kujtohej që ishte i zemëruar. Jo më pak të zemëruar qenë fshatarët dhe Skënderi. Ata flisin të tërë pothuaj njëherësh. Ishin fyer rëndë. Ai që e pësoi i pari nga Miloja tha duke iu dridhur buza prej zemërimit:

— Vallahi, o shokë, edhe të kem, s'jap asnë thërrime! Po përse në këtë mënyrë? Ç'jam unë? Diversant?...

Një tjetër, ai që ngriti hostenin, turfullonte:

— Pse? Me forcë qenka puna, a? Me forcë as në xhennet nuk vete? Në djall xheneti dhe Milo haleja!

Kur shkuan secili në punë të vet, Skënderi ndjeu një boshllék të madh në shpirt. Mendoi me vete:

— Kërcënime, urdhra! Jo, ore Jaçe jo! Terreni s'punon në rregull! Bëhet puna pas qejfit. Kontroll s'ka. Dhe populli i zi heq...

Të nesëmen përsëri Lytoja e Malka u thirrën në qytet përfushatën e mbjelljeve dhe për grumbullimin. Në mëngjes herët Skënderi ndreqi gardhin e oborrit, që ishte prishur vende-vende gjatë dimrit, dhe, si pa qielin, tha me vete:

«Edhe sot nuk do të kemi shi.»

Eëma, duke punuar në ashek, e vështronte nga dritarja e vogël dhe sepse përsëriste gjithnjë të njëjtin mendim:

— Djali im kurrë s'na ka turpëruar!

Në fshat kishte rënë një heshtje e rëndë, si përparran donjë furtune nga e cila s'pritet asgjë e mirë. Kur doli në rrugë, matanë çakëllit me gurë, Skënderi pa në oborr Kasém Sharrën. Oborri ishte plot me dhen, që blegërinin të trembara. Nën këmbët e fshatarit përpélitej një dele dhe duart e Kasëmit ishin tërë gjak.

— Po i shënoj që mos të më ngatërrohen në tufë!, — tha ai i zënë ngushtë dhe i uroi mirëmëngjesin.

— Paske goxha tufe, xhaxha!, — i tha Skënderi duke parë një qengj, që dridhte bishtin e vraponte midis deleve për të gjetur t'ëmën.

— Atë nuk e kam lëshuar fare. E rrit për miqtë, — tha Kasëmi duke parë qengjin tek kërcente. — Shikoja bish-tin! — zgjati dorën dhe e kapi — A, të hëngërt Kenoja, ty! — i tha buzagaz dhe e ftoi Skënderin — për ty e kam, — i tha. — Të më urdhërosh! Dua të kujtoj tët atë, ndjesë pastë! Vdiq si burrat. Vdekja iu bë kapak floriri. Ishim së bashku në luftë, kur u vra, — dhe sepse vuri dorën te ylli i qeleshesh, kurse unë s'dihet si do ta kem atë virane.

— Nuk po vjen në fushë?, — e pyeti Skënderi disi i mallëngjyer.

— Them të shkoj në qytet. Kam një hall. Ditë pazari sot, helbete, — tha Kasëmi duke shënuar delen e fundit. — Po na urdhëro, o bir! Se të kam në vend të t'yt eti, ndjesë pastë!

— Do të vij, patjetër, — i tha Skënderi dhe bëri tatë-pjetë rrugës, duke mënjanuar gropat me ujë e me llucë. Që nga larg pa oxhakun e lartë të shtëpisë së Nuriut dhe e mori me mend se aty njerëzit ishin zgjuar. Dhe vërtet, kur u afrua, e pa plakun te hajati i oborrit. Jepte e merrte me të shoqen e me të bijën, me gojën plot. Po hante mëngjesin dhe e shoqja, një grua e tretur, lëkurëzezë, si hoshafkë, qëndronte më këmbë, e gatshme për të kryer menjëherë çdo porosi të tij. Me dollomanë e gjerë, ajo dukej edhe më e vogël. E bija, e pakrehur, ashtu siç ishte ngritur nga gjumi, po fshinte oborrin tërë kashtë e bajga.

— Lëre fshesën e zër brumin!, — dëgjoi Skënderi nënën që porosiste të bijën kur ai ishte pranë gardhit. Vajza e kishte parë djalin që kur ai mori kthesën te shkolla e re

dhe nuk ia hiqte sytë. E pa edhe Nuriu, largoi sahanët me gjellë dhe u ngrit duke fshirë buzët me pëllëmbë.

— Është djalë i mirë ky!, — tha dhe me një vështrim i futi femrat brenda. — Bëj shpejt ndonjë oshmar dhe mos harro kafenë... kafenë!, — e porositi të shoqen dhe vetë hapi lesën e gardhit.

E bija lëshoi fshesën në hajat dhe pa nga dritarja me hekura. Eëma e shau:

— Mos m'u azgalis kështu! Po të pa yt atë, ta këputi kokën, si të zogut...

Vajza mbuloi fytyrën me duar, pastaj rrëmbeu kusinë me ujë të valuar dhe shkoi në ashef, te magjja e madhe. Duke zënë brumin, bënte ç'bënte dhe zgjaste kokën te dritarja. I ati dhe ai, Skënderi, dukeshin mirë që andej, aty te lesa e gardhit. Ai ishte djalë i gjatë, i pashëm, i bukur. I ati kishte thënë: «Është djalë i mirë!» Kishin thënë edhe ca të tjerë kështu. Edhe eëma kështu kishte thënë dhe në zemrën e saj të ndrydhur kishte lindur një èndje mikluese, e ndritshme si vesa e mëngjesit dhe e pashpjegueshme. Që nga dritarja dëgjoheshin mirë edhe fjalët e tyre. I ati dukej si me krahë. E ftonte mikun të hynte brenda e të pinte një kafe. Ndërsa ai thoshte se nuk kishte kohë dhe ngulte këmbë në të tijën. Papritur, i ati, me hap të zgjatur, i ra oborrit përmes dhe hyri në hajat. Ajo, e trembur, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u gjend me duart ngjeshur në brumin e magjes.

— Kafenë, — thirri ai me gurmaz, — kafenë dhe oshmarin. Therni edhe ndonjë zog dhe kuqeni me gjalpë!, — dhe po me atë hap iu afrua gardhit.

E shoqja e kishte vënë tiganin me gjalpë e me djathë në zjarr. S'qe nevoja t'ia përsërisje urdhrat. Shkoi me vrap në kopsht, si ndonjë dhëlpër e shkathët, kapi një pulë dhe ia këputi kokën. Pas pesë minutash pula filloj të marrë valë në kusi. E bija fluturonte nga gëzimi. E mori me mend se i ati e kishte ftuar mikun për drekë dhe, duke punuar brumin pa pushim, u mbulua në djersë dhe faqet iu bënë gjak nga emocioni.

— Shpejt, moj bijë, shpejt. Se kështu bëhen këto punë. Ishallah e të del kismet! Ku do të gjesh më të mirë? Thamë

një herë pér atë... Jaçen, po ç'ta duam atë Kuqon në shtëpi! Ç'ta duam atë njeri pa njeri! Apo e ke ntrashur me të? Se të kam gjetur një herë në plevicë pér ibret. Po s'të fola...

Vajza e shtroi kulaçen në çerep dhe i vuri saçin:

— Ç'flet kështu, moj nënë!

— Hesht! Se të kam parë me këta sy, po s'guxova t'i tregoj tyt eti!

Vajzës iu mbushën sytë me lot. Tha e përdëllyer:

— Ai është tutkun! Desh ma këputi llërën, po unë... unë... s'e lashë!

— Budallaçkë, o budallaçkë! Shih se po të digjet kulaçja! U pa kjo punë. Ai do të vijë pér drekë. Tëholli petët, shpejt, shpejt!

Okllaia vërtitej mbi jastagaç si një mekanizëm i përpiktë dhe petët dilnin të holla si fletë cigareje. Oshmarri u bë gati. Filloi të skuqeji pula e zhytur në gjalpë. Nën saç, në çerep, kulaçja ishte fryrë si pambuk. Ndërsa ata të dy, babai i sertë dhe ai djali i porsaardhur e i bukur, kuvendonin, njëri këtej lesës e tjetri matanë, në rrugë.

— Unë s'përzihem më në këto punë, o bir, se janë me zarar i thoshte Nuriu si i pikëlluar.

— S'je përzier, — e ndërpree Skënderi. — Kam gati një javë këtu dhe s'kam dëgjuar asnë fjalë të keqe pér ty. Kjo është gjë e mirë, xhaxha!

«Xhaxha!» Kjo fjalë e shkrinte Nuriun të térin, sidomos kur ia thoshte ndonjë komunist ose ndonjë njeri i besuar i pushtetit, nga ata që kishin lejë të mbanin armë të çdo lloji: pushkë, revole, bomba.

— Kështu, o të keqen xhaxha Nuriu. Ti e ke kuptuar vetë se ç'rrëmujë është. Dhe po vazhdoi kështu, fshatin do ta marrë lumi! Apo e kam gabim? Jo, në qoftë se e kam gabim, ma thuaj, se unë, tek ti, o bir, kam besim! Qafsha të gjithë, kam besim më shumë se te vetja ime. Sa pér atë nofkën, të ta them hapur, më vjen rëndë sa s'bëhet! Po, në fund të fundit, ç'rëndësi ka ajo? Puna është që të shpëtojë fshati e njerëzit, pa xhaxha Nuriu me një këmbë në varr është. Ç'bëri nesër, ç'bëri sot, vrania do të më vijë...

Skënderi kishte kapur me një dorë hurin e lesës, mbante kokën poshtë dhe me majën e çizmes përpinqej kot të shkulte një popël me bar të thatë. Nuriu, me ata sytë e veckël si të dhelprës, ndiqte çdo lëvizje të tij. Ishte téré sy e veshë dhe nuk i shpëtonte asgjë, si atij gjahtarit të regjur. S'i duhej Nuriut ndonjë gjë e madhe. Mjaft që ai ushtaraku i ri e pa përvojë në punët e fshatit, ta shihte botën me sytë e xhaxha Nuriut dhe (o perëndi sikur t'ia arrinte asaj dite!), t'ia vinte syrin së bijës e të martohej me të. Nuk donte trashëgim Nuriu. Thellë në shpirt ai nuk donte që t'i përzihej gjaku. Ai e donte këtë vetëm sa të hidhëte vrahun, të kishte ku të mbahej fort, pastaj... Pastaj, po të ndryshonin kohët, do të dinte vetë si ta hidhët vallen. Mirëpo Skënderi nuk po e kapërcente lesën, me gjithë lutjet e tij të përdëllyera. Djaloshi, dukej sheshazi, s'e ndiente veten mirë. E shqiti më në fund poplën me bar, i futi një shqelm dhe pyeti:

— Po mirë, more xhaxha, çfarë të duhet ty nga ky pushtet?

Nuriu e pati përgjigjen në majë të gjuhës:

— Asgjë, o bir! Ato që të duhen edhe ty, edhe fshatarëve të tjerë! Le të na japin gazin, kripën e sapunin që bëhen në vend. Për të tjerat, që vijnë nga jashtë, as që çajmë kokën. Le të na hiqet ajo urdhëresë e shkretë e shit-blerjes, le të na pakësojnë grumbullimet. Le të na japin më në fund triskat. I kishim. Përse na i hogën? A s'jemi edhe ne njerëz, si ata të qytetit. Këto duam. S'duam qiqra në hell. Përndryshe, ti e shikon vetë, o bir, se jeta po na bëhet varr...

Skënderi e pa veten ngushtë dhe s'dinte ç'përgjigje t'i jepte, po tashmë e kishte të qartë se bashkëbiseduesi i ntrashte gjérat:

— Unë ka vite që s'kam qënë në fshat, po më duket se ti, o xhaxha, i zmadhon vështirësitet. Tani të gjithë ne kemi tokë edhe mjete. Edhe zotrote, megjithëse ke ndihmuar, keq s'je për vete. Ke edhe qe, edhe lopë, edhe kopsht. Dhe s'i ke keq. Të mirë të gjithë. Drithrat, si kam dëgjuar, këta dy vjet, kanë qenë të mbara. Pra bukë ka.

Sigurisht, po të mos na kishin dëmtuar rëndë trockistët, siç e di, do të ishim akoma më mirë...

Nuriu tundi kokën me hidhërim të madh.

— Ah! Ç'kam hequr unë prej atyre rufjanëve! Ç'kam hequr! Varrit do t'ia tregoj!

Skënderi vazhdoi mendimin e vet:

— Dhe nëse këtu na prish punë njeri, dhe na prishin, unë shoh mirë se sytë në ballë i kam, Partia do ta dënojë. Mos ki merak. Partia s'lejon gabime!

— Partia nuk i lejon, — tha Nuriu duke ulur zërin sikur t'i zbulonte ndonjë të fshehtë. — Po Partia është larg, o bir. Sa t'i marrë vesh ajo, bujqësia bëhet dërrmë...

— E ke gabim!, — e ndërpreu Skënderi, — Partia është kudo.

— Është dhe s'është! Dale, prit një herë. Ja, të marrim për shembull grumbullimin. A e di sa më ka caktuar ai Malka mua? Nuk e di! Dhe jo vetëm mua!... Na ka caktuar kaq shumë sa, siç e sheh, mezi po mbajmë xhanë. Ja xhani, ja qetë, o bir... një nga të dyja! Po më mirë qetë. M'i lumtë Lames së varfër!

— Për këtë ke hak. Kurse për të tjerat jo. Rrëmu-jës do t'ia presim rrënjet. Po qe nevoja, di unë ku të drejtohem. Shkruaj, në Tiranë dhe mbaron puna.

Nuriut nuk i pëlqeu ky mendim i fundit. Ai e dinte si dreqi ç'përgjigje do të merrte Skënderi nga udhëheqja e Partisë.

— Përse të shpejtohesh xhanëm, pa edhe mund të shkruash. Të tërë e kemi atë të drejtë. Po, përse t'i shqetësojmë? Pak andralla kanë? Na edhe një nga ne. Punët duhen rregulluar vetë. I zoti e nxjerr gomarin nga balta. Apo e kam gabim?

Nuriu bënte ç'bënte dhe kthente kokën herë nga hajati dhe herë nga dritarja e shtëpisë. Po andej nuk dukej asnjë fytyrë njeriu. Më në fund Skënderi vendosi të largohej. Kishte biseduar gjatë dhe nga ajo bisedë nuk kishte mbetur i kënaqur. I qe mbështjellë një si lëmsh mu në grykë dhe gojën e kishte të hidhur farmak.

— Po urdhëro të pimë një kafe!, — e ftoi Nuriu për të tretën herë. — Ti, more i uruar, s'i ngjake hiç tyt eti,

ndjesë pastë! Po urdhëro, se shpejtë është. Pastaj sot është edhe ditë pazari. A e di? Kur është ditë pazari, mua meazzallah se më zihet puna me dorë. Vete, s'vete në pazar, kam qejf të pushoj.

Atij i fliste, kurse kokën e kthente nga shtëpia dhe mallkonte me vete të shoqen e të bijën që nuk po i sillnin kafenë.

— Hajde, pra, mos ia prish xhaxhait! Ja, këtu në hajat, sa ta pimë atë të shkretë, — nguli këmbë Nuriu me një nervozizëm të përmbajtur. — Moj grua!, — thirri më në fund me zë gryke, të ngjirur — A na e poqe atë kafe! Po sille, moj e uruar, sille, se miku ka punë e do të ikë...

Te hajati i jashtëm u dha e bija. Ajo qe krehur e veshur me një fustan boj qielli, të gjatë gjer te pulpat e këmbëve. Flokët e dendur e të gjatë i kishte lidhur me një fjongo të bardhë. Skënderi i hodhi një vështrim të shpejtë dhe, si fshatar i ndershëm që e di se nuk është gjë e mirë ta vështrosh gjatë femrën, i hoqi sytë dhe ua nguli çizmeve.

— Urdhëroni!, — tha ajo, — çdo gjë e keni gati...

— Nuriu u bë i butë papritur:

— Po ç'na ke shtruar, moj bijë e babait? Me se do ta presësh mikun? A e di se të shkel shtëpinë për herë të parë?

Vajza u skuq nga turpi e tha, e habitur nga mirë-sjellja e të atit:

— Bukë e kripë e zemër!

— Të keqen babai ty!, — ia bëri Nuriu dhe, si hodhi një hap tej lesës, ia futi krahun Skënderit.

— Jo, jo, — tha djali, — një herë tjetër. Më presin shokët në fushë.

— Po ti mos ia prish qejfin çupës, o bir, — u shkri Nuriu.

Mirëpo Skënderi kundërshtoi me ngulm gjer në fund.

— Nga mbrëmja, — tha vetëm e vetëm që të ikte, — nga darka shohim e bëjmë. Nga darka, xhaxha!, — dhe i mërzitur, pa qejf e me zemër të thyer, mori rrugën e fushës.

Atë çast kaloi para shtëpisë Jacja, me qetë përpara.
Nuk arriti të përshëndetej me Nuriun, se ky ia priti me
duf të hidhur:

— Si nuk dole një herë në shteg kur duhet, more
derr i kuq! Jepu këmbëve, se e ke përpara! Në darkë të
ma sjellësh patjetër. Hy, gremisu!, — dhe përplasi lesën
sa desh e shkallmoi.

— Si nuk dole një herë në shteg kur duhet, more
derr i kuq! Jepu këmbëve, se e ke përpara! Në darkë të
ma sjellësh patjetër. Hy, gremisu!, — dhe përplasi lesën
sa desh e shkallmoi.

KAPITULLI I KATËRT

1.

Atë mbrëmje Skënderi u mbyll që herët në shtëpi. E ëma po merrej me dhitë e me kusitë dhe nuk e vuri re që i biri ishte pa qejf e i mërzitur. Me t'u ulur buzë vatrës, nxori nga çanta fletoren e stilografin, afroi llambën me vajguri, vuri fletoren mbi gjunjët dhe filloi të mendohej duke kafshuar këllëfin e stilografit.

— Si ta filloj?! T'i them më parë për takimet me fshatarët e për bisedat me ta?... Kështu do të më vejë gjatë dhe s'do ta qullos dot. Unë s'di as të shkruaj mirë. Me të vjedhur mësova. Do të bëj gabime dhe do të thonë: gjash-të vjet në ushtri dhe s'paska mësuar të shkruaj si duhet ky shok! Si ta filloj?!

Më në fund shkroi frazën e parë mengadalë dhe me kujdes.

«I dashur Komandanti jonë, shoku Enver!»

Atë çast hyri e ëma dhe e ndërpreu.

— Bah, mor bir! Me të ardhur e me të filluar! Po ti çlodhu njëherë!, — e këshilloi duke i shtruar përpara tep-sinë me bukë e kos. — Ha, se është bërë kosi ta presësh me thikë, pastaj bjer e fli dhe nesër në mëngjes ulu e shkruaj, se mëngjesi është më i mënçem se nata.

— Nuk më hahet!, — ia preu shkurt Skënderi.

— Si kështu?!, — u habit ajo dhe vetëm atëherë e kup-toi që i biri ishte në një hall të madh.

Ai iu lut:

— Mos më ngatërrro, moj nënë. Lëre bukën këtu dhe shko! — Do të ha më vonë.

Ajo donte të zbulonte të vërtetëtë dhe e pyeti tërë merak:

— Çfarë të mundon, o bir?

— Eh! çfarë më mundon! Sikur të ishte aq e lehtë për ta kuptuar do të ta thosha. Po kur s'e kam as vetë të qartë, si të ta them e si do ta kuptosh ti? Ja, po të them vetëm kaq. Kam një turbullirë këtu përbrenda që më mërzit, shumë. Dhe për këtë po i shkruaj letër shokut Enver... Kurse ti më ngatërron!

— Kush të ngatërron, more xhan! Nëna të ngatërron? Mos e thuaj atë fjalë, — dhe doli në majë të gishtave, pa zhurmë, e pikëlluar.

Skënderi u mendua një copë herë dhe filloi të shkruajë, i përqëndruar. E ëma, bënte ç'bënte, dhe zgjaste kokëن te dera.

«Bir, o bir! ç'halle u kanë rënë mbi kokë!», — thoshte me vete duke u munduar të mos bënte asnjë zhurmë.

Vonë natën ai e mbaroi letrën.

«Ka ca ditë që erdha në fshat, i liruar nga Divizioni i Mbrojtjes së Popullit dhe kam parë shumë të metë, jo vetëm në fshat, po i gjithë populli këtej éshtë shumë i dëshpëruar sa s'ka më. E para, për sistemin e ri, që s'kanë çfarë të shpien në dyqan që të marrin, se shumica s'kanë. E dyta, për misht'e tokës që berra s'kanë edhe mish. Iu kanë caktuar të shpien vetëm qetë e arës në ndërmarrje. E treta, éshtë për bukë, se shumica s'e kanë bukën, po detyrohen të marrin shtatë mijë e tetë mijë lekë kuinalin jashtë, për këtë po i çojnë pendët e bujqësisë dhe i shesin që të blenë misër në pazar, jashtë. E kjo s'éshëtë e drejtë. Terreni s'punon në rregull. Bëhet puna pas qejfit. Kontroll s'ka. Unë jam anëtar partie dhe po vë re se po prishet bujqësia fare. Mua më dhimbset shumë, se për këtë kemi luftuar, janë vrarë shokë të mirë, janë djegur e shkatërruar gjithë populli jonë, si e dini vetë! Partia të marrë masa.

E përfundoj me nderime dhe respekte si komunist i gatshëm. Rreshter Skënder Zaloja».

E lexoi letrën disa herë, e rishkroi në të pastër dhe e vuri në zarf. Atëherë ndjeu një lehtësi në shpirt. Kur, pas pak, e ëma hapi derën mengadalë, llamba kishte filluar të kleitte dhe hijet lonin valle përmbi mure.

— Bah! More bir! — pëshpëriti ajo e shqetësuar — s'vure një kafshatë në gojë! Të paska zënë gjumi veshur, si në kohë të luftës! Si s'mu dha të ta kisha shtruar dy-shekun! Më rëntë pika mua.

E mbuloi me jorgan, shuajti llambën dhe u shtri pranë tij...

2.

Pranvera po vinte me të katra, e parakohshme. Shirat pushuan, retë u shpérndanë dhe dielli përkëdhelte me ëmbëlsi çdo gjë të gjallë. Një mëngjes, për habi të të gjithëve, kishin çelur bajamet, pemët ishin mbushur plot sythe, rrënjet e barit të thatë po lëshonin filiza të blertë dhe pjergullat e krasitura lëshonin lot si margaritarë. Tahiri, një dembel e gjumash kokëmadh, bënte be se kishte parë një dallëndyshe tek fluturonte në quell, po askush nuk e besoi, se ishte ende herët për shtegtimin e zogje. E dinin të gjithë se dallëndyshet vijnë vetëm atëhere kur sigurohen mirë që pranvera nuk bën asnjë dredhi. Megjithatë ditët vinin, njëra më e ngrohtë se tjetra, njëra më e gjatë se tjetra dhe diellin s'e errësonte më asnjë re. Fshatarët çoheshin herët, vështronin përmes dritareve qiellin e kthjellët dhe me ngazëllim në shpirt mbrehnин qetë e shkonin në fushë, grupe-grupe, për vete e për njëri-tjetrin.

Edhe Skënderi atë mëngjes e ndjeu veten të lehtë, të gjallë dhe energjik, megjithëse e kishte zënë gjumi vonë. Tërë atë javë ai kishte punuar për të tjerët, sepse ara e tij nuk kishte kulluar ende. Në mes, ngaqë vinte si gropë, ishte e tëra baltë. Kurse atë mëngjes të tjerët do të punonin për të! Toka ishte bymyer dhe sikur priste plugun edhe

farën. Doli shumë herët dhe papritur, te vija e ujit, buzë gardhit që kishte ndrequr pak ditë më parë, u ndesh ballë për ballë me Rasimenë. Ky takim, që nuk e priste, e hutoi. Ajo qe veshur me një fustan të thjeshtë pune, sipër tutave blu. Ishte e para vajzë e fshatit që vishej ashtu. Po, ishte ajo Rasimeja, me ato gërsheetat e dendura e me ata sytë e mëdhenj e të zgjuar që e kishte parë atë mbrëmje te she-shi i shkollës. Edhe ajo, si duket u trubullua nga befasia, u foli qeve dhe e përshëndeti.

— Nga ke humbur? — e pyeti pa të keq. — S'të kam parë fare. Përse s'na ke ardhur te skuadrat e rinisë?

Ai e humbi toruan më keq nga këto pyetje të çiltra e të guximshme dhe sidomos u turbullua kur ajo i zgjati dorën e ngrohtë.

— Kam qenë i zënë, — mezi tha duke ia shtrënguar dorën, por pa e mbledhur veten.

— Mos u nda nga tufa, se të ha ujku, — bëri shaka Rasimeja dhe shtoi. — Babai të ka pritur gjithë këto net. Po ti s'begenis. Helbete! Ke gjithë ato dekorata...

Ai e ndjeu thumbin e saj dhe u skuq.

— Do të vij. Do të vij patjetër, — përsëriti shpejt e shpejt, i vrenjtur.

Duke shkuar për në fushë, e mblodhi veten. Rrugës u takua edhe me të tjerë dhe gjithë grupi, duke bërë shaka, mbërriti te ara e Skënderit. Kur doli dielli, dhjetë pendë qe, secila në brazdën e vet, têrhiqnin plugjet e kallitur e të ndritshëm. Plisat binin përbys dhe thërmoheshin me një fëshfërimë të lehtë. Toka punohej mirë, ishte e qëruar dhe qetë nuk ndienin ndonjë lodhje të madhe. Njerëzit punonin me qejf, të gëzuar dhe këpusnin qyfyre herë pas here. Vetëm Tahiri nuk fliste. Me kokën ulur, si të qeve, mezi i hidhët hapat e rëndë. Po qetë i shponte, që të ngisnin më shpejt.

— O Tahir, o derr! — i thirri Qamili, që mezi e hidhët këmbën sakate. — Ngule plugun thellë e mos gërvisht koren e tokës.

Tahiri punonte me hile. Ishte dembel e gjumash i madh. Po të mos i qëndroje çekan mbi kokë, ta hidhët. Si

i folën edhe të tjerët, rëndoi mbi plug, po ndjeu lodhje dhe e mbuluan djersët.

— O, ha-ha! — u foli qeve. I çmbrehu dhe u shtri mbi ledhin e hendekut, me kurrizin nga dielli. Si hëngri bukë misri me qepë e gjizë dhe si piu gjysmë bucele me ujë, ia mori me gjumë. Kur bënë pushimin e parë të gjithë, e gjetën duke gjerrhitur. Bollkat i qenë ngritur pakëz lart dhe i dukeshin pulpat e fryra, të bardha qumësht e të mbuluar me ca qime të gjata e të forta si tel. Një nga djemtë, ndërsa u ulën për të ngrënë, ia mbështolli një qime pas gishtit dhe ia shkul. Tahiri as që lëvizi nga vendi. Të gjithë ia dhanë gazit. Atëherë djali përdroddhi dy qime rrëth gishtit dhe i tërroqi me forcë. Të gjithë qeshën përsëri. Kurse Tahiri, siç ishte përbys, ferkoi pak pulpën, me majën e opingës dhe filloj të gérhasë përsëri, sikur të mos kishte ndodhur asgjë me të. Në poret ku pak më parë ishin qimet, ishin formuar tri sumbulla të vogla gjaku.

— S'do t'ia dijë, derri! Kujton se e ha ndonjë mizë dheu, — tha djali dhe mbloshki lëmsh një turrë lesh nga këmba e tij. I tërroqi me sa fuqi pat. Fshatarët mbanin ijet me duar e binin përbys nga gazi.

— Tel për të rrëthuar gardhin!, — queshte edhe djaloshi duke u treguar shokëve qimet që ishin tamam si fije teli të ndritshëm. Ndërsa Tahiri, hapi njërin sy dhe ashtu, i përgjumur, vështroi këmbën:

— Mosni, bre! Mos ma prishni gjumin! Ç'keni me mua! Më lini rehat të vdes.

I mbrehën edhe një herë qetë dhe gjer më drekë punuan papushim. E lëruan arën e Skënderit e të Demkës dhe hynë në parcelën e Kasëmit. Aty, nën një gorricë; u hodhën të hanë qeve dhe vetë u ulën në një lëndinë, buzë arës, që e hante dielli tejembanë. Pas pak u erdhi ushqimi nga fshati. Dikush e solli ngarkuar në gomar, dikush në kalë, të tjerët me krahi e me kokë. Qamili ferkoi pëllëmbët e ashpra kur pa të shoqen që kapërceu jazin me një tepsi në kokë e me një bardhak në dorë. Tahiri, me qylafin mbi sy, kruante kokën e madhe dhe nuk e hiqte vështrimin e përgjumur nga shtëpitë e fshatit, që dukeshin rrëzë Gurit si ca kuti të bardha shkrepësesh. Një nga një u

shtruān tē gjithë nē lëndinë, nē një rreth, si nē një sofér tē stërmadhe. Përpara kishin bukën e misrit, qepët, gjizën, stomnat me ujë e bardhakët me dhallë dhe filluan tē hanë me uri, duke biseduar e duke këputur qyfyre. Erdhi edhe nëna e Skënderit dhe ia lëshoi téré lakrorin me presh e me kos, nē një peshtemall. Atij i erdhi rëndë dhe e ndau me shokët.

— Kështu mbaje ti, Zalovicë, kështu, me byrek!, — bëri shaka Qamili duke zgjatur pa teklif dorën drejt lakinorit që ishte ende i ngrohtë.

Dhe pas një heshtjeje tē vogël, ndërsa tē gjitha mbllaqiteshin e pinin ujë e dhallë, filloj një bisedë tjetër, nē fillim si me shaka, po që u acarua shumë më vonë, sa përkak desh i ndau njerëzit. Në këtë bisedë u futën edhe ca fshatarë tē tjerë, që punonin përtej lëndinave. Midis tyre ishte edhe Jaçja, me hostenin nē dorë, edhe Lamja. Dalngadalë si ndonjë qen i zgjebosur sallhanesh, u afrua edhe Nuri Zyberi dhe zuri një vend pak si larg, gati buzë hëndekut, po nga s'i shpëtonte asnjë fjalë.

E filloj muhabetin Qamili me një shaka që bëri me Mehmet mustaqeverdhin. Nuk e mori vesh njeri se q'tha, se ai e kishte gojën plot me bukë. Po Mehmeti, që ishte pranë tij, e kuptoi dhe u nxeh menjëherë.

— C'na thënke, more çalo! Ta bëj unë bukën dhe tē ma hajë qyteti! Ja! Hip këtu tē shohësh Stambollë!

— Stambollë ia trego sat shoqeje, dhe jo mua! — shfryu Qamili duke nxjerrë, së bashku me fjalët, thërrime tē verdha buke e fërshëllima tē mbytura — Po ti, si e bëke vetë këtë bukë? E pjellke? Apo ke ndonjë haznë zotrote?

— Kam, haznë kam!, — përsëriti kot Mehmeti duke fshirë mustaqet e mëdha me pëllëmbë!

— Morra ke ti dhe jo haznë!

Të gjithë ia plasën gazit pa tē keq.

Mehmeti rrahu gjoksin:

— Kam tokën unë. Tokën e kam haznë. Ajo ma jep bukën dhe gjithë tē tjerat. Këto duar m'i japid dhe s'i lë tē ma hanë tē tjerët!...

— Të hëngërt derri turinjtë! Po tokën ku e gjete? Mos e polle?, — e talli Qamili dhe, si ngriti bardhakun e vogël

që mbante midis këmbëve dhe që të gjithë e kujtonin se ishte me ujë, vazhdoi. — Ta dhanë tokën! Ta dha kush ta dha! Ta dha Partia. Kurse ti nuk shlyen një copkë grumbullim, po vete e më yshtesh me klapkat.

Mehmeti e pa vëngër, tërë inat, dhe i dha munxët:

— U hedh qurrat kulakëve unë dhe jo të yshtem!

Bëri të ngrihej, po Qamili e kapi nga bollkat dhe e uli përsëri. E ngriti edhe një herë bardhakun e vogël, u shëmtua në fytyrë dhe i tha:

— Dale, mos u nxeh, o Mehmet, se jemi kushërinj të një gjaku! Ti, tërë jetën obobo dhe olele ke lebetitur, të ka gérhitur mideja si daullkë e çjerrë. Shih si je, o Mehmet! Koskë e lëkurë. S'e marr vesh ku të qëndron shpirti në ato koklla! Të mos qenke Partia, e kishe ngrënë kullo-tën me kohë. Po, more kushëri, tokë të dhanë, një pendë që të dhanë, të dhanë dhi dhe ca hardhi pér pekmez e raki, — Qamili e ngriti edhe një herë bardhakun, — po ç'do më akoma, o kushëri? Hosten do? Se vetëm atë s'e ke marrë! Dhe ke gojë të flasësh! Lipsu, more, me gjithë ato që thua! Ke gojë të thuash: s'jap grumbullim, se më ësh-të mykur misri, se e kam bérë vetë, me djersën time e me klapkën që ke në bark! Lipsu, kushëri, lipsu! Farmak kishe bérë ti dhe jo këtë bukë, po të mos qe Partia! Po rri sus e mbyll gojën, se je burrë me mustaqe! Dhe do të bëje mirë t'i theshe sat shoqje të t'i priste me gérshërë e të të thurte një palë çorape të mira, se, shih si të kanë dalë patatet!

Gazi shpërtheu pérreth i shfrenuar, sidomos nga rinia. Me zor qeshte Lamja, kurse Kasemi ishte mbledhur lëmsh. Nuriu qeshte hidhur, atje, buzë hendekut, duke pirë duhan qetë, me sytë mbyllur, ngaqë ia vriste dielli.

— Me ty s'fjaloset dot njeri! Çaloja i djallit! Mos ke pirë? — dyshoi Mehmeti duke ia afruar hundën te goja. Pastaj u ngrit e bëri tutje.

— Ku vete, o Mete!, — qeshi me djallëzi Qamili dhe e ngriti edhe një herë bardhakun — Ke hyrë në bollkat e kulakëve, o kushëriziu! Hyrë, hyrë, po do të shoç si do të të pëlcasë tëmblit ty edhe fëmijëve! Rrëmbeu drunë klapkave, more! Bëjua kurrizin petë atyre që të yshtin kësh-

tu! Ty të nçoi Partia, more gérxho. Atë të dëgjosh, ti i pari, more zullumqar!

Qamili ngrinte bardhakun e vogël dhe nuk pushonte me ato fjalët pér të qeshur, por dhe të rënda sa nuk i ngrinte kandari. E shoqja, midis grave, zgjaste qafën e gjatë si të patës, tundte kokën dhe i bënte shenja me duar, po ai as që e vinte re fare.

Mehmeti rrithet kokën me llastikat e tij, shkundte ja-kën e xhaketës me dy gishta, siç bëjnë gratë e zemëruara, dhe i thërriste te veshi:

— Mua mos më mbaj llogo! Ta dish! Partinë e dua më shumë se ti! E kam dëgjuar dhe do ta dëgjoj tërë jetën e jetës, unë edhe fëmijët. Do t'ua lë amanet, brez pas brezi.. Po ty s'të dëgjoj...!

— Jo me fjalë, po me punë, o lumëmadh! Me fjalë, kllapkat thërrasin e brohorasin e duartrokasin më shumë se ti e se unë. Partia s'duhet me fjalë, që hyjnë nga një vesh e dalin nga tjetri. Partia s'duhet dëgjuar me veshë, po me zemër, me shpirt, o kushëri! T'u bënë fëmijët pér t'u martuar, e kaqkë gjë s'e ke kuptuar....

— E di vetë se ç'bëj! Aman, vetëm më lërë rehat, pa atë që duhet të jap, do ta jap! Vetëm ti mos më fol! E di unë ç'do Partia. Dhe atë që do, s'e bëj dysh. Që nesër.. që nesër... jo... më vdekshin fëmija!

Qamili e ngriti edhe një herë bardhakun. Sytë i shkël-qyen nga kënaqësia:

— Hak, kushëri! Mezi dëgjova prej teje një fjalë me mend! Të lumtë!

— Me këto të qeshura, me këto copa buke misri, presh, gjizë, stomna, bardhakë e bucela me ujë, me këtë shoqëri të re, që kishte thyer guaskën e fortë të vetëmisë sheku-llore, ata, fshatarët, megjithëse zahiretë që kishin pre-gatitur me shumë kujdes gjatë vjeshtës së fundit po u mba-roheshin, nuk e ndienin pothuaj fare varfërinë. Kishte ndonjë që një farë dyshimi pasigurie i endej në cepat e bù-zëve. Brazdave ishin ulur gargujt e pangopur e bisht-dredhur dhe sorrat e zeza e këndeskat laramane të kënetës, që pastronin çdo gjë të gjallë që dilte nga fundi i tokës

për të parë diellin. Si ngopeshin a si trembeshin nga ba-gëtia e fëmija, shpeshët grabitqare fluturonin e zhdukeshin në horizontin e pa fund të ujërave të fjetura, kurse shqetësimi, dyshimi e pasiguria mbeteshin të mbërthyera në ato cepat e buzëve të pérthara nga thëllimi i hershëm pranveror ose nga gjaku që, siç thonin pleqtë, hollohej e kullohej në fillim të stinës së re.

Kur të gjithë po qeshnin me lot në sy nga grindja e burrave, Qamili ngriti papritur bardhakun, e tundi si një shishe rakin dhe hodhi vështrimin rreth e rrrotull, sikur donte të kapte ndonjë egërsirë:

— Të gjeta, Jaçe! — thirri — bromp! — dhe, si e ngriti një dy a tri herë, ia zgjati bardhakun që gati ishte bosh.

Mehmeti ia bëri sikur zbuloi ndonjë të fshehtë të madhe:

— Po e dija unë që ky s'pinte ujë! Ky s'pi as raki. Ky pi mentdë! I ka fajet, ajo, Çalovica...

— Kujt ia bën, o dajë Qamil, këtë nder?! Kujt ia bën, o më të çaptë ujku!

— Atij që di të llomotitë mirë e bukur!...

— Atij që shtrihet si bullar plevicave me bar!

— Bromp, o Kuqo!, — thirri Qamili — Na bëj një urim dhe na mbaj një fjajm.

Gratë ia plasën gazit, aty mënjanë, burrave, mbledhur kokë më kokë, si dhentë kur mérzejnë. Qeshte nga e keqja edhe Çalovica dhe përsëri me vete: «I ziu ti! E pive të bëftë mirë! Po përsë më gënjeve? Përsë the që e deshe për Skënderin!... Të piftë bukla, o i zi! Sa i mirë je, aq i keq bëhesh!

Jaçja e shkundi bardhakun dhe e ktheu tërë gëzim edhe aji. Tha një shaka dhe e qeshura u përhap mbi lëndinë si zjarri kur bie te kashtoret, verës, në një ditë me erë.

— Tani pushoni, që të dëgjojmë!, — hyri pesë para në qese edhe Lamja.

— Pse? Për ku nxiton ti, o xhaxha? Hankoja është mësuar të të presë — i dha përgjigjen Qamili, pa e marrë vesh se kush e dha atë urdhër.

— Boll, bre! Kush i bën këto shaka?, — pyeti një tjetër me mbytka në fyt.

— Po ja, dajë Qamil, xha Lamja! Kasëmi me yll. Edhe ai, kushëri Tahiri...

— Çne, bre, unë. Ku kam folur unë!, — ia priti Tahiri, të cilit tanimë i kishte dalë gjumi krejt.

Kuqoja ia ktheu bardhakun të zotit dhe fshiu buzët.

— Ç'alamet burri! Vetëm qafa i nxjerr nja tri okë dhjamë... Si thua, o Mehmet, po ta shposh në zverk, a i vete gjaku gjer në hënë? — pyeti Qamili me sytë pakëz të trubulluar nga alkooli.

Fshatari mustaqemadh zjeu si brumbull:

— Unë s'e di, o kushëri! Në ta mban, matja vetë. Zh... zh... zh... ç... ç... ç... Kush të merr vesh ty!

Qamili s'i dha përgjigje, se nuk e dëgjoi dhe sepse atë çast filloj të flasë Jacja, duke shtrirë përpara të dy pëllëmbët e mëdha, sikur donte të përfshinte me to gazin e shfrenuar:

— E dini si është puna, more shokë. Më mirë le të dëgjojmë djalin e fshatit tonë. Ja tek e kini!, —dhe u drejtua i téri nga Skënderi, në fytyrën e të cilit qenë mbërthyer, si me gozhđë, gëzimi e hidhërimi së bashku.

Gazi u ndërpre, për çudi, menjëherë. Kështu pritet Cangonjarka e tërbuar, menjëherë, sikur s'ka ndodhur gjë prej gjëje. Të gjithë vështronin atë, djalin e porsaardhur, që s'i kishte hequr ende dekoratat nga gjoksi. Rasimeja e vështroi në xixë të syrit për një kohë të gjatë me një farë shqetësimi ronor, të ëmbël e të trubullt njëkohësisht. Po ai u ngrit më këmbë, i hedhur, i gjatë dhe i bukur, dhe as që e vështroi vajzën e hutuar! Të gjithëve, meqë ishin të ulur e meqë e vështronin nga poshtë lart, iu duk si një njeri i stërmadh, që kishte zënë një pjesë të mirë të qellit. Shuallin e çizmeve e kishte vërtet mbi lëndinë, aty pranë tyre, kurse koka mezi i dukej atje lart, mbështjellë me një kaltërsi verbuese.

— Ju falënderoj për tokën time, që ma punuat mirë e ma bëtë si bukëvale, — tha ai tepër i emocionuar, pa ditur se ku t'i vinte duart. — Ju falemnderit!... Ç't'ju them! Siç e dini, vij nga ushtria për të punuar së bashku me ju, — dhe fjala iu pre.

Duke pritur që ai të vazhdonte, Tahiri, siç ishte shtrirë, tha pa të keq:

— Mirë se na erdhe, po këtë e dimë, o djalë, që një javë më parë.

Mirëpo fjala e tij ose nuk u dëgjua, ose, dhe në u dëgjua, nuk bëri asnje përshtypje.

— Në ushtri, — vazhdoi Skënderi duke parë hijen e vet që ishte zgjatur përpara, gjer te grumbulli i grave, — kam qenë mirë, si në shtëpi. Kur ika nga fshati, aherë, në kohët e krismave, s'dija as shkrim, as këndim. Tani di. Kam shkruar edhe një letër — dhe e kërkoi nëpër xhepa.

Përsëri Tahiri, i shtrirë siç ishte, tha i përgjumur:

— Ashtu de! Të na mësosh edhe neve...

Qamili kishte përqëndruar tërë vëmendjen tek ushtaraku dhe, pas ditur se kush ndërhyri, ktheu kokën e trubulluar djathtas, andej nga erdhi zëri, e urdhëroi prerë:

— Na lini të dëgjojmë, se na plasët!

— Në fshat, — vazhdoi Skënderi, pa pyetur për ndërhyrjet e njërit e të tjetrit, po me zë më të sigurt, — t'ju them sinqerisht, nuk gjeta atë që shpresoja. Këtu s'ka rregull, s'ka kontroll. Kushdo bën më kokë të tij. Njëri shet kaun, po me se do të lërojë as që e çan kokën! — Vështrimi i tij u mbërthye te Lamja. Fshatari u mblodh, u bë sa një grusht, rënkoj dhe mallëkoj veten për atë që kishte bërë. — Një tjeter merret me treg të zi. Helbete, ky pushtet ia mbushi oborrin plot dhen e ai... — Ai nuk e gjeti dot Kasemin midis turmës, se fshatari si dëgjoi ç'u tha, u mbështoll kutullaç dhe u bë, edhe ai, sa një grusht, me duart mbi qeleshen me yll. — Njëri i bie gozhdës, tjetri potkoit. S'e merr vesh qeni të zonë. Pa ta vëmë një çikë gishtin në kokë: kujt i bëjmë dëm? — Ai heshti pak dhe përsëriti: — Kujt i bëjmë dëm?

S'pipëtiu asgjë. U dëgjua vetëm përgjigjja e têrthorë e Qamilit:

— Kllapkës!

— Jo!, — ngriti zërin Skënderi. — Dëm i bëjmë vetëm vetes. Po Partia nuk na mëson kështu. Partia na mëson që ta bëjmë jetën me luftë, të mirë e të lumtur. Po ne ç'bëj-

më?! (Ai donte tē thoshte: «po ju ç'bëni?! mirëpo e zbuti mendimin me qëllim). Pa tē mendojmë, nga na vijnë tē këqijat? Kush i ka fajet që s'na venë punët mirë?

Biseda kishte marrë rrugë. Njerëzit dëgjonin me vë-mendje e seriozë. S'kishte më puna për shaka e qyfyre. Bëhej fjalë për jetën, për atë që kishin jetuar, për atë që jetonin dhe për ato që do tē vinte. Pyetjet që bëri ai, i gozhduan njerëzit, sikur i mbërthyen në mur. Edhe Qamili u bë esëll, i doli rakia që kishte pirë me bardhak dhe ia nguli vështrimin filizave tē rinx tē barit, që kishin çatisur anës opingave tē tij.

— Kush i ka fajet?, — pyeti Skënderi, me vështrimin lart në qìll, sikur pyeste veten.

— Mbase Malka, mbase Lytoja, mbase tē gjithë ne — mezi u dëgjua Kasëmi i mbledhur shuk, atje, afër Nuriut, që pinte duhan e rrinte si ndonjë njeri i huaj.

— Ne s'kemi ndonjë faj! Ne punojmë! Ka tē tjerë që hanë në çairin tonë, — tha pa tē keq Tahiri, gjithnjë përmbyss e duke gogositur.

Dikush nga djemtë i shtrirri dorën te pulpa dhe ia shkuli qimet si tela, me inat.

— Hajvani! Dje tē linin pa hiç. Sot jemi vetë zotër!

— Mos më picko si riq, se më dhemb!, — tha Tahiri dhe u ngrit gjunjazi.

— Të merremi vesh, — vazhdoi Skënderi me zë më tē qetë, — kush thotë se punën tonë e gjëzojnë tē tjerët? Se hanë në çairin tonë? Njësoj éshtë! Tahir, ti thua?

Tahiri tha sinqerisht:

— Si urdhëron!

— S'éshtë e vërtetë. Punën tonë ne duhet ta gjëzojmë vetë, se s'kemi as bejlerë e as agallarë që tē na e rrëm-bejnë.

— Ashtu, o bir, ata u shuan. S'kemi vërtet. Po kemi ca urdhëresa, që po na i nxjerrin xhanë.

— Ai që foli, i vetmi fshatar barkmadh nga mëhallat e si-pérme, rrinte më bisht, i tulatur, si pulat në qymez.

— Xhaxha! Mos fol ashtu, xhaxha! — e këshilloi Tahiri duke kthyer nga ai qafën e trashë e kokën e madhe.

Skënderi nuk i kuptoi fare ata. Përkundrazi iu dhimb-
sen dhe shtoi me zë qetësues:

— Po mirë. Le t'i shohim edhe urdhëresat! Jemi që
jemi, le t'i shohim. Edhe ato njerëzit i bëjnë dhe njerëzit
nuk janë që të gjithë llagar.

Atë çast Nuri Zyberi hapi sytë dhe u kthye nga bash-
këfshatarët me tërë trupin, i vëmendshëm, si gjahtar i
regjur, duke thënë me vete:

«Ashtu de! Ashtu! Vëri flakën!»

Skënderi kishte marrë zjarr dhe s'përmbahej.

— Partia na do të mirën, neve, fshatarëve. Këtë e kemi
të qartë që të gjithë. Prandaj ajo na thotë që t'i shikojmë
mbarë e prapë vendimet e urdhëresat. Në qençin të drejta,
t'i zbatojmë. Në qençin të gabuara, t'i hedhim tej. Në qen-
çin të ngatërruara, të kërkojmë që të na i shpjegojnë. Të
na e shpjegojnë edhe urdhëresën e grumbullimit, edhe të
këmbimit, edhe të mishit, edhe pse u hoqën triskat e ush-
qimit e të veshmbathjes, edhe përsë nuk po e shlyejmë dot
detyrimin.

— Ato urdhëresa janë të gjitha gabim, — tha Tahirri
dhe, për çudi të të gjithëve, u ngrit më këmbë, si ndonjë
ari.

— Në mos qofshin të gjitha, ka ndonjë me gabime! —
tha Lamja me gjysmë zëri.

— Patjetër që ka! — ngriti zërin Kasemi dhe iu zu fjala
në grykë kur pa gjithë ata njerëz, që e vështronin si me
inat.

— Mirë, mirë, — thoshte me butësi Skënderi. — Ta
marrim shtruar. Ti, xha Lame, përsë nuk e shlyen dety-
rimin? Unë, me mendtë e mia, ta di hallin, po dua të
bindem edhe nga fjalët e tua.

Lamja u ngrit me fije bari të thatë e me rrodhe midis
të qepurave. Tha me sinqeritet:

— M'u myk misri që kur e korra. M'u hidhërua. Ma
zu shiu përjashta, m'u bë valë, dhe gjersa e futa brenda
m'u ndez. Mos paça sytë e ballit! Mos paça fëmijët! Ia ho-
dha lopës, as ajo s'e vuri në gojë. Vetë i kam fajet. Po sa
para bën, shita kaun...

Fshatari i kishte sytë me lot. Skënderi e vuri re, u maliengjye dhe iu kthye xhaxhait të Tahirit, atij barkmadhit:

— Po ti, ç'hall ke?

Fshatari hoqi kapën nga koka dhe me vështrimin në qielj tha:

— Unë... nga e keqja... po ha farën. Ja, tokën e punova, po s'kam me se ta mbjell. S'kam as me se të paguaj mishin...

— Po ti, o xha Kasëm?

— Unë nuk jam keq, po edhe mirë s'jam...

— Xha Kasëm, — e ndérpree Skënderi, — oborrin e kishe, mashallah, plot me dhen...

— E, e, o të keqen. Po kam gjashtë dhëndurë. Nga një secilit, marrin fund ato të shkreta...

— Po ti, o Tahir?

U ngrit më këmbë, si arushë edhe Tahiri:

— Unë, duart e hostenin kam. Ja, pyesni xhaxhanë. Në hambarin tim bie miu e thyen kokën.

— Po ti?... Po ti?... Po ti?..., — pyeste Skënderi i trubulluar dhe, më në fund, gishti i mbeti te Nuriu. Ky, me kokën poshtë, i mallëngjyer, me një qëndrim që të këpuste shpirtin, i tha...

— Po ti e pe xhaxha Nurinë, o bir, si u kthye bosh nga pazari! Pata edhe një fatkeqësi: Ma prishën misrin në arë. Pata edhe një fatkeqësi tjetër: ma kalbi bryma bereqetin. Këto ditë po ha farën! Ti e njeh Nurinë, përsë e pyet?

Ai bërkmadhi i lagjes së sipërme, dha e mori me Tahirin, që s'i bindej, edhe më në fund, thirri në rrëmujë e sipër, duke i ngaterruar fjalët:

— Ato janë gabim... Urdhëresat, domethënë!...

— Prit, se nuk e ke mirë!

— Ti kuptoje vetë më parë, ç'është kjo bombë që hedh!

— Gabim janë! Se na kërkojnë mish edhe neve, që s'kemi...

— Duhen urdhëresa të tjera. Këto që kanë dalë, të hiqen!

U ngritën të gjithë më këmbë. Gratë dhe vajzat mblidh-dhnin shpejt e shpejt mbeturinat e ushqimeve nëpër pe-

shtamallet. Ngritën edhe bucelat e stomnat e ujit. Qamili ia rrëmbeu së shoqes bardhakun.

— Ditézi, o ditézi! U dehe!, — i tha ajo me dhembje të madhe, por pa e treguar veten. E bija, Rasimeja, me faqet flakë nga ato që kishte dëgjuar, me krahët zgjatur anash, mbi supet e dy bashkëfshatarëve moshatarë, thoshte e zemëruar:

— Lytoja e Malka kurrë nuk i kanë rrëzuar urdhëresat e qeverisë. Ato janë të drejta dhe s'ka pse na vjen një ushtar i ditur shumë e na i hedh poshtë. Kurrë mos i pël-qefshin atij! Aq na bën, neve, të rinjve!

Shoqet e nduknin nga tutat, i luteshin të mos e zgjaste, po ajo, si për inat, ngrinte zërin më lart:

— Le të vijë këtu kush të dojë! Mos flisni kështu, se na loni themelet! Fol, o baba. Ku je? — Ajo hodhi sytë rreth e rrrotull për të parë të atin. Tahiri, duke lëvizur ngadalë, shkundi fundin e bollkave e tha:

— Po kur na doli kjo çupërlinë, bre?

Se kush ia preu fjalën:

— Çupërlinë, po ka mend më shumë se ti! Të gjitha c'hotë ajo janë të drejta. Kurse ti i bën hije xhaxhait.

Rasimeja nuk u bindej shoqeve. Thërriste të anë me emër. Po ai se ç'i thoshte Nuriut, që pinte duhan qetë dhe e nxirrte nga hundët shtullinga-shtullinga. Tahiri e humbi toruan, kruante kokën dhe përpiqej të ruhej nga hosteni i xhaxhait që i ngulej tërë inat në pulpat e këmbëve. Lamja ishte mbështjellë në lekkat e veta si ndonjë gogozhel. Jaçja i thoshte me kërcënim Kasëmit: «Mos na lër në battë!» Kurse Skënderi e kishte humbur krejt toruan. Burrat u mblohdhën më në fund te qetë. I mbrehën duke folur me zë të lartë duke mos u marrë vesh me njëri-tjetrin. Dëgjoheshin në atë zallahi veç dy fjalë: «Të drejta!» «Gabim!». Qamili dëgjoi thirrjen e së bijës dhe i hipi gjaku në kokë. Mezi i mbrehu qetë dhe doli para tyre. Thirri sa kishte në kokë:

— E ku ju shpie mushka, more! Po me se do të rrojnë punëtorët në qytet? Mishin e njëri-tjetrit do të hanë?

— Drejt, dajë Qamil! Drejt, — thirrën njëzëri të rinjtë.

Qetë ngritën kryet lart, dhe Qamili, i kapur fort pas
brirëve, e ndjeu veten në ajër, pa mbështetje.

— Zbrit, o çalo, se do të thyesh edhe këmbën tjetër!,
— i tha pa të keq njëri nga fshatarët.

Qamili mbahej fort pas brirëve e thërriste:

— Copë të bëhen këmbët e mia. Po ju e keni gabim.
E keni gabim, se dëgjoni kllapkën! Poshtë kllapka! Poshtë!

Jacja e përfshiu nga këmbët dhe e vuri në tokë, duke
qeshur:

— Boll, o Qamil!, — i tha. — Të mori e mira! Nga gajase!
Po si njeri, ama, s'di të flasësh. Vetëm për sherr e qyfyre
je. Përse nuk e lë të flasë? Vjen nga ushtria, me katër
dekorata! Turp të kesh, bre!

U bë një zallahi tjetër përpara se t'i ngisnin qetë. Nu-
riu vështronte me kënaqësi fshatarët, që grindeshin me
njëri-tjetrin. Lutej me vete që të rrëmbejn hostenët e të
hanin kokën e njëri-tjetrit dhe thellë në shpirt e ndiente se
kjo farë e përcarjes dhe e sherrit ishte e vetja edhe e miqve
të tij. Kur Jacja e ngriti Qamilin hopa, si ndonjë kalama, i
hodhi një vështrim të shpejtë e tha me vete: «Mbyte, bre,
atë çalaman të pëgërë! Mbyte! Fryji, more derr, zjarrit,
fryji, se po u ndez mirë, as Devolli, as tërë përrenjtë e as
këneta nuk do ta shuajnë dot!»

— E sheh c'bëhet? E sheh?, — i thoshte Jacja Skënderit
kur vunë qetë përpara dhe, si kapërcyen lëndinat, i futën
në arën e palëruar. — Si ta quajmë këtë? C'emër t'i vëmë?

Skënderi ishte shumë i hutuar dhe nuk fliste. Kur qetë
u vunë secili në brazdën e vet dhe fëmijët, ngarkuar me
trasta, morën rrugën e fshatit, sekush tha përsëri me zemë-
rim të papërbajtur:

— Fajtorët i kemi këtu. Fajtorë janë Malka e Lytojam...

— Ata i kanë fajet, ata, edhe Jacja. Po ku janë? Po vërtet,
ku janë, që s'u dukën sot fare?

— Bredhin në qytet. Mirë e kanë ata. Përse të mos bres-
dhin? Helbete një kërrnackë, një birrë, një kafe! Bir o bir,
qejf që bëjnë dynjaja!

— Daleni, more, se na lojtët nga mendtë. Jazék kur flis-
ni kështu pér shokët e luftës. Ata s'kanë asnje faj. Fajet i
kanë kulakët! — tha me zemërim babai i një dëshmori.

Qamili e ndiente kokën të rënduar nga rakia dhe i pi-hej ujë. Po mendjen e kishte më të.

— Mos i shani djemtë, edepsëzë! Ata kanë shkuar në qytet për të ndrequr prapësitë tonë. Ç'hyjnë ata në këtë mes? Fajet i kanë klapkat, domethënë kulakët. Ah! Ç'gabim kemi bërë në kohën e luftës?! Kuku, moj nënë! Ne i kemi fajet, që dëgjojmë kulakët dhe këlyshët e tyre! Kuku, moj nënë, ç'gabim kemi bërë!

Ai që vinte pas tij, fshatari i heshtur, që i kishte falur luftës një djalë, e merrte me të mirë:

— Drejt e ke, drejt! Edhe fjalën, edhe brazdën! Ashtu mbaje!

Qamili ktheu kokën, e pa me sy gati të përlotur:

— Ti Haziz, je? Të lumtë, o Haziz!

— Kulakët na i kanë fajet!

— Edhe ne vetë kemi faj, o Haziz!

Si punuan nja dy orë, i çmprehën qetë përfundimisht. Megjithëse po vinte pranvera, prapëserapë dita qe e shkurtër dhe mbrëmja gjithashtu. U grumbulluan përsëri te lëndina, kur zogjtë fluturonin drejt foleve. Aty Skënderi, si veshi xhaketën ku tringëllinin dekoratat, u tha me zë të butë e miqësor:

— Unë tani mund të them se i kuptova mirë punët tonë. Prandaj i shkrova edhe një letër shokut Enver, në Tirana. Ia nisa që në mëngjes me kaçiatorin. I shkrova thjesht për të gjitha sa pashë e sa dëgjova, e si ma mori mendja. Po të kemi gabime, ai do të na i thotë dhe ne do t'i ndreqim, se, edhe shumë s'na e pret, prandaj bëjmë gabime! Po Partia, ama, s'gabon! Përse e kemi Komandantin tonë të dashur? Ç'të na thotë, do të bëjmë, se është për të mirën tonë, për socializmin... Dhe shkaktarët e kësaj rrëmuje do t'i zbulojmë, si një e një bëjnë dy, dhe do të dimë si t'i dënojmë...

Më në fund ai nxori nga xhepi kopjen e letrës dhe e lexoi me zë të lartë, pa asnjë gabim, se gati e kishte mësuar përmendsh. Fshatarët e dëgjuan me vëmendje e në heshtje të plotë. Kur e mbaroi, Qamili iu derdh në qafë:

— O Keno, o bir. S'ke qullo sur gjë!

Skënderi nuk ia dëgjoi fjalët me vëmendje, se e mori për të dehur. Qamili s'ia hiqte buzët nga faqet:

— Pse, o xhan i daiut, e bëre këtë? Pse s'na pyete ne, të varfrit? Bie erë klapkë letra jote, Keno! Dëgjo dajë Qamilin ti, erë klapkë bie. Erë kulaku. Përse e bëre? Ç'të shtyri?...

Qamili fliste pakëz si përcart, si çdo i dehur, dhe Skënderi e mori me të mirë, për ta zbutur.

— Mirë të thotë Qamili, more djalë. Mos e merr për të dehur. Ai ka pirë rakinë, po jo mendjen. Dhe mos e harro atë fjalën e pleqve: Uji fle, hasmi s'fle! Po ishallah e të vjen ndonjë përgjigje e mirë! Ishallah!, — tha Hazizi duke i vënë qetë përpara me plugun pér së prapi mbi zgjedhë.

Qamili shkundi bardhakun me raki mbi flokët e tij të shkurtër e të dredhur dhe filloj të kërkojë shkrepsen në xhepat e jelekut.

Njerëzit filluan të iknin. Iku Kasëmi me një peshë të rëndë në shpirt. Lamja fshiu syrin tërë sklepa, ngriti jakën e setrës dhe u bë firar. Ca të tjerë i thanë të shkruante ç'të donte dhe, si e përhëndetën, sa të hapësh e të myllësh sytë, u zhdukën drizave. Iku edhe ai barkmadhi i lagjes së sipërme me qetë e me Tahirin, që mezi hidhte panxhat e fryra e tërë qime të gjata e të forta. Tahiri e përaqfoi Skënderin, i uroi natën e mirë dhe i kërkoi të falur pér atë brazdë që e kishte lëruar shkel e shko.

— Ç'ke ti! — i tha, — vjen nesër vëllai me shatë dhe ta rregullon... E di si është puna, o byrazer? Ky xhaxhai im s'është më të fare! Është një...! Ç'të të them! Po, nejse, ishallah gdhihem shëndoshë, pa do të vijë edhe dita ime!

Iku edhe Nuriu pa thënë gjë. Atë këshilli s'e kishte futur në skuadrat e ndihmës reciproke. Qe i gjëzuar që s'e kishin begenisur! E kishin lénë të punonte fill i vetëm. E kishin lénë që edhe të vdiste ashtu. Askush nuk e qaste pranë, sikur të kishte zgjebën. Vetëm, nga e keqja, kur bë-heshin mbledhje pune, e thërrisin. Ai e peshonte. Kur kishte interes, shkonte, kur e shihte që do t'i dilte huq, bëhej i sëmurë. Po, ama, pér mbledhjet e frontit e merrte malli. Mirëpo ia kishin hequr triskën. Atje s'puthte, me-

gjithëse kishte njerëz që thoshin se të gjitha masat ndaj tij ishin të kota, të pabazuara, bile edhe armiqësore.

— Xha Nuriu po të përshëndet, — i tha Jaçja duke ia treguar me xhelugën e zgjedhës në dorë.

Kulaku ishte larg, matanë lëndinave. Qetë i kishte lëshuar në tragë, kurse vetë po shkrepte masatin.

— Natën e mirë!, — ia ktheu përshëndetjen Skënderi dhe i erdhi keq për atë njeri që jetonte ashtu i veçuar, i braktisur nga bota.

Nuriu e përshëndeti edhe njëherë me dorë, pastaj ndezzi me eshkë cigaren dhe, duke buzëqeshur hidhur, eci pas qeve, me një hap shumë të rëndë e pakëz i kërrusur përpara.

Dielli po kaptonte brigjet e Pиргут. Tufat e rosave e të patave dilnin vargan-vargan nga Çërrava dhe binin si popla thellë kënetës. Çurrkat e shpejta, fluturonin shumë lart, me një fluturim të çmendur dhe kushedi se kur ktheheshin përtë kaluar natën. Tufa e vetme e pelikanëve të bardhë e të mëdhenj si desh, e trembur nga një krismë çifteje, rrahu krahët në mes të gjolit, që ishte kthyer tanimë në një si hauz të madh, dhe fluturoi drejt diellit. E ndiqnin nga pas zogjtë e vegjël sqepgjatë, që porsa kishin mësuar të fluturonin. Kështu ikin gjithnjë shpendët e rrallë e të bukur, drejt diellit, kur shpërthejnë krismat e çifteve pa asnjë kontroll.

Skënderi i pa shpendët e mëdhenj që i flutruan mbi kokë, ndjeu fëshfëritjen e krahëve të tyre dhe e mori me mend se ata dikush i kishte qëlluar keq, në befasi.

— Epo, ika unë, — i tha Jaçja kur i bëri qetë gati. Ai e kuptoi që shoku i tij ishte disi i pezmatuar e në hall. — Sidoqoftë nuk dole keq! U dhe një mësim të mirë! E pe ç'drengër janë? Ec e llafosu me ta! Të kam thënë: Të gjitha të këqijat na vijnë nga i dreq Malkë. E dëgjove ç'thanë përtë? Kanë të drejtë, se ti nuk e di, po, ai, vjet në këtë kohë, i shkoi në dru fshatarët e vet! Në dru, o, në dru! E përse? Se s'kishin me se ta lanin grumbullimin.

Jaçja vuri qetë përpëra, i tha që të takoheshin në mbrëmje e t'i bënин një vizitë Nuriut, a Qamilit, a Kasëmit

(ku të donte ai) dhe, i mbuluar nga tymi i duhanit të thatë, mori rrugën andej nga u zhduk kulaku.

Qamili nuk i rregullonte dot qetë. S'i bënин as duart e as këmbët. Nuk shihte dhe mirë. Qe mpirë pothuaj krejt nga alkooli që e kishte hedhur fshehurazi, sikur pinte ujë. Te jazi e priste e shoqja, e shqetësuar në kulgë. Qëndronte me stomnën në dorë dhe ashtu, pa lëvizur, dukej si një selvi, e hollë, e gjatë dhe tërë nur. Rasimeja që nga lëndinat i bënte s'ëmës me dorë shenja që të largohej. Nëna e kuptonte e megjithatë nuk luante nga vendi. Kishte ngrirë atje, buzë jazit, si një selvi.

— Hë, baba! I çmbrehe qetë? Do të ikim?

— Ikim, ikim, — mërmëriti Qamili pa ditur se ku ishte. E kishte zënë më në fund rakia. Ia kishte shtrënguar trurin e këmbët dhe nuk e linte të bënte asnë hap.

Vajza i liroi qetë, dhe ata, sikur t'u kishin folur në gjuhën e tyre, u capitën drejt fshatit. Pastaj iu kthyte Skënderit, që kishte humbur pas fluturimit të nositëve.

— Ti ke qenë në ushtri, po punët tonë ende nuk i di mirë, — i tha me një farë mospërfilljeje. — Ka dhe të tjerë që kthehen nga shërbimi ushtarak, po ata kuptojnë më shumë se ti. Na fut kot në telash!... Hë, o baba, do të ikim apo jo? E sheh ku na pret nëna? Buzë jazit. Ikim se na zu nata!

Skënderi e ndjeu veten të fyer.

— Ato që thua janë gjepura. Ti, moj vajzë, s'kupton asgjë nga kjo botë!

— Erdhe ti të na ndritësh! Lëre, ç'dritë po na lëshon!

Ai ndjeu se fjalët e saj ishin të hidhura helm dhe u trubullua shumë.

— Mos u nxeh!, — ia priti Rasimeja. — Ti s'i kupton as kaqkë punët e kulakut. Në fund të fundit, si ta bëri zemra të dëgjosh ato fjalë të ndyra për Malkën e për Lyton? Për shokët e tu? Kështu qenkan shokët?... Hë, more baba, a do të ikim?

— Ja dhe pak! Edhe pak!, — përsëriti Qamili dhe u ngrit!

Skënderi u foli qeve dhe iu kthyte vajzës:

— Dëgjo këtu, — i tha me një farë nervozizmi. — Unë kam parë vajza sa të duash, në tërë Shqipërinë. Po ty s'të bie të më mësosh. E di vetë se ç'bëj.

— Ti mund të shohësh vajzat e gjithë botës, po unë po të them se ti po na prish punë!.. Asnjë nga të rintjtë s'është me ty. Asnjë! Vëç ndonjë bir kulaku!...

Ai tha me kokëfortësi:

— Mos më mëso mua! Jam anëtar partie!

— Qofsh shëndoshë! Edhe unë diçka jam në këtë fshat!

— Fëmijë! Çupkë e vogël! Të ushqen nëna me qumësh! C'fluturon hahet për ty!, — dërdëllisi ai pa hesap dhe pa i peshuar fjalët fare. Ishte zgjuar, në të ai shpirti i keq she-kullor i supremacisë së mashkullit ndaj femrës dhe përpiquej me të gjitha mënyrat që ta provonte këtë.

Po ajo i tha, më në fund, me përbuzje:

— Ti ke vetëm fjalë dhe asgjë tjetër.

Po të mos u qe afruar Qamili, nuk mund ta dijë njeri se ku do të arrinin të rintjtë zemërakë e të panënshtuar. Ishin zemëruar keq me njëri-tjetrin dhe tani, duke u kujdesur për të pirin e duke ecur së bashku me të, që të dy mendonin se e kishin shkelur. Ajo ia hidhte sytë e mëdhenj e të mençëm, si ndonjë shqerrë dhe dukej sheshit se i kërkonte të falur. Ai shikonte herë nga fshati dhe herë gjizmet, po i ndiente vështrimet e saj lutëse. Do të kishin këmbyer mbasë edhe disa fjalë po të mos qe Qamili midis tyre, që e hijte këmbën e gjymtë fare zvarre. Në një çast, kur po i afroheshin jazit ku priste gruaja, ai u bë pishman për të gjitha dhe deshi t'i kërkojë të falur. Po tamam në atë çast Qamili erdhi në vete. Ia rrëmbeu së bijës bardhakun, e shkundi mbi flokë edhe një herë dhe, papritur, ndezi shkrepson. Ajo që ndodhi e llahtarisi Skënderin. Flaka mbuloi gjithë kafkën e Qamilit. Lart ishte e verdhë, kurse pranë flokëve bëhej blu e çelur. Skënderi thërriste i tmerruar. Vajza qeshte. Qamili bënte sikur derdhët lot me duart në faqe:

— Oi, oi! Ç'na gjeti! Na përvëloji kulaku! Na përvëloji, o Skënder!... Po mirë na e bën, se fajet i kemi vetë! S'ju vumë kllapkën në vesh kur duhej, tani na e vënë ata! Oi, ai! o Skënder, o bir!

Djali s'dinte ç'të bënte. Rasimeja queshte. S'ishte hera e parë që i ati i vinte shkrepsen flokëve të lagur me raki të fortë. Ajo qe mësur. Kurse ai lebetitej!

— O, ç'na gjeti! O ç'na gjeti, moj Rasime! Moj Rasi-me!

Më në fund «selvia» u shkëput nga vendi dhe vrapiçi drejt tyre. Në rrugë e sipër zgjidhi peshtemallin dhe ia hodhi të shoqit mbi krye. Flaka u shua menjëherë. Qamili u bë esëll fare.

— E, more djalë i Zalos, si të duket?! Je zverdhur, o të keqen! Po dëgjo çalon ti! Kulakut, matrapazit, spekulantit, hajdutit, shpifarakut, borgjezit, kurrë mos u zërë besë. Të tërë janë armiq!

Skënderi s'po merrte vesh ç'bëhej. Rasimeja queshte me zë të lartë. Nëna ia hoqi peshtemallin nga koka të shoqit e i tha me të butë e me të qeshur:

— I ziu ti, o burrë!

3.

Të nesërmen, në tërë fshatin rrëzë Gurit të Bardhë si piramidë dhe në tërë fushën pa anë e pa fund, që dukej nga parcelat e lëruara si e veshur me copa të kadifenjta, ndoshët edhe përtej Cangonjit, në fshatrat e Devollit të vogël, ku merrnin e jepnin nuse për të forcuar miqësinë, ziente biseda për ato që ngjanë në fushë.

Skënderi nuk e veshi atë ditë xhaketën ushtarake, zbukuruar me dekorata. Ishte shumë i pezmatuar dhe i tronditur dhe, në vend të saj, veshi xhaketën prej shajaku të të atit, që i rrinte tamam pas trupit, sikur ta kishte prerë me porosi. Sytë, të lodhur nga pagjumësia, i shkëlqen si në ethe dhe e ëma u bë përsëri merak kur i biri nuk e mbaroi gjellën. Duke mbjellë në kopsht farën e specave e të domateve, ai mendonte se, padashur, kishte bërë një punë të shpejtuar e të papëlqyer. Kishte mbjellë dyshimin kundrejt urdhërave të qeverisë! Edhe kur lehën qentë e u zunë me njëri-tjetrin përtej vijës së ujit, ai mendoi se kishte shkaktuar grindje e përçarja.

Kur doli dielli dhe i ra drejt e në sy, e ndjeu veten se nuk ishte fare në të. Kishte qef të ishte vetëm, të strukej në ndonjë qoshe të errët e të qetë, po s'e linte rehat as eëma, as pulat e bezdishme, as bletët, që vërvshënonin pas ushqimit, as ajo zhurma e lehtë e vijës së ujit, që rridhete para shtëpisë. Donte të ishte fill i vetëm dhe duke u përqëndruar në mendimet të gjente arsyet e gjithë atij shqetësimi të madh. E dinte se, në atë luftë të madhe për bukën e popullit, nuk ishte vetëm. Nga gazetat merrte vesh se tërë njerëzit ishin ngritur më këmbë, fshatrave e qyteteve. Bëhej luftë e madhe edhe për një çyrek bukë, edhe për një kafshatë, edhe për një kokërr grurë, misër a elb. E ndiente se kjo ishte një luftë e rëndë dhe, tek rrinte e vështronë cepin e mbjellë të kopshtit, thoshte me vete: «kjo është lufta më e rëndë, më e vështirë! Lufta për bukën!...» Dhe e përfytyroi veten, dhe fshatin dhe qytetin pa bukë. Iu bë një lëmsh në shpirt kur i dolën në parafytyrim fëmijët e uritur, që sulmonin me trimëri furrat, rrëmbenin bukët dhe diku, prapa ferrave, i kafshonin si të tèrbuar dhe i gëlltinin koret me dy-tre të mbllaçitura.

— Buka të fut në dhe të gjallë, — mërmëriti dhe pa kopshtin pjellor, ku qenë harlisur filizat e rinj, dhe në sytë e tij shkëlqeu një fije gezimi. Po përnjëherësh iu kujtua gjithë dita e kaluar, me tërë hollësitë, dhe u hidhërua sikur të kishte pirë ndonjë helm nepërke kur mendoi se ç'kishte bërë. Iu duk sikur i rëndoi mbi supe trefishi i viteve që kishte. E ndjeu veten si një plak të drobitur, megjithëse ende ishte larg të tridhjetave. Iu duk fshati i madh tepër i madh, sa ai s'ia dilte dot fill i vetëm, siç kishte mbetur. Me një lëmsh në fyt e në tru u ngrit për të marrë zgjedhën, po e ndalën të lehurat e qenve matanë çakellit. Lehnin qentë sikur të kishin rënë në lepur. Ata kaluan duke gulçuar përpara shtëpisë, gjithnjë duke lehur dhe e ndalën vrapin te shtëpia e Qamilit, që ishte aty pranë, nën pillatin me katër sylynjarë. Atëherë iu kujtua biseda me Rasimenë, me babanë e nënën e saj dhe ndjeu neveri nga vetja.

Në drekëherë, dy fshatarë se ku ishin rrumbullosur me raki dhe thërrisin si tellallë përpara dyqanit:

— A e more vesh, o fshat! S'ka më grumbullim. Ur-dhëresat u hoqën!

Ky lajm kishte zier tërë mëngjesin dhe atë ditë askush nuk shkoi për të dorëzuar drithë në depot e grumbullimit, bile as nga ata që kishin premtuar. Njëri, bile, që e kishte ngarkuar gomarin, me të dëgjuar këtë lajm, u kthyen menjëherë në shtëpi. Një tjetër i grahu kafshët nga udha e pazari dhe vendosi aty për aty ta shesë drithin në qytet, në tregun e zi.

Të dehurit nuk pushuan së llomotituri gjer më të perënduar të diellit. Kur erdhën Malka e Lytoja, i gjetën ulur mbi çakëll duke thirrur e duke kënduar.

— C'jeni bërë kështu, more hajvanë, — i qortoi Lytoja.
— Po a pihet, bre, në mes të ditës e në valën e punës? Pastaj, c'janë ato parulla që hidhni? Kush u tha që s'ka grumbullim?

— Unë them. S'ka dhe mbaroi, — u mburr njëri nga të dehurit.

Malka hapi sytë katër dhe i foli ashpër:

— Mos fol përqart, pijanec! Më flet si kulak!

— Po s'ka, bre Malkë, s'ka! Kështu thonë të tërë. Është bërë një si mbledhje dje, atje te lëndinat. Skënderi i ka dërguar edhe një letër Komitetit Qendror! Më plaçin sytë në gënjej! Vetë ai i ka quajtur të padrejta urdhëresat...

Të dehurit flisnin përnjëherësh, me një të qeshur të mpirë dhe bënин be e rufe se ato që thoshin ishin të vërteta e aspak shpifje.

Malka u zemërua shumë dhe u shfryu:

— Pa zbrisni njëherë nga çakëlli! Ashtu! Tani drejt e në shtëpi, se jeni bërë gazi i botës! Horra! Turp të keni!, — dhe i vuri përrpara.

Të dehurit, zënë krahëqafë, ia thirrën këngës dhe larguan duke i hedhur këmbët sa andej këtej.

— C'havaze dalin në një ditë! Pak telashe kishim, edhe kjo na duhej!, — tha Malka i zymtë. Mezi e përbante vreten dhe, kur hynë në zyrë, i ra tryezës me grusht: — Ti më thua jemi katër komunistë dhe punët do të na shkojnë më mirë. Thuaj tre, se Kuqon unë nuk e numëroj. Kjo është puna e tij! S'e marr vesh, përsë e mbajmë në orga-

nizatë! Duhet ta shtrojmë çështjen e tij në qarkor dhe ta hedhim jashtë. Edhe Skënderi duhet përvëluar për këto që ka bërë...

Lytoja dëgjonte i qetë:

— Mos u nxeh! Me të nxehur s'bëhet gjë, — e këshilloi.

Atë çast në derë u duk fytyra tërë krundë e Jaçes. Pas tij hyri Skënderi. U përshëndetën, u ulën rrëth tryezës dhe biseda u ndez që në fillim.

— S'e kuptoj përsë e bëtë atë mbledhje dje, — tha Lytoja shtruar.

— Çfarë mbledhje! Kush u tha që bëmë mbledhje? Muhabet bëmë gjatë pushimit, si gjithnjë, duke ngrënë bukë. Punët e fshatit biseduam, — e ndërpreu Skënderi i pakënaqur që biseda mori atë rrugë që në fillim.

— Mirë bëtë, po puna është se ti ende nuk e di mirë politikën e Partisë në fshat. Juve, anëtarë partie, në një mënyrë a në tjetrën, keni dënuar urdhëresat e qeverisë, gjersa thërrasin tellallët në mes të ditës: «S'ka grumbullim», e gjersa fshatarët i ktheyen kafshët e ngarkuara me drithë në shtëpi ose morën qytetin për t'i shitur në treg të zi. Kësaj i thonë, o shok, të ndihmosh kulakët.

— Kulakët?! Ti thua se unë ndihmoj kulakët?, — e ndërpreu i nxehur Skënderi. — A, të lutem! Peshoi fjalët para se t'i thuash! Po këto ç'janë, shoku Lyto? — Ai nxori gjoksin përpara për të treguar dekoratat, po u kujtua që kishte veshur xhaketën e të atit. — Ti m'i ke parë. S'm'i kanë dhënë kot, për sytë e bukur. Kam luftuar për Partinë, pa m'i kanë dhënë. Dhe ti thua se u ndihmoj kulakëve! Po fajet i keni ju, ju të dy në radhë të parë, që i keni lënë punët plloçkë. U kam thënë se misri shitet shtatë e tetë mijë lekë kuintali? U kam thënë se Lamja shiti kaun e vetëm? Po a e dini se ka fshatarë që po hanë farën, kurse ne u kërkojmë detyrimet e tepricat? A mund të punohet kështu? Jo. Kështu s'punohet. Prandaj u detyrova t'i shkruaj Komendant...

— Mirë bëre që i shkrojte. S'të them për këtë, megjithëse nuk do të ishte keq të ishe këshilluar edhe me ne njëherë, shokë jemi...

— E bëra unë tani... Mirë, keq, e bëra... Por, po të ishte punuar me mend, nuk do të shkonin punët kaq keq...

— Mos dëgjo kulakët, Skënder! Se ata në një vrimë i bien fyellit, — ia preu Malka, i nxirë në fytyrë, ca nga të ftohtit dhe ca nga inati. Kafshonte thonjtë duke vështruar Jaçen me bisht të syrit, sikur do ta hante. Po Jaçja pinte duhan, nuk fliste dhe, për çudi, dukej më i qetë nga të tjerët.

Skënderi e ndjeu vëten të fyer, po dhe të tronditur. Iu kthyte Malkës me nervozizëm:

— Unë s'i dëgjoj dhe s'kam për t'i dëgjuar kurrë kulakët! Mos flisni në erë!...

— Ti kujton se ua ke mbyllur derën, po ata të kanë hyrë nga dritaret, — ia hodhi Malka.

— More shokë, po si nuk e kuptioni, që unë, edhe kështu, pa romuzet tuaja, jam shumë i shqetësuar...

— T'i lëmë këto, — tha Lytoja duke ulur zérin...

— Si t'i lëmë! Qyteti është në krizë. Do bukë. Shitet 40 lekë kiloja e preshit, për turp, kurse ne, — Malka bëri një shenjë pakënaqësie me dorë.

— Dua të them, — vazhdoi Lytoja mendimin e vet, po me atë zë të qetë, — se, po të vazhdojmë kështu, duke thirrur, s'kemi për të zgjidhur gjë. Ta marrim shtruar. Ti, Skënder, lexoje me kujdes këtë gazetë. Aty është botuar urdhëresa që ndalon shitjen e lirë të tepricave të dridhit, pa u plotësuar grumbullimi. Me të, kulakëve e matrapazëve do t'u futen të dy këmbët në një këpucë. Duhet t'ua shpjegojmë mirë fshatarëve. Po kjo s'është e lehtë. Më parë duhet ta kemi vetë të qartë.

Skënderi e lexoi materialin në heshtje dhe e la në cep të tryezës.

— Kjo është një pengesë për tregun e zi, — tha. — Po vetëm kjo s'mjafton...

— Sigurisht, — e ndërpreu Lytoja.

— Përsëri urdhëresa?!, — pyeti Jaçja duke i hedhur një sy gazetës. — S'e marr vesh këtë punë! — tha dhe u zhyt në lexim.

Lytoja i hodhi dorën në qafë Skënderit dhe i tha se

ata, si komunistë, e kishin më keq se të gjithë. Vështirësitë ekonomike ishin të mëdha dhe nganjëherë, disa, e humbin toruan nga këto vështirësi dhe mendonin se edhe ky pushtet s'ishte gjë. Gjersa nuk po i jepte fund varfërisë shekullore, domethënë se nuk ishte në gjendje. Nuk ishte në gjendje ose ai, ose njerëzit e tij. Po, meqë ky pushtet përmbysi të vjetrën me shumë sakrifica e gjak, s'kishte ndonjë arsy që të mos e mbante, sa do të mëdha të ishin vështirësitë. Prandaj kishte më shumë mundësi që fajet t'i kishin disa nga njerëzit e tij, që e humbisnin toruan e nuk dinin të punonin. Skënderi e kuptoi se fjalët e Lytos i drejtoheshin pikërisht atij, po bëri sikur s'i mori vesh, megjithëse, thellë në shpirt, e brente dyshimi se nuk kishte vepruar si duhej, se ishte shpejtuar dhe, mbasë, edhe ishte gënjer nga ndonjë manevër e fshehtë e njerëzve të ligj.

— Ne kemi një detyrë të madhe tani, — vazhdoi Lytoja pa ia hequr dorën nga qafa, — dhe, të vështirë. Shumë të vështirë! Punëtorët po heqin keq, po vuajnë, po hanë një lloj bereqeti që është bërë me ilaç. Ku do të vejë kjo punë, nuk dihet! Mbasë edhe helmohen. Kurse ne e kemi drithin të pastër. Po e fshehim, e kalbim, ia hedhim lopës... Do t'ia japim klasës punëtore, apo të na marrë dreqi?! Kjo është detyra numër një... Dhe detyra tjeter është përsëri grumbullimi i tepricave. Të merremi vesh, me pagesë, sigurisht, po me çmimin e shtetit e jo me atë të tregut të zi! Të mos na ndodhë si vitin e kaluar... Dhe më në fund mbjelljet! Nuk jemi keq. Po na jep dorë puna kolektive, me skuadra. Kjo është pakëz si qëmoti, por e mirë. Vetëm duhet ta organizojmë më mirë. Ky është pragu i kooperativës. Po të mos na e hedhë asnjë Tahir! Se, ti e di, éndrra jonë ajo është, kooperativa, puna e përbashkët, pér të mirën tonë e të tjegrit, pér të mirën e të gjithëve...

Lytoja do të fliste edhe më, po e tërhoqi Jaçja, që e hodhi gazetën përdhe, mbasi e mblodhi në grusht, si një shuk dëbore.

— Kjo qenka tamam farmak, moj nënë!, — thirri Jaçe Marra pa iu drejtuar askujt dhe fytyra iu bë spec i kuq.

— Po ti, ç'pate?, — e pyeti Lytoja i habitur.

Malka e vështroi me urejtje e përbuzje të hapur. Po fjalët ia tha të përmbajtura:

— Kuqoo! Mbylle gojën!

— Si ore, të mbyll gojën?! Unë s'ia dal dot me grumbullimin, ha dajak pér ditë, zgjohem natën nga èndrra të këqija dhe tanë të rri e të ndaloj fshatarët që të shesin tepricat, pa marrë fund grumbullimi në anët tonë! Mënjanë u them: shisni e shlyeni, me anën tjetër t'i ndaloj. Jo. Kjo do të thotë të jesh midis dy zjarreve. As andej, as këtej dhe, ngado që të shkosh, digjesh! — Jaçja shtriu dorën e gjatë, kapi shukun e letrës dhe, në inat e sipër, e bëri copa-copa.

Malkës iu fry një damar në qafën e hollë dhe i kërceu gjaku në kokë. Nuk duronte më. Ishte i sertë dhe krejtësisht i papërmbajtur kur ndiente se ia përbuznin pushtetin. I dukej sikur pëgërnin atë, gjithë jetimët e botës dhe gjithë ata që u vranë në betejat e mëdha. E përfshiu Jaçen pér jake me ato duart e holla e të zeza si kore toke dhe e shtyu në drejtim të derës:

— Dil jashtë, këlysh kulaku?!

Thirri aq fort, sa të tre u tronditën.

Jaçja e mblohti veten menjëherë, megjithëse ishte tronditur shumë dhe të kuqtë e fytyrës i qe zhdukur po-thuaj krejt:

— Mos kështu, Malkë! S'e ke drejt, Malkë!

Zëri i tij qe i trembur, me mbytka fytì. Malka e shtyu më me forcë dhe, me siguri, do ta nxirrte jashtë me gjithë derën e zyrës po të mos hynin midis tyre Skënderi dhe Lytoja.

— More shokë, ç'bëni kështu?! Këtu s'është han!, — tha Skënderi duke i larguar njërin nga tjetri.

Lytoja e kishte humbur pakëz durimin. Ia bënte me gishtin lart:

— Ti, Malkë,... Ti Malkë!, — po s'nxirrte fjalë tjetër dhe, e tërhiqte kryetarin e këshillit nga mënga. — Ti Malkë, duhet ta mbash veten, në fund të fundit. Këtu jemi midis komunistësh.

Malkës, duke dashur t'u shpëtojë nga duart, i ra ka-

pelja përdhe, dhe, ai, pa e vënë re, e mori nëpër këmbë dhe e bëri helaq me opingat e tij tërë baltë. Flokët iu ngritën përpjetë si të eshit dhe iu zbulua vendi i plagës mu në tepe të kokës. Thirri me sa fuqi kishte:

— Po si e gris ai gazeten e Partisë? Si e gris ky hajvan urdhëresën që është për ne? Jo, Kjo s'durohet. Qofshi ju që e duroni! Unë, vetëm për këtë, ia heq tesërën! E degdis! E nxjerr si mace të ngordhur, që ta pështyjnë të gjithë...

Malka, kur nxehet, fliste e shante me fjalët më të rënda. Nga fjalët e tij, Jaçja e mblođhi veten. Mori copat e shpërndara të gazetës, i shtriu me pëllëmbë dhe i vuri mbi tryezë:

— Po daleni bre, shokë! Ja, e humba toruan. Bëra gabim! Aman, o Skënder! Pse? Me qëllim e bëra? U rrëmbeva! Ç'është kjo kështu? Kërkon të më nxjerrë jashtë! Përse? E drejtë është kjo? Po ti e ke zakon! Ty të kemi kritikuar për këtë! Të kemi kritikuar rëndë në mbledhje... Fol, o shoku Lyto! Është kështu, apo jo? Në fund të fundit, ja, e bëra gabim, po s'paskam të drejtë të shpreh atë që ndiej?... Aman, o Skënder, fol edhe ti një fjalë, se këtu po na bëjnë armiq!

Skënderi u shëmtua në fytyrë sikur kafshoi ndonjë gjë të thartuar e të hidhur. Dukej qartë se nuk i pëlqeu qëndrimi dhe veprimi i Jaçes. Tha me dëshpërim, më shumë për Jaçen, se sa për Malkën që i binte masatit:

— Ç'bëni kështu, more shokë! Kjo është për turp!

Jaçja kërkoi nëpër xhepa, me duart që i dridheshin kutinë e duhanit dhe tha me zë të heshtur, lutës e si më të qarë:

— Bëra gabim! Jam nervoz. Ju e dini. U nxeha kot! Edhe fare kot jo, xhanëm. Po sidoqoftë u nxeha. T'u them më falni, është e kotë.

Askush nuk iu përgjigj. U bë heshtje, sikur po varrošnin njeri. Malkës i dridheshin gishtat dhe mezi mbante cigaren. Fytyra i qe nxirë krejt dhe s'i lëvizte asnjë muskul e asnjë nerv. Ishte bërë si gur varri. Jaçja e vuri re mirë dhe e kuptoq që, po të thoshte, qoftë edhe ndonjë

fjalë të papeshuar, ai gur varri, i rëndë e i ftohtë, do t'i binte në kokë pa një pa dy. I hodhi fshehurazi një vështrim Skënderit, po nuk kuptoi gjë, sepse ai i kishte kthyer kurrizin. Po kur pa shikimin e akullt të Lytos, u përpoq të mbrohej me të gjitha mënyrat e me çdo kusht:

Po si do t'i bind fshatarët e mi, o Lyto? Ti e di mirë se ata e kanë atë të shkretë si daulle. Bjeri sa të duash! Bubullon! Dam-dum vazhdimisht dhe s'e lot topi, e jo fjala. Aman, o Lyto, fol edhe ti një fjalë!... — tha i dëshpëruar dhe i përlotur.

Skënderit iu neverit Jaçja. I hodhi një vështrim përbuzës, shau me vete me fjalët që i erdhën ndër mend aty pér aty dhe i ktheu kurrizin duke lexuar kot parullat e vjetra shkruar që një vit më parë nëpër mure. Malka e pa drejt në sy, bëri një lëvizje të buzëve, sikur do ta pështynë, dhe i tha me zë çuditërisht të qetë «këlysh kulaku». Lytoja, i butë siç ishte nga natyra, që nxehej rrallë e pér mall dhe që kur nxehej bëhej më i mirë, vështroi në mur fotografinë e Komandantit e tha disi i menduar:

— Ç'të them unë! Ai i ka thënë. Dhe kur i thotë, rrëzohen malet. Na ka thënë gjithnjë të vërtetën. Sado e hidhur dhe e rëndë ka qenë, ajo, si çdo e vërtetë, ka arritur gjer në zemrat tonë. I kemi besuar, kemi shkuar pas asaj së vërtete dhe kemi fituar. Fituan luftën, se ecëm pas porosive të tij. E vërteta e Partisë na bën që edhe jetën e re ta ndërtojmë të bukur, sidomos pér brezat që vijnë... Tani, ti Jaçe, dije se po besove vetë në ato që u thua fshatarëve, ata do të vijnë pas teje. Po, gjersa ti nuk beson, as ata kurrë s'kanë pér të të ndjekur... Pa shiko aty brenda teje, pa gërmio se mos ke ndonjë këlysh në bark!...

U bë heshtje. Jaçja, mbasë pér herë të parë në jetën e tij, u mblodh dhe u bë i vogël. Malka nuk zinte vend dhe karrigia ku qe ulur kërciste sikur do të bëhej copë-copë. Skënderi, me sytë gati mbyllur e me një çehre jo të mirë në fytyrë, mendohej dhe dukej hapur që vuante nga mëdyshja, nga pavendosmëria që është, sidomos në çastet e betejave, shkaktari numër një i disfatave.

Lytoja vazhdoi përsëri me atë zërin e qetë, si të ndo-

një mësuesi me eksperiencë të madhe, që i njeh mirë nxënësitet, meritat e dobësitë e tyre:

— Po të jemi ne në binarë, fshatarët do ta kuptojnë menjëherë se urdhëresat janë në të mirë të tyre dhe në dëm të kulakëve, të matrapazëve e të këlyshëve të tyre...

Jacja luajti nga vendi dhe drejtoi syrin e kuq nga sekretari. Ai sy, i butë, i kujdeshëm e i përvuajtur në dukje, kishte brenda një urrejtje që Lytoja nuk e dinte. Duhet parë përtej pamjes së jashtme, të shtirur, që të mund t'i zbulosh njerëzit. Po Lytoja, i butë e i mirë, sa s'ka ku të vejë më, gjer te ai prag arrinte.

— Do ta kuptojnë se, duke shlyer detyrimet, domosdo me pagesë e jo falas, siç e bënë në kohë të luftës, ata forcojnë lidhjet me klasën punëtore, pa të cilën as mund të bëhet fjalë, jo vetëm përlumturi, por as pér liri... Po fshatar i ynë i kuption këto punë. S'është e vërtetë që e ka kokën si shkëmb, a si daulle. I kuption pér bukuri. Truri i tij s'është hiç më i keq se ai yti, Jaçe Marra. Hiç më i keq! Përkundrazi, ty të ka zënë ndryshk e pezhishkka. Jaçe Marra, dëgjon ç'po të them?! S'je në rregull! Ke vetëm fjalë e profka, Jaçe!...

Lytoja u nxeh në të folur e sipër. Kur nxehet, ai s'lejonte që t'ia priste fjalën njeri. Erdhi rrotull zyrës së vogël, e shau Jaçen me rrënë e me degë, si devollinjtë e sertë, ia preu fjalën dy herë dhe të dy herët i tha: «Qorr! Hajvan! Këlysh i kulakëve». Ia numëroi të gjitha ç'thuhe-shin në fshat. I tha se e quanin «kllapkë», ia zuri veshin, ia tërhoqi, i thirri: «Këtu do ta kishe, këtu!», pastaj, papritur, heshti. Aq e kishte ai zemërimin. Si flakë kashte. Nuk qe si Malka, që s'i shuhej kurrë. Qe si një qengj që tërbohet pak nga shuplaka e fëmijës dhe derdhet kuturu, megjithëse i vogël, të nxjerrë inatin e vet.

Por jo. Lytoja nuk nxirrte inatet e veta. Nxirrte du-fin që i shkaktonin vështirësitë dhe armiqjtë si dhe, njerëzit e mirë që gënjeleshin nga armiku i klasës.

Me Jaçen atë duf nxirrte. Nuk e dinte mirë kush ishte Jacja, ç'punonte, ç'dredhira bënte, ç'lidhje kishte! Dinte që e kishte kandidat partie, me një biografi të mirë në fle-

tët e së cilës ishin shkruar gjithë ato fjalë të bukura dhe në fund të të cilave, veç vulës e datës, ishte vënë edhe firma e punonjësit të kuadrit. Një firmë e pastër, e lexueshme.

Lytoja e preu vetëm me një shenjë bisedën. Malka e Jaçja, që ia dinin huqet, u ngritën dhe shkuat drejt derës që kishte mbetur e hapur. Skënderi ishte prerë në fytyrë. Kishte një ankth në shpirt. Ishte po ajo ndjenjë mizore e mëngjesit, kur ai ndjeu neveri nga vetja. Megjithëse nga natyra ishte krenar e donte të dukej pakëz, e kapi Lyton miqësish për krahu dhe i tha me zë që kishte dridhma e shqetësime:

— O Lyto, boll, o Lyto! Kam ardhur me dëshirë këtu e jo për pushtet a ndonjë gjë tjetër. Kam ardhur thjesht të punoj, si fshatar, në mallin që më dha pushteti. Dhe dëgjo... Mbështetje e shkela atje te lëndinat!... Me siguri e shkela, se i fola rëndë asaj Rasimesë... Po ne komunistët duhet të jemi të lidhur ngshtë me njeri-tjetrin. Po na hyri grindja neve, ç'u kuptua? Hic gjë! Edhe ti e di, edhe Rasimeja, edhe Malka edhe dajë Qamili me të shoqen, edhe nëna ime, të gjithë e dinë se sa më të bashkuar të jemi, aq më mirë mund të punojmë. Jo, ti, më thuaj, e kam gabim?

Lytoja nuk fliste.

— Jo, ti më thuaj!... Lyto! Unë, po të hap zemrën. Kam një dëshpërim që s'ta shpjegoj dot!...

I qanë hallin njëri-tjetrit, pastaj kaluan në çështjet e tjera. Ishin po ato çështje, po me fjalë të tjera. Lytoja i vuri në dijeni se skuadrat vullnetare kishin punuar mirë, prandaj, gjersa të ngrivej kooperativa, t'i mbanin ato si organizma të gjalla socialiste. Këto skuadra, si të plugonin gjithë ngastrat, do t'i mbillnin, do t'i prashitnin, do t'i ujtin, dhe mbështetje, andej nga vjeshta, mund edhe t'i përzienin e t'i bashkonin. Po tanë, për tanë, tha Lytoja, të mos shpejtohem. Tani për tanë të mbjellim sa më shumë e sa më mirë dhe kujdesin më të madh t'ia kushtojmë grumbullimit të drithit, se qyteti po vuani dhe është nën kërcënimin e urisë.

— Puna është, — vazhdoi, — që të ruajmë kulakët e

spekulantët mos të blejnë e mos të grumbullojnë drithë në fshatin tonë për ta shitur pastaj me çmime të larta. Ju e dini se kulakët e këlyshët e tyre kanë filluar me kohë fushatën kundër grumbullimit, thonë se viti s'ka qenë i mbarë, se, nga pakujdesia, u është mykur, bile edhe fara.
— Ai pa Skënderin me një vështrim kuptimplotë, që e detyroi ushtarakuun të shohë majën e çizmeve. — Ata po ngnë krye. Thonë që u kemi vënë detyrime pak si shumë, prandaj, nga inati, s'do të japin hiç?! C'i thonë kësaj? Nuk është një lloj greve? Nuk është sabotim?

Foli gjatë Lytoja. Ai nuk e kishte zakon të fliste gjatë, po i dukej sikur shokët nuk e kuptonin mirë atë mbrëmje. Më në fund, papritur, iu drejtua Jaçes, që rrinte si mbi gjemba.

— Dhe me ty, Jaçe, do të bëjmë një muhabet të shtruar. Bile shumë të shtruar!...

Jaçes iu prenë fjalët. E kuptonte se ishte hedhur më shumë se sa duhej, prandaj e ndjeu veten të vrarë nga fjalët e sekretarit. Mezi tha:

— E bëjmë kur të duash atë muhabet!

Lytoja nuk e zgjati më. E kuptoi se kishte folur pak si tepër. Donte t'i jepte fund bisedës:

— Ne kërkuam një traktor. Shefi i bujqësisë në filim mblodhi buzët, po do të na e dërgojë. Ka rëndësi që po punojmë në fushë të bashkuar, se veçimin, veç rasteve kur na kërcënonin kufijtë, ju e dini, e kemi pasur në gjak. Tani, të bëhem i pakëz të mençëm e të shkathët. T'u shpjegojmë shokëve se puna kolektive sjell vetëm të mira. Llafet janë llafe. Puna është gjëja më e mirë. Po u bashkuam tani, do ta kemi më lehtë ta ngremë nga vjeshta kooperativën. Një kooperativë më të shëndoshë se ajo e Vishocicës. Një kooperativë me baza.

Lytoja foli me frymëzim, si ndonjë endërrimtar. Kur mbeti vetëm me Malkën jashtë kishte rënë errësira. Edhe në zyrë po binte një si mjegull dhe, sa kalonte koha, aq më pak shihnin njëri-tjetrin. Llampa kleitte mbi tryezë dhe siluetat e tyre hidhnin valle të çuditshme nëpër mure.

— Do të flemë këtu?, — pyeti më në fund Malka.

— S'ka rëndësi se ku do të flemë, — u përgjigj Lytoja si i përgjumur. — Rëndësi ka se po na e hedhin.

Malka e pa shokun e vet dhe ngriti llambën:

— Ty po të zë gjumi, Lyto!

— Jo... Pse?. Jam lodhur pak, po gjumë s'kam...

— Babait arat... Dëgjo këtu! Ky Kuqoja, po ta them troç, éshtë një dreq pune! S'e kuptoj! Po ta them shqip, si sekretar partie, si Parti. Nuk e dua dhe s'i besoj! Mbanoi! A bën ta shohim seriozisht këtë njeri. Na mblidh, bre, ne të Partisë me gjithë këshillin! Në s'na mbledh, unë do të mbledh kryesi e front! E kam kaq gjë në dorë, dreqi e mori!...

Malkës ende nuk i kishte ikur zemërimi. Lytoja e mori me të mirë. I ra supeve me përkëdheli dhe ia ktheu me shaka:

— Hajde, se je nxehur tani! Me të gjitha që më the jam dakord! Çdo gjë do të rregullohet, veç qafës sate, që e ke si pe më dysh...

— Të dola borxhit! Kuqos nuk i besoj! Ai éshtë safi rufjan, dhe i djallëzuar sa s'ka ku të vejë më, — dhe Malka fiku me një frymë llambën e vajgurit.

Në errësirë të plotë dëgjoi zërin e qetë të Litos:

— Në se një njeri bën gabime padashka, nuk do të thotë se éshtë armik! Kurse pér Jaçen, mirë thua ti! Drejt e ke! Po sikur ta shohim edhe një herë se si do të sillet paskëtej?... Në fund të fundit ai bëri një farë autokritike. Si thua, Malkë?...

— Dakord! Prova e fundit!, — tha Malka me një çerek zëri.

Dolën te sheshi i dyqanit, kapërcyen çakëllin dhe ranë në rrugë. Hëna kishte nxjerrë vetëm një vetull midis reve. Qentë lehnin të tèrbuar pas asaj vetulle. Ata të dy, ecën deri afër pillatit me katër syllynjarë, të zënë dora-dorës si fëmijët. Lytoja piu ujë, ndërsa Malka lagu vetëm buzët dhe ballin.

— E di ç'mendoj unë?, — tha Lytoja duke parë vetullën tjetër të hënës që doli nga reja. — Ti sonte do të vish tek unë.

— Jo, jo, mos u bëj merak pér mua.

Lytoja u mallëngjye. Ai e dinte se Malka ishte fillikat vetëm. S'kishte asnjeri, as katandi. Një nënë kishte pasur. Po, kur u kthye nga lufta, e gjeti të vdekur. Ia kishin pushkatuar armiqtë, aty mbi atë pillatin tërë ujë, së bashku me pesë të tjerë, të gjithë nëna e baballarë partizanësh.

Dhe Malka flinte ku ta zinte nata. Ai kishte një kasolle me kashtë dhe në oborrin e vogël të saj një qerre të braktisur. Dimrit dhe vjeshtës, kur binin shirat e frynte cangonjarka e pamëshirshme, flinte pranë kllanikut të kassolles. Pranverës e verës, kur pikte dielli dhe kur netët ishin të ngrohta, e kalonte natën në atë qerren e vjetër. Në shtratin e saj kishte hedhur kashtë e bar të thatë, kositur përtëj Shkozës e përtëj majës së Gurit të Bardhë. Bari ishte i ashpër, ai e kishte ngjeshur me trup, po megjithatë binte erë të mirë, erë zhumbrecë të pjekur nga dielli, erë luleshtrydhesh e marajthe.

— Do të vish tek unë sonte, mbaroi!, — tha Lytoja dhe e vuri përpara, si ndonjë qengj.

Malka ecte në errësirë si ndonjë kafshë nate. I gjente tragat menjëherë. Këpçente çakëllët për të shkurtuar udhë dhe i bënte zë shokut:

— Këtej, Lyto, këtej! Kujdes, se ke një si gropë!

— Mirë, mirë! E di!, — i përgjigjej Lytoja dhe, duke ecur, mendonte me vete:

«Djalë i mirë! Vetëm se je një çikë nevrik! Je një çikë i papërbajtur, o Malkë! Je, mos e moho!

Fliste tamam sikur i drejtohej atij, ndërsa Malka, që ecte përpara, kujdesej për të si pér ndonjë fëmijë!

— Lyto! Këtu ke një tel me gjemba! Kujdes. T'ëmënë, po ç'duhen këta tela me gjemba?

— Hajt, se socializmi do t'uа tregojë qejfin edhe te-lave, edhe gardheve.

Ata shkonin si dy shokë të dashur, njëri përpara e tjeter pas, kurse Jaçja i qe qepur Skënderit dhe gjithë rrugës i ankohej:

— E sheh ç'bëhet?! E sheh ç'të këputin?! Të thashë unë!, Lytoja është djalë i mirë, ha muhabet. Të kupton e të gjykon urtë e butë. Po ai thataniku i dreqit nuk durohet fare. E pe si më përfshiu për gryke?! Ja, mirë unë... e ki-

sha gabim, po kush ia dha atij tē drejtēn tē sillet si harbut? Ja ku po ta them si byrazerit, nuk punoj dot me tē. O unë, o ai! Tē dy s'hamë dot nē një grazhd...

Skënderi psherëtiu prapa krahëve tē tij. Jaçja vazhdoi me ankime:

— Do tē kërkoj tē më heqin që këtej e tē më degdisin ku tē duan. Ku tē duan tē më degdisin, veç tē mos jem nē një celulë me tē.

Skënderi mezi e dëgjonte.

— A di çë, Jaçe?

— Çfarë?, — pyeti ai me zë tē lartë. Atë kohë një shpend nate fluturoi i trembur mbi kryet e tyre.

— Më lër rehat!

— Pse? Tē shqetësova gjë?

Skënderi u hodh këtej hendekut dhe, pa u përgjigjur, shkoi drejt e në shtëpi.

Në natën e ndriçuar nga një vetull hënë dëgjoheshin vetëm tē lehurat e qenve dhe thirrja e druajtur e Jaçes:

— Skënder!... O Skënder!...

Pas dy ditësh, që pa gdhirë mirë, Malka mbiu te dera e këshillit me jakën e xhaketës ngritur, që t'i mbulonte sadopak qafën e hollë e tē gjatë. Kur erdhi Jaçja, Malka i tharë nga tē ftohtit, u shkëput nga dera dhe i doli rrëmbimthi përpëra. E pyeti me inat, megjithëse sytë i kishte tē përgjumur:

— C'deshe mbrëmë te Nuri Zyberi, zotrote?

— Ünë!, — u habit Jaçja duke ndier zemërimin e tij, sidomos nē fjälën «zotrote», që e shpoi si një plumb.

— Ti, ti! ç'deshe?, — e pyeti Malka me ngulm duke e ngrënë me sytë e tij që nga lindja e diellit dukeshin gati si tē përgjakur.

Jaçja u përpoq t'i bëjë bisht pyetjes së papritur dhe u tërhoq gjer te çakëlli.

— Më thuaj, ç'deshe?, — nguli këmbë kryetari duke ia ngulur sytë e vegjël dhe duke e detyruar tē mbështetej te gurët e bardhë tē murit.

Jaçja e kuptoi që kryetari kishte marrë vesh diçka. E pyeti me tē mirë:

— Po ti, nga e more vesh që isha te Nuriu?

Malka ishte xhindosur. Në atë trupin e tij të thatë du-
kej sikur s'kishte as mish, as koska, po vetëm nerva të
tendosura e të egra, që e thernin fort, si maja shpatash të
mprehura shumë.

— Unë marr vesh çdo gjë që bëhet në fshat. S'jam kot
kryetar! Po ti, përgjigju! Ç'desher në shtëpinë e tij afër
mesnatës?

Jacja u zu ngushtë. Prapa kishte çakëllin e lartë me
gurë të pagdhendur. Këtej kishte, sipas tij, një tjeter gur
të pagdhendur. Nga e papritura qeshi me zor dhe krojti
kokën.

— C'të të them... Sikur ti s'e di!

Kryetari s'duroi e ia priti:

— Ç'më qesh e ç'më zgërdhihesh si tuhaf! Nga mund
ta di unë?

Jacja u shkri i téri, aty te muri i çakëllit. Nuk dinte
ç'përgjigje t'i jepte:

— Unë... isha mbrëmë me Skënderin gjer vonë...

Malka e ndërpreeu:

— E pastaj, si u ndave, ku u degdise?

Jacja e kuptoi se do të bënte gabim po të gënjenjtë. U
përgjigj me zë krejt tjetër, që askush nuk do ta besonte se
ishte zëri i tij. Bëri dhe një lëvizje krahësh, sikur i vinte
zor të tregonte. Më në fund mori guxim dhe i pëshpëriti
Malkës gati te veshi:

— Isha te Nuriu... Më kishte ftuar!...

Malka ia plasi në fytyrë zemërimin:

— Unë këtë e di. Më thuaj përse vajte?

— Kot... për miqësi.

— Gënjen! se ne e kemi thënë që te kulaku nuk duhet
vajtur as kur del nga burgu, as kur marton vajzën, as kur
bën synet djalin!... Ti na vajte për miqësi. Po ç'është kjo
miqësi? Ti je me këtë pushtet, apo me pushtetin e horra-
ve?!

Jacja tha me të butë:

— Mos thirr kaq shumë, se na dëgjon bota.

Pastaj i pëshpëriti në vesh:

— E di si është puna? Ai ka atë çupën... E ka të mirë,
për besë...

Malka e ndërpreeu:

- Kërkon të bësh krushqi?... Krushqi me kulakun?
 - Po jo, bre Malkë, jo krushqi! Ti qenke tuhaf fare!
- Do burra ajo, a më merr vesh? Do djem të rinj.
- Malkës i hip gjaku në tru. Sytë iu errësuan. Nuk donte ta shikonte Jaçen.

I ktheu kurrizin dhe e shau:

- Hesht, more lanxho!
 - Asaj i pëlqen Skënderi, — tha si pa të keq Jaçja.
- Malka ktheu nga ai vetëm fytyrën e nxirë nga inati:
- Qen! Skënderi pi ujë në burimet e lajthive...

K A P I T U L L I V

1.

Fshatin e kishte përfshirë vala e punës. Ditët u bënë të ngrohta. Në fushë u shtuan pëndët e qeve dhe fshatarët mbuloheshin në djersë nga mëngjesi gjer në mbrëmje. Në një nga këto ditë, aty nga dreka, që matanë lumit u përhap një zhurmë, që sa vinte shtohej. Harabelat e cërrret ngrihesin nga shelgjishtet e fluturonin të trembur, ndërsa tragës së qerreve ngjitej për në fshat, ngadalë, një makinë e madhe dhe e zezë, e paparë ndonjëherë në ato anë.

Qamili, me të dëgjuar zhurmën, la par mendën dhe vuri pëllëmbën si strehë mbi ballë, që të mos ia vriste dielli sytë. Fëmijët e tij të vegjël rendën me të katër në drejtim të lumit.

— Traktori, — i tha Qamili së shoqes, e cila filloi të lëronte duke luftuar me rrënjet e forta të presjeve, ku plugu ngekte nganjëherë. — E sheh? E dhanë fjalën dhe na e suallën.

— Ç'qenka ai, si gogol!... Pse, nuk e ngjesh tokën ai? Si do ta lërvjë? Mos e prishë me naftë e me benzinë. Mos na bjerë edhe misri erë, o i zi!

Qamili e pa vëngër:

— Grua! Mos më fol me gjuhën e kllapkës! Oj! Nga i ke këto mendime?

- Kot, them...
- Ku merr vesh ti nga këto punë!
- E sa mund të lërojë në ditë? Lëron sa tri pendë qe?, — pyeti ajo me naivitet.
- Qamili i hodhi një vështrim të tërthortë dhe i tha me bindje, sikur të ishte ndonjë specialist:
- Edhe një mijë pendëve ua kalon! I thonë traktor, s'i thonë damalug!
- A thua!? — u çudit ajo dhe plugu i ngeci te rrënjet e forta të presjeve.

Qamili e la të shoqen të habitur dhe u nis ngadalë drejt makinës. Sa kapërceu hendekun e arës, nga ku nuk dukej e shoqja, kërceu si karkalec me këmbën e shëndoshë dhe me një frysje, u bashkua me shokët që shoqëronin traktorin.

— Kjo qenka, c'qenka!, — ia bëri ai duke vënë duart në kokë. — Hajde, traktor, hajde!

Në timon qëndronte një djalë i ri, pa asnje rrudhë, me një pulovër të kaltër. Në fytyrë i qe mbërthyer një shprehje serioze dhe krenare. Herë-herë e ngiste makinën me një dorë e me tjetrën përshtendoste fëmijët e fshatarët duke i këshilluar:

— Kini mendjen, shokë! Largohuni! Hapni rrugën!
— Ik, ore çalo, se do të të bëjë petë!, — i tha Mehmeti i gjatë si lloz me dorën te mustaqet e dendura e të zverdhura.

— Ti më qenke?, — e talli Qamili pa të keq. — Ja c'bën pushteti i ri, kurse ti... të kujtohet c'më ke thënë?
«S'e jap bereqetin unë që të hanë të tjerët!»

Qamili tha edhe diçka tjetër, po fjalët humbën mes zhurmës së traktorit e gazit të njerëzve.

Lytoja shikonte me krenari se si çuditeshin fshatarët, se si preknin të gëzuar makinën, se si pyesnin njëri-tjetrin sa dynym tokë mund të lëronte në ditë. Ishte mësuar ai tanimë me këtë pamje të habitur dhe të gëzuar. E dinte c'pyetje bënин fshatarët e c'merak kishin. E dinte mirë edhe inatin e kulakëve, që tërboheshin kur traktori hynte në ish-tokat e tyre dhe parullat që përhapnin. Po, sado që të vuanin kulakët, sado që të tërboheshin, ata s'kishin

fuqi të pengonin përparimin, ashtu siç nuk mundën të pengojnë ardhjen e traktorit.

— Ku do të fillojmë? — pyeti traktoristi, pa e ndaluar makinën.

— Ja, këtu. Ktheje majtas. Është parcelë e ardhur mirë kjo, — i tha Lytoja duke i treguar me dorë arën që kishte një formë gati rrumbullake.

Papritur traktori nxori një krismë aq të fortë, sa fëmijët u trembën dhe zunë veshët. Fshatarët panë njëri-tjetrin të habitur.

— C'pësoi?! — pyetën disa.

— Asgjë!, — tha traktoristi dhe, si zbriti, hipi mbi ledh.

Nga zëri, nga lëvizjet, nga shprehja e fytyrës dukej qartë se në duart e tij traktori s'mund të prishej kurrë.

— Sa keq, sa keq!, — tha ai pas pak, duke i hedhur një sy fushës. — Ka gjerdhe shumë! Ku të hyj unë këtu? Një orë punë kam. Duhen prishur gjerdhet!

— Do t'i prishim, — e ndërpreu Lytoja, — kur t'u vijë koha, se ka ende rezistencë nga fshatarët. Nga vjeshta, besoj! Keq e ke, e di, po s'ke ç'bën. Kështu do të punosh, copa-copa.

— Harxhoj kohën kot, edhe karburantin... Po nejse, hapuni!

Motori u ndez dhe traktori filloi përsëri të ecë me zhurmë. Kur kapërceu hendekun, aty ku ishte pakëz më i rrafshët, u duk sikur toka u trondit dhe traktori do të fundosej. Po, ai bëri përrpara me gulçima dhe doli në arë. Ndihmësi i tij, çunak edhe ai, rregulloi plugjet, u ul prapa traktorit dhe i bëri me shenjë traktoristit.

— Gati!, — i thirri me zë të lartë.

— Një minutë, — ia ktheu traktoristi dhe, si hapi kapakun e motorit, se ç'vidhosи aty me një çelës të madh.

Ndërkaj ishin grumbulluar aq shumë njerëz, sa dukej sikur ishte shkultur tërë fshati. Pleqtë qenë ulur mbi ledh, pinin duhan dhe i largonin fëmijët, që u dilnin përrpara.

— Po atje, në tokat e reja, që ishin gjer dje kënetë, a hyn? — pyeti njëri prej tyre.

— Jo, atje s'hyn dot. Ky e do tokën të kulluar. Atje hëpërhc e kanë fjalën qetë dhe, po të ketë shumë lagështirë, shata. Ky e do tokën edhe pa gjerdhe, që t'i bjerë këtu e të dalë në Cangonj, — u shpjegonte Lytoja, i gëzuar, që më në fund, me shumë përpjekje, kishte mundur të sillte në fshat traktorin e parë.

— A ha shumë?, — e pyeti një tjetër.

— Shumë, — u përgjigj Lytoja.

— Sa dynam?

— Njëqind në ditë.

— Jo, more?!

— Punon edhe natën.

— Ka fener?

— Ka, ka, dy. Ja ku i ka përpara.

— Si makinë, tamam!

Po prisnin me ankth që të gjithë, mirëpo traktoristi s'po e nxirrte kokën nga motori. Të gjithë ishin bërë si me krahë. Edhe atyre pleqve që rrinin mbi ledh u qe ndezur shpirti.

— S'ke parë ndonjëherë traktor?, — e pyeti Skënderi Rasimenë, që thithte e menduar aromën e një luleje fushe.

— Të gjithë ne që jemi këtu kemi parë kur ishim vullnetarë në hekurudhën Durrës-Tiranë. Kurse ata atje, ku të shikonin?

Vajza e kishte fjalën për shoqet e saj dhe për pleqtë e gratë. Preku me dorë traktorin dhe çeliku iu duk i ngrrohtë.

— Kur më thanë se do të vinte traktori, unë e përfytyrova krejt ndryshe, — tha njëra nga gratë që ishte pakëz e kaluar në moshë.

— Kjo është dallëndyshka e parë, — foli me figurë Skënderi, gjë që s'e kishte zakon. — Po do të vijnë të tjerat dhe aherëjeta do të bëhet vërtet e bukur, — dhe u mundua ta shikonte në sy Rasimenë.

— Po edhe tanëjeta është e mirë, — tha vajza dhenjë në shpirt sikur dikush i pëshpëriti fjalë të ëmbla dashurie.

Lytoja e Malka jepnin e merrnin me fshatarët, të cilët pyesnin vazhdimisht duke pritur me ankth që traktori të fillonte nga puna.

Lytoja, duke vështruar Mehmetin e gjatë, që mundohej, kot të fshihej prapa krahëve të të tjerëve, vazhdonte të thoshte:

— Kishim edhe ne ca njerëz që nuk besonin.

Qamili ia ngjeshi me bërryl Mehmetit dhe picërroi sytë.

— E ç'më shikon kështu?, — e pyeti fshatari.

— Kot!

— Léri ato! Po fundi i fundit, janë gjëra që ngjasin. S'ke si të besosh menjëherë në çdo gjë. Mos më shiko ashtu shtrembër zotrote.

— Hajt! se sytë s'kanë dhëmbë, s'kafshojnë!, — i tha Qamili me zë të lartë.

Fshatarët qeshën.

— Tani s'kam përsë të mos besoj. Dhe ato që kam thënë i marr prapë. Lytoja e kuptoq që Mehmeti i tha me shumë zor ato fjalë, po u gëzua si fëmijë. E pa me ata sytë e tij të butë dhe e përqafoi:

— Kështu flasin burrat, o Mehmet!

Papritur, traktori kérceu mbi makinë me shumë shkathtësi dhe në çast bisedat u ndërprenë. Traktori gu-mëzhiu dhe plugjet e mprehta çanë thellë tokën e butë. Të gjithë sa ishin, edhe pleqtë, ecën në gjurmët e zeza të makinës, matën me pëllëmbë thellësinë, mbushën duart me dheun e shkrifët dhe uruan me gjithë zemër:

— Epo, me shëndet e gëzuar!

Atëherë më plaku i pleqve, që e thërrisin gjyshi Dule, u ngrit nga ledhi dhe me mbeskën e vogël për dore hyri në tokën e porsalëruar. Ai nuk shihte mirë nga sytë, prandaj shpeshherë me të do të shihje edhe mbeskën dy-mbëdhjetëvjeçare, vajzën e urtë flokë-kashtë, që kishte mbaruar shkëlqyeshëm filloren e që gjyshi Dule kishte dëshirë të madhe ta dërgonte në qytet, në shkollën për mama. Ajo mbante një fustan të vjetër, prej basmeje të thjeshtë, me arnë në njërin bërryl dhe të zbatur. Ishte e urtë, e sjellshme, shumë e turpshme dhe nuk i ndahej gjyshit këmba-këmbës. Plaku u ul më bisht dhe futi në brazdë duart që i kishte të zeza si toka. Edhe rrabet e rrec-kosura i kishte si toka. I mbushi duart me dhé e i afroi

pranë syve, për ta parë mirë. Gjyshi Dule ishte vështirë nga gjendja, po, siç thoshte vetë, zemrën e kishte të re, të re e të çeliktë, kishte marrë tokë nga Reforma, kishte hapur edhe vetë tokë të re dhe punonte me bindje për të ardhmen.

— E sheh, moj Ditkë, — i tha së mbesës. — Ja edhe këtë ditë e arrita. Mirë e ka punuar, hë? Dëgjo, moj bijë e babagjyshit, të gjitha c'thuhën duhet t'i bëjmë, se janë të drejta. Dhe janë të drejta se i thotë Partia jonë, për të cilën unë luftova dy vjet nëpër pyje. Ajo na dha tokën. Ja, ti do të vesh në qytet, në shkollë. Të mësosh për Partinë dhe kur të kthehesë të më kthehesë anëtare partie. Të shpresojë babagjyshi në këto që thashë?

— Po, babagjysh, — iu përgjigj ajo.

Plaku shkriftoi dheun nëpër gishta, i qeshën sytë, e zuri vajzën për dore dhe i tha:

— Je e mirë ti, Ditkë, si toka!

Në këtë tokë pjellorre, buzë lumiit e pranë kënetës, që nga kohët më të lashta, që nga koha kur erdhi e u ngul njeriu i parë e gjer atë ditë, nuk kishte kaluar kurrë asnëjë lloj makine. Toka, gjatë shumë shekujuve, ishte punuar me damalug, me parmendë, me shatë e bel. Bregut të lumiit, nëpër monopatet e verbëta, tragave, lëndinave, shekull pas shekulli kishin ecur njerëzit, delet, lopët, kuajt, qentë. Dimër e verë kishin fryrë erërat, Cangonjara e stuhihime dhe në quell e mbi shtëpitë kishin flutuar zogjtë.... Dhe ja më në fund, makina e parë, traktori i parë, dallëndyshka e parë, dhe pas asaj fshatarët, pakëz të hutuar, po me ngazëllim të madh në shpirt! Çdo të thonte, vallë, toka sikur të kishte gojë e të fliste?! E pamësuar me peshën e rëndë të hekurit ajo sikur rënkon e ulerin. Pleqtë venë veshin e dëgjojnë një çast, si të ngrirë. Jo, nuk rënkon e nuk ulerin toka. Zhurmon traktori. Ata mbushin grushtat me dhë të shkrifët dhe i marrin erë, si një trëndafili. Jo. Toka s'bie erë naftë. Kanë qenë të gjitha fjale, gjenjeshtra, shpifje! Toka ka erën e saj të zakonshme, të mirë!

Traktoristit i doli fjala. Brenda orës ai e ktheu arën përbys. Fshatarët s'kishin më nevojë për shpjegime dhe nuk pyetën më. E matën arën me sy dhe i bënë llogaritë me

gishta. U doli se u duheshin 50 pendë qe pér tē bërë atë punë që kiske bërë makina!

— 50 duhen! Po sikur tē kemi 7 a 8 traktorë...

— Do tē vijë koha dhe do t'i kemi, — u tha Lytoja — traktorë, kombajna e makina tē tjera. Tē gjitha do t'i kemi... Po tani, ku ta futim makinën nëpër këto gjerdhe?

— Shumë gjerdhe keni, — tha traktoristi si me vete duke thithur cigaren — shumë gjerdhe do tē thotë se s'ka bashkim. Bashkohuni dhe zhdukini! Ja, më thoni, nga ta fut traktorin tek parcela tjetër? Andej janë plepat, këtej është mbjellë grurë, përpara është gardhi me ferra. Nga ta fut? Tē fluturoj?

— Bjeri drejt! — i tha Malka dhe me hap tē shpejtë iu afroa gardhit që ndante arat.

— Ore, Malkë! Do tē më shajë xhaxhai. Mos e prish gardhin!, — i thirri Tahiri.

Traktoristi ia plasi gazit.

— Ty tē tē shajë xhaxhai? Po ti je sa gomari i baba-gjyshit!

— Më shan, ore! Pér këtë bukë më shan! — u ankua Tahiri duke tundur kokën e madhe.

Të rintjtë e ngacmuani një copë herë, qeshën me tē dhe e bindën.

— Epo mirë, kur qenka kështu, Jepini! — tha më në fund. Të gjithë u turrën drejt gardhit me ferra. Po i ndali traktoristi:

— Daleni!, — u tha. — Unë i urrej gjerdhet më shumë se ju, sepse nuk më lënë tē punoj si duhet — dhe e çau gardhin në mes me traktor, ndërsa tē rintjtë brohorisnin e qeshnin tē gëzuar.

Dielli përflaku pér tē fundit herë ujërat e lumiit e tē kënetës dhe perëndoi. Atëherë fshatarët u kujtuan se dita kiske ikur dhe, si vunë përpara, kush qetë e lodhur e kush delet me leshin mplekur, tèrë baltë e rrodhe, u kthyen në-pér shtëpitë. Veshët u buçisnin nga zhurma e traktorit, që punonte vazhdimit në fushë. I kiske ndezur dritat dhe dukej që nga fshati si një xixëllonjë e vetëmuar. U kthyen edhe tē rintjtë. Pak prapa grupit tē tyre, ecnin Skënderi e Rasimeja. Kiske kohë që ecnin pa folur, duke vështruar

herë hënën e plotë, që doli mbi brigjet e Zëmlakut, herë malet e larta, që dukeshin si perde të trasha varur nën qiellin e thellë e të ftohtë. Ecnin përkrah njëri-tjetrit e s'dinin përsë të flisnin.

— Nesër do të ngrihem herët, se traktori do të lërojë arat tonë! — tha më në fund Rasimeja me zë të shuar, vetëm e vetëm sa për të hapur bisedën.

— Kurse unë do t'i bëj, a s'do t'i bëj dy-tri orë gjumë...
— Pse?

— Do të shkoj në mal për dru. Ka tri ditë që po e shtyj hë sot, hë nesër. Nëna s'ka me se t'i pjekë bukët. I bëri duart copë së mbledhuri shkarpa.

— Do të lodhesh, — e ndërpren vajza me keqardhje.
— Të vjen keq për mua? — ngau ai me interesim.
— S'e di... Ndoshita...
— Domethënë s'të vjen...
— Po të jesh i mënçëm, e kupton vetë.

Ajo i tha këto fjalë me mundim dhe po të ishte ditë do t'i dallohej të kuqtë e fytyrës dhe ajo buza e poshtme, që i dridhej lehtë nga një ndjenjë e ëmbël.

— Asgjë s'kuptoj, — tha Skënderi, po ndërkaj vajza vrapi i dha e arriti grupin gazmor të të rinjve...

Në fushë kishin mbetur vetëm Malka, Lytoja, Jaçja dhe traktoristi me ndihmësin e tij. Malka, që ngulte këmbë për çdo gjë të re e të dobishme, kishte hipur në traktor dhe me kujdes vinte re lëvizjet e veprimet e traktoristit. Jaçja ndiqte plugjet, i heshtur, si gur varri. Lytoja, duke pritur mbi ledh që ata ta mbaronin së lëruari ngastrën, kujtonte Rasimenë, e cila nuk kishte pranuar të kthehej së bashku me të në fshat. Ai kishte dashur edhe t'i thoshte diçka, po ajo u largua shumë shpejt. Duke pritur shokët atje, mbi ledh, ai ndjeu menjëherë një si këputje të fuqive. Nga i vinte kjo kapitje? Nga gëzimi që kishte ardhur traktori? Nga lodhja e madhe? Nga ftohtësia e Rassimesë? Apo nga të tria së bashku? Ishte zhytur në mendime për punët që e prisnin, për punët e vogla e të mëdha, për grumbullimet që kishin ngecur, për mbjelljet që ishin vënë në udhë, për kooperativën e ardhshme, kur u për-

mend nga zëri i Jaçes që i qe afruar në errësirë si ndonjë kafshë e egër:

— Lyto! Unë të kam shok...., — i tha Jaçja duke hyrë drejt e në temë.

— Ç'do të thuash me këtë?, — e pyeti Lytoja pakëz i habitur.

— Dua... dua të të paralajmëroj për një gjë...

— Ti, mua?!

— Mos i mbaj sytë myllur, Lyto!

— Pse? Çfarë duhet të shoh?

Lytoja vërtet nuk po kuptonte se ku desh të dilte Jaçja që ia hodhi dorën në sup dhe e uli pakëz zërin

— Ushtarakun që po të rrëmben çupën. Tërë ditën pranë saj qëndron. Tërë ditën pësh-pësh, vesh më vesh!... Si shok të them.

Lytoja kaq shpejt ia largoi dorën nga supi, sa Jaçja, i trembur, bëri dy hapa prapa. Me siguri fytyra i qe zbehur, sytë i xixëllonin nga zemërimi dhe duart i dridheshin nga inati.

— Dëgjo këtu, Kuqo!... Kurrë mos guxo të flasësh me mua edhe një herë me këtë gjuhë! Përndryshe...

Nuk e mbaroi frazën, po menjëherë i ktheu krahët, se atë çast ishte gati ta godiste në fytyrë. Edhe vetë nuk e kuptoi përsë i ngjallën atë inat e zemërim fjalët e Jaçes. Ky kishte ngrirë nga habia dhe nga frika, me supet ngritur, me sytë të zmadhuar çuditërisht shumë dhe nuk dinte ç'të bënte, t'i fliste apo të ikte. Më në fund tha me gjysmë zëri:

— Më fal në bëra ndonjë gabim. Unë po iki. Natën e mirë!, — dhe në çast humbi në errësirë.

2.

Nuriu kishte rënë fare shpirtërisht dhe ngjarjet e kishin tronditür aq shumë, sa fliste me vete me zë, si ndonjë i çmendur, kudo që të ishte, në fushë, në stallë, në oborrin e shtëpisë pranë vatrës... Që kur dëgjoi zhurmën e trakto-

rit ndjeu një dhembje therrëse në zemër. Kishte filluar të ndiente frikë, shihte èndrra të këqija e e zinte një si makth. Ato çaste ngrihej përnjéherësh nga shtrati dhe, ashtu siç ishte, nxirrte hundën te xhami i thyer i dritares dhe thith-te ajrin gati të ngrirë. Nganjëherë, në èndërr, e shihte veten të vdekur dhe zgjоhej plot tmerr e llahtari... Dhe punët nuk po i shkonin mirë. Në qytet nuk vinte më. Edhe në fshat s'kishte mundur të bënte më shumë, sidomos, që kur doli urdhërasa që ndalonë shitjen e lirë pa shlyer detyrimin. «Na e mblohdhën litarin pas fytit!» thoshte me vete. «Ja, tani, edhe traktori!»

S'ia dëgjonte dot zhurmën. I dukej si klithmë vdekjeje. E shikonte nga dritarja atë dritë që vinte poshtë e lart dhe i dukej si ndonjë shpir i keq, që kishte dalë nga flakët e zjarrit me dy sy të ndezur. Pastaj nuk e pa e nuk e dëgjoi më. Si duket traktoristi e la punën. Përpara shtëpisë së tij kaloi grupi i fundit i fshatarëve që ktheheshin nga fusha. Nga zëri njoihu Lyton e Malkën. Ai që fliste me zë të hollë duhej të ishte traktoristi i ri. Ai i katërti kushedi kush ishte. Dhe si u larguan ata, pas pak, çdo gjë ra në qetësi. Errësira dhe gjumi i mbuluan gjithë ato zhurma të fuqishme të asaj mbasditeje. Vetëm qentë lehnin në erë duke bredhur nëpër udhë e nëpër bahë.

Njerëzit flinin të qetë nëpër shtretërit e ngrohtë. Atë natë èndrrat me siguri do të ishin të jashtëzakonshme. Do të ishin èndrrat e hekurit, e zinxhirëve të trashë, e 100 plugjeve që çanin njëherësh. Èndërr krejtësisht e re, e kaltër, që zhduk ferra e gjerdhe, që hap toka të reja, që e kthen kënetën në një liqen me ujë të kulluar, rrethuar me bredha e pisha të larta...

Aty nga mesnata, dy vetë, ecnin pa folur, rrugë e pa rrugë. Kaluan xhadënë mbanë fshatit, kapërcyen gardhin e kopshtit dhe qëndruan para shtëpisë së Nuriut. Dera e hajatit ishte e hapur dhe ata hynë pa trokitur, si njerëz të shtëpisë. Një kandil u përpëlit në dritare dhe u shua. Kur ata të dy hynë në dhomë, Nuriu, që qëndronte me çibuk në dorë, njoihu Milo Peçin dhe Jaçen. I priste, prandaj nuk i kishte lëshuar qentë atë natë. Lëshoi perdët e trasha dhe mbylli derën me lloz.

— Urdhëro, shoku Milo, — e uroi me një farë shqetësimi, ia shtrëngoi dorën dhe u ulën të dy rrëth vatrës. Jaçja qëndroi më këmbë. Ish-specialisti i bujqësisë qe veshur me setër prej shajaku, me bollka dhe me kapë si të fshatarëve dhe Nuriu nuk e kuptoi as përse kishte ardhur në mesnatë e as përse ishte veshur në atë mënyrë e aq keq.

— Ti dil, e hidh një sy përjashta!, — e urdhëroi ai Jaçen, me zë të ngjirur nga të ftohit, kur ky u mat të ulej pranë tyre.

— S'ka nevojë, — tha Nuriu, — sipër në dritare ruajnë fëmija.

— S'u besoj grave në punë të tilla!, — kundërshtoi me inat mysafiri dhe, me një lëvizje të kokës, e degdisi Jaçen përjashta.

— Për grumbullimet ke ardhur?, — e pyeti i zoti i shtëpisë duke marrë nga kamarja e kllanikut që kishte prapa shpine shishen e rakisë dhe gotat.

— Jo. Me grumbullimet i lava duart. Më pushuan nga puna. Ma bënë maskarenjtë e këtij fshati. Fundja, s'kam nevojë pér punë. Këtë e kam plot.

Futi dorën në xhepin e brendshëm të setrës dhe nxori një qese plot me florinj. I zbrazi mbi qilim dhe sytë e Nuri Zyberit shndritën. Pastaj i mbledhi përsëri. Piu një gotë të madhe raki dhe pyeti:

— Këtej, si i kemi punët?

— Ç'ka, zoti Milo, çka. Vetëm se sot na sollën traktorin. Nesër kushedi se ç'sjellin... — Nuriu donte të shtonte diçka, po ish-specialisti, e ndërpreu, pasi piu edhe një gotë tjetër me plot:

— Duhet vepruar, Nuri aga! Duhet vepruar, — përsëriti, — o sot o kurrë. Po mirë, pa më thuaj, a ke organizuar gjë në fshat?

Nga kjo pyetje e drejtpërdrejtë, Nuriu sikur e ndjeu veten ngusht:

— Po zotrote e di punën time. Hedh gurin e fsheh dorën. Me grumbullimet ngecën njëherë. I bëra unë të ngecin, se ia prisha mendjen atij ish-ushtarakut...

— Atij... si i thonë... Skënderit?

— Si, urdhëron!

— Ai do vrarë! Ç'më punoi atë ditë. Ai është shkaktari që më pushuan nga puna... Po ti vazhdo me të, vazhdo. Se, ku i dihet, mund edhe të të dalë diçka.

Piu edhe Nuriu dy-tri gota dhe iu zgjidh gjuha. I foli për shqetësimet e veta, për ëndrrat që shihte, për zhurmën e traktorit që nuk i hiqej nga veshët, për urrejtjen që ndiente ndaj çdo gjëje që lidhej me pushtetin e ri? Pas pak u kthyte Jacja. Kishte mbërdhirë, piu një gotë dhe shtriu pëllëmbët mbi zjarr.

— A lot gjë?, — e pyeti Miloja.

— Qetësi! — u përgjigj Jacja.

— Këto hollësira s'më hyjnë në punë. Duhet vepruar, Nuri aga. — tha Milo Peçi duke i drejtar të zotit të shtëpisë një vështrim që shprehte pakënaqësi.

— Po zotrote e di vetë se nuk është aq kollaj...

— Po koha s'pret, Nuri Aga! Duhen sabotime, si ato të Maliquit e të hekurudhës! Ku i keni juve ato? Përse s'i hidhni sytë e të shihni ç'bëhet rreth e rrrotull?... Tanët po pregatisin luftën. T'u ndihmojmë me punë, t'ua pregatim terrenin. Ja një rast i mirë. Erdhi traktori i parë. Prisheni, që të mos vijë i dyti! Kështu do ta humbin fshatarët besimin që kanë ndaj këtij pushteti rreckamanësh e injorantësh... Po ju keni edhe fat, se e keni njeriun brenda Partisë dhe në krye të pushtetit. Gëzuar, o Jaçe...! Dhe këtej e tutje do të lidheni me zotin Niko... Mua nuk do të më shihni më. Këtu për mua, çdo orë është e rrezikshme... Më kanë caktuar punë të tjera.

Nuriu me një vesh dégjonte Milo Peçin dhe me tjetrin të lehurat e qenve. Megjithëse kishte pirë mjaft, raka s'e kishte trubulluar asnjë fije. Ndiente përbrenda diçka të keqe, të përzier, një lëmsh e një mishmash dhe bënte çmos që ta largonte atë ndjenjë frike e ankthi.

Milo Peçi e ngriti rakinë me shishe. Fshiu buzët me mëngë e tha:

— Traktori s'duhet të punojë më, asnjë minutë. Hiqini ndonjë vegël, hidhini rërë në naftë, thyejani motorin ose bëjini ç'të doni, veç të mos punojë. Pastaj, c'e zgjatni me ata dy komunistë? Të tjerët u kanë prerë ko-

kën kryetarëve të këshillave, u kanë hedhur bombën mu
në arë, tek lëronin. Ti ç'pret, Nuri aga? ... Më dëgjon?

— Po, o Milo, po!

— Tani më thuaj: sa larg është prej këtej Shkëmbi i
Bardhë?

— Nja tre sahat, përsë?

— Pres ca miq...

— Miq te Shkëmbi i Bardhë?!, — u drodh Nuriu duke
e kuptuar se përsë bëhej fjalë.

— Janë tanët!, — i dha zémër Miloja. — Do të jenë
mysafirët e tu.

— Të vijnë tek unë?! Po këtu ka roje, Milo! Pastaj
populli....

Miloja ia preu fjalën: — Nuri aga, po ti, a nuk e kupton se, po të veprosh
ndryshe, ata i lajnë hesapet me ty? I lajnë edhe me Jaçen...

— Sigurisht, xhanëm... E kam të qartë.

Milo Peçi e ndjeu se i zoti i shtëpisë ishte tronditur
shumë atë çast. Ia ktheu me shaka, për t'i dhënë zemër:

— Prandaj kësaj i thonë: «Puthu me Milon!». Tani na
shtro bukën, — dhe qeshën të tre me zë.

Skënderi fjeti vetëm dy orë e pak, ashtu siç i kishte
thënë Rasimesë. Kur doli në oborr, dëgjoi zhurmën e trak-
torit, që vinte nga fusha dallgë-dallgë po shumë e qartë.
Meqë nuk ia dalloi dritat, e mori me mend se makina pu-
nonte me ndonjë arë buzë lumit, rrerhuar me shelgje. E
përkedheli kalin në vithe e kur i vuri samarin, e ëma e
ndjeu dhe doli në oborr e shqetësuar:

— More bir, po ku do të vesh kaq herët? Ti s'je ngo-
pur as me gjumë. S'më duhen as drutë kështu!

Ai vuri sëpatën në samar, ngjeshi revolverin në brez
dhe e mori me të mirë:

— E dëgjon zhurmën që vjen nga fusha? Ka të tjerë
që e kanë filluar punën para meje. Tani shko brenda, se
do të ftohesh! Apo s'bëka ftohtë.

Ajo, si ato nënët që janë mësuar t'i binden gjithnjë vullnetit të fëmijëve, nuk foli më, vetëm mallëkoi veten që ia kishte përmendur të birit disa herë mungesën e druve.

Skënderi vuri përpara kalin dhe vetë eci më këmbë, se rruga ishte e përpjetë. Gjer te Dheri i Kuq nuk qëndroi askund. Aty, te burimi që rridhte përmes lajthishtes, lau duar e fytyrë dhe piu dy-tre grushta ujë. Përkëdheli kalin në vithe dhe, meqë frynte erë e ftohtë, eci pakëz i kërrusur. Kur doli në majë të bregut, pa retë që vraponin drejt lindjes, të përshkënditura nga drita e hënës, dhe iu duk sikur nga thellësitetë e tokës ngrihej një zhurmë. I vuri veshin natës. Për çudi, zhurma kësaj radhe iu duk sikur buronte nga retë. Pas pak ajo iu ngatërrua dhe ai s'e përcaktonte dot nga vinte, nga nëntoka, apo nga qielli. Më në fund ajo humbi krejt dhe në veshë i fërshëllente vetëm era e thatë dhe e ngrirë. Vazhdoi rrugën me një farë dyshimi. Ai ishte mësuar me zhurmat, i dallonte të gjitha, edhe ato që mund të bëjë me hapat e pandjeshme një dhëlpër dinake, edhe ato që mund të bëjë një flutur me krahët e saj të lehtë, edhe ato që bën era, njeriu ose makina. Kurse ajo ishte e çuditshme dhe i ngjallte dyshim. Me atë dyshim, pas një ore, kapërceu qafën e malit dhe prej andej ra drejt e në pyllin e dendur me dushk, ku nuk e grinte më era. Eci një copë herë mbi fletët e thata si mbi minder të butë dhe, kur doli në një lëndinë, pa tutje liqenin e madh malor me ujërat e kulluara, që reflektonte vendevende rrezet e argjendta të hënës. Në mes të liqenit dalloi nisinë e vogël, ku strehoheshin peshkatarët në kohë të këqija, kur era ngrinte dallgë të tërbuara e krijonte gjeneratorë kobzeza.

Skënderi donte ta lidhte e ta pengonte kalin, po kafsha e mësuar të kulloste lirisht, hingëlli e turfulloj me inat. Atëherë ai i ra vitheve, e la të kulloste sipas qejfit, hoqi xhaketën dhe rrëmbeu sépatën.

Porsa goditi trungun e dushkut, përsëri dëgjoi atë zhurmën e çuditshme, po kësaj radhe e përcaktoi menjëherë se nga vinte. Ajo vinte nga qielli, sillej mbi majat e maleve diku mbi liqen. Për t'u siguruar vuri veshin me kryet lart: në qìell qenë vetëm yjet e rralluara dhe hëna

e venitur nga agimi. Ndërsa zhurma sillej e sillej përreth, afrohej e largohej.

— Thashë unë, — mendoi Skënderi pa as më të voglin dyshim. — S'qe zhurmë ere ajo!... Ky është aeroplan. Armiqtë edhe natën nuk flenë!

Qëndroi ashtu, me fytyrën nga qelli, si i ngrirë, gjersa zhurma nuk u dëgjuat më.

«Ç'desh ky aeroplan sonte mbi pyjet tona? Ka humbur rrugën? Këtë s'e besoj kurrë. Ka furnizuar ndonjë bandë? Ka mundësi... Ka hedhur ndonjë spiun?... Ka mundësi» — mendonte ai duke rrëzuar trungjet dhe, në kohën që po u priste degët, filloj agimi i parë, kur s'është as natë e as ditë, po një bardhësi e përzier me errësirën; si dy forca të balancuara, si dy ushtri të vëna përballë njëra-tjetrës, që hidhen në sulmin përfundimtar përvdekje a jetë. Dhe ja, në këtë betejë, fitorja e sigurt është nga ana e bardhësisë së fshehtë, që shtohet nga çasti në çast dhe, pas pak, shpërthen në dritë llamburitëse, e cila e zhduk errësirën edhe nga honest e përrenjtë e thellë. Malet nga lindja filluan të marrin ngjyrën e manushaqes dhe mbi to po formohej një kurorë e kuqe, që tretej dalngadalë.

— Po gdihet, — pëshpëriti Skënderi duke parë nga lindja dhe duke fshirë djersët e ballit me shaminë e qafës.

— Po ç'do të na sjellë ky mëngjes? Ç'sjell nata, nuk sjell dita! Ç'solli ai aeroplan?

E la sëpatën dhe nuk vazhdoi më të presë dru. E dinte që ndaj të gdhirë sëpata dëgjohet në pyll, sado larg që të jetë.

— Po sikur... po sikur... — pëshpëriti, veshi xhaketën dhe preku hekurin e ftohtë të revolverit.

«Dielli duhet të më zérë në gjysmë të rrugës, — mendonte duke u munduar të shquajë kalin në mugëtirë. — Në fushë duhet të jem me një hosten diell, jo më vonë, se sot kemi gjithë ato punë. Edhe nesër kemi punë boll. Edhe pasnesër po kështu. Dhe tërë jetën kështu. Mirë thotë nëna ime: puna e bën njeriun, njeri!... Po sikur... po sikur, — përsëriti me dorën në revolver duke shkelur me kujdes mbi barin e dendur ende të parritur, që shndriste nën dritën e akullt të hënës në atë copëz lëndine të butë.

Kali kishte hyrë thellë në pyll dhe Skënderi s'e merrte dot me mend se ku ishte degdisur. U bë pishman që nuk e lidhi me litar pas ndonjë dashku. Të paktën ta kishte penguar.

— Vetë i kam fajet, — mendoi i pakënaqur duke filozofuar. — Liria është për njerëzit. Kafshët duan patjetër vargonj, se ja si ta punojnë! Të lënë në baltë ose të prishin punë. Po sikur! Po sikur!, — përsëriti ai dhe u bë tërë sy e veshë. Duke thithur ajrin e ftohtë, ndjeu një erë tymi, po as zjarr e as tym nuk dukej kund. Lagu gishtin tregues dhe e ngriti lart si antenë për të kuptuar se nga frynte era, e lodhur pas gjithë asaj furtune të natës. E ndjeu nga frynte dhe shkoi në drejtëm të kundërt me të, duke ecur me shumë kujdes mbi gjethet e kalbura dhe duke ndalur në çdo hap. Përgjonte gjysmë i kërrusur, ua ngulte sytë kaçubeve, gropave, vendeve të errëta dhe, si sigurohej, bënte përsëri drejt erës, duke nuhatur ajrin e duke ndier gjithnjë më pranë atë aromën e duhanit ose të diçkaje të djegur. Dhe ja më në fund një shkarpë që u thye me një krismë të thatë. Ja edhe zhurma e hapave të një njeriu. Ishin hapa njeriu që ecte me kujdes të madh. Ja edhe pëshpërima e dikujt. Dikush fliste, po fjalët s'i kuptoheshin. Skënderi u shtri barkas dhe ngjeshi veshin në tokën e lagur. Zhurmat dëgjoheshin të qarta. Njerëzit, që ishin diku pranë tij, nuk mund të ishin fshatarë. Po atëherë q'ishin?

Ai rrëshqiti zvarrë, pa u ndier, si peshku në ujë dhe iu afrua një kaçubeje të dendur e të errët. Që andej, poshtë, në një vend si gropë dalloj siluetat e dy njerëzve që pinin duhan duke i fshehur cigaret në grushta për të mos bërë dritë. Dëgjoi njërin prej tyre që urdhëroi:

— Transmeto! Përgëzojmë nxehësish personelin ushtarë që na nxori nga kufiri. Manovrimi për dizorientimin e armikut ka qenë i mrekullueshëm. Po përpinqemi të ndërlidhem me njerëzit tanë.

«Ata janë... diversantët!» — mendoi Skënderi dhe, pa bërë as zhurmën më të vogël, nxori revolverin dhe u

bë si i vdekur, pa ua hequr vështrimin atyre që ishin në gropë. Ai kishte punuar disa vjet në armën e Mbrojtjes së Popullit, në informacion, dhe e dinte se si duhej të vepron-te në një rast të tillë.

«Duhen zënë të gjallë», mendoi krejt i ngrirë, si një trung dushku. «Vetëm të gjallë», Po si të veproj? T'u dal drejtpërdrejt me revolver?... Gjakftohtësi... Gjakftohtësi!, — kujtoi atë çast këshillat e komandantit të tij të dikurshëm. — Ata janë të armatosur!. Po kali?! Mos hingëlli jë dreqi! Ah! Ç'bëra! Ta kisha lidhur! Duhet të pres! Duhet të pres! Po sa duhet pritur?!!»

Ata të dy bisedonin me zë normal:

— Tani u gdhë. Ti, si vendali, dil e shih një herë: — Ç'u bënë të tjerët? Duhet të ndërlidhem. E kemi larg atë dreq shkëmb. Apo jemi tamam te vendi?

— Po të ishim, do ta takonim njeriun tonë.

— Ashtu them edhe unë. Prandaj dil e shih një herë. Veç kujdes, mos u largo shumë, se mos ndahemi njëri nga tjetri.

— I njoh këto vende me pëllëmbë! Edhe liqeni, edhe këta pyje, e gjithë ç'të zë syri rrëth e rrötull kanë qenë çifligje të babait. Këtu kam kaluar fëmijérinë time të lumbtur. Këtej, nëpër këto pyje të blertë e nëpër këto ujëra të kulluara, jam rritur. Këtej kam luftuar gjashtë vjet për t'i mbrojtur çifligjet. Po m'i rrëmbyen. Tani duhet filluar nga e para...

Në kohën që do të dilte nga grëpa, u dëgjuau hingëllima e kalit.

— Dreqi të mori!, — e mallëkoi me vete Skënderi, po i erdhi mirë që hingëllima vinte nga larg. Domethënë, sipas tij, kali duhet të ishte atje tej, buzë liqenit!

Ata të dy, me të dëgjuar hingëllimën, brofën në këmbë njëherësh, me automatikë në duar. Pastaj ngrinë, me veshët bigë, duke vështruar njëri-tjetrin.

— Ndonjë fshatar vjen të bëjë dru!, — tha vendaliu, po ai tjetri, që ishte i gjatë e me mustaqe të vogla e ndërpren. — Dil e shih! Po s'pati gjë, më fërshëlle dhe shko drejt e te Shkëmbi i Bardhë! Nuk mund të presim tërë ditën këtu. S'është vend i sigurt.

Tjetri iu bind dhe bëri të dalë nga gropat, po ai i gjati me mustaqe, e këshilloi:

— C'e merr automatikun! Do të të shohë njeri. Mjaft ke revolen.

Shoku e pa shtrembër dhe kësaj radhe nuk iu bind. Shtrëngoi automatikun, i hoqi siguresën dhe shkoi andej nga erdhi hingëllima e kalit.

«Tani duhet vepruar», — mendoi Skënderi kur njëri nga diversantët u fsheh në pyll e tjetri mbeti vetëm, i vëmendshëm e i gatshëm, me armë në dorë, duke pritur sinjalin e shokut të vet.

«Jo, jo tani. Të presim férshëllimën!» — tha me vete Skënderi duke ndier zemrën t'i rrihte fort nga emocioni dhe duke e kupuar se ai që shkoi për të parë kalin ishte i biri i pronarit të këtyre tokave, pyjeve e ujërave...

Dhe ja férshëllima e tij e shkurtër dhe e mprehtë si klithma e vdekjes. Ai i gjati me mustaqe, si e dëgjoi po atë vërvshëllimë edhe një herë, u ul më i qetë pranë aparatit të radios. Atéherë Skënderi mblodhi tërë forcat e tij mendore e fizike. U bë një çast qetësi e plotë, sikur pllakosi vdekja. Atë çast harroi çdo gjë, përvëç atij, diversanti, që po ndizte cigaren me çakmak. U ngrit dhe u lëshua drejt tij. Diversanti nuk arriti të rrëmbejë automatikun, nuk arriti të nxjerrë as thikën e as revolverin, nuk arriti as të kafshojë pilulen me çianur fshehur në jakën e xhaketës. Psherëtiu rëndë me frymëmarrje të shthurur, si para vdekjes, dhe mbështeti kokën në ledh. Skënderi me shpjetësi rrufeje e kishte goditur me myllin e nagantit në tëmth dhe që andej i rridhte një vijëzë gjaku. Por ishte gjallë... Atë çast, nga Shkëmbi i Bardhë krisën armët dhe Skënderi e kuptoi se atje ishin forcat e Mbrojtjes së Popullit...

4.

Jehona e kësaj ngjarjeje u përhap aty nga dreka dhe s'mbeti njeri pa e marrë vesh. Natyra ishte e ngrirë, me gjithëse herë pas here dilte dielli sipër reve të larta e të

errëta. Fshatarët e lanë punën para kohe, rregulluan qetë nëpër stalla dhe u grumbulluan para zyrës së këshillit. Lajmin e kishte sjellë një nga barinjtë e fshatit, që zbriti nga mali pa dhitë. Po njerëzit donin hollësira, kërkonin të dinin fill e për pe ç'kishte ndodhur, prandaj pyesnin njëri-tjetrin, merrnin me hamendje ngjarjen, kërkonin më kot bariun, i cili sa solli lajmin, u kthye përsëri në mal, së bashku me katër-pesë djem të armatosur. I ndoqi ata edhe Qamili, po djemtë ishin të shkathët e të shpejtë, kurse ai një sakat. Mallëkoi zotin e kupën e gjurit dhe u kthye te zyra e këshillit pikë e vrer. Nuk ishte hera e parë që flitej për asgjësimin e një bande diversantësh. Po, në ato anë, ashtu si edhe në Devoll, në Gorë e në mjaft krahina të tjera, diversioni ishte një nga mjetet kryesore të armiqve. Banda të tëra kriminelësh, të preqatitur mirë nëpër shkolla speciale, dërgoheshin në Shqipëri me të gjitha mënyrat: nga ajri, nga toka e nga deti... Atë vit thuhej se ato ishin shtuar. Vinin dimër e verë, aktivizonin të përbysurit, kërcëniston të lëkundurit e të pakënaqurit, vrisnin patriotë e komunistë dhe përpinqeshin të krijonin baza të përhershme. Mirëpo toka u lëkundej kudo nën këmbë, lidhjet u këputeshin, mendja u çoroditej, asgjësoheshin ose kapeshin të gjallë. Forca e heshtur, e madhe dhe e mençme, e popullit i fshinte një nga një e grupë-grupe të gjithë, si ai përrroi i shirave të vjeshtës, që përlan çdo gjë që gjen përpara.

Te sheshi përpara zyrës së këshillit vazhdonin të vinin gjithnjë burra, gra, vajza... Vetëm fëmijët kërcenin të gëzuar duke u hedhur nga çakelli e duke ndjekur njëri-tjetrin. Të rriturit ishin seriozë e të heshtur. Prisnin me një farë dyshimi hollësirat e asgjësimit të bandës. Asnjeli nuk e dinte se prej sa vetësh përbëhej banda, sa ishin zënë të gjallë e sa ishin vrarë dhe nëse kishte pasur ndonjë të vrarë nga tanët. Më e shqetësuar nga të gjithë dukej Rasimeja. Nga pakujdesia, shamia e kuqe i kishte shkarë. Me të mbërritur te sheshi pyeti Lyton, që bisedonte me fshatarët:

- S'qenka Skënderi këtu?
- S'e kam parë fare sot, — iu përgjigj Lytoja.

— Ai më tha mbrëmë se do të vinte në mal për dru,
— shpjegoi Rasimeja.

— Në mal?! — pyeti me shqetësim Lytoja.

— Po, — tha vajza dhe ndjeu rrashjet e zemrës.

— Po aherë do të jetë marrë edhe ai me diversantët...

— Mos i ka ngjarë gjë?!

Vajzës iu drodh pak cepi i buzës kur bëri këtë pyejte,
po askush s'e vuri re.

— Do të ishte marrë vesh. E keqja përhapet shpejt,
— tha i ati, që nuk ishte gazmor si herët e tjera.

— Kryesoja është që kriminelët e patën, — tha Lamja
duke fërkuar pëllëmbët nga gjëzimi.

— Pesëqind grosh vrima e miut për «klapkat»!, —
shtoi Qamili duke parë Nuriun, që kalonte në xhade, hipur
mbi qerren e ngarkuar me pleh.

Atë çast dikush thirri:

— Po vijnë! Po vijnë!

Të gjithë drejtuan kokat nga Dheri i Kuq. Midis atyre
që zbrisnin nga mali, Rasimeja dalloi mirë Skënderin dhe
u gjëzua aq shumë sa desh ra nga çakëlli:

— Po vijnë! Po vijnë!, — u dëgjuan zërat gjithandej:
Ca të rinj ia morën vrapi për t'u dalë përparrë. Pas pak,
një bari i vogël dymbëdhjetëvjeçar, zbathur, lulëkuq në
fytyrë e qull në djersë nga vrapit, mbërriti te sheshi dhe
i pari dha lajmin e gjëzuar:

— Lyto! o Lytoo! Skënderi ka zënë të gjallë një di-
versant! Të tjerët u vranë!

Qamili nxori revolen nga këllëfi dhe e zbrazi dy herë:

— I lumtë djalit! Trimi përshtendetet, ja kështu!, —
dhe e zbrazi edhe një herë drejt qiellit, ku vraponin retë
e ngarkuara me shi.

— Po si e ka zënë, xhanëm?, — pyeti Lamja duke mos
pushuar së fërkuari pëllëmbët.

— Si miun në çark!, — u përgjigj Qamili dhe, si i fryu
tytës, e futi revolen në këllëf. Tani u bë përsëri gazmor dhe
përgjigjet i kishte në majë të gjuhës. Po të kishte raki të
fortë, do të hidhte disa gllënjkë dhe do t'u vinte me siguri
zjarr flokëve të dendur.

U gjallëruan që të gjithë. Në sytë ledhatues të fshatarëve ndritnin yje të bukura gjëzimi. Flisnin me nderim e me adhurim:

- Ja kujt i thonë ushtar i popullit!
- S'e kanë bërë kot komunist!
- Sikur s'na e mbushte syrin, o derrka i derrit. Po qenka tamam katërqind dërhem!, — qeshte Qamili duke bërë zhurmë me mushamanë e zezë.

Kur mbërritën te sheshi Skënderi, Malka e ata pesë djemtë e armatosur, dielli duhej të kishte perënduar, se u errësua shumë. Fshatarët iu derdhën në qafë dhe kush e kush ta përqafonte e ta puthte më parë. E mytën me pyetje dhe ia morën frymën:

Sa ishin? Ku ishin? Ku i pe? Si e zure? Kush u vra? Sa u vranë?

Skënderi s'arrinte t'u përgjigjej të gjitha pyetjeve. Më në fund ua tregoi të gjitha, me hollësi. U tha se te Shkëmbi i Bardhë kishte zënë pritë një repart i Mbrojtjes së Popullit, i cili e dinte që më parë se atë natë do të mbërrinin diversantët. Ishin tre kriminelë atje dhe të tre u vranë. Njëri helmoi veten me çianur. Dy mbetën në vend. Njëri prej këtyre kishte qenë Milo Peçi. Fshatarët u çuditën pa masë;

— Milo Peçi ynë!? Ai specialisti!? Ai i grumbullimit!?

— Po, ore, po, ai!

— T'ëmënë, ç'punon armiku! Po si është e mundur? Kur qenka hedhur ai matanë? Unë s'ka dy javë që e kam parë në qytet.

— Me sa duket ishte ndërlidhësi i tyre...

— Ç'na ka punuar ai qen! Të kujtohet, Skënder, atë ditë kur u zure? I poshtri! Na tani, i hëngri goja dhé!

— Duhej ta kishim zënë të gjallë, — tha Skënderi dhe me kaq fshatarët u shpërndanë duke i uruar me gjithë shpirt natën e mirë...

Kur mbërriti në shtëpi, u habit. Te vija e ujit, para derës gjeti Rasimenë.

— Erdha e i thashë nënës që të mos bëhej merak përtty, — i tha vajza dhe u bë lulëkuqe në fytyrë.

— Falemnderit! — mundi të thotë ai.

— U bëra merak unë... U bëmë merak të gjithë, dhe jo ajo e mjera, — vazhdoi Rasimeja dhe i shtriu dorën. — Po unë e dija që ti je trim, Skënder. Ma thoshte zemra!... Prandaj ma jep dorën!

Ai ia dha duke qeshur.

— Të lumtë — e uroi vajza dhe e vështroi me guxim drejt e në sy. Ishte më tepër se një vështrim miqësor. Ai ndjeu ngrrohtësinë e pëllëmbës së saj, të zërit, të veshtri mit dhe i erdhi mirë që ajo u tregua aq e afërt dhe e dashur me të.

Me t'u larguar vajza, e ëma u dha te dera dhe iu derdh në qafë:

— Po drutë, more trim i nënës, ku i ke?

— Në vend të tyre, të solla një barrë me spinë, — qeshi i biri.

Duke hyrë në kuzhinë ajo e ndiqte nga pas e i tre-gonte:

— Kur më erdhi kali vetëm dhe i pa ngarkuar, desh lojta nga mendtë. Ç'm'u bë im bir?! Mos ma vranë?! Mos ma prenë?!

Ai queshte pa të keq, me zë të lartë...

Ai queshte, kurse Nuriu atë çast ulërinte në shtëpinë e vet. Ulërinte ai dhe me ulërima i përgjigjeshin edhe qentë, që i kishte lëshuar nga zinxhirët më herët se çdo mbrëmje tjetër. Duke hyrë në ahur me një kandil të vogël, u hodhi qeve në grazhd dhe zuri kokën me të dyja duart. Ngjarja e kishte tmerruar dhe shushatur. Ata, miqtë e tij, të cilët atë natë ose në një nga netët e ardhshme do t'i kishte në shtëpi, ishin vrarë. Ishte vrarë edhe Milo Peçi! I ziu ai! I mjeri ai! Vdiq me zemër të trishtuar, pa parë një ditë të bukur e të gëzuar, që kur u vendos ky pushtet. U hodhi një vështrim qeve e lopës që përtypeshin vazhdimisht shtrirë mbi kashtë, i përkëdheli vithet kalit, që dremiste më këmbë dhe, duke mos u përbajtur dot, filloi të mallëkojë me gjithë shpirt të gjithë ata që e katandisën në atë ditë. Mallëkonte, pështynte dhe përplaste këmbët në truallin tërë pleh e kashtë të kalbur. Trualli gjëmoi papritur dhe atëherë iu kujtua se pikërisht aty, te ajo qoshe e errët, ishte një gropë e thellë. Në atë gropë ai kishte bërë një

hambar dhe në atë hambar kishte fshehur kuintalë të tërë me drithë. Iu kujtua dhe arka e vogël që e ruante diku, nën shkallët e vjetra të hajatit. Në atë arkë, mbështjellë me një mushama të dyllosur, ai kishte të gjitha tapitë e shtëpisë e të tokave dhe një fletore të vogël, ku kishte shënuar emrat e fshatarëve që i kishin borxhe të pashlyera, kush një kilogram misër, kush një dele, kush një teneqe me vajguri e kush një grusht me para. Borxhet ishin anuluar që kur u vendos pushteti. Reforma Agrare kishte tre vjet që ishte bërë, po ai i ruante ato dokumente si relike të shenjta dhe do t'i ruante gjersa të vdiste se «botë është, e s'dihet se ç'ngjet nesër!» Iu kujtua edhe arma e rëndë, me gjithë radhët e fishekëve që kishte fshehur po aty, nën shkallët, dhe ndjeu sikur u çlirua nga ankthi e nga tmerri.

— I vaftë shpirti në xhenet!, — uroi për Milo Peçin dhe e kuptoi se u bë më mirë që u vra se sa të ishte zënë i gjallë. I vdekuri i merr me vete në varr të gjitha të fshehtat, kurse i gjalli edhe mund të tregojë.

Hyri në dhomë me një vendim të prerë: gjer në frymën e fundit, edhe sikur të mbetej fill i vetë, do të luftonte për rikthimin e parajsës së humbur. E shoqja dhe e bija qëndronin më këmbë të lemeritura dhe nuk ia hiqnin sytë buzëve të tij, që lëviznin pa pushim e nuk nxirrin asnijë fjale.

— Le që nuk jam vetëm! Nuk jam vetëm! — tha më nё fund me zë, pa iu drejtuar njeriu duke i shkuar mendja te zoti Niko, dhe urdhëroi të shtronin sofrën.

Le që nuk jam vetëm! Nuk jam vetëm! — tha më nё fund me zë, pa iu drejtuar njeriu duke i shkuar mendja te zoti Niko, dhe urdhëroi të shtronin sofrën.

1. KAPITULLI VI. është e fushatuar që së paktën është një kohë kur tani, si-
domos të rintjtë, e vështronin plakén që mblidhët lecka
të vjetra dhe talleshin me të. Po kjo nuk zemërohej dhe

Tërë javën e dytë të muajit rai shi dhe mbjelljet u
vonuan. Fshatarët rrinint nën strehët e shtëpive, nën pemët
dhe prisin më kryet lart mos hapej qielli. Nganjëherë,
sikur ta kishin bërë me fjalë, grumbulloheshin në zy-
rën e këshillit popullor dhe bënин biseda të zgjatura, ose ia
merrnin këngës, po shiu s'pushonte. Nuk pushoi as kur mag-
istricha e fshatit, më plaka e të gjitha plakave, Hallo Mud-
ja, doli në lëmë me ca shkarpa e lecka, që i mblodhi qosheve
të errëta, dhe u mundua më kot t'i ndizte nën shi, duke
mërmëritur fjalë pa kuptim. Ajo ishte «doktoresha» e fshatit
për të gjitha sëmundjet. Me magjira të çuditshme largonte
gjoja xhindet nga hatullat e shtëpive e nga shpirtrat e nje-
rëzve duke i ndjekur me shkop, shëronte ata që vuanin
nga kukunjtë, i pështynte ata që binin mësysh, u këndonte
grave që s'lindnin dhe lopëve që fryheshin nga jona-
xha e njomë dhe më në fund, netëve të kthjellta, i nxirrte
te pragu i portës fëmijët që digjeshin zjarr nga temperatura
e lartë, i urdhëronte të vështronin qiellin me yje dhe
ua fërkonte gushën me dy thërrime kripë...

Ishte një kohë kur të gjithë i besonin kurse tani, si-
domos të rintjtë, e vështronin plakén që mblidhët lecka
të vjetra dhe talleshin me të. Po kjo nuk zemërohej dhe

nuk i mallëkonte. Ekte gati e kërrusur më dysh, me duart lidhur prapa, me buzët futur krejt në gojën pa dhëmbë dhe nomatiste e bindur se u bënte mirë njerëzve e kafshëve...

Tërë atë javë, ata të dy, Rasimeja dhe Skënderi sikur ta kishin bërë me fjalë, gjendeshin pranë njëri-tjetrit, herë nën strehë, herë nën pemë, herë te zyra e këshillit.

— Hallo Mudja po përpinqet të ndalojë shiun, — i tha ajo një ditë kur e pa plakën të kërrusur në një bahë duke u fryrë shkarpave të njoma.

— Po të na shohë të dyve do të na mallëkojë.

— E pastaj?

— Asgjë...

— Të gjitha magjitet e saj janë të lashta e të kota, megjithëse nuk është plakë e keqe. I bën për të mirën e përgjithshme.

— Ka njerëz që i besojnë ende...

— Ne do të punojmë që të vijë sa më shpejt koha kur të mos i besojë asnjë.

— Na pa, Keno! Po na mallëkon!, — qeshi ajo dhe me sytë e saj të mëdhenj e të kthjellët e pa djalin drejt në fytyrë.

Rasimeja e shqiptoi emrin e tij jo si ngaherë dhe ai e kuptoi se vajzës i vinte turp të thoshte atë që ndiente. Pa dashur, i preku gërsheetat dhe vuri re në faqet e saj po atë ngjyrë të kuqe që e kishte parë sa herë që bisedonte vetëm për vetëm me të.

«Ngjyra e kuqe! Turpi i vajzës që dashuron» mendoi ai dhe, si ia ledhatoi me dashje gërsheetat, ia mbështeti pëllëmbën në sup.

Ishte hera e parë në jetë të tij që ndiente aq pranë frysmin e vajzës që dashuronte dhe zemra i rrahu fort.

Shiu binte me rrëmbim. Hallo Mudja përpiquej ta pu-shonte me magjirat e saj boshe e pa kuptim. Ata rrinin nën një rrap të moçëm dhe nuk guxonin të flisnin hapur. Kur ai ia mori kokën dhe donte t'ia mbështeste te supi i vet, vajza kundërshtoi me tmerr në sy. Në ato anë nuk e kishin zakon as të putheshtin e as të bënin ato që mundohej të bënte ai.

— Kujdes!, — i tha ajo. — Në rrugë kalojnë njerëz!
— E pastaj?!

Ajo nuk iu përgjigj po vrapoi nëpër shi, pa kthyer kokën.

Të nesërmen Skënderi e kërkoi gjithë ditën, po nuk e gjeti as në rrugë as te zyrat e këshillit, as në dyqan. Nga dreka shiu pushoi dhe fshatarët u derdhën në fushë për të kulluar ujërat nga arat me grurë. Kjo ishte puna më e rëndë dhe më e lodhshme nga të gjitha punët në fshat. Njerëzit futeshin në baltë gjer nën gju dhe hapnin kanalet kulluesë. Balta ngjitej në lopatë si tutkall dhe rëndonte si plumb. Ishte njësoj sikur të shkulje ndonjë trung me rrënë. Që në lopatat e para fshatarët nxeheshin, balli u mbushej me bulëza djerse. Ata shfrynin bullçitë duke tundur kryet dhe pikat e djersës u binin përdhe, si shi. Po kush pyet për lodhje e punë të rëndë, kur është fjala për të siguruar bukën e gojës?!

Shiu filloj përsëri. Hallo Mudja doli përsëri në bahçe. Po fshatarët nuk e ndërprenë punën. Kanalet hapen edhe kur bie shi. Puna është që uji të kullojë, të mos kalbet gruri e të bëhet buka...

Ata u kthyen të dy, me shatat në supe. Ishin bërë quall dhe tërë baltë. Para se të ndaheshin qëndruan nën një strehë dhe atëherë ai, ia mori dorën dhe i tha me një frymë:

— Rasime! Unë të dua... për nuse!

Vajza shtangu, si e ngrirë dhe ndjeu që e mbuloi të kuqtë. Zemra iu përpelit, sikur në krahëror të mos kishte vend për të e të donte t'i fluturonte përjashta.

Shiu binte me rrëmbim. Hallo Mudja i vështroi me ato bebëzat gati të shuara, diçka mërmëriti dhe vazhdoi magjitet e saj. Me siguri i mallëkoi dhe u ndollti të keqen.

Vajza nuk kishte më guxim ta shikonte në sy. Po më në fund buzët i lëvizën dhe tha shpejt e shpejt, me mbytka në fyt:

— Edhe unë të dua, Keno!, — dhe vrapoi nëpër shi duke mbuluar fytyrën me një dorë, sikur të kishte bërë ndonjë turp të madh. Vraponte aq shumë e me kokën ulur, sa desh u përplas me Lyton, që i doli përpara pa-

pritur, aty, pranë gardhit të shtëpisë së saj. Djali ia preu rrugën dhe i tha duke qeshur:

— Qenke bërë qull, moj e mjerë?! Rasime!...

Ajo nuk iu përgjigj. I hodhi një vështrim të shpejtë dhe hapi derën e shtëpisë. Lytos iu duk sikur ajo kishëtë sytë me lot dhe për një çast i mbetën në mendje gërshtat e saj të gjata e të qullura dhe shamia e kuqe, që i kishte shkarë nga koka.

Të nesërmen mori vesh të vërtetën. Ndjeu një farë pikëllimi, po e ndrydhi thellë në shpirt dhe nuk ia hapi zemrën asnjëriu.

Ishte me Skënderin në zyrë. E pyeti:

— Më dukesh si pa qejf sot. Ç'ke?

Skënderi buzëqeshi:

— Përkundrazi! S'kam kurrgjë dhe e ndiej veten mirë...

— Thashë se mos u ftohe dje në fushë. Tërë ai shi dhe tërë ajo punë e rëndë...

— E rëndë vërtet...

Biseduan për kohën e keqe, për grumbullimet që kishin ngecur, për bandën e diversantëve dhe qeshën një copë herë me marrëzitë e Hallo Mudes. Pastaj u kthyen përsëri te çështjet e tyre intime e personale. Skënderi vendosi t'i tregojë çdo gjë për lidhjet e tij me Rasimenë.

— Dëgjo, Lyto! — tha Skënderi dhe i hodhi dorën në sup. — Unë s'të mbaj gjë të fshehtë. Të kam shokun më të ngushtë e më të dashur. Unë me Rasimenë duhem dë do të martohemi.

Lytoja e ndrydhi dhembjen dhe e ktheu me shaka:

— Dreq! Vajzën më të mirë na more!

U ngrit dhe e përqafoi:

— Ta them me gjithë zemër. Të trashëgohesh!

2.

Koha ishte shumë e paqëndrueshme, xanxare, si e quanin fshatarët, po më në fund u hap dhe tërë ditën diellin nuk e errësonët asnjë re. Ato ditë parcela të tëra me grurë

morën ngjyrën e blertë më të errët, kurse bimët e vona, që ishin mbyllë ato ditë çatisën të shëndetshme, me bisqet e freskëta e të mprehta drejt qiellit. Megjithatë ishin vonë me mbjelljet dhe me punimin e tokave. Traktori, dy ditë, për shkak të shirave, nuk u ndez fare. Po e pengonin atë edhe gjerdhet, edhe dobësitë e organizimit. Komunistët ankoheshin me hidhërim.

— Dy ditë nuk hapi asnje brazdë, kur fshatrat e tjera e presin, — tha Malka i zemëruar. — E dini ç'do të thotë dy ditë?

— Këtë duhet ta kishim menduar më parë, e ndërpren Skënderi.

— Bëmë gabim. Duhet ta kishim futur në ato arat rrëzë kodrave. T'i kishim bindur të zotët. Në fund të fundit ato toka i përfituan nga Reforma, — tha Lytoja, i dëshpëruar edhe ai, dhe i këshilloi shokët të punojnë me të gjitha forcat se grumbullimi i tepricave ishte një ligj i ri, i domosdoshëm që çelikos lidhjet me klasën punëtore dhe forcon shtetin, se ishte plumb për armiqtë, që vazhdonin të hidhnin diversantë edhe në pyjet e tyre. Mirë e thotë populli: «Uji fle, hasmi s'fle!».

— Me këto fjalë në gojë Lytoja u largua.

Po ja, ditët erdhën përsëri të kthjellta, traktori gumezhiu dhe njerëzit u derdhën arave.

Skënderi u kthyte atë mbrëmje i lodhur por edhe i gëzuar. I kishte lëruar tokat e veta dhe të nesërmen do t'u hidhte farën. Pa u ulur mirë, e ëma, e gëzuar edhe ajo nga ky lajm, i solli legenin dhe ibrikun me ujë.

— Hajde të të shtie, — i tha ajo.

— Të kam thënë që të mos më përkëdhelësh, kështu, sikur jam fémijë. Nëma ibrikun, se lahem vetë, — qeshi ai, dhe doli në oborr, pastaj u kthyte duke fshirë fytyrën e lagur.

E ëma ia kishte shtruar darkën.

— Kur i preqatit këto gjëra kaq shpejt?, — u habit ai.

— Léri! Gjizë e presh! Dhe ca fasulka që tepruan nga dreka. U plaka unë tanë. S'më bëjnë duart. Më duhet nusja në shtëpi.

Fjalët e fundit i theksoi në mënyrë të veçantë duke i hedhur të birit një vështrim kuptimplotë. Ai filloj të hajë në heshtje. Ajo ia tha troç më në fund:

— Martohu, more bir! Ç'pret më? S'ia ke shtënë syrin ndonjërës? Fshati ka boll çupa të mira. Ja, ajo... — u mendua pakëz dhe shtoi, — e Qamilit.

— Rasimeja? — pyeti ai pa e shikuar nënën.

— Xhevahire është! S'e ka shoqen! E urtë, e sjellshme, duarartë...

Skënderi vendosi t'i flasë hapur:

— Të pëlqen ty?, — e pyeti.

— S'ka të dytë.

Ajo qëndronte më këmbë dhe nga buzëqeshja i qenë thelluar rrudhat anës syve. U ul pranë tij dhe e pyeti me zë gati të heshtur:

— Po mirë, thuaji nënës, ke gjë me të?

Ai qeshi e tha me zë të lartë:

— Diçka lot, o nënë! Lot!

Ajo iu derdh në qafë me lot në sy dhe e puthi më ballë:

— E dija unë! Ma ndillte zemra!

— S'di a do të pranojë dajë Qamili...

— E ku do të gjejë dhëndër më të mirë?! Që nesër do t'i dërgoj mblesin.

— Më mirë ec vetë!, — e këshilloi Skënderi.

— S'bën, bir. Domosdo duhet mblesi, — nguli këmbë ajo.

— Thuaji se kanë ardhur kohë të reja, po që unë jam marrë vesh me të bijën, asnjë fjalë, se do t'i vijë rëndë e do të zemërohet.

— Ç'më bëre mua, ndonjë budallaçkë? Po sikur s'më vjen mirë që t'i shkoj vetë.

— Hajde, se s'ka gjë! Molloisja ashtu, si të dish.

Ajo e puthi përsëri dhe ia lagu faqet me lot gëzimi.

Ranë për të fjetur, po nënën s'e mori gjumi gjer ndaj të gdhirë. Vërtitej nën jorganin e trashë dhe shpesh, me vështrimin nga dritarja e vogël, vinte veshin se mos këndonin gjelat. Po në errësirën e plotë dëgjohej vetëm tik-

-taku i sahatit, që ishte mbi oxhak, dhe frymëmarrja e rregullt e të birit.

— Natë e gjatë sonte! S'po gdhihet, — mendoi. — Edhe ky sahat, punon e punon, po, me sa duket, akrepët s'i lëviz fare, ndryshe do të ishte gdhirë me kohë... Si do t'ia them?! Turp është që do të shkoj vetë... Fundi i fundit, punë e madhe! — Mirë thotë birkë e nënës: kanë ardhur kohë të tjera...

Diçka iu kujtua. Mengadalë, për të mos e zgjuar të birin, u ngrit dhe nëpër terr hapi kapakun e sëndukut. Nxori prej tij shaminë që i pat sjellur i biri, e vuri nën jastëk dhe u shtri përsëri në shtratin e ngrohtë.

Dridhej nga gjëzimi e lumturia që ia kishte arritur asaj dite dhe i kujtohej koha kur qe martuar vetë. I dukej një kohë tepër e largët. Diçka kishte harruar, diçka i qe ngatërruar, po thellë në shpirt edhe tani i rrinin zgjuar kujtimet... Mendonte si do ta vishte djalin dhëndër, si do t'i priste miqtë e shokët e tij në dasmë, si do ta mësonte nusen me punët e shtëpisë, se njeriu i ri në shtëpi të tjetrit është si i huaj. Ndante me mend punët e shumta midis vetes dhe nuses së ardhshme. Pulat e miskat do t'i kishte kujdes vetë, se zoqtë, sidomos ato miskat e misrokët e shushatur, duhen rritur si fëmijët, duke i ushqyer në pëllëmbë të dorës. Edhe kopshtin do ta kishte kujdes vetë, se nusja do të lodhej shumë po të punonte edhe në fushë edhe në kopsht. Sa për gjellët, sigurisht që do t'i gatuante vetë, se të rejet, jo vetëm që harxhojnë shumë vaj e gjalpë, po edhe gjellën s'e bëjnë që s'e bëjnë të shijshme. Edhe dhitë, domosdo, do t'i milte vetë, se janë mësuar me të. Po t'i prekë tjetër njeri gjinjt e tyre, ato ta përbysin gobellën, ta derdhin qumështin e ta bëjnë të kegen. Sigurisht, kosin do ta zerë vetë dhe vetë do ta tundë për t'i marrë gjalpin e për ta bërë dhallë. Sa për zahiretë e dimrit, si gogozharet me lakër, piperkat me gjizë, armeja që duhej toçitur vazhdimisht, dukagjini që e do sinapin me shumë karar, rosnickat, petkat, trahanaja, pekmezi, të gjitha këto janë punë të vjehrës dhe vetëm të vjehrës.

— Epo mirë, — mendoi, — po t'i bëj unë këto, q'i mbe-tet nuses për të bërë?

Dukej se nuses s'i mbetej asgjë.

Qeshi nën jorgan e tha me vete e gjëzuar:

— Po ajo do të bëjë fëmijë! Ja q'do të bëjë ajo: fëmijë! I pari do të jetë djalë. Iu bëfsha kurban! Do të më thërrasë gjyshe, kurse këtij, — ktheu kokën nga i biri, që flinte i qetë dhe mbasse shihte ndonjë ëndërr të bukur, — këtij «babë»! Emri ndo t'ia vëmë Zalo. Do të ngjall tim shoq. Zalo, o Zalo ditëshkurtri! S'të lanë të bëheshe gjysh! S'të lanë armiqjtë, o burrë, që u bëfshin def! Të vranë, o Zalo!, — asaj iu mbushën sytë dhe e lagu jastëkun e fortë me lot të kripur e të hidhur. Pas pak e mblodhi veten, e largoi helmin e vdekjes së burrit dhe u kthyte përsëri te lumburia. — Pastaj nusja do të bëjë fëmijën e dytë, — mendoi duke fshirë sytë me pëllëmbë. — Edhe ky djalë do të jetë. Po i treti? Edhe i treti djalë. Tre djem! Sa mirë! Më mirë djem. Ç'i do çupat?! I rrit me një mijë halle e mundime dhe një ditë vjen i biri i botës nga ana e anës dhe ta merr, sidozot ne Qamilit!

Duke përmendur këtë emër, i shkuant mornica në-për trup dhe iu bë një si lëmsh në fyt. I vinte shumë rëndë që do t'ia kërkonte vajzën vetë dhe s'dinte se si do t'ia thoshte. Kishte frikë se mos e katranoste. Më në fund u kthyte më krah e tha me vete:

— Do t'ia marrim, patjetër! Qamili atë kokë kishte. Vajti e bëri çupa!

Nganjëherë tulitej dhe nuk lëvizte fare. Nganjëherë, frap ia bënte jorganit dhe vështronte dritaren ose orën. Pastaj mendimet iu bënë lëmsh dhe ndaj të gdhirë e mbërtheu gjumi. Kur u zgjua, dielli kishte dalë dhe Skënderi kishte shkuar në fushë.

E priti mbrëmjen, siç pret beharin e ngrrohtë një plak që ka vuajtur tërë dimrin nga reumatizma. Po dita iu duk tepër e gjatë, sikur të ishin mbledhur disa ditë së toku. Kur po perëndonte dielli, lidhi mirë e bukur shaminë e re, ia lëshoi çipat përpara, që të dukej më mirë, u pa te xhami i dritares dhe u nis duke ndier gëzim e shqetësim së bashku.

Qamili porsa kishte mbaruar së ngrëni darkë dhe po pinte duhan me çibukun e tij të vjetër e gati të djegur. Kushedi sa herë i kishte thënë e shoqja që ta hidhite atë dreq, që i dukej në gojë si ndonjë copë karthje, e të pinte duhan me çibukun e ri, që i kishte dhuruar Lytoja. Po Qamili, pér inat të së shoqes, e ruante atë si sytë e ballit në xhepin e jelekut dhe nuk e përdorte. Me të hyrë e éma e Skënderit, pa luajtur nga vendi, i tregoi këndin dhe i hodhi një vështrim të shpejtë shamisë së re.

— Kemi habere të mira, — mendoi dhe e shkundi çibukun në vatër.

Nëna u përshëndet dhe, duke mos ditur si ta fillonte bisedën, trazoi kot zjarrin me mashë. Rasimeja, e shpejtë dhe e lehtë si flutur, u bëri kafenë prej elbi dhe u ul pranë tyre. Nëna e vështroi me çip të syrit dhe iu duk mjaft e shqetësuar. E shoqja e Qamilit, ajo selvia e heshtur dhe e qeshur, që s'e prishte zemrën kurrë pér gjëra të vogla e të parëndësishme, vuri fëmijët në gjumë dhe u ul në krah të mysafires, e cila rrinte si mbi gjemba. Nëna ndiente se koha po kalonte, se po bëhej vonë dhe se kështu s'kishte pér të bërë gjë prej gjëje. E pengonin e shoqja e Qamilit dhe sidomos Rasimeja. Nuk donte të fliste në sy të tyre. Këto gjëra kaq të rëndësishme sa më pak njerëz t'i dinë aq më mirë është. Prandaj biseda vërtitej ireth punëve të fshatit. Folën pér mbjelljet, pér sistemin e ri të furnizimit e të grumbullimit, pér «kllapkat». Kujtuan kohët e rënda të luftës, sakrificat, të rënët. Bënë parashikime se si do të ishte dimri i ardhshém dhe gjer në q'muaj do t'u arrinin zahiretë. Nëna bënte çmos që t'i përcillte me marifet gratë, sidomos Rasimenë, mirëpo truri atë mbrëmje i ishte mpirë krejt dhe nuk i pillte gjë. Donte të kërkonte një gotë ujë, por ajo porsa kishte pirë kafenë dhe ujë pas kafesë mund të kërkojnë vetëm fëmijët. Më në fund e bëri zemrën gur dhe iu drejtua Rasimesë:

— Më sill një kupë ujë të ftohtë, moj çupë, se m'u tha xhani.

Vajza, si era, shpejt e shpejt i solli bucelen.

— Ç'i jep atë?!, — e qortoi i ati. — Shko e mbush taze
në çesmë.

«U, more Qamil, të lumtë goja, — mendoi plaka kur
vajza doli me stomnat në duar. — Po kësaj si t'ia bëjmë?».

Qamili, sikur ta kishte kuptuar mendimin e mysafires,
iu drejtua së shoqes:

— Shko e u hidh qeve, se nesër do të lëroj që me sa-
bah.

— Tani t'u hedh! — pyeti e shoqja duke qeshur, pa
kuptuar se ku rrihte çekani.

— Kur të thonë shko, shko!, — e urdhëroi i shoqi dhe
ia bëri me kokë nga dera.
Ajo u bind.

Si mbetën vetëm, Qamili nxori nga jeleku çibukun e
ri, e mbushi me duhan dhe, duke e ndezur me eshkë, ia
hodhi sytë shamisë së mysafires dhe pastaj fytyrës së saj
që shprehte mëdyshje. Dukej sikur i thoshte: «Edhe unë
kam diçka të re, jo vetëm zotrote. Po më mirë na thuaj
hapur, përsë na urdhërove!»

E thithi çibukun me èndje, u mbulua me tym-dhe iu
kthyesh gruas, drejtëpërdrejt:

— E po, hair ishallah! Urdhëro e fol! Po të dëgjoj.

Nëna e Skënderit ia solli rrotull, megjithëse i zoti i
shtëpisë i doli në shteg dhe dukej sheshit se diçka kishte
nuhatur.

— Po ja, more Qamil, m'u rrit djali. M'u bë për të
martuar, po s'më fle mendja asgjékundi. Djalin e kam të
mirë, ti e di vetë.

— S'e ka shokun! Trim!, — ia preu ai. — Mirë e ke
menduar. Martesa i mbledh djemtë.

— Po s'më fle mendja.

Ata kthenin kryet shpesh nga dera. Të dy nuk donin
që ndokush t'u ndërpriste bisedën.

— Vajza ka plot, — i tha Qamili me këmbën sakatë
shtrirë si shkop drejt zjarrit. — Zgjidh e merr! Veç të
gjakut tënd, e jo të kllapkave.

— Si do të marr unë te kulaku! Meazallah! Sikur të
përmbyset bota. Kurrën e kurrës!

— E them, se ka ndonjë që është futur në atë halë!

Po mirë, atij, t'yt biri, s'i ka vajtur mendja më ndonjë? S'e ka zgjatur dorën një çikë në tërë këtë tufë e të rrëmbente ndonjë?

— Bah! Im bir s'është ujk që të rrëmbejë nga tufa! Ti e di ç'djalë kam. Ai s'bën kurrgjë pa nënën.

— E them, se ka ndonjë që zgjedh vetë e s'na pyet fare ne pleqtë.

— Tani, ç'është e vërteta, kohët kanë ndryshuar, o Qamil.

— Ke hak! Kohë të reja kanë ardhur.

Plaka qeshi:

— Tani ka edhe të tillë që s'dërgojnë mblesë, po shkojnë vetë ose dërgojnë nënën a babanë tua mbarojë punën.

Nëna ndreqi shaminë. Qamili e kuptoi ku donte të dilte ajo dhe priti me padurim fjalët e fundit. Të dy rrin si mbi gjemba. Në oborr u dëgjua trokëllima e nallëneve.

— U kthyen ato, — tha Qamili për të shoqen e për të bijën. — Bjeri shkurt!

Nëna nxori një psherëtimë të zgjatur dhe tha shpejt e shpejt:

— Vajzë të mirë ke, o Qamil, shumë vajzë të mirë. Do të më mbetet merak po ta martoj **djalin** me ndonjë tjetër, — dhe iu duk sikur shkarkoi një barrë shumë të rëndë.

Ai thithi çibukun kaq shumë sa koka e vogël me flokë të dredhur iu mbulua me tym për një çast. Sytë e vegjël i ndritën. Donte të thërriste, po e mbajti veten. Më në fund tha:

— S'kam kundërshtim. Qoftë për hair!

Ajo i zgjati dorën që i dridhej lehtë:

— Po Rasimeja ç'do të thotë? Duhet pyetur çupa...

— Cupën e pyesim ne. Ajo s'bën kurrgjë, pa babanë.

Ata ia shtrënguan duart njëri-tjetrit dhe nuk ndaheshin.

— Po dasmën, kur ishallah?, — e pyeti gruaja me sy të përlotur. — Pas të korrave?... Në vjeshtë të tretë?

— Ashtu qoftë! Të na trashëgohen!, — s'u përbajt më Qamili.

— Na u trashëgofshin!, — dhe nënës i rrodhën lot në-për faqe.

Ata u ngritën dhe u përqafuan, të gjuar e të lumtur, duke pérzier flokët e thinjur. Nëna iku me të shpejtë, që t'i conte djalit lajmin gazmor. E shoqja e Qamilit, kur u kthye, e gjeti të shoqin vetëm, më këmbë, pranë oxhakut.

— Bah! Po kur iku? Ajo s'piu as ujë?!, — u habit gruaja.

Qamili lëvizi, zëri i tij kishte tinguj gazmorë:

— Në dasmë do të pijë, raki dhe jo ujë! Tani, më parë, ma sill shishen, se më ka marrë malli t'u vë flakën edhe një herë leshrave të mia... Pastaj do të të them se Rasi-menë e fejova me Skënderin e Zalos!

Na u trashëgofshin!, — dhe nënës i rrodhën lot në-për faqe.

Ata u ngritën dhe u përqafuan, të gjuar e të lumtur, duke pérzier flokët e thinjur. Nëna iku me të shpejtë, që t'i conte djalit lajmin gazmor. E shoqja e Qamilit, kur u kthye, e gjeti të shoqin vetëm, më këmbë, pranë oxhakut.

— Bah! Po kur iku? Ajo s'piu as ujë?!, — u habit gruaja.

Qamili lëvizi, zëri i tij kishte tinguj gazmorë:

— Në dasmë do të pijë, raki dhe jo ujë! Tani, më parë, ma sill shishen, se më ka marrë malli t'u vë flakën edhe një herë leshrave të mia... Pastaj do të të them se Rasi-menë e fejova me Skënderin e Zalos!

—
—
—
—
—

Sapo ra nata e errët. Nuriu lëshoi qentë dhe u mbyll
në njérën nga dhomat e katit të sipërm ku zjarri flakëron-
te. Që kur kishte ndodhur vrasja e Milo Pegit, ai kthehej
në shtëpi pa perënduar dielli, rregullonte kularët në stre-
hë, u hidhte bagëtive bar të thatë dhe mbyllej në atë dho-
më të vogël e të ngrohtë. Dritaret ishin mbuluar mirë me
perde të trasha, që të mos binte drita përjashta. Rrinte aty
me orë të tëra duke pirë raki e duke ngrënë veten me
dhëmbë. Ishte pa qejf, i qe prishur rehati dhe gjumi i qe
prerë. Shpesh ngrinte cepin e perdes dhe për një kohë të
gjatë, i dëshpëruar e i menduar, shikonte se si shuheshin,
një nga një, llampat e kandilet me vajguri. Dhe kur nuk
kleitte më asnjë dritë, sillej poshtë e lart dhomës, si ndonjë
i çmendur. Dërrasat e dyshemesë kërcisnin nën peshën e
tij. Diku, nëpër hatulla këndonte një kukuajkë, sikur
ndillte vdekje. Larg, nga kodrat e buta, vinte zhurma mo-
notone e traktorit. Jaçja nuk i vinte më në shtëpi dhe ai
e ndiente veten krejtësisht të vetëmuar. Ishte edhe i dërr-
muar nga puna e rëndë. Dikur tokat ia punonin hyzmeqa-
rët, bagëtitë ia kullandritnin hyzmeqarët, drutë ia sillnin
nga mali po ata. Po atë ia bluanin grurin... Kurse tani çdo
gjë e bënte vetë. Ç'është e vërteta, e ndihmonin shumë e
shoqja dhe e bija, po atij i dukej sikur punët e tyre brenda-
përbrenda shtëpisë ishin aq të zakonshme e pa rëndësi,
sa nuk ia lehtësonin aspak peshën e rëndë të barrës. Po,

megjithëse i vetëmuar, punonte si kalë. Atë ditë, për orë të tëra, mbeti i kërrusur më dysh, duke hapur kanale ku lluese në një arë me grurë pranë shtëpisë. Gruri ishte i mbarë, filizat e shëndetshëm shndrisnin tërë blerim në atë tokë të shkrifët e pjellore. Dikur, kur atë arë ia punonin hyzmeqarët, ai i vështronte nga dritarja me sy që i shkëlqenin nga kënaqësia, kurse tani ndiente hidhërim e dëshpërim dhe i çante beli nga mundimi.

Në çaste dëshpërimi të thellë mendonte për sabotime dhe atentate. Edhe atë natë fjalët e para që i tha Jaçes, të cilin e thirri vetë, kishin të bënин me sabotim.

— Do të shkosh tani dhe do t'i heqësh ndonjë hallat! Traktori duhet prishur!

Jaçja, që kishte vajtur fshehurazi, rrinte si i hutuar.

— Si t'ia heq kur nuk di?

— Ja ashtu! T'i bësh ndonjë gjë, bjeri me vare, thyeje, ose hidhi rërë në karburant si na porositi i ndjeri Milo.

Me të dëgjuar këtë emër Jaçja u drodh. Iu kujtua Shkëmbi i Bardhë. Po sikur të ishte zënë i gjallë Milo Peçi?

— Do të kishim rënë brenda e do të na kishte marrë lumi, — psherëtiu Jaçja si një njeri që shpëton papritur nga një rrezik shumë i madh.

— Nuk duhen harruar fjalët e të ndjerit. Do të bëhet luftë përsëri. Ty, o Jaçe, do të të bëj oficer!... Po tani atë traktor s'e dëgjoj dot... S'është puna te traktori, po te besimi. Prishet makina, prishet dhe besimi i fshatarëve te pushteti. Kudo punojnë, vetëm ne flëmë. Janë shpërndarë fletushka nëpër kinematë. I pari hidrocentral, ai i Selitës, s'po ngrihet dot, se njerëzit tanë sabotojnë. Po kështu në kënetën e Maliqit, në Rubik, në Kuçovë, në hekurudhë... Vetëm ne flëmë. A dëgjon?

— Dëgjoj, dëgjoj, — përgjigjej Jaçja si nëpër gjumë.

— Epo, ç'pret akoma? Mbush një torbë me rërë dhe nisu!

— Mos po shpejtohem, aga Nuri?

— Jo! Jemi vonuar! Vetëm ne vonohemi! Do të kujtojnë se ua prishën diversantët. Edhe zoti Milo nuk do të mendojë keq për ty... Më lajmëroi se do prova nga ti, ndryshe...

Më nё fund Jacja u bind, mbushi hejbetё me rёrё bu-
зё lumit dhe shkoi te kodrat e ulёta. Ishte qetёsi e plotё
dhe errёsirё. E gjeti traktorin mbanё njё are dhe e zbrazi
njёren nga hejbetё nё serbator. Tjetrёn e hodhi nё fuçinё e
karburantit. Pastaj goditi me njё shufёr hekuri motorin,
po zhurma qe aq e madhe, sa ai u tremb dhe u hodh nё
xhade. Tamam aty, si bёri disa hapa, njё njeri me kasketё
i doli pёrpara:

— Ti Jaçe qenke? Nga vjen kёshtu?...

— Dola pёr kontroll. Po ti, o Malkё!, — u pёrgjigj
Jaçja me zemёr tё ngrirё.

— Isha te Qamili. I urova fejesёn e vajzёs...

Gjysmё ore mё vonё, nёpёr errёsirё e plotё, Jaçja
kapёrceu gardhin e kopshtit dhe hyri nё shtёpi. Nuriu nuk
ia vuri re fytyrёn e zverdhur. Ia shtrёngoi dorёn dhe e uroi:

— Tё lumtё. Mezi bёre njё punё tё paqme! Nesёr ja
dёgjojmё avazin...

— Ç'avaz?!, e ndёrpree Jaçja dhe Nuriu e kuptoi nga
tё folurit se diçka i kishte ndodhur.

— Ç'ke kёshtu?! U trembe? Apo tё pa njeri?, — e
pyeti i shqetёsuar.

— Malka, — tha Jaçja duke marrё frymё me vёshtirё-
si. Vuri dorёn nё zemёr dhe perёndoi sytё sikur po hiqte
shpirt.

— Po fol, more!, — urdhёroi Nuriu. Nga lёvizjet e tij,
flaka e kandilit u lёkund dhe hijet u drodhёn mbi muret.

— Mё pikasi...

— Si?

— Po, po. Mё pikasi. Po bёri sikur s'vuri re gjё.

— E pe mirё ti? Shiko se mos tё bёnё sytё nga frika...

— E takova kur dola nё xhade. Mё pyeti ku isha.

Jaçja e kishte humbur toruan dhe u bё gati tё dalё.
Nuriu e kapi pёr krahu:

— Ku vete?, — e pyeti. — Tё ёshtё bёrё ferra Brahim!
Dale njё herё ta pleqёrojmё!

— Mbaroi edhe puna ime!, — Jaçja shtoi edhe diçka tё
pakuptueshme dhe zbriti shkallёt. Nё çardhak Nuriu e pёr-
fshiu pёr jake.

— Mё lёrё, aga Nuri, aman! Mё piu e zeza.

Nuriu e futi me zor dhe e mori me të mirë:

— Po dale, more Jaçe, ta marrim vesh njëherë, si ngjau? Ti, kur e pe, përse nuk i flake hejbetë me gjithë rërë në hendek?

Jaçja piu një gotë raki dhe sikur e mblođhi veten:

— Unë e kisha hedhur rërën në motor e në fuçi, kur e takova. S'e dallova për së largu, se ishte errësirë. Më doli, papritur, si fandi spathi, më pyeti për ato që të thashë dhe u ndamë te pillati. Ai shkoi në shtëpi të tij, unë erdha këtu.

Nuriu i dha zemër:

— Po nga e di ti që të pikasi? Gjepura! Po të të kishte parë, s'të linte ai. Të vinte tytën e revoles në zverk. Prandaj kot dyshon.

Jaçja u hodh përpjetë.

— Si kot! Ja ta zemë se s'më pa. Po nesër traktori s'do të punojë. Avazi, si thua ti. Kush e bëri këtë avaz? Kush ishte natën vonë nga kodrat? Jaçja! Ç'bëri Jaçja atje? I hodhi rërë traktorit, prishi makinën. Kjo është ashiqare. Të lë Malka të mbrohesh? Të beson ai? Apo s'më ka edhe inat sa të më hajë me dhëmbë.

Nuriu dëgjoi me durim dhe më në fund i tha:

— Ke të drejtë! Keq punët! Ngado që ta kthesht, nuk shpëton dot! Po ti prit, mos u shpejto! Këto punë s'bëhen kështu! E ku do të vesh, që kërkon të ikësh? Kudo është mbjellë urov. S'ke ku vete!

U bë një copë herë heshtje, siç ndodh zakonisht në varrime. Kukuvajka klithi sipër në çati.

— Dëgjo!, — i tha Nuriu me zë të ulët. — Ti e di që Malka është jetim dhe fle fill i vetëm.

— E di, — u përgjigj Jaçja.

Nuriu shuajti llambën dhe Jaçja e kuptoi menjëherë se nuk e priste ndonjë punë e mirë.

— Të ishte verë, e gjeje në oborr, mbi qerre. Po edhe brenda në kasolle mund t'i hysh lehtë. Apo jo?

Jaçja e kuptoi edhe mendimin e kulakut:

— Po, — u përgjigj me zë gati të mekur. — Ti do që unë të vete e ta vras.

Nuriu u mendua një copë herë t'ia mbushte mendjen:

— Ne duhet ta bëjmë këtë. Zhdukim gjurmët dhe zbatojmë porositë e të ndjerit. Rrugë tjetër s'kemi!... Na, merre këtë sépatë. E mprehtë éshtë. Mos e shiko fare. E vret, bëhesh vetë kryetar dhe dimë si t'i vërtitim punët pastaj. Në fund të fundit dy duar për një kokë janë... Sépatën dje e mpreha. Me një të rënë, ta këput kokën. Ç'të dridhet dora kështu?! Ti je alamet burri! Hajde, nisu! Bjeri në kokë. Dëgjove? Drejt në kokë! Një herë mjafton, — dhe Nuriu, duke ia shtrënguar bërrylin për t'i dhënë zemër, e përçolli gjer te porta e jashtme...

2.

Gjithë ato ditë Malka ishte marrë shumë me punët e këshillit popullor. Si kryetar që ishte, tek ai përplaseshin punët e shtetit dhe hallet e fshatarëve. Ishte botuar një muaj e ca më parë statuti i kooperativave bujqësore miratuar në Kongresin e Parë të Kooperativave. Disa ditë Malka u mor me studimin e tij, pastaj ngarkoi anëtarë të këshillit që ta studjonin vetë e ta punonin me fshatarët. Edhe vetë organizoi takime të tilla dhe kudo që gjendej s'i pushonte goja së foluri për kooperativën e ardhshme dhe për statutin e saj të ri. Disa ditë më vonë u botua edhe vendimi i Këshillit të Ministrave dhe i Komitetit Qendror për mbjelljet e pranverës. Edhe atë e punuan nëpër skuadrat, me rininë, me gruan. Po ndërsa mbjelljet ishin vënë në vijë, sidomos me ardhjen e traktorit, puna për grumbullimin kishte mbetur dhe një pjesë e fshatarëve as që dëgjonin me nga ai vesh:

— Të shohim, — thoshin, — ç'përgjigje do të marrë Skënderi. Ku dihet, mbase hiqet krejt grumbullimi. Përse të digjemi kot.

Malka nxehet kur i dëgjonte, po meqë e kishin kritikuar një herë në qarkor, e përbante veten, u shpjegonte me durim vendimet dhe i merrte me të mirë. Për ndonjë të prapë a të sertë, që ia sillte në majë të hundës, thoshte me shaka:

— Po mësohem t'i them derrit dajë!

Atë natë e kaloi te Qamili. Ishte gëzuar kur kishte marrë vesh fejesën e Skënderit me Rasimenë. Te Skënderi kishte qenë dy net më parë dhe kishte kaluar një mbrëmje të mirë e të gëzuar. Edhe te Qamili e kaloi mirë. Fshatari nuk e la të ikte, gjersa u vuri flakën flokëve. Me atë ndjenjë gëzimi që të ngjallin në shpirt mbrëmjet e tilla familljare, ai u kthyte në kasollen e vet. Hëna e plotë ishte fshehur reve, që herë shtriheshin e holloheshin si petë, herë mblidheshin shuk si dengje leshi. Heshtja e natës prishej nga ndonjë qerre e vonuar dhe nga hingëllima e kuajve, që kullošnin lëndinave të penguar te këmbët e para. Qentë, sigurisht, lehnin herë pranë e herë diku larg, duke bëdhur pas kafshëve të egra dhe pas ndonjë copë hëne, që fekste papritur. Duke u kthyer për në shtëpi, në xhade takoi Jaçen. C'donte ai derr aq vonë në atë anë të fshatit? Nga bridhë? Kujt i binte më qafë? Cilin ngatërronte? Po Malka, që i bëri pyetje me vete, ishte bërë pakëz më qejf dhe nuk e vras mendjen më thellë. U nda me të te çezmja me katër sylynjarë dhe u drejtua për te kasollja e vet. Ekte ngadalë me një gëzim në shpirt. Dhe era e lehtë, që frynte nga grykat e maleve hijerëndë, sikur ia shtonte atë gëzim. Malet hijerëndë flinin, gjithësia flinte, kurse ai ecte i menduar me atë ngazëllim që ngjall vetëm puna e ndershme dhe djersa e ndershme për vete e për të tjerët. Qëndroi përpara shtëpisë së Lytos. Nuk kishte dritë as në kuzhinë, as në haur, askund. Zgjati kokën te dritarja që binte në rrugë. Kandili ishte shuar. Brenda ishte errësirë. Në vatër, nën hi, po jepnin dritën e fundit shpuza dhe thëngjijtë. Njerëzit flinin. Me siguri flinte edhe Lytoja.

— Gjumë të ëmbël, Lyto, — tha Malka duke u drejtuar për në kasollen e vet, me mendimin se i vetmi burim i lumturisë njerëzore është lufta dhe puna për popullin.

Kasollja e tij ishte zhytur e tëra në errësirë. Hijet e dendura të plepave mbulonin gjithë oborrin. Mezi dalloheshin bigat e qerres së vjetër. Dukeshin si shpata që kercënionin qiellin. Aty, në atë shtrat gati të kalbur gjatë verës, Malka flinte mbi dyshekun mbushur me lëpushka misri e me bar të butë erékëndshëm. Hiqte vetëm llastikat dhe setrën vinte revolverin nën jastëkun e fortë dhe

shtrihej nē kurriz duke vështruar yjet qē xixëllonin njéri mē shumē se tjetri, sikur i kishin zili i madhi tē voglit...

— Ja, sikur ka ardhur edhe vera! Marsi po del dhe po hyn prilli, — mendoi duke hapur derën e kasolles dhe ndjeu kënaqësi kur kujtoi netët e shkurtra e tē ngrohta tē qershoret, qē i gdhinte nē oborr.

U zhvesh dhe u shtri nē shtratin e ftohtë. Diçka e vrau nē ije. Vuri dorën dhe hoqi nagantin. I rrotulloj mu llirin me gishtin e madh, i fryu grykës dhe e vuri nën kokë.

— Të flemë tani, — tha me vete, po atë çast ia thirri këngës një këndez mu te dritarja e kasolles.

— Ç'ë ke këtë zë, more qafir! Kohën kërkon tē na pri shësh? — qeshi Malka me kokën nën jorgan, se ndiente tē ftohtë.

Këndezi këndoi dy-tri herë dhe, meqë asnë nga raca e tij nuk i dha ndonjë përgjigje, ra nē qetësi.

Malka mendoi:

— Luftën e kemi tē vështirë e tē ashpër! Në pyje na hedhin armiq. Në fushë s'na lënë rehat kulakët. Të ngatërron edhe Lamja i zi. Dëgjon kulakët dhe shkon e shet kaun. Po me se do tē lërosh, more Lame? Vetë do tē mbrehesh! A-ha, me traktor!... Po Kasëm Sharra, i babëzituri!... Ku e shpie mushka atë njeri? Kulak kërkon tē bëhet?... Gjene mirë. I ra mendjes prapa. Më mirë vonë se kurrë... Kurse Jaçja mbeti Jaçe! Ç'donte andej ai? Ku ishte? ku vinte? Përse? Tërë jetën në mjegull do tē qëndrojë ky njeri? Jo, vjen një orë, e mjegulla shpërndahet... shpërndahet...

Lumi gumëzhinte si nën dhe e ia mbuloi mendimet. Koka iu rëndua, iu rënduan kapakët e syve, i zienë këmbët dhe qafa e hollë iu mpi nē atë jastëk tē fortë.

— Qenkom lodhur! — mërmëriti dhe, si mbylli sytë, i dolën nē përfytyrim fusha tē lëruara, parcela me grurë tē pjekur, gjerdhe, qerre, lopë, shi, ujëra, kënetë dhe fytyra njerëzish tē njojur. Dalngadalë mendimet po i këputeshin, s'i lidhte dot. Fytyra e largët e nënës së dashur. Ca fjalë pa kuptim tē Skënderit. Lytoja ëndërrimtar me vështrim tē ëmbël nga e ardhmja. Jaçja e Nuriu dhe për-

sëri Nuriu e Jaçja dhe fjala «kllapkë», që Qamili e kishte në majë të gjuhës, zhurmë traktori dhe më në fund e mori gjumi...

Aherë një njeri me sëpatë në dorë, i zi si nata, shtyu lehtë derën e vjetër dhe hyri në kasolle pa u ndier...

3.

... Të nesërmen gjer më të afruar të drekës, aty nga ora njëmbëdhjetë, fshatarët u morën si zakonisht me punët e tyre. Kush lëronte e mbillte, kush voziste pleh me qerre e me kosha, kush krasiste pemët apo pjergullat që lotonin. Lytoja që në mëngjes shkoi te zyrat e këshillit për të shkruar raportin që i kërkonte qarkori i Partisë. Duhet të bënte një raport të hollësishëm për gjithë punën e Partisë në fshat, sidomos për mbjelljet e pranverës, për grumbullimet dhe propagandën për kolektivizimin. Por, sa u ul në tryezë, u kujtua se i mungonin disa të dhëna që mund t'i merrte vetëm nga kryetari i këshillit, po Malka po vonohej atë mëngjes dhe askush nuk e kishte parë e nuk e dinte se ku ishte. E la punën për gjysmë dhe doli te sheshi para zyrës. Shitësi, ai burri tepër i gjatë që kërrusej sa herë hynte e dilte nga dyqani, po u shpjegonte nga katër a pesë grave ligjin e ri të furnizimit e të grumbullimit. Lytoja pyeti Qamilin në e dinte se ku ndodhej kryetari.

— Gjer afër mesit të natës Malka ishte nga ne. Pastaj, kur i zoti i shtëpisë u vuri zjarrin flokëve, nuk mban mend q'u bë — qeshi Qamili dhe vazhdoi: — Po, besoj, andej nga traktori do të jetë. I ka hyrë më qejf makina. Dje lëroi vetë për herë të parë atë selishten e Lames.

Kur kujtuan traktorin ata heshtën një copë herë me vështrimin nga kodrat. Qamili picërrroi sytë e vegjël, se nuk e duronte shkëlqimin e diellit, që i binte drejt e në fytyrë.

Lytoja pyeti i habitur:

— Përse s'punon traktori?

Qamili mblodhi supet pa hequr vështrimin prej kordave:

— Ku ta dish? Mbase ka shkuar traktoristi në qytet për karburant.

— Karburantin e sollëm mbrëmë me qerre, — shpjegoj Lytoja dhe atë çast dalloj në krye të xhadesë një çunak, që vraponte zbathur sa i hanin këmbët. Ai solli lajmin që traktori ishte bllokuar keq nga balta e nga rrëra. Rëra ishte vënë re në serbator dhe në fuçi. Edhe një bulon ishte thyer, po sipas traktoristit, ajo vegël ishte pa rëndësi dhe mund të gjendej lehtë ose të bëhej në oficinën e SMT-së.

— Epo, shyqyr që s'qenka ndonjë gjë e madhe — tha Jaçja, që porsa mbërriti te sheshi, pak i zbehur në fytyrë. Sytë i kishte të lodhur dhe i mbante të hapur, si peshku. Ndiente një boshllék të madh në kraharor, s'i mjaftonte ajri dhe ishte krejt i këputur, sikur kishte shkultur kërgëpa të mëdhenj me gjithë rrënjen. U nisën të tre për te kordrat dhe, sa herë që u dilte përpara ndonjë fshatar, Jaçja vështronte me bisht të syrit Lyton dhe në kurriz ndiente mornica, sikur i hidhni copa akulli në zverk.

Lytoja iu drejtua çunakut:

— Skënderi atje éshtë?

Djali bëri «po» me kokë.

— Po Malka?

— Xhaxhi Malka nuk éshtë atje.

Lytoja pyeti Jaçen:

— More, Kuqo, mos e di ku éshtë kryetari?

Jaçja ngriu dhe s'diti si të përgjigjej, megjithëse tërë natën i kishte sjellë ndër mend me qindra herë të gjitha pyetjet që mund t'i bëheshin dhe të gjitha përgjigjet që do të jepte. Kur sekretari e pyeti përsëri, u përgjigj me zë të shqetësuar.

— S'e kam parë fare sot. Pse?

— Më duhet për ca të dhëna. Fundja mund të m'i nxjerrësh edhe ti. Për shembull, sa përqind jemi me punimet e tokës, me mbjelljet dhe me grumbullimet...

— Po, me punimin e tokës e kemi kapërcyer pesëdhjetëpërqindëshin. Me mbjelljet jemi afër çerekut. Me grumbullimet te....

— I dua të përpikta, Jaçe! Jo të rrumbullakosura, se gënjejmë veten dhe pushtetin. Më mirë, e di q'të bësh, dajë

Qamil, meqë shkon andej, hidh një sy në kasollen e tij se mos e kanë zënë ethet. Ia mori shpirtin malarja e mallëkuar.

Ata vazhduan të ecin në xhade, drejt kodrave, të ndjekur nga çunaku këmbëzbathur, kurse Qamili ktheu nga çesmja me katër sylynjarë. Kur kaloi përpara shtëpisë së Nuriut, e pa kulakun që lesonte arën me grurë.

— Kllapka! — tha me zë dhe mërmëriti një të sharë devollje. Nuriu ktheu kokën dhe Qamilit iu duk sikur ai i dëgjoi fjalët e tij.

«Le t'i dëgjojë» — tha me vete dhe e shau përsëri.

Po Nuriu ktheu kokën për të parë arën. Aty ku kishte kaluar lesa, gruri ishte bërë lesh e li. Bisqet ishin katosur dhe vende-vende dukeshin rrënjet e holla. Kur e shikon këtë pamje, atë që s'merr vesh nga bujqësia e mbulon të qarët. Mbasi ai mendon se bujku që lesion është i çmendur dhe po e prish drithin. Kurse Nuriu mendonte ndryshe:

«Ja kështu, si kjo arë do përbëysur bota jote, o çalaman që të rritet pastaj gruri im...! Unë s'bëj ndonjë të keqe. Unë lesoj. Vetëm lesoj. Që të më bëhet gruri i mbarë, e të ngordhësh ti!...» — Ajs! Ajs! — i ngacmonte qetë më shumë, duke hedhur si ndonjë i ri këmbët e mbathura me çizme.

— Ajs! Ajs!, — dëgjonte Qamili gjithnjë e më pak zërin e Nuriut dhe i vinte të pëlciste me komisionin e Reformës Agrare, që i la kulakut edhe toka më të mira, edhe qetë më të mirë, edhe lopën e delet më të mira.

— Kllapka, kllapkë mbetet!, — tha më në fund dhe dëgjoi buçimën e traktorit. Qëndroi dhe vuri veshin. Makina punonte. U gëzua, uroi me mend traktoristin dhe u hodh mbi vijën e ujit për të shkurtuar udhë. Po, me të bërrë nja dhjetë hapa, buçima u ndërpere.

— Era më gënjen, apo u prish përsëri?

Priti një copë herë me vështrimin nga kodrat. Andej s'pipëtinte gjë prej gjëje, veç një tufë korbash vërtitej me krrakellimë shumë lart në qiell. Atij iu mblodh një lëmsh në kraharor. Thuri cigaren dhe e ndezi, po as atëherë s'u dëgjua gjë. S'u dëgjua buçima as kur hyri në oborrin e rrethuar me plepa, në mes të të cilit ishte qerrja e brak-

tisur. Dëgjonte vec fjalët e Nuriut, që vinin nga larg, shumë larg, si nga një botë tjetër: «Ajs! Ajs! Ajs!» Shtyu me rrëmbim derën e kasolles, iu afrua shtratit ku flinte zakonisht Malka dhe ngriu në vend, duke mos u zënë besë syve.

4.

Traktoristi i ri, nxirë nga inati e quall në djersë, vinte rrotull traktorit dhe u thoshte atyre që e kishin rrëthuar e që e vështronin me habi e me shpresë:

— Pa hapni sytë mirë. A nuk është rërë kjo? Rërë lu-mi, safi! Në fuçi dhe në serbator. Hajde e puno tani. Këtu është goditur me hekur të fortë, se nuk thyhet aq lehtë buloni... Të kujt janë këta fëmijë?

— Të mitë, — tha e shoqja e Qamilit, që u kishte sjellë drekën së bijës e të shoqit.

— Po folu, se më rrinë nëpër këmbë e më pengojnë. Gruaja, e skuqur në fytyrë nga turpi, me një të folur, i mblođhi fëmijët si klloçka zogjtë.

— Të ikin fëmijët, se këta djaj të bëjnë të pabërën. Aq mend kanë. Mbushin grushtat me rërë e me baltë dhe i hedhin në fuçi. Hajt! Shporruni!, — i trembi Jaçja dhe fëmijët, të gjithë sa ishin, morën vrapin për në shtëpitë e tyre.

— S'është punë fëmijësh kjo!, — tha Skënderi duke parë pëllëmbët e përlyera me naftë e me rërë.

— Ku ta dish!, — tha Jaçja. — Çdo gjë bën vaki. Po mund të jetë edhe sabotim.

— Sabotim me brirë!, — tha Lytoja, i vrenjtur dhe damari i kërceu në ballë. Me duart të përlyera, i bëri shenjë Skënderit dhe, si e hoqi pakëz mënjanë e porositi:

— Do të nisesh që tani, në lokalitet. Që andej merr në telefon rrëthin dhe vëri në dijeni! Lajmëro edhe Degën, edhe Prokurorinë!

Fshatarët qëndronin të hutuar rrëth traktorit, pyesnin me ngulm për çdo gjë, këmbenin ndonjë mendim, shanin e mallékonin:

— Më ardhka për të qarë!, — tha njëri dhe fshiu sytë.
— Ai që e ka bërë këtë, të piqet në hell, i gjallë!, — tha tjetri me zemërim.

Gjyshi Dule, ai fshatari i varfér gati njëqindvjeçar, la dhentë të kullosnin në qafën midis dy bregoreve, qëndroi një kohë të gjatë përpara traktorit të prishur dhe pastaj tha, i qetë:

— Unë kam qenë tërë jetën në hasmëri me bezlerët e agallarët. Ishin të fortë e të pasur ata. Po ne, na udhëhoqi Partia, dhe i mundëm ata, ua morëm tokën dhe të gjitha ç'kishin dhe tanë s'ndahemi kurrë nga Partia, sa të jetë jeta. Të punojmë për sot, edhe për nesër e përgjithmonë. Fajtorin aty ta kërkojmë, midis të përmbysurve e të pakënaqurve, ta gjejmë e ta dënojmë rreptë, që të na kthehet e qeshura.

I tha këto dhe, duke u mbështetur në kërrabë, shkoi te Lytoja që kontrollonte fuçinë, diçka e këshilloi, pastaj mori përpjetë qafës, tek ato lëndinat ku kullosnin dhentë e tij, pa kthyer kokën prapa.

Traktoristi gjithë njolla të zeza në fytyrë, me çelësa e lecka nëpër duar, i vinte rrotull traktorit dhe përpiquej ta ndizte.

— Kështu na i bënë edhe vjet në fushë të Starovës me një makinë shirëse. Futën hunj te duajt e fshatarëve të varfér. Po u gjetën më në fund...

Lytoja pyeti:

— Po kush e ka bërë këtë sabotim?
— Kulakët, s'ka njeri tjetër — u përgjigj traktoristi duke luajtur marshet.

— Kulakët nuk përjashtohen, po nuk përjashtohet edhe ndonjë tjetër — ia hodhi Jaçja duke e parë me ngulm në sy.

Traktoristi e kuptoi ku rrihte Jaçja dhe iu kthye me inat:

— Ti... mos llomotit! Traktori është shpirti im, jeta ime... dhe shpirtit unë s'mund t'i hedh rërë... Ti, mbas...
Jaçja e mori me të mirë.

— S'e kam me ty! Dale, të merremi vesh. Për ideal që s'e pata me ty. As me ndihmësin tënd! E thashë për

rojtësin. Kush qe roje mbrëmë?... Kush qe roje këtu gjatë natës?, — pyeti dy herë rresht, po asnjeri nuk iu përgjigj.

— Lytoja ia preu shkurt:

— Kot ngjiresh! Ti e di që s'kemi vënë roje. Po ja që u dashka. Do të fillojmë që sonte, ne të parët.

Skënderi u nis menjëherë për në lokalitet. Fshatarët bisedonin me zë të lartë duke vrarë mendjen për të gjetur fajtorin. Pikërisht, në atë kohë, u dha në xhade Qamili. Ai vraponte, po meqë e pengonte këmba sakate, nuk dukej si një njeri që vrapon po që kërcen. Në një dorë mbante shkopin, në tjetrën kapën dhe flokët e dredhur ia merrte era. Me të dalë te kthesa, nga dukej mirë grumbulli i fshatarëve, thirri në vrap e sipër:

— O Lytoo... o Skëndooo!

S'e dégjoi e s'e pa njeri, veç Jaçes. Ky e kuptoi ç'lajm po sillte fshatari, u zverdh dhe mezi po qëndronte më këmbë. Donte të ikte, po iu duk vetja si njeri prej plumbi. Ishte bërë tamam si ata që i zë gjaku.

Qamili vraponte e thërriste:

— O Lytoo... O Skëndooo!

Balli i qe djersitur. Mezi merrte frymë. Edhe mjekrën e parruar prej ditësh e të thinjur, e kishte të lagur. Rasi-meja i doli përpara dhe e pyeti që nga ledhi e trondititura pamja e t'et:

— Ç'ka ndodhur, baba?! Përse vrapon kështu??!

Ai nuk arriti t'i thotë gjë, se s'ngopej dot me frymë. Fshatarët e panë dhe u turrën drejt tij, të alarmuar. Qamili qëndroi më në fund buzë xhades me fytyrë nga njërezit, me të dy duart ngritur lart e me këmbët hapur anash. Ishte gati duke rënë.

— Ç'ke? Fol dajo, ç'të ka ndodhur? — Lytoja e zuri për krahu.

Ai s'fliste dot. Fshinte sytë e përlotur me kapë dhe kafshonte buzët. Më në fund mundi të thotë me mbytka në fyt:

— Malkën... na e kanë therur... me sëpatë!

K A P I T U L L I VIII

1.

Vrasja e Malkës e preku fshatin mu në palcë. Ishte vrarë kryetari i këshillit popullor dhe u prekën veçanërisht bashkëluftëtarët e tij, fshatarët e varfër, ata që kishin luf-tuar maleve, së bashku me të, ata që kishin marrë tokë e bagëti drejt për drejt nga duart e kryetarit. Lajmi i vrasjes u përhap si furtunë dhe hyri në çdo ngastër toke, në çdo vatër, në çdo plevicë a kopshtije ku punonin burrat e gratë. Njerëzit, të shqetësuar nxitonin, venin e vinin, grumbulloheshin në oborrin e kasolles dhe kërkonin ta shih-nin edhe një herë kryetarin e këshillit. Gratë e plakat e qanë me lot të hidhur jetimin. Burrave u pikonte në shpirt, se e ndienin që kjo ishte një vrasje e egër, shtazore, e turpshme.

—Nuk vritet njeriu në gjumë!

— Jetova njëqind vjet për të parë edhe këtë gjëmë!

— Armiku të vraka e ta këputka ëndrrën më dysh!

Erdhën nga qyteti prokurori, hetuesit, instruktorë të Partisë e të komitetit ekzekutiv, punëtorë të sigurimit dhe filluan menjëherë nga hetimet. Malkën e gjetën të zhytur në gjak. Si duket e kishin goditur disa herë në kokë me së-patë. Ai duhej të ishte përmendur e do të kishte bërë përpjekje për t'u mbrojtur, se njëren dorë e kishte mbi

revolver, po vrasësi kishte qenë më i shpejtë. Nga të dhënat e tyre rezultoi se Malka, ishte vrarë për arsyё politike nga armiqtë e klasës. Kishte mundësi që vrasësi të ishte po ai njeri që sabotoi traktorin. Këto dy ngjarje kishin patjetër lidhje me njëra-tjetrën. Po vrasësi, edhe pse dyshonin që kjo është punë e kulakëve, nuk u zbulua menjëherë, prandaj hetimet do të vazhdonin edhe pas varrimit.

Malkën e shpunë në varreza si mbaruan formalitetet e para. Ishte një korte i gjatë, i përzieshëm. Qivurin e nxorëni nga kasollja duke e mbajtur mbi supe Lytoja, Skëndëri, prokurori dhe instruktori i Partisë i zonës. E kishin mbuluar me flamur të kuq dhe gjer te varrezat e mbajtën mbi supe, me radhë, të gjithë burrat. E mbajti edhe Jacja. Atje, pas pështjellimit të vogël që ndodh në kësi rastesh dhe pas fjalës prekëse të Litos, e futën në varr dhe e mbuluan duke i hedhur secili nga një grusht dhë. Dheu binte mbi dërrasa me një tingëllim të thatë. Fytyrat e fshatarëve ishin të vrenjtura, të gurtësuara, shprehnin dhembje dhe vendosmëri, shprehnin zemërim dhe revoltë ndaj armikut të klasës...

Lytoja, së bashku me hetuesit e shokët e tjerë, tërë ditën gjer në mesnatë u munduan të gjejnë vrasësin, po nuk sqaruan ndonjë gjë të madhe. I lodhur e i dërrmuar nga ngjarjet e papritura e të hidhura, ra në dyshek si i prerë, po gjumi nuk e mori. Kandili kleiste mbi oxhak dhe ai mendonte... mendonte. Parafytonte Malkën e dashur e të drejtë, me atë qafën e gjatë e të hollë, të dobët sa s'ka ku të vejë më, me atë shenjë plage në kafkë. Kujtoi copa ngajeta e përbashkët, nga bisedat e gjata e të zjarrta që kishte bërë me të për problemet e fshatit dhe herën e fundit kur e pa shtrirë në një pellg gjaku, masakruar barabarisht.

«Kush e vrou?... Kush?», pyeste veten dhe kafshonte buzët për të përbajtur lotët. Solli nëpër mend kulakët, të pakënaqurit, ish-ballistët, por nuk vinte dot dorën te asnjëri, se nuk ishte i bindur plotësisht. Mendoi se Malka do ta kishte parë njeriun që prishi traktorin dhe ky njeri, për të humbur gjurmët, e vrou me sëpatë.

«Jo, kështu nuk mund të ketë ngjarë! Malka do ta arrestonte menjëherë!» mendoi ai, pa ditur se ishte pranë së vërtetës. — Po si ta gjej këtë kriminel?! Si të veprojmë?! C'masa të marrim?!

Shpeshherë férkonte ballin me noçkat e gishtave. I dukej sikur një darë ia shtrëngonte kokën dhe ai përpinqej ta hiqte atë dhembje të tmerrshme.

— Kush e bëri këtë krim të shëmtuar? ! Gjyshi Dule tha se u bë njëqind vjec, ka dëgjuar për shumë vrasje për gjakmarrje, po kurrë s'kishte ndodhur që të vritej njeriu në gjumë. Qëmoti, tha Gjyshi Dule, po ta gjeje gjakësin në gjumë, nuk e vrisje. Do ta zgjoje domosdo, do ta lije të luteshe e të të thoshte amanetet, pastaj bëje atë që kishe për të bërë...

Pranë dyshekut ishin gazetat që kishin sjellë atë ditë dhe që ai s'pati kohë t'u hidhte një sy. Vetëm tani u kujtua për shtypin që e lexonte rregullisht. Mori «Zérin e popullit», po nuk e shfletoi se nuk e linin të qetë mendimet e shumta, të çuditshme e të paqarta, mendimet që e sulmonin pa mëshirë dhe e detyronin herë pas here të kafshonte jastëkun mbushur me fletë misri. Më në fund u ngrit përgjysmë, u mbështet pas murit, ia ngriti fitilin kandilit dhe hapi gazeten. Në faqen e parë, me gërmëna të mëdha, ishte shkruar: «Mbi disa probleme në fshat», Enver Hoxha, sekretar i Përgjithshëm i Partisë së Punës të Shqipërisë» Lexoi shpejt e shpejt faqen e parë. Ishte përgjigjja që udhëheqësi i Partisë i jepte letrës së rreshterit Safet Malaj, e nëpërmjet tij tërë letrave të këtij lloji që i ishin drejtuar, duke përfshirë edhe atë të rreshterit Skënder Zalo. E lexoi letrën pa ngritur sytë asnjëherë. Në çdo radhë gjente të vërtetën e jetës fshatare. Aty ishin të gjitha problemet e mëdha e të vështira të fshatit, punët e errëta te kulakut, njerëzit e fortë e të papërkulur, që punonin me bindje në të ardhmen, ata që lëkundeshin, ata që gabonin dhe ata që sabotonin. Kur e mbaroi leximin, iu duk sikur pa nga lartësia fshatin e vet, aty buzë shkëmbit, si piramidë, me ata njerëzit e fortë e të mirë, me hallet e dertet e shumta dhe me armiqtë e rrezikshëm që puno-

nin nën dhë e vrisnin me sëpatë shokun më të mirë. Kur e rilexoi u ndal një copë herë te këto mendime të letrës:

«...Urdhëresat në lidhje me grumbullimet janë nga më të drejtat, por duhet t'i kuptojmë mirë dhe t'ua shpjegojmë fshatarëve mirë dhe jo të veprohet si një anëtar partie i rrethit të Delvinës, i cili e mori gazetën ku ishin shtypur këto urdhëresa, e lexoi një herë si një roman të mërzitshëm dhe mbasandaj e hodhi në zjarr, pse s'i pëlqeu. Ai s'mund të jetë një anëtar partie, ai është një këlysh kulaku, që ka hyrë kontrabandë në Parti...»

I rilexoi këto radhë dhe tha me zë:
«Jaçja!»

Në trurin e tij të lodhur nga mendimet, shkrepit paritür një dritë e madhe. Nënë atë dritë, ai përfytyroi qartë Jaçen me trupin e gjatë e të shëndoshë, me fytyrën e kuqe tërë krunde, me ato mustaqet e rralla e të verdha. Rikujtoi ditën kur ata të katër ishin në zyrën e këshillit dhe kur Jaçja grisi «Zërin e popullit», ku ishte botuar një urdhëresë.

«Po!, — tha Lytoja me zë sikur të bisedonte me njeri. — Ai e grisi para syve të mi dhe unë s'mora asnë masë. Përkundrazi, e mbrojta... Po, e mbrojta... S'është vetëm ai i Delvinës, i dashur shoku Enver! Kemi edhe ne një kuhill kulaku, që na ka hyrë kontrabandë në Parti. E kemi dhe e kemi mbrojtur! Unë i pari...»

Dhe rikujtoi të gjitha veprimet, fjalët e sjelljet e Jaçes dhe nuk pati më asnë dyshim e asnë lëkundje. Përkundrazi, nga çasti në çast, bindej se Jaçja kishte gisht në të gjitha punët armiqësore të fshatit, gjer te sabotimi e te vrasja.

«Ai i është bërë gjithnjë krah Nuriut. Vjet, kur iu vodh e iu kalb misri kulakut, fajtori nuk u gjet. Tek ai hyn e del. Malka vetë më ka thënë për këtë. Ç'do ai te Nuriu? Po me Malkën sa herë është zënë! Po gjatë luftës ku ka qenë ky njeri? Mirë thoshte Malka: Ku ka qenë? Malka... Malka.... Na iku Malka? Më i miri, më i drejti nga ne të gjithë...»

Lytoja u ngrit nga shtrati, u vesh dhe hodhi pallton krahëve. Fliste me vete me zë të lartë, pa menduar se mund të zgjonte të atin e të motrën, që flinin po në atë dhomë të ftotë e pa zjarr.

«Unë Kuqos s'i besoj. Duhet parë puna e tij». Kështu më ka thënë Malka disa herë. Edhe dajë Qamili më ka thënë: «Ata të dy, Nuri e Jaçe, janë kllapka». Edhe gjyshi Dule më ka thënë njëherë: «Kur shoh Jaçen, sepse harroj të qesh». «Pse?» e pyeta. «I pakënaquri është më i keq se i babëzituri», m'u përgjigji. Po unë s'ua vura veshin këtyre fjalëve të gjyshit Dule... Dhe ja, më në fund, sabotimi edhe krimi...»

I zemëruar me vetveten, pa një herë rrith dhomës përdhese, me trarë të nxirë nga tymi. I ati gërrhiste lehtë nën gunë. E motra diçka mërmëriste në èndërr. Mori nga vatra gazeten «Zeri i popullit», e palosi me kujdes dhe e futi në gji, si një gjë të shtrenjtë, që e ka vendin vetëm atje, në gji, për të dëgjuar më mirë rrahjet e zemrës.

«Qenka shumë e vështirë kjo luftë. Po kemi Komandan tin që na mëson e na zbulon armiqjtë», — tha i lehtësuar dhe, megjithëse rrezet e kandilit ishin të zbeta, sytë e tij ndritnin nga mirën johja e dashuria për udhëheqësin. Ndritnin nga gëzimi për jetën e re që transformohej me shumë mundime e sakrifica. Ndritnin edhe ngaurrejtja për armiqjtë e për gjerdhet.

Ishte më të gdhirë. Hëna llapste dhe përreth dukej siditë, me një dritë qumëshти, pa ngjyra të ndezura. Ai doli në rrugë me një mendim të prerë:

— Kjo punë duhet të marrë fund që sot, — tha duke ecur me hap të shpejtë, dhe me të mbërritur te shtëpia e Skënderit, trokiti në dritare, ku fekste drita e kandilit. Nëna plakë hapi kanatin, zgjati kokën dhe, si e njohu Lyton, i tha e shqetësuar:

— Sa mirë bëre që erdhe, o Lyto, t'u bëfsha kurban! Se ç'ka im bir, s'e di! S'ka fjetur fare, tërë natën e natës!...

— Thuaji të dalë!

Edhe Skënderi e kishte lexuar letrën e Enver Hoxhës dhe tanj bluante në mendje qindra mendi me. Kishte kohë që vinte poshtë e lart dhomës, i zymtë, i

zemëruar dhe vazhdimisht diçka mërmëriste duke mos e hequr gazetën nga duart. Qindra hapa... mijëra mendime, si stuhi, mendime të ndershme, të sinqerta... E ëma kishte dhënë e kishte marrë, e më në fund, e habitur nga shqetësimi i tij, e kishte pyetur me frikë:

— Ç'ke kështu, more bir?

Ai ia kishte prerë shkurt dhe ashpër:

— Më lër rehat, se nuk është punë pér ty. Bjer e fli!

«Të ka hidhëruar vdekja e atij ditëshkurtit, e atij jetimit, që s'e lanë të shohë ditë të gjëzuarë e të lumtura. Vdekja e Malkës të ka helmuar, o bir, që u shofshin ata që e vranë», — kishte menduar nëna me kokën nën jorgan, duke lagur jastëkun me lot të vakët prej nëne.

Vërtet, vdekja e Malkës e kishte dëshpëruar në kulm Skënderin. Tani, pas vdekjes, ai shihte te kryetari i këshillit, vetëm merita, vetëm virtute, vetëm të mira. Tani edhe ajo ashpërsia e tij, i dukej e drejtë. Bile, ajo s'ishte ashpërsi. Ishte butësi e dashuri së bashku pér shokun, pér fshatarin e varfër, pér të drejtën e të mirën. Tani, pas lexit të letrës, ai i jepte të drejtë Malkës pér çdo gjë dhe hante veten me dhëmbë pér kundërshtimet dhe pér ato që kishte bërë. Thoshte disi i habitur, por i zemëruar në kulm me vetveten:

— Si nuk e kam kuptuar këtë?! Si rashë në prehërin e kulakut?! Si rashë unë, ushtaraku, që jam marrë gjer më sot vetëm me asgjësimin e armiqve?... Po, ky është i fshehur, i padukshëm, si era. Hedh gurin e fsheh dorën. Ky është dinak, finok, fjalët i ka të ëmbla mjaltë, buzëqeshjen të çiltër... Po, po. I tillë është treguar me mua Nuriu. «Xhaxha» Nuriu! Ptu!

Skënderit i bëri pështypje të thellë letra e Komandanit. Ajo ishte shkruar pér të. Ishte përgjigjja që priste. Dhe e kuptoi tani se pér një kohë kishte rënë në prehrin e kulakut. Solli ndërmend atë, «xhaxha» Nuriun, takimin e parë me të, (atij i vinte pér të vjellë kur mendonte se e kishte thirrur «xhaxha») dhe tani e vinte re mirë se buzëqeshja e tij ishte e shtitur, e ftohtë, kurse mendimet e fjalët helm nëpërke. Edhe Jaçja s'ishte gjë tjetër, veçse një «kulish kulaku» si ai i Delvinës... Të gjitha këto i rikujtoi me qar-

tësinë më të madhe nën dritën që flakërinte nga letra e Enver Hoxhës. Kujtoi me hollësi edhe ngjarjet e asaj dite, prishjen e traktorit dhe vrasjen e Malkës. Për të s'kishte më asnjë dyshim: vrasësit e sabotatorët ishin në fshat, jettonin midis tyre, bisedonin me ta, punonin e hanin me ta. Dhe u bind se detyra e tij ishte lufta kundër kulakëve e këlyshëve të tyre, lufta për të zbatuar me drejtësinë më të madhe urdhëresat e shtetit të ri. Kjo ishte fjala e Partisë. Kështu po e mësonte dhe po e porosiste, si babai të birin, mësuesi i tij:

«Është i drejtë kujdesi juaj që tregoni për çështjen e popullit, kjo tregon se ju dhimbset çështja e popullit dhe e Partisë...

Ju thoni se apo jeni liruar nga ushfria dhe tani gjendeni në fshatin tuaj, ku ju ka dërguar Partia të punoni. Pak ditë keni që jeni kthyer në fshat dhe ju më shkruani një letër shumë të dëshpëruar. Duket qartë se ju ka mbuluar pesimizmi, keni rënë në pozita jo të shëndosha dhe arrini në përfundime jo të drejta dhe disa herë shumë të gabuara, duke u mbështetur në disa vështirësi, që me të vërtetë janë, por që përpara këtyre vështirësive të kapërcyeshme ju jeni çarmatosur. Një qëndrim i tillë nuk është i denjë dhe nuk mund të lejohet për një nënëficer, që ka hasur vështirësi shumë më të mëdha në jetë dhe sidomos kur është dhe anëtar partie...

...nuk ju lejohet juve, anëtar i Partisë... t'i gjykon i çështjet në atë mënyrë të gabuar e të humbisni besimin dhe perspektivën. Duhet të thelloheni në çështjet, të përpileni t'i kuptioni mirë problemet, dhe t'i zbatoni me ndërgjegjen më të plotë dhe me disiplinën më të madhe, pse vetëm kështu do të ecim përpara....

Skënderi i lexoi këto radhë disa herë dhe me shumë kujdes. Zemra i rrihte, se e ndiente veten pranë, shumë pranë Partisë. Ishte mençuria e saj që i fliste, ishte afshi

i gjirit të saj që e ngrohte, ishte dora e saj që i tregonte rrugën e së vërtetës. Nuk kishte rrugë tjetër. Të gjitha rrugët e tjera ishin të gabuara, të çonin nëpër ferra e shkurre, të çonin në errësirën e kaluar, që ishte varrosur një herë e përgjithnjë. Ai e ndjeu gabimin, siç ndjen njeriu një dhembje të fortë në shpatullën e majtë dhe për një çast i erdhi rëndë nga vetja...

E ëma e lajmëroi që po e thërrisin dhe e pyeti:

— Çështë gjithë ky shqetësim, more bir. Tregoi nënës plakë.

Kësaj radhe ai i foli me të butë dhe i tregoi se letra që i kishte dërguar dy javë më parë Enver Hoxhës, kishte qenë e gabuar.

— E shkela nënë!, — i tha ai dhe anës syve iu formuan rrudha të holla.

— Pse kështu, more bir??!

— E ëma kafshoi buzën, e habitur, po i erdhi mirë që Skënderi qe zbutur.

Lytoja e priste te dera, përtej vijës së ujit, i vrenjtur, me sy të kuq nga pagjumësia.

— E lexove?, — e pyeti.

— E lexova!, — u përgjigj Skënderi.

U panë sy në sy dhe heshtën një copë herë, sikur donin të dëgjonin gjelat që lajmërojnë afrimin e mëngjesit.

— Kam rënë brenda kokë e këmbë, — vazhdoi Skënderi.

— Më vjen turp nga vetja dhe nga bashkëfshatarët. S'di si t'u dal përparrë. Po do t'u dal. Do të bëj autokritikë. Ku shedi ç'nofkë do të më verë vjehrri! Ka pasur hak kur më këshillonte të mos i zija besa as Nuriut, as Jaçes...

— Dajë Qamili edhe mua më ka këshilluar...

— S'e dëgjova atë që duhej dhe kjo na kushtoi shumë shtrenjt. Humbëm shokun më të mirë. Jam përgjegjës për këtë.

— Jo vetëm ti, por edhe unë, — tha Lytoja me zë të ngjitur. — Por letra e Komandantit është pér ne si drita e die llit.

Atë çast dielli ishte më të dalë. Nga lindja, përtej maleve ngjyrë jargavani, dukej sikur po digjeshin pyje të tërë, sepse tërë qelli ishte përflikur.

- Shkojmë e lajmërojmë ata shokët që ta marrin Jaçen në hetuesi, — tha Skënderi.
- Më parë duhet t'ia heqim teserën, — tha Lytoja.
- Jo. Tesera merret kur arrestohet, — shpjegoi Skënderi.

2.

Jaçen e mori në pyetje njëri nga hetuesit. Ishte një djalë tepër serioz për moshën e tij të re. Pinte vazhdimisht duhan, fliste ngadalë dhe dëgjontë pa luajtur asnje muskul të fytyrës, sikur të mos i interesonin fare fjalët e Jaçes. Ishte përtëj masës gjakftohtë dhe të ngjallte respekt me qëndrimin e tij.

I dha Jaçes një cigare dhe i tha më indiferentizëm:

— S'kemi q'bëjmë, shoku Jaçe. Do t'i marrim të gjithë në pyetje... edhe shokun Lyto, edhe shokun Skënder... Detyra, detyra...

Jaçja e vështronë me bisht të syrit duke u përpjekur të zbulonte në dinte gjë hetuesi. Atij djali iu duk tepër indiferent, çunak në këto punë dhe për t'u dukur, kapadaisej, me cigare në gojë.

— Keni punë të vështira juve, — i tha Jaçja duke e mbledhur veten pak nga pak — Bëhen vjedhje, vrasje, ju duhet t'i gjeni...

— Ashtu, ashtu, — tha djali indiferent, ngriti sytë dhe e pyeti:

— Di gjë ti për këtë vrasje?

— Ah! Ta dija, s'qe nevoja të vinit juve nga qyteti. E zija vetë vrasësin dhe e bëja copë-copë.

— Kish ndonjë armik personal Malka? Ndonjë hasmëri të vjetër?

— Edhe mund të ketë pasur, po unë s'di gjë.

— Si mendon ti, kush mund ta ketë vrarë?

— Besa, vështirë e kam të vë gishtin me ndonjë. Po mundet edhe ndonjë diversant. Ju e dini, ca kohë më parë ne asgjësam një bandë, te Shkëmbi i Bardhë...

— Nuk përjashtohet edhe kjo, — tha hetuesi, pastaj ngriti sytë dhe e pyeti papritur:

- Ku ishe dje, shoku Jače?
 - Térë ditën në fushë, lërova.
 - Kur e le punën?
 - Sapo perëndoi dielli.
 - Po pastaj ç'bëre?
 - Pastaj... — ai ngurroi një çast të përgjigjej dhe këtë e vuri re hetuesi.
 - Ti në shtëpi s'ke qenë, se gjyshi Dule na tha në hetuesi këto: «Vajta dy herë te Jaçja për një punë që ai e di, në mbrëmje vonë dhe në mëngjes pa gdhirë, nuk ishte. Të shtëpisë më thanë se ai s'kishte fjetur aty atë natë».
 - Të drejtën ka thënë gjyshi Dule. Kemi një bursë për në shkollën e infermierëve. Ai e kërkon për të mbesën dhe ne atij do t'ia japim.
 - Domethënë s'ke fjetur në shtëpi.
 - Jo.
 - Po ku ke qenë?
- Jacja hezitoi përsëri dhe u përgjigj trubull:
- Te ca dajllarë të mi.
 - Ku?
 - Në Zëmblak, pra — gënjeu dhe u bë pishman aty për aty.
 - Te cili?
 - ?
 - Si quhen dajllarët, pyes?
 - Hasan Doko.
 - Përse vajte?
 - Për një fejesë.
 - Djalin fejoi dajiu, apo çupën?
 - Djalin... djalin!
 - T'i trashëgohet!
 - Faleminderit! — Jacja psherëtiu i lehtësuar.
 - Atje fjete mbrëmë?
 - Si urdhëron, — gënjeu përsëri.
 - Epo, domosdo, s'kishte kuptim të udhëtoje natën. Dhe u ktheve në mëngjes me një hosten diell?
 - Jo me një hosten, po sapo kishte dalë dielli.
 - Po mirë, o shoku Jaçe, bëjmë një pushim. Urdhëro e ndize edhe një herë.

Hetuesi e la vetëm dhe shkoi e informoi shokët që ishin në dhomën fqinjë. Skënderi me hetuesin tjetër u hipën kuajve dhe brenda dy orëve u kthyen. Ata sollën lajmin se Jaçja kishte një muaj që s'kishte qenë te dajallarët. Këtu u kap filli dhe gjer në orën tre pas mesit të natës, Jaçja u zbërthye i téri. Atëherë Lytoja ia mori teserën e Partisë dhe prokurori urdhëroi arrestimin e tij e të Nuri Zyberit. Gjysmë ore më vonë Lytoja, Skënderi, disa nga anëtarët e këshillit popullor dhe shokët e ardhur nga qyteti, të gjithë të armatosur, kush me pushkë e kush me revolver, rrëthuan shtëpinë e kulakut. Lytoja, si shtyu lësën e oborrit, trokiti fort në derë.

— Kush është?, — pyeti si nëpër gjumë një zë i trashë e i ngjirur.

— Hape, jam unë, Lytoja.

— Lytoja?!

U bë një heshtje e shkurtër, pastaj u dëgjua përsëri zëri i Nuri Zyberit:

— Po përse na zgjon natën, mëre djalë?

— Hape, se kam punë.

— Kur të gdihet... Kur të gdihet!, — u përgjigj kulaku i mbytur nga kolla.

— Hape! Jemi ne të pushtetit! Në emër të ligjit, hape!

Lytoja e Skënderi i vunë trupin derës. Llozi ra dhe ajo u hap me zhurmë, kat e kat.

— Kemi ardhur për kontroll, — tha një ushtarak i Sigurimit, zëri i të cilit iu duk Nuriut i padëgjuar ndonjëherë.

— Po ç'jam unë? Qen apo njeri?, — pyeti Nuriu i nxehur.

— Qen bir qeni, — iu përgjigjën.

— Athere, urdhëroni të merrni morrat, — u tall kulaku dhe doli në oborr me rrëmbim. Në dritën e pishave ata e vunë re se ai qe i veshur, bile edhe me pallto. Me siguri, dikë priste.

— Morrat i mbaj për vete!, — i shfryu Qamili, të cilin Nuriu e njohu edhe nga të ecurit, edhe nga të folurit si me férshëllima. — Kllapkë e fëlliqr!

Nuriu shkoi te trina për të lëshuar qentë.

— Kot e ke!, — dëgjoi në gjysmerrësirë zërin e Skënderit.

Kishin ndezur kandilët e pishat dhe kulaku, në ato drita që ndriçonin zbetë, dalloi mirë armët. E kuptoi dhe vetë që çdo kundërshtim ishte i kotë. Megjithatë rrëmbue një hu nga sëra e druve dhe thirri si i tèrbuar.

— Mos m'u afroni. Do t'ju thyej kryqet!

E flaku hurin, po njerëzit u mbrojtën dhe huri ra në një llom me ujë. Kur u bë gati të marrë tjetrin, dy vetë e përfshinë keq dhe i hodhën hekurat. Atë çast u dha në hajat e shoqja, me një këmishë nate të gjatë gjer në fund të këmbëve. Kishte humbur e tëra në atë robë të zezë e të gjerë.

— Ç'është kështu? !, — u lebetit ajo kur pa të shoqin të lidhur. Ai i shfryu duke u dridhur.

— Këput qafën!, — dhe gruaja u zhduk si hije.

— Kontrolloni!, — urdhëroi ushtaraku.

Dy vetë hynë në ahur me kazma e lopata. Dy të tjerë thyenin me sëpatë shkallarët e fundit të hajatit sipas denoncimit që kishte bërë Jacja. — Nuriu vështronë flakë të verdha, njerëz gjysmë të ndriçuar, pushkë, dëgjonte zhurmat e veglave të punës dhe nuk kuptonte mirë ç'kishte ndodhur dhe përse Jacja nuk ishte me anëtarët e tjerë të këshillit.

— Po-o — thoshte me zemërim e me zë të lartë. — Pushteti të bën varrë. Këtë e di. E di, se kam qenë vetë pushtet... Po e kini kot. Atje, në ahur, ku kontrolloni ju, kam varrosur mackat. Janë të këtij shkurti dhe s'janë kalbur ende. Do t'ju qelbin!...

Ishë tèrbuar nga inati dhe gati i dilte shkumbë nga goja. Qamili qëndronte pranë tij. Në një dorë mbante një pishë të ndezur e në tjetrën një malipher greku me veshë.

— Kulaku i derrit, ç'më shikon me ata sy të trubulluar?! Thirr, shkumbavitu sa të duash! Një hiç je! Një copë bajgë je! Ja ç'je!, — Qamili e pështyu drejt e në gojë ndërsa Nuriut iu shtrembërua fytyra sikur e vunë në elektroshok....

Në kontrollin që bënë gjetën pesëdhjetë kuintalë grurë e misër të fshehur në ahur përposh grazhdit, katër radio,

gjashtë sahatë muri të mëdhenj në një musandër dhe, nën shkallët, një mitraloz të lehtë, pesë arka me fishekë dhe një kuti të çuditshme, ku ishin tapitë e tokave e të pyjeve dhe një listë e gjatë me emrat e fshatarëve të varfër dhe të hyzmeqarëve, që i kishin borxhe të vjetra kulakut. Të gjitha këto ishin palosur me kujdes të madh dhe ishin mbështjellë me mushama, me dyllë mjalti, në mënyrë që të duronin njëqind vjet e mbasse më shumë.

3.

Erdhën dhe ditët e ngrohta të prillit... Delet nuk kishin më rrodhe e baltë të zezë bërë kotka kotka në bark e në ije. Leshi i tyre u bë i bardhë qumësht dhe qengjat e rritur kërcenin nga gëzimi gjer afër një metër lart. Erdhën dallëndyshet nga vendet e largëta dhe me shpejtësi filluan të ndërtojnë çerdhet nën strehët e çardhakëve, ku s'i hante era. Ç'punëtorë të palodhur janë këta zogj! Me ç'gjë mund të krahasohen dallëndyshet që fluturojnë me qindra kilometra dhe ndërtojnë çerdhe të reja dy herë në vit?! I ndërtojnë në vende të ndryshme të botës vit pér vit, pastaj rritin zogjtë, fluturojnë së bashku me ta mbi dete, male e shkretëtira, i braktisin çerdhet e vjetra dhe ndërtojnë të reja gjithnjë ndërtojnë, ndërtojnë, ndërtojnë...

Kishte ardhur prilli. Traktori buçiste arave. Fëmijët u hipnin kuajve pa samar dhe i shpinin lëndinave të hanin bar të njomë. Të rinjve u qe qëruar fytì dhe këndonin me zë të tingëllueshëm këngë pér dashurinë e pér lumburinë.

*Ballët me sedef, me sërma qëndisur,
E shkreta sevda ku paska kolisur!....*

Jeta është e bukur. Jeta është pa fund, ripërtërin driftat e ngjyrat, ripërtërin tokën, njerëzit, zemrën e rinisë së bukur dhe shpirtin e pleqërisë së thinjur.

Po, kishte ardhur prilli dhe fshati rrëzë shkëmbit, si piramidë, ishte zhytur i téri në gjelbërim dhe në ujëra të kulluara, të kthjellëta.

Një të diel të ngrohtë e të ndritshme, fshati u mblodh te shelgjishtet buzë lumit, përtej arave ku kishte lëruar në fillim traktori. Në një ditë të tillë të bukur pranvere, kur njeriu është i lirë, kur ka tokën e vet, shtëpinë e vet dhe pushtetin e vet fjalët e mira dalin vetvetiu nga thellësia e shpirtit. Lytoja u habit kur vuri re se kishin ardhur që të gjithë, burra, gra, me pleqtë e nderuar në krye. Domsdo mungonin kulakët dhe ish-ballistët, të cilëve nuk u ishin dhënë triskat e frontit. Mungonte edhe Hallo Mudja. Ajo s'dinte ç'ishin mbledhjet. Ajo nuk vinte kurrë në to. Jetonte e vetëmuar si bolla, qosheve të errëta e nëpër hattulla.

Fëmijët kullošnin kuajt lëndinave. Ca merreshin me qingjat, ca me lopët, ca me çerdhet e zogjve nëpër shelgjishtet. Më të guximshmit laheshin në lumë duke fryrë brekushet si balona. Nënët u bënin zë, u thoshin se do të ftoheshin, se uji ishte akull po ata lëshonin stërkala si ylbere dhe nuk dilnin. Qeshnin, ngacmonin njëri-tjetrin, vështronin të heshtur ylberet e ujërave dhe kush mund ta dijë se ç'ëndërronin?! Kurse vajzat e vogla mblidhnin lutet e para të pranverës në livadhét anës lumit.

Gjyshin Dule po e dëgjonin ata që e kishin rrëthuar. Plaku tregonte historitë e vjetra, shumë të moçme, heroike po dhe, të hidhura e të dëshpëruara. Fliste për të rënët, për të vdekurit, që në gojën e tij gjallëroheshin e bëheshin si ata që e dëgjonin.

— Kështu ka qenë ajo kohë. Atëherë nga Canongji e përpjetë i thoshin Devoll i Vogël. Nga Canongji e këtej i thoshin Devoll i Madh. Tashi s'i thonë më kështu. Po tërë fusha e Korçës devollinj janë. Të mos harrojmë që jemi devollinj, që të na njohë bota. Të na zbardhet faqja kur bëjmë të mira e të na skuqet kur bëjmë turpe e prapësira...

Ishin mbledhur për të lexuar letrën që Komandanti i dërgonte një komunisti nga Lapuleci i Ballshit dhe në-përmjet tij i përgjigjej edhe bashkëfshatarit të tyre, Skënder Zalos. Fshatarët, ulur këmbëkryq mbi barin e njomë, pinin duhan e bisedonin për mbjelljet, për detyrimet që s'i kishin shlyer ende të gjithë. Gratë të mbledhura të gjitha mënjanë, rrinë në gjunjë dhe thurnin çorape

e triko. Të moshuarat tirrnin lesh në furka. Vajzat e djemtë qëndronin më këmbë, rrëth prindërve dhe, tinës tyre, i hidhnin njëri-tjetrit vështrime dashurie. Kur u ngrit Lytoja për të folur, një tufë zogjsh fluturoi mbi fshatarët për t'u strehuar nëpër degët e dendura të shelgjishteve. U bë menjéherë qetësi e plotë. S'pipëtinte njeri. Veç nga larg vinin thirrjet e gëzuara të fëmijëve, që vraponin buzë lumi t për t'u nxehur. Skënderi kujtoi ditën kur u kishte lexuar po këtyre fshatarëve letërën e vet. C'zhurmë qe bërë atë ditë! C'rrëmujë! Ndjeu një ndrydhje të muskujve të këmbëve. Nga tendosja e nervave, nga halli, nga turpi, kjo ndrydhje iu kthyte në ngërç të gishtave e të këmbëve. Mundohej të çlirohej nga ngërçi duke fërkuar këmbët dhe në vesh i buçiste zëri i Lytos që lexonte letërën e Komandantit. Në mendje i rrihnin si çekan mendimet e shprehura në nëntitujt e «Zërit të popullit»:

- Gjendja e fshatarësisë s'ka barazim me të kaluarën. Ajo është si dita me natën.
- Të çarmatosesh përpëra luftës së klasave në fshat e qytet do të thotë të bësh gabimin më të madh.
- Partia nuk punon që t'i japë fshatarit vetëm vajgurin e kripën.
- Kulaku në fshat punon, ai lufton Partinë, urdhëresat e të gjitha me radhë.
- Urdhëresat e reja janë plotësisht të drejta dhe të realizueshme.
- Cila është ajo urdhëresë që detyron fshatarin të çojë kaun për të shlyer detyrimin? Ai fshatar që kërkon të numërojë në vend, të lindë dhe të vdesë me një ka në derë, ai fshatar do të dëmtohet.
- Kurrë nuk gabohe të jesh i ashpër kundër armikut të klasës.
- Kini besim të madh në masat e popullit. Ato duhet të shohin tek komunisti udhëheqësin që i drejton dhe, nga ana tjetër, ju duhet të mësoni prej tyre. Fshatarët e varfër nuk mendojnë siç më shkruani, ata kanë besim te Partia dhe në të ardhmen...

Të fala shoqërore, Enver Hoxha!...

Pas një grimë heshtjeje shpërthyen brohoritje e duartrokositje të zjarrta. Të gjithë ishin ngritur më këmbë. Nga shelgjishtet e dendura u ngriten tufa të mëdha me zogj, që erdhën rrrotull duke cicëruar në qiellin e kaltër e pa asnjë re. Të gjitha këto u përzien me thirrjet e gëzuara të fëmijëve, që kishin lënë lumin e bagëtinë dhe kishin ardhur të dëgjonin letrën e xhaxhi Enverit, duke ecur zbathur mbi tokën e butë. Vetëm atëherë Skënderi u cilrua nga ankthi dhe iu hoq ngërci krejtësisht. Hipi mbi një kukumale që ta shikonin e t'i shikonte të gjithë dhe bëri autokritikë të thjeshtë e të ndershme komuniste. Ai fliste, ndërsa fshatarët, të prekur nga qëndrimi i tij, thoshin:

- Na vjen keq për këtë djalë që gaboi, se është trim!
- I thamë: s'e ke mirë, more djalë, po s'na dëgjoi, — ndërhyri Qamili.
- Dhëndrin shan, more dajë Qamil? Hajde vjehërr, hajde!
- S'ka dhëndër e vjehërr këtu! Këtu ka dy rrugë: o me klapkën, o me komunizmin!

— Neve andej, në mëhallën e sipërme na e prishi mendjen kulaku — tha Tahiri duke tundur atë kokën e mëdha majtas e djathtas.

Fshatarët thanë se letra ishte si ai melhemi çudibërës që e shëron plagën shumë shpejt dhe kishte mbërritur tamam në kohën e duhur, si dallandyshkat në pranverë. Mehmeti, mustaqemadhi, propozoi që t'i dërgohej Partisë një letër ku të thuhej se detyrimet do t'i shlyenin menjëherë, që të nesërmend. Lamja, duke fshirë syrin e kuq, tha që të shtohej edhe dëshira për të formuar kooperativën.

— Ne këtë duam të gjithë, — thirri Rasimeja midis shoqeve.

— Ta for-moj-më!... Ta for-moj-më, — brohoritën ritmikisht të rintjtë duke rrahur shuplakat.

— Pa shikoni Vishocicën, Rrëmbecin e Lumalasin, Vashtëminë e... Pse? C'janë ata? Më të mirë se ne?

— Ja që janë më të mirë!

— Pse? S'janë devollinj? Gjyshi Dule thotë se ç'të sheh syri më të majtë e më të djathtë, devollinj janë.

— Në Vishocicë kanë vënë edhe elektrik. Do ta vëmë edhe ne, në shtëpi edhe në rrugë, që të llapsë nata.

Mirëpo Tahiri kundërshtoi me shaka.

— Neve edhe drita e hënës s'na duhet, ai thotë do të vëmë elektrik që të llapsë nata. Por, po u bë kështu, si do të jetojë kjo raca ime pa vjedhur ndonjë misérkë, ndonjë kopan rrush a ndonjë nga ata që cirren: ki-ki-ki e be-be-be-!!

Plasi gazi. Shokët që e njihnin u habitën e thanë duke qeshur me lot e duke mbajtur ijet:

— Kur qenka bërë kaq shakaxhi ky dreq?

Kur pushoi gazi dhe u zgjodh komisioni prej tre vëtësh për të shkruar letrën që do t'i dërgohej Komitetit Qendror të Partisë, (në komision u zgjodhën Lytoja, gjyshi Dule dhe Rasimeja), Lytoja tha:

— Para se të ndahemi, të vendosim, si do të bëjmë me grumbullimin e drithit. Ju e dini që qyteti është në hall të madh. U turpëruam, shokë edhe shoqe, u turpëruam. Le të flasin ata që s'kanë dorëzuar ende.

Kasëm Sharra u ngrit menjëherë:

— Unë jam i pari, — tha

— Ke drithë?

— Kam.

— Kur je gati?

— Nesër që në mëngjes.

— Mirë, xha Kasëm. Tjetër.

— Unë, — tha Mehmeti.

— Hë! Bishtkoja i derrit!, — e goditi Qamili në ije më grusht.

— Ke drithë?, — e pyeti Lytoja.

— Nesër që në mëngjes e sjell.

— Jam edhe unë, — tha Tahiri, — ç't'i bëj atij xha-xhait tim, pa e kisha sjellë me kohë.

— Ke drithë?

— Ua! ke, pyet. Sa të duash, ore! Edhe gjer në vjesh-të të tretë.

— Tjetër?

U ngriten me radhë të gjithë ata që kishin thënë: «Të presim!...» dhe kush i turpëruar, kush i pezmatuar

nga vonesa pa vend, kush duke psherëtirë i lehtësuar, dhanë fjalën se do ta sillnin drithin që në mëngjes te zyra e këshillit popullor.

— Kemi bërë gabime. Na gënjen Nuriu e Jaçja. Të na falin shokët edhe pushteti! Të na falin punëtorët e qytetit, — tha një fshatar dhe u struk prapa shpinës së shokut se ndjeu që po nxihej e po skuqej nga inati e nga turpi.

Gjyshi Dule tha fjalën e fundit në atë mbledhje:

— Po dëgjove të sëmurin, sëmuresh edhe vetë!

Pastaj fshatarët u shpërndanë nëpër livadhe grupe-grupe dhe u shtruan për të ngrënë drekën. Të rinjtë ia morën këngëve të lashta e të reja. Shelqishtet u mbushën me zogj. Mrenjkat, të ngrohura nga dielli, filluan të kërcejnë mbi ujë në drejtim të kundërt me rrymën e lumi. Fëmijët zhyteshin pas tyre, me not.

— A mban mend ç'të kam thënë atëherë te lëndinat?, — e pyeti Rasimeja me vështrimin te uji shumë i kulluar i lumi.

— Unë s'harroj asgjë, — u përgjigj Skënderi duke hedhur guralecë në ujë e duke ndjekur rrathët që formoheshin prej tyre.

Kënga e të rinjve vinte valë-valë, shumë e harmonizuar.

— Po, ti më qortove atëherë.

Ai kishte mbështetur faqen te druri i një kumbulle. Pema ishte e re dhe lëkura nuk qe ashpërsuar ende. Vajza ia shikonte profilin me vetulla të holla, me qepallat e gjatë, si të fëmijëve, me buzë të hequra e të mbërthyera, që shprehnin vullnet e vendosmëri. Edhe lëkurën ai e kishte si të pemës së re. Ktheu kryet nga ajo dhe i tha:

— I tërheq fjalët.

— A do të më shash më?, — e pyeti Rasimeja me të qeshur.

— Kurrë!...

— Ti je i mirë... Sa i mirë je!

Kjo ishte e mrekullueshme, e mahnitshme. Asgjë në natyrë nuk mund të jetë aq e bukur. Vesonte shi me diell!

Ata të dy, që e shikonin nga dritarja, pyesnin pa fjalë: C'është kështu? C'bie ashtu nga qielli, aq émbël e aq butë, me të shtatë ngjyrat e ylberit? Pluhur floriri, xixëllonja të argjendta, hi xhevahiri nga yjet e bluar? Apo janë të gjitha së bashku, të përziera e të shkrira në një?!

Vesonte shi me diell!...

Lytoja rrinte mbështetur te pervazi i dritares. Skënderi qëndronte më këmbë dhe të dy shikonin përjashta e dëgjonin këngën e pavdekshme të natyrës. Dielli porsa kishte dalë mbi majën e malit, një diell i madh, verbues, kurse mbi fshat binin rrezet e tij të ngrohta dhe, së bashku me to, edhe shiu i imtë e i butë. Në dritare ishte një vazohelmetë me mëllagë. Kërcenjtë e lules zgjateshin drejt diellit, tërë leng e jetë, siç zgjatej tërë bimësia e fushës, tërë blerimi i ndezur i atij mëngjesi. Kudo ndihej forca e madhe e jetës edhe tek ai lumi i argjendtë me brigjet tërë pemë e korije shelgjishtesh, edhe tek ata të dy, që vështronin të menduar.

Në sheshin përpara këshillit popullor ishin grumbulluar shumë fshatarë me kuaj të ngarkuar. Ishte edhe një qerre plot me thasë të ngjeshur. Qetë përtypeshin. Kuajt pa gojëzë këputnin barin e njomë e qumështor rrëzë murit, kurse ata me fre brenin hekurin, përplasnin këmbët dhe nga patkonjtë u shkrepnin xixa.

Kaluan një grup vajzash me veglat e punës në duar. Ato i kishin hequr trikot e leshta dhe u dukeshin beli i hollë dhe llërët e shëndetshme. Hoqën edhe shamitë nga koka dhe dielli e shiu filluan të lozin me flokët e tyre. Vajzat qeshnin të gëzuara, sepse shiu ua bënte leshrat të dredhura, të bukura e të buta si mëndafshi. Si ranë në fushe, ia morën këngës.

Tërë natyra notonte në gjelbërim, në diell e në shi të vakët!

Lytoja, me sy të ngrohur, pëshpëriti:

— C'bukuri!

— Po këndoijnë, — tha Skënderi.

— Mua më duket sikur çdo gjë këndon, edhe dielli, edhe shiu, edhe lumi edhe fusha e malet. Çdo gjë. Kam gjithë këtë kohë që rri këtu duke ëndërruar për të ardhmen! Po mendojë: Si do të bëhet fshati ynë, kur t'i zhdukim gjerdhet, pas pesëmbëdhjetë a njëzet vjetësh? Pa mendo edhe ti! Fushën do ta vaditin kanalet. Traktorët do të punojnë tokën. Dëmalugu as që do të kujtohet më. Këto kasolle do të zhduken nga faqja e dheut dhe në vend të tyre do të ndërtojmë shtëpi të reja, të bukura, me kopshte e me fytyrën nga dielli. Mbi përroin e Shkozës do të ngremë stacionin elektrik. Do të kemi stallat e përbashkëta, hangarët, klubin, çerdhen përfëmijë, kinemanë tonë...

Tiparet e fytyrës, të ngrohura nga èndrra e bukur i e së ardhimes, i qenë zbutur.

— Sa èndërrimtar je ti, o Lyto!, — i tha Skënderi.

— Pa èndrra s'jetohet... Po èndrra, për mua, s'është kurrë vetëm èndërr. Ajo bëhet jetë. Èndërroj, se besoj që do të vihet në jetë. Këtu do të jemi, po s'e bëmë fshatin socialist.

— Edhé unë ashtu them, vëtëm se atëherë do të jemi pleq.

— Pleq me moshë, po me zemër të rinj. Ata që punojnë për popullin nuk plaken kurrë!

— Eh! C'vështirësi do të kemi...

— Po prandaj janë vështirësitë, që ne t'i kapërcejmë.

— Dhe armiqtë s'do të na lénë rehat.

Hyri Gjyshi Dule për bursën e mbeskës.

— Urdhëro, babagjysh! Ja ku e kam shkresën. E solle vajzën? — e pyeti Lytojë.

— E hipë në qerre.

— Mirë. Mos ki merak. E dorëzojmë ne me Skënderin në shkollë shëndoshë e mirë.

Plaku buzëqeshi. E kishte dëgjuar Skënderin kur tha: «armiqtë s'do të na lénë rehat» dhe donte t'i përgjigjej:

— Ti the ashtu, po dhe unë të them kështu, o trim: uji fle, hasmi s'fle, dhe, siç i kemi mundur, do t'i mundim, se na jep gjak Partia jonë!

Qeshi me zë dhe shtoi:

— E shihni gjyshin Dule?! Jam te qindi dhe s'kam ndërmend të vdes. Po në këtë pleqëri të thellë mësova të qesh, se ma fali gëzimin Partia...

Kur dolën, dielli ndriçonte e shiu i imtë shumëngjyrrësh vazhdonte të binte. Kishin ardhur të gjithë ata që s'e kishin shlyer detyrimin, kishin ardhur, me drithin ngarkuar nëpër kuajt e në një qerre. Lytoja ndjeu një gëzim të madh në shpirt, kur pa fytyrat e çelura të fshatarëve.

— Epo, nisemi, shokë!, — tha i mallëngjyer dhe i hodi Skënderit dorën në sup.

Qerrja gërviu. Kuajt rrahën potkonjtë. Një gjok i bardhë hingëlliu dhe karvani u nis drejt qytetit. Ky ishte për të gjithë udhëtimi më i bukur i atyre viteve. Edhe përmeskën e gjyshit Dule, që rrinte në qerre mbi thasët me drithë.

Ajo ishte e lumtur.

Mbi flokët e butë dhe mbi qerpikët e saj të gjatë avullonte vesa e shiut!